

Indeksi për gjithëpërfshirje:

udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Tony Booth dhe Mel Ainscow




4th edition
reprint

Indeksi për gjithëpërfshirje:

udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Tony Booth dhe Mel Ainscow



Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Tony Booth dhe Mel Ainscow

Edicioni i tretë dhe i katërt i rishikuar rrënjësisht nga Tony Booth

Edicioni i parë botuar në mars 2000

Edicioni i dytë botuar në shtator 2002

Edicioni i tretë botuar në maj 2011

Edicioni i katërt botuar në janar 2016

Rishtypur në prill 2017

Publikuar nga Index for Inclusion Network
(IfIN) 3 Norwich Street, Cambridge, CB2 1ND.

Tel: 07813 974694

email: info@indexforinclusion.org

Publikimi © e drejta e autorit Index for Inclusion Network

Lejohet fotokopjimi i pjesëve të këtij dokumenti për
përdorim arsimor me qëllim promovimin e zhvillimit arsimor
gjithëpërfshirës. Të gjitha të drejtat e tjera janë të
rezervuara

Teksti © e drejta e autorit Tony Booth 2016

Dizajni për edicioni e 4-të u adaptua nga Jannie Brightman

Shtypja dhe lidhja nga Fuller Davies

Katalogu për këtë libër është i qasshëm në British Library.

ISBN 978-0-9935122-0-9



Index for Inclusion Network (Rrjeti i Indeksit për gjithëpërfshirje) u themelua në vitin 2012 për të promovuar punën me *Indeksin për gjithëpërfshirje* në mbarë botën dhe aktivitete të tjera që kanë për qëllim vënien në veprim të vlerave gjithëpërfshirëse.

Përmbajtja

Mirënjohje	4
Historiku i edicionit të katërt	5
Fillimi	6
Pjesa 1: Përmbledhje e Indeksit	7
Pjesa 2: Një qasje e vetme për zhvillimin e shkollës suaj	19
Udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse	21
Sqarim për gjithëpërfshirjen	22
Zhvillimi i një kuadri të vlerave	24
Parimet pedagogjike plotësuese	34
Vëmendja ndaj gjërave të domoshdoshme	35
Pjesëmarrja në kurrikulë	36
Formimi i aleancave	41
Pengesat, burimet dhe mbështetja	44
Materialet për shqyrtim	49
Pjesa 3: Përdorimi i Indeksit për të ndërmarrë veprim	53
Rrugët drejt zhvillimit të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse	55
Faza 1: Fillimi	56
Faza 2: Kuptojmë së bashku	67
Faza 3: Përpilimi i një plani	73
Faza 4: Ndërmarrja e veprimit	73
Faza 5: Shqyrtimi i zhvillimit	75
Pjesa 4: Treguesit me pyetje	77
Dimensioni A: Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse	79
A1: Ndërtimi i komunitetit	80
A2: Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse	99
Dimensioni B: Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse	101
B1: Zhvillimi i shkollës për të gjithë	102
B2: Organizimi i mbështetjes së diversitetit	115
Dimensioni C: Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse	124
C1: Përpilimi i një kurrikule për të gjithë	125
C2: Orkestrimi i të nxënit	163
Pjesa 5: Kuadri i planifikimit dhe Pyetësorët	177
Kuadri i planifikimit	179
Pyetësori 1: Treguesit	180
Pyetësori 2: Shkolla e fëmijës tim	182
Pyetësori 3: Shkolla ime (për fëmijët dhe të rinjtë)	184
Pyetësori 4: Shkolla ime (për fëmijët më të vegjël)	186
Pjesa 6: Burimet	187

Mirënjohje

Idetë për këtë libër u zhvilluan nga bisedat me shumë njerëz gjatë dekadës së fundit. Janë disa persona që meritojnë të përmenden në mënyrë të veçantë. Inkurajimi dhe komentet e Judith Carter-it kanë qenë mbështetëse, jo më pak ekspertiza e saj në koordinimin e punës me Norfolk County Council (Këshillin e kontes së Norfolk-ut) dhe përkushtimi i saj për ta bërë *Indeksin* kompatibil me kuadrin e inspektimit të shkollave. Sue Buckingham-i më prezantoi me të drejtat planetare të cilave në fillim u rezistova por pastaj i përqafova. Grupi nga Transitions Cambridge, Anna McIvor, Mark Skipper, Myriam Thomachot dhe Margaret Parker për kohën dhe ekspertizën e tyre. Përvoja dhe komentet nga Stephen Scoffham, Gill Hope, Jill Matthews, Jonathan Barnes, nga Universiteti Canterbury Christ Church më dhanë besim se puna për kurrikulën kishte përdorim teorik dhe praktik. Andreas Hinz-i dhe Barbara Brokamp-i ofruan perspektivën e tyre si persona që kanë punuar një kohë të gjatë me *Indeksin* në Gjermani dhe Kari Nes-i ka bërë të njëjtën për Norvegjinë. Kari Nes-i dha kontribut të veçantë për Traditën evropiane të didaktikës me pyetjet rreth përmbajtjes së kurrikulës dhe Barbara me idetë e saj domethënëse për procesin e punës me *Indeksin* dhe mënyrat e mbështetjes së tij përmes 'shoqëruesve të procesit'. Sugjerimi dhe miratimi nga Susan Hart ishin të rëndësishme për atë që unë përpiquesha të bëja. Em Williams-i për insitimin e saj të drejtë për një rishikim në lidhje me binarizmin gjinor. Jannie Brightman, Mary Young, Jane Carpenter, Alison Peacock, Peter Pope, Hannah Booth, Katie Booth, Ben Greig, Astrid Greven, Mark Antopolski, Nigel Pickford, Pat Yarker po ashtu ofruan komente shumë të dobishme.

Falënderim edhe për fotografët nga shkollat: Burston and Tivetshall, Caister Junior, Diss High School, Edward Worlledge, Hanover Primary and Nursery, Hemsby Primary, Hemsby High School, Highgate Infants, Holloway, Parkside, Roydon Junior, Wroxham School dhe Tom dhe Clair Mein për Pemën e ullirit. Stuart Beard-i ofroi disa foto mahnitëse të të rriturve dhe fëmijëve gjatë punës dhe lojës, ashtu sikur edhe Hannah Burns-i të aktiviteteve në Tyrrels Wood. Falënderojmë kompaninë Candoco dance për foton në faqe 47. Jill Eastland-i vizatoi fierin dhe lulet e bukura në pjesën 1, Denise Knowelden-i dha ndihmën e saj në lidhje me disa redaktime në momentin e duhur dhe Jannie Brightman-i vuri në punë një nga shkathtësitë e saj të shumta në adaptimin e këtij edicioni. Falënderojmë kolegët tonë spanjollë që na lejuan të imitojmë kopertinën në versionin e tyre të përkthyer të *Indeksit*: Gerardo Echeita, Cecilia Simon, Marta Sandoval dhe Yolanda Munoz.

Shkollat e pilot projektit të *Indeksit në Norfolk*. **Kopshtet dhe institucionet parashkollore:** Clover Hill. **Kopshtet:** Colman, Costessy, Lodge Lane, Recreation Road.

Shkollat e juniorëve: Caister, Edward Worlledge, Lingwood, St. Michael's, Wroughton.

Shkollat fillore: Bignold, Bishop's, Bluebell, Cawston, Colby Ditchingham Fairstead, Hapton, Heartsease, Roydon, Sporle, Tacolneston, Terrington St John, Tilney St Lawrence, Walpole Highway, Whitefriars, Wicklewood.

Shkollat e mesme: Broadland High, Downham Market High, Hewett Comprehensive, Hobart High, King Edward VII High, Springwood High.

Shkollat speciale: Churchill Park, Sidestrand.

Historiku i edicionit të katërt

Edicioni i parë u botua në vitin 2000 me nëntitullin: zhvillimi i të nxëniet dhe pjesëmarrjes në shkolla. Ekipi i parë i *Indeksit* përbëhej nga Mel Ainscow-i dhe Mark Vaughan-i. Përmbajtja e edicionit të parë u karakterizua veçanërisht nga puna e Tony Booth-it dhe kolegëve të tij, Patricia Potts dhe Will Swann në Open University, duke lidhur gjithëpërfshirjen me zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës parashkollor, fillor dhe të mesëm të komunitetit dhe nga puna e Mel Ainscow-it rreth përmirësimit të shkollave.

Qeveria u ofroi një kopje të edicionit të parë të gjitha shkollavefillore, të mesme, shkollave speciale dhe autoriteteve lokale të arsimit në Angli. Edicioni i dytë, i ngjashëm me të parin, u publikua në vitin 2002 dhe u shpërnda nga Asambleja e Uellsit në të gjitha shkollat në Uells, në gjuhën e Uellsit-it ose në gjuhën angleze.

Versionet e *Indeksit* për vitet e hershme dhe kujdesin për fëmijët u zhvilluan në vitin 2004 dhe 2006.¹ Përveç shtrirjes së *Indeksit* për fëmijët shumë të vegjël dhe bebet, pas rishikimeve projekti vazhdoi më tej duke e shtuar rëndësinë e mirëqenies për fëmijët dhe të rriturit dhe duke e theksuar rëndësinë e lojës.

Ndonëse libri është përpiluar për shkollat në Angli, ai nuk paraqet dokument tipik të Anglisë. Ai pasqyron dialogët e panumërt me kolegët në mbarë botën. Libri e sheh përmirësimin e arsimit të shtyrë përpara nga vëmendja në përparimin e mësimdhënies, të nxëniet dhe marrëdhënieve e jo me fokus të vetëm në rezultatet e arritjeve. Qasja e tij ndaj zhvillimit është parë relevante për shumë vende dhe është përkthyer dhe përshtatur për përdorim në rreth 50 vende. Një ekip ndërkombëtar i mbështetur nga UNESCO-ja ka shqyrtuar mundësinë e zhvillimit të versioneve për zonat ekonomikisht të varfra të vendeve në zhvillim.²

Kam bërë ndryshime rrënjësore në edicionin e tretë të publikuar në vitin 2011 dhe ia kam kushtuar atë dekadës së biodiversitetit 2011 deri 2020. Ky version pasqyron të parën në Angli³ dhe në vende të tjera gjatë një periudhe dhjetëvjeçare. Prezantonte një kuadër të vlerave gjithëpërfshirëse si përgjigje ndaj pyetjes 'si duhet të jetojmë së bashku?' Versioni përmbledhi ndërhyrjet parimore që kanë të bëjnë

me qëndrueshmërinë mjedisore, qytetarinë kombëtare dhe globale, jo-dhunën, arsimin demokratik dhe promovimin e shëndetit brenda një qasje të vetme. Përfshinte shqetësimet për mjedisin si një domosdoshmëri për arsimin që duhet të shkojë krah për krah me domosdoshmërinë e nxitjes së marrëdhënieve jo të dhunshme në nivel lokal dhe global. Bënte thirrje për dialog rreth përmbajtjes së kurrikulës duke paraqitur një përgjigje të shekullit të 21 për pyetjen: 'Çfarë duhet të dimë për të jetuar mirë së bashku?' Kjo e ndihmoi *Indeksin* të përmbushë më me ndershmëri se më parë pohimin se ai përcakton implikimet e vlerave gjithëpërfshirëse për të gjitha aspektet e shkollave.

Në edicionin e katërt kam bërë ndryshime relativisht të vogla. Nëntitulli është i ri: *udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse*. Kjo e bën më të qartë se *Indeksi* ka të bëjë me zhvillimin e shkollave dhe përmirësimin që përfshin të rriturit dhe fëmijët dhe të gjitha aspektet e shkollave. Duhet të ndihmojë për të kapërcyer pikëpamjen e gjithëmbarshme se gjithëpërfshirja ka të bëjë me një grup të veçantë të fëmijëve që shihen si 'fëmijë me nevoja të veçanta arsimore'. Krahason zhvillimin e 'udhëhequr nga vlerat' me zhvillimin e 'udhëhequr nga rezultatet', qasje që ka dominuar pikëpamjen për përmirësimin e shkollave në Angli dhe në vende të tjera për shumë vite. Duke e bërë këtë synon të rrisë qëndrueshmërinë e një grupi të zgjeruar të rezultateve.

Vlerat tani përfaqësohen në një strukturë tredimensionale pa ndonjë sugjerim të hierarkisë. Kam prezantuar idenë e 'njohjes së vlerave' për ta emëruar procesin e studimit të lidhjeve të vlerave me veprimet. Kam krahasuar vlerat përfshirëse me vlerat përjashtuese. Shumë kolegë i shohin këto të fundit të pasqyruara në aspektet e shkollave të tyre. Detyra për zhvillim është vënia në veprim e vlerave gjithëpërfshirëse dhe shkëputja e veprimeve nga vlerat përjashtuese. Kam dhënë indikacione se si një qasje e udhëhequr nga vlerat mund të ndihmojë për t'u përgatitur dhe për t'ju përgjigjur inspektimeve. *Indeksi* mbështetet nga faqja e internetit indexforinclusion.org, ku ofrohen informacione për përdorimin e tij në Angli dhe në vende të tjera, burime të tjera dhe mundësi për dhënie e mendimit tuaj.

Tony Booth janar 2016

1 Booth, T., Ainscow, M. and Kingston, D. (2004, 2006) *Index for inclusion: developing play, learning and participation in early years and childcare* [Indeksi për gjithëpërfshirje: zhvillimi i lojës, të nxëniet dhe pjesëmarrja në vitet e hershme dhe kujdesi për fëmijët], Bristol, CSIE.

2 Booth, T. and Black-Hawkins, K., (2001, 2005). *Developing learning and participation in countries of the South; the role of an Index for inclusion* [Zhvillimi i të nxëniet dhe pjesëmarrjes në vendet në zhvillim, roli i një *Indeksi* për gjithëpërfshirje], Paris, Unesco.

3 Rustemier, S. and Booth, T., (2005). *Learning about the Index in use: A study of the use of the Index for inclusion in schools and LEAs in England* [Për *Indeksin* në përdorim: Studim i përdorimit të *Indeksit* për përfshirje në shkolla dhe LEA në Angli], Bristol, CSIE.

Fillimi

Libri është një udhëzues gjithëpërfshirës për zhvillimin e shkollës suaj.

Kolegët në Gjermani kanë qenë ndër më krijuesit për t'i shtyrë njerëzit që të punojnë me materialet e *Indeksit*. Megjithëse disa shkolla e përdorin *Indeksin* për ta mbështetur zhvillimin e tërë shkollës nga fillimi, shpesh kjo nuk ndodh. Ndryshime të vogla mund të zhvillohen në angazhimet e tërë shkollës kur të tjerët i shohin përfitimet që kolegët e tyre nxjerrin nga puna me materialet e *Indeksit*. Inkurajimi i mëposhtëm për të filluar është përshtatur nga një listë e këshillave dhënë personave në Gjermani⁴. Pika 9 vjen nga kolegët australianë që kanë punuar me materialet e *Indeksit* në mënyra po ashtu fleksibile, në Queensland⁵ dhe nga përvoja e punës me shkollat nën presion në Norfolk. Idetë për të filluar me *Indeksin* janë zhvilluar më tej në Pjesën 3.

1. Filloni – filloni kudo, edhe duke e gjetur dhe diskutuar një pyetje interesante, prapë është më mirë sesa të mos filloni fare.
2. Mbani shënime të shkurtra për punën tuaj në një fletore dhe përdorni aparat fotografik.
3. Përfshini të tjerët që kanë mendimet e njëjta me ju.
4. Nëse nuk jeni anëtar i lartë i stafit përpuni ta përfshini dikë që është.
5. Flisni me të rinjtë ose me të rriturit me të cilët nuk konsultoheni zakonisht për prioritetet e tyre për zhvillim në shkollë.
6. Filloni duke bërë një ndryshim të vogël që është brenda kompetencave tuaja.
7. Përpiloni një listë të iniciativave aktuale në shkollë. Si mund t'i lidhë së bashku ato *Indeksi*?
8. Shqyrtoni kuadrin e vlerave në pjesën 2 të *Indeksit*. Cilin aktivitet mund ta ndryshoni në shkollë në mënyrë që veprimet të pasqyrojnë më nga afër vlerat tuaja?
9. Mendojeni një ndryshim që ju dhe/ose të tjerët shpresojnë ose përpiqen ta bëjnë. Ndoshta kjo është tashmë në planin tuaj zhvillimor. Gjeni treguesin më të relevant. Përdoreni për ta përsosur planin tuaj.
10. Nëse punoni vetëm, gjeni dikë që ka përvojë pune me *Indeksin* për t'ju mbështetur.



⁴ Barbara Brokamp, Montag Stiftung Jugend und Gesellschaft, *Practical Hints*.

⁵ Suzanne Carrington dhe Robin Robinson, komunikim personal

1 Përmbledhje e *Indeksit*



“Puna me Indeksit ka ringjallur planifikimin për përmirësimin e shkollës sonë, duke na mundësuar që t'i shqyrtojmë çështjet dhe shqetësimet në një mënyrë krejt tjetër. Na ka pëlqyer puna me të dhe do të vazhdojmë ta bëjmë...”

– June Sewell, George White Junior School

“Indeksi ka qenë si një mik kritik, me pyetje që të ndihmojnë ta shikosh një çështje ndryshe dhe pastaj t'i çosh para përmirësimit.”

– Elly Roberts,
Highgate Infant School



“Indeksi ka dhënë një kuadër për të parë se si të gjithë përfshihen në komunitetin tonë shkollor. Ai na ofron struktura dhe na nxit të kërkojmë pikëpamje dhe mendime se si mund ta përmirësojmë shkollën tonë. Duke u përqendruar në vlerat e pjesëmarrjes dhe komunitetit na ka mundësuar të punojmë së bashku për të arritur rezultatet më të mira për të gjithë.”

– Nick Southgate, Colman Infant School

“E kam përdorur Indeksit si mjet për të ndihmuar në rifokusimin në vlerat e shkollës; na ka... dhënë strukturën për t'i mundësuar palëve të interesit që të përfshihen në mënyrë aktive në përmirësimin e shkollës. Do t'ja rekomandoja Indeksit çdo shkolle që po fillon rrugëtimin e saj të përmirësimit të shkollës, më ka ndihmuar me të vërtetë.”

– Jane Jewson, King Edward VII High

“Indeksi ka çuar në një marrëdhënie pune bashkëpunuese me dy shkolla të tjera, për t'i përmirësuar rezultatet për fëmijët. Kemi përdorur Indeksit si mjet për të zbuluar zërin e nxënësve dhe pjesëmarrjen e komunitetit në projekte të vlefshme. Ka qenë fantastike të shohim entuziazmin e nxënësve gjatë gjetjes dhe diskutimit të mënyrave për të punuar së bashku. Besoj se kjo punë në partneritet do të vazhdojë të rritet edhe më.”

– Coral Brinklow, Caister Junior

“Indeksi ka sjell bashkëpunimin në mes shkollës sonë fillore dhe shkollës Caistor Junior dhe Caistor High. Nxënësit kanë pëlqyer sidomos punën me nxënësit më të rritur se ata... Janë krenar që përfaqësojnë shkollën tonë por gjithashtu edhe 'këshillat e ri ndërshkollorë', pjesë e të cilave janë tani.


Përvojë e shkëlqyer si për nxënësit ashtu edhe për stafin.” – Edward Savage, Hemsby Primary

Përmbledhje e Indeksit

Si mund t'ju ndihmojë *Indeksi* për ta zhvilluar shkollën tuaj?

Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlera gjithëpërfshirëse është një grup materialesh që mbështet shqyrtimin dhe zhvillimin e të gjitha aspekteve të një shkolle; në sheshet e lojërave, sallat e stafit, klasat dhe komunitetet dhe mjediset përreth.

Inkurajon pjesëmarrjen e gjerë në zhvillimin dhe zbatimin e planeve gjithëpërfshirëse të përmirësimit.





Çfarë është zhvillimi gjithëpërfshirës?

Ne e pranojmë ndryshimin si zhvillim ose përmirësim kur reflekton vlerat tona. Ai bëhet zhvillim gjithëpërfshirës kur udhëhiqet nga vlerat gjithëpërfshirëse.

Për ta bërë gjënë e duhur duhet bërë lidhja e veprimeve dhe vlerave.

Ndërlidhja e veprimeve me vlerat mund të jetë hapi më praktik në zhvillimin e një shkolle.

Vlerat janë besime që zënë vend thellë tek ne që na shtynë të veprojmë. Ne i kuptojmë vlerat më shumë përmes veprimeve sesa përmes fjalëve. Fjalët e bukura bëhen tituj për vlerat kur i lidhim ato me besimet tona të thella, u japim kuptim të hollësishëm dhe pastaj veprojmë bazuar në to.



Kuadri apo universi i vlerave i përgjigjet pyetjes:
‘Si duhet të jetojmë së bashku?’
 Treguesit dhe pyetjet e Indeksit përpiqen t'i përgjigjen kësaj pyetjeje për arsimin.

Dimensionet, seksionet dhe treguesit e Indeksit

Dimensioni A: Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse

A1: Ndërtimi i komunitetit

1	Të gjithë janë të mirëpritur.	80
2	Stafi bashkëpunon.	81
3	Fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin.	82
4	Stafi dhe fëmijët respektojnë njëri-tjetrin.	83
5	Stafi dhe prindërit/kujdestarët bashkëpunojnë.	84
6	Stafi dhe administratorët punojnë mirë së bashku.	85
7	Shkolla është model i qytetarisë demokratike.	86
8	Shkolla e inkurajon kuptimin e ndërlidhjeve ndërmjet njerëzve në mbarë botën.	87
9	Të rriturit dhe fëmijët i përgjigjen mënyrave të ndryshme të përjetimit të gjinisë.	88
10	Shkolla dhe komunitetet lokale e zhvillojnë njëra tjetrën.	89
11	Stafi e ndërlidh atë që ndodh në shkollë me jetën e fëmijëve në shtëpi.	90

A2: Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse

1	Shkolla zhvillon vlera të përbashkëta gjithëpërfshirëse.	91
2	Shkolla nxit respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut.	92
3	Shkolla inkurajon respektin për integritetin e planetit Tokë.	93
4	Gjithëpërfshirja shihet si pjesëmarrje në rritje për të gjithë.	94
5	Pritjet janë të larta për të gjithë fëmijët.	95
6	Fëmijët vlerësohen në mënyrë të barabartë.	96
7	Shkolla lufton të gjitha format e diskriminimit.	97
8	Shkolla nxit ndërveprimet dhe zgjidhjet jo të dhunshme të mosmarrëveshjeve.	98
9	Shkolla inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten.	99
10	Shkolla kontribuon në shëndetin e fëmijëve dhe të rriturve.	100

Dimensioni B: Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse

B1: Zhvillimi i shkollës për të gjithë

1	Shkolla ka një proces zhvillimi me pjesëmarrje.	102
2	Shkolla ka qasje gjithëpërfshirëse në udhëheqje.	103
3	Emërimet dhe promovimet janë të drejta.	104
4	Ekspertiza e stafit njihet dhe përdoret.	105
5	Stafi i ri ndihmohet për t'u vendosur në shkollë.	106
6	Shkolla përpiqet të pranojë të gjithë fëmijët nga lokaliteti i saj.	107
7	Të gjithë fëmijët e rinj ndihmohen të vendosen në shkollë.	108
8	Grupet e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të organizuara drejt për të mbështetur nxënien e të gjithë fëmijëve.	109
9	Fëmijët janë të përgatitur mirë për të kaluar në shkolla të tjera.	110
10	Shkolla është bërë fizikisht e qasshme për të gjithë.	111
11	Ndërtesat dhe terreni janë zhvilluar për të mbështetur pjesëmarrjen e të gjithëve.	112
12	Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit.	113
13	Shkolla kontribuon në reduktimin e mbeturinave.	114

B2: Organizimi i mbështetjes së diversitetit

1	Të gjitha format e mbështetjes janë të koordinuara.	115
2	Aktivitetet e zhvillimit profesional të stafit ndihmojnë në përgjigje ndaj diversitetit.	116
3	Gjuha angleze si mbështetje në gjuhë tjetër është burim për tërë shkollën.	117
4	Shkolla mbështet vazhdimësinë në arsimimin e fëmijëve në kujdesin publik.	118
5	Shkolla siguron që politikat për 'nevojat e veçanta arsimore' mbështesin gjithëpërfshirjen.	119
6	Politika e sjelljes është e lidhur me mësimin dhe zhvillimin e kurrikulës.	120
7	Presionet për përjashtim disiplinor janë ulur.	121
8	Pengesat për vijimin e shkollës janë zvogëluar.	122
9	Ngacmimi është minimizuar.	123

Dimensioni C: Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse**C1: Përpilimi i një kurrikule për të gjithë**

1	Fëmijët eksplorojnë ciklet e prodhimit dhe konsumin e ushqimit.	126
2	Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit.	130
3	Fëmijët i studiojnë veshjet dhe stolitë e trupit.	132
4	Fëmijët mësojnë rreth banimit dhe mjedisit të ndërtuar.	134
5	Fëmijët shqyrtojnë si dhe pse njerëzit lëvizin në lokalitetin e tyre dhe botë.	136
6	Fëmijët mësojnë për shëndetin dhe marrëdhëniet.	138
7	Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin.	141
8	Fëmijët studiojnë jetën në tokë.	145
9	Fëmijët hetojnë rreth burimeve të energjisë.	150
10	Fëmijët mësojnë rreth komunikimit dhe teknologjisë së komunikimit.	153
11	Fëmijët angazhohen dhe merren me krijime në literaturë, art dhe muzikë.	155
12	Fëmijët mësojnë për punën dhe e lidhin atë me zhvillimin e interesave të tyre.	158
13	Fëmijët mësojnë për etikën, pushtetin dhe qeverinë.	160

C2: Orkestrimi i të nxënit

1	Aktivitetet mësimore planifikohen duke pasur parasysh të gjithë fëmijët.	163
2	Aktivitetet mësimore inkurajojnë pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve.	164
3	Fëmijët inkurajohen të kenë vetëbesim dhe të zhvillojnë mendimin kritik.	165
4	Fëmijët janë të përfshirë në mënyrë aktive në të nxënit e tyre.	166
5	Fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri.	167
6	Mësimet zhvillojnë aftësinë për të kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve.	168
7	Vlerësimet inkurajojnë arritjet e të gjithë fëmijëve.	169
8	Disiplina bazohet në respekt të ndërsjellë.	170
9	Stafi planifikojnë, japin mësim dhe rishikojnë së bashku.	171
10	Stafi zhvillon burime të përbashkëta për ta mbështetur të nxënit.	172
11	Ndihmës mësimdhënësit mbështesin të nxënit dhe pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve.	173
12	Detyrat e shtëpisë caktohen që të kontribuojnë në të nxënit e të gjithë fëmijëve.	174
13	Aktivitetet jashtë mësimave të shkollës përfshijnë të gjithë fëmijët.	175
14	Burimet në lokalitetin e shkollës njihen dhe shfrytëzohen.	176

Secili tregues, ose aspiratë për zhvillim, sqarohet me pyetjet që lidhin kuptimin e tij dhe ofrojnë ide për zhvillim.

C2.3 Fëmijët inkurajohen të kenë vetëbesim dhe të zhvillojnë mendimin kritik.

C2.4 Fëmijët janë të përfshirë në mënyrë aktive në të nxënit e tyre.

- a) A e mbështesin stafi njëri-tjetrin për të pasur vetëbesim dhe mendim kritik?
- b) A është kuptuar se dialogu funksionon më së miri kur njerëzit lënë mënjanë dallimet e pushtetit dhe statusin e perceptuar?
- c) A e tregon stafi se i respekton dhe vlerëson pikëpamjet alternative?
- d) A inkurajohen fëmijët dhe të rriturit që të shprehin pikëpamjet e tyre me vetësiguri dhe në mënyrë jo agresive?
- e) A inkurajohen debatet në mënyrë që njerëzit të dëgjojnë pikëpamje të ndryshme nga ato të tyre dhe të praktikojnë të shprehurit?
- f) A nxiten fëmijët të zhvillojnë dhe shprehin pikëpamjet dhe ndjenjat për ngjarje të rëndësishme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, siç është rasti kur vendi i tyre është në luftë ose kur ka ndodhur një katastrofë në vendin e tyre apo në një vend tjetër?
- g) A nxiten fëmijët të bëjnë pyetje sfiduese?
- h) A e njohin ata që janë në anët e kundërta të argumenteve rëndësishme e pikëpamjeve të tjera për sqarimin e mendimeve dhe arritjen e zgjidhjeve të përbashkëta për problemet?
- i) A mësojnë fëmijët të zbulojnë kontradikta në argumentet e tyre dhe të personave të tjerë?
- j) A mësojnë fëmijët dhe të rriturit të peshojnë forcën e argumenteve duke përfshirë edhe të tyre?
- k) A mësojnë fëmijët kur e vërteta e një pohimi ose argumenti kërkon dëshmi mbështetëse?
- l) A mësojnë fëmijët se si të përdorin shembuj për të mbështetur një argument?
- m) A mësojnë fëmijët se si shembujt e zgjedhur me kujdes mund të tregojnë limitet e përgjithësimeve?
- n) A mësojnë fëmijët të shtrojnë pyetjet 'në çfarë mase..?' dhe 'në cilat rrethana...?' kur njerëzit pohojnë se diçka është e vërtetë për botën (për shembull për dallimet midis gjinive)?
- o) A mësojnë fëmijët se si ta vlerësojnë audiencën të cilës iu bën thirrje një pjesë e shkruar?
- p) A mësojnë fëmijët se si njerëzit e marrin si të mirëqenë se disa argumente janë të vërteta, edhe kur nuk janë, sepse duket se bartin zërin e autoritetit?
- q) A i identifikojnë fëmijët dhe të rriturit besimet dhe vlerat që theksojnë dallimet e pikëpamjeve?
- r) A ndihmohen fëmijët dhe të rriturit që të rrisin rrjedhshmërinë e tyre në argumentim?
- s) A mësojnë fëmijët për presionet që iu bëhen për të menduar dhe vepruar në mënyra të caktuara?
- t) A i shqyrtojnë fëmijët arsyet për mendimet që shprehin?
- u) A mbështeten të gjithë ata që marrin pjesë në dialog për ta ruajtur vetëbesimin e tyre?
- v) A e shmangin njerëzit triumfalizmin kur mendojnë se kanë fituar një argument?
- w) A i ndihmojnë fëmijët dhe të rriturit mentorë të tjerët për të kontribuar me pikëpamjet e tyre?
- x) A i kushtohet vëmendje e veçantë ofrimit të ndihmës për ata që janë më të turpshëm për të folur, për të dhënë kontribut?

aa) _____

ab) _____

ac) _____

Secili tregues nis me sugjerime për marrëdhëniet e tij me treguesit e tjerë.

Kjo shërben për të treguar se mund të shtoni pyetjet tuaja. Nuk ka limite në pyetjet që mund të shtohen.

Mbështetje për zhvillimin e kurrikulës

Seksioni C1 në *Indeks* përshkruan një mënyrë të re të ndarjes së aktiviteteve të mësimdhënies dhe mësimxënies nën 13 tituj të lëndëve. Ofron lëndë shtesë dhe rikombinim të lëndëve tradicionale si një kurrikulë për shekullin 21. Përdoret për t'i ndihmuar shkollat që të zgjerojnë kurrikulat e tyre në mënyrë që ato të lidhen më mirë me përvojën e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre. Del nga vlerat, parimet dhe imperativët e promovuar brenda *Indeksit*.

Është menduar si një program ndërkombëtar dhe ndërlidhës, që ka kuptim në çdo vend të botës. Është mënyrë e ndarjes së dijes për të gjithë – brenda dhe jashtë shkollave – gjatë gjithë jetës.

I jep përgjigje pyetjes:

‘Çfarë duhet të dimë për të jetuar mirë së bashku?’

Figura 2 Lëndët për një kurrikulë të shekullit të 21



Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Zhvillimi i udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse bashkon të gjitha qasjet parimore për zhvillimin e shkollave...

Shkollat janë të përfshira në shumë aktivitete për të promovuar zhvillimin e tyre, të cilat ndajnë vlera të përbashkëta me *Indeksin*. *Indeksi* ndihmon për t'i bashkuar ato në një qasje të vetme; një pemë të vetme që merr forcë nga shumë rrënjë.

Aleancat për zhvillimin arsimor gjithëpërfshirës



Pra në vend se të përfshiheni në disa nisma të ndryshme, ju mund t'i lidhni ato së bashku në një qasje të vetme kah zhvillimi i udhëhequr nga vlerat. Në këtë mënyrë, ato mbështesin njëra-tjetrën, ju kurseni përpjekjet dhe keni kontroll më të madh të zhvillimit të shkollës suaj. Në këtë e quajmë qasje të vetme, 'zhvillim arsimor gjithëpërfshirës', por e rëndësishme është që të krijohen lidhjet, andaj nuk ka rëndësi nëse e quani 'gjithëpërfshirës' apo 'demokratik' apo 'i qëndrueshëm' apo i vini emër tjetër. Është përpjekja për të vënë në veprim vlerat gjithëpërfshirëse që ne e konsiderojmë të rëndësishme, e jo emri i detyrës apo përdorimi domosdoshmërisht i *Indeksit* për t'ju mbështetur, ndonëse mendojmë se ai mund t'ju ndihmojë shumë.

Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Si punohet me *Indeks*?

Përdorimi i *Indeksit* mund të fillojë kudo: me ndryshimet në praktikë që dalin nga fokusi në vlerat në veprim; shqyrtimi i implikimeve për zhvillimin e një treguesi dhe pyetjeve të tij që tashmë janë me rëndësi të veçantë për ju ose janë bërë të tilla pas një inspektimi; me fokus në një pyetje të vetme për të nxitur dialogun; interesi në shqyrtimin e aspekteve të kurrikulës; ose si mënyrë për të kuptuar një numër ndërhyrjesh individuale në një shkollë.

Indeksi nxit përfshirjen e gjerë të stafit, fëmijëve, familjeve dhe administratorëve në shqyrtimin dhe përmirësimin e aktiviteteve. Zgjerimi i përfshirjes edhe vetë është pjesë e zhvillimit gjithëpërfshirës. Ndihton në shpërndarjen e njohurive dhe energjisë për veprim brenda komuniteteve të shkollës.

Por ndonëse mund të filloni kudo, *Indeksi* mund të përdoret më fuqishëm kur ndihmon në zhvillim dhe pastaj integrohet në proceset rutinë të planifikimit dhe zhvillimit, në krijimin dhe zbatimin e një plani zhvillimor të shkollës.

Indeksi është i ndarë në tre dimensione për të strukturuar zhvillimin e shkollës:

Kulturat pasqyrojnë marrëdhënie dhe vlera dhe besime të thella. Ndryshimi i kulturës është thelbësor për mbështetjen e zhvillimit.

Politikat kanë të bëjnë me mënyrën se si menaxhohet shkolla dhe planet për ta ndryshuar atë.

Praktikat kanë të bëjnë me atë çfarë mësohet nga nxënësit dhe ofrohet nga mësuesit dhe mënyrat e mësimit dhe mësimit.

Secili dimension ndahet në dy seksione. Dimensionet dhe seksionet formojnë një kuadër të planifikimit në mënyrë që ndryshimet e bëra në një fushë të mbështeten nga ndryshimet e nevojshme në të tjerat.

Figura 3

Dimensionet e zhvillimit të *Indeksit*




Figura 4.

Kuadri i planifikimit

Dimensioni A:

Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse

A1: Ndërtimi i komunitetit

A2: Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse

Dimensioni B:

Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse

A1: Zhvillimi i shkollës për të gjithë

A2: Organizimi i mbështetjes së diversitetit

Dimensioni C:

Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse

A1: Përpilimi i një kurrikule për të gjithë

A2: Orkestrimi i të nxënësve

Si mund t'ju ndihmojë *Indeksi* që t'i përgjigjeni presioneve të jashtme?

Të gjitha shkollat i nënshtrohen presioneve të jashtme duke përfshirë inspektimin, testet kombëtare dhe politikën dhe udhëzimet nga qeveria. *Indeksi* mund t'ju ndihmojë shkollat t'ju përgjigjen kërkesave të tilla në mënyra që pasqyrojnë vlerat e tyre.

Përgjigja ndaj inspektimit

Kemi paraqitur treguesit e *Indeksit* në kuadrin e inspektimit të Ofsted-it duke treguar se si ata i adresojnë të gjitha shqetësimet e tij si pjesë e një qasjeje koherente ndaj zhvillimit. Referojuni faqes sonë indexforinclusion.org për versionin e fundit të këtij dokumenti. Vetëvlerësimi me pjesëmarrje i mbështetur nga *Indeksi* mund të përdoret për të siguruar dëshmi bindëse të aktiviteteve për vetë-rishikimin e kërkuar nga kuadri. Pas inspektimit, *Indeksi* mund të japë ide për veprim të menjëhershëm në rekomandimet e raporteve të Ofsted-it. Kjo është veçanërisht e vlefshme kur pas një raporti të pafavorshëm vullneti mund të jetë i ulët. Siç ka thënë një drejtor i shkollës "*Indeksi* i shton qartësi dhe fokus Ofsted-it".

Puna me numrat

Krahasimet e performancës në teste dhe provime, në mes shkollave, dhe gjatë viteve në të njëjtën shkollë, kanë qenë më të rëndësishmet në përcaktimin e klasifikimit që marrin shkollat pas inspektimit. Kjo ndodh edhe kur ato janë të dyshimta në aspektin statistikor sepse numrat për krahasim janë të ulët ose njësjia që matet ka ndryshuar, për shkak të komuniteteve që i bashkohen apo që largohen nga skolla.

Rishqyrtimi i vlerësimit

Kur marrëdhëniet janë bashkëpunuese, vlerësimi - shqyrtimi i rregullt i punës së stafit dhe të qenit mbështetës - bazohet në njohuri të përditshme të detajuara që stafi tashmë i di për punën e njëri-tjetrit dhe rrallë nxjerr informacione ose detyra të reja. Megjithatë, në shkolla të tjera njerëzve mund t'u jepen objektiva që nuk kanë kuptim për ta dhe mund të mos pasqyrojnë aspiratat e tyre më të thella për mirëqenien dhe progresin

e fëmijëve. Paga sipas performancës e lidhur me përmbushjen e suksesshme të objektivave mund t'ju dëmtojë marrëdhëniet e stafit kur vendimet duken të padrejta. Qasja e *Indeksit* mund të përdoret për të siguruar që politika e vlerësimit të jetë në përputhje me vlerat e shkollës.

Hartimi i planeve zhvillimore

Planet zhvillimore mund të shkruhen në mënyrë të tillë që të jenë dokumente reale të punës, të qasshme për stafin, fëmijët dhe familjet e tyre dhe që të ngrisin moralin e gjithsecilit. Ato nuk duhet të shkruhen sipas një formule të dhënë nga një organizatë për përmirësimin e shkollës apo autoriteti lokal. Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në formësimin e prioritetëve të zhvillimit të shkollës mund të integrohet në aktivitete të vlefshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mund të përgatiten plane me ilustrime të dizajnuara nga të rriturit dhe fëmijët në shkollë ashtu siç është bërë në një kurs të *Indeksit* për kolegët nga Ukraina.



2 Një qasje e vetme për zhvillimin e shkollës suaj



Një qasje e vetme për zhvillimin e shkollës suaj

Këtu paraqesim një qasje të ndryshme për zhvillimin gjithëpërfshirës të shkollës. Ne e përcaktojmë gjithëpërfshirjen, më e rëndësishmja, si **vënie në veprim e vlerave gjithëpërfshirëse**. Ne ofrojmë një kuadër të vlerave si bazë për ndërhyrje parimore, praktike në arsim – një përgjigje në pyetjen ‘si duhet të jetojmë së bashku?’. Ne ofrojmë një grup parimesh pedagogjike gjithëpërfshirëse. Përshkruajmë një kurrikulë, ose mënyrë për ndarjen e njohurive, për shekullin 21, të lidhur me vlerat, parimet dhe imperativët e *Indeksit*. Kjo i jep përgjigje pyetjes: ‘Çfarë duhet të dimë për të jetuar mirë së bashku?’ Plotëson një boshllëk në diskutimet për zhvillimin e udhëhequr nga vlerat dhe mësimdhënien e mësimnxënien gjithëpërfshirëse.

Ne shohim se si qasja në Indeks mund të bashkojë pikëpamjet parimore të zhvillimit arsimor që kanë të bëjnë me të drejtat, pjesëmarrjen demokratike, qëndrueshmërinë mjedisore, qytetarinë globale, promovimin e shëndetit, jo dhunën dhe anti-diskriminimin. Ne argumentojmë se këto shqetësime të mbivendosura zbatohen më mirë kur koordinohen në një qasje të vetme.

Konceptet e ‘pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje’, ‘burimet për të mbështetur të nxënit dhe pjesëmarrjen’ dhe ‘mbështetja për diversitetin’ mund të përdoren për të drejtuar një eksplorim të përbashkët të hapur të njohurive tashmë të zotëruara brenda një shkolle dhe për të dhënë ide për shqyrtime të mëtejshme. Ne prezantojmë materialet e shqyrtimit të *Indeksit* të strukturuar në tri dimensione për zhvillim, që lidhen me *kulturën, politikën dhe praktikën*. Treguesit dhe pyetjet bëjnë thirrje për të reflektuar se cilat vlera gjithëpërfshirëse kërkojnë aktivitete në të gjitha aspektet e një shkolle, mjediset dhe komunitetet e saj. Ata gjithashtu ndihmojnë për të identifikuar pengesat dhe burimet. Këto materiale bashkë me pyetësorët ofrojnë mjete të tjera për t’u mbështetur në atë që tashmë dihet, duke formësuar një rishikim të detajuar të asaj që po ndodh, për të nxjerrë dhe zbatuar një plan zhvillimor gjithëpërfshirës. Në këtë mënyrë *Indeksi* sjell një planifikim më sistematik të zhvillimit, me ndryshimet e paraqitura teksa të rriturit dhe fëmijët jetojnë vlerat e tyre të përbashkëta, nga momenti në moment, në komunitetet bashkëpunuese.

Udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlera gjithëpërfshirëse	21
Sqarimi i gjithëpërfshirjes	22
Zhvillimi i një kuadri të vlerave	24
Parimet pedagogjike plotësuese	34
Vëmendja ndaj gjërave të domoshdoshme	35
Pjesëmarrja në kurrikulë	36
Formimi i aleancave	41
Pengesat, burimet dhe mbështetja	44
Materialet për shqyrtim	49

Udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlera gjithëpërfshirëse

Indeksi për gjithëpërfshirje ofron një proces mbështetës të vetë-rishikimit dhe zhvillimit si një alternativë ndaj asaj të bazuar në inspektim, konkurrencë dhe frikë nga dështimi. *Indeksi* ju ofron një mundësi për ta zhvilluar shkollën tuaj në bashkëpunim me të tjerët në përputhje me parimet tuaja. Mund të përdoret në mënyra të ndryshme. Mund të ndihmojë në sqarimin e mendimeve dhe veprimin e menjëhershëm individual dhe kolektiv si dhe në strukturimin e zhvillimit arsimor për një shkollë dhe komunitetet e saj. Mund të përdoret nga mësimmshënës, stafi jo mësimmshënës, prindërit/kujdestarët dhe të rinjtë si një mënyrë për shqyrtimin dhe përmirësimin e shkollave të tyre. Mund të nxisë dialogun për atë se çfarë fëmijët mund të mësojnë brenda dhe jashtë shkollës.

Materialet janë të dizajnuara për t'u bazuar në njohuritë dhe përvojën e stafit, fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre për natyrën e mjedisit të tyre dhe si ai mund të përmirësohet. Procesi i punës me *Indeksin* lejon që këto burime të pasura të këmbehen dhe të arrihet ndryshimi. Është një dokument gjithëpërfshirës që mund ta ndihmojë secilin për t'i gjetur hapat e tyre të ardhshëm për zhvillimin e një shkolle. Sado që mendohet se një shkollë është e suksesshme dhe gjithëpërfshirëse për momentin, *Indeksi* mund të përdoret për t'i mbështetur proceset e pafundme të përfshira në zhvillimin e të nxënësve dhe pjesëmarrjes për të gjithë dhe për reduktimin e të gjitha presioneve përjashtuese.

Kur njerëzit e hapin *Indeksin* për herë të parë mund t'ju duket se aty ka shumë ide. Megjithatë, ndërsa mësojnë të përqendrohen në një ose disa çështje në një kohë, ata e kuptojnë rëndësinë e një dokumenti kaq gjithëpërfshirës. Si një udhërrëfyes për një qytet apo një vend, *Indeksi* mundëson që njerëzit të zgjedhin vendet që ata dëshirojnë të vizitojnë, duke lënë hapur mundësinë për t'u kthyer dhe eksploruar vende të tjera.

Atëherë, *Indeksi* mund t'i ndihmojë njerëzit që të punojnë së bashku për të vendosur se çfarë duan të zhvillojnë në vijim, të hartojnë një plan dhe ta zbatojnë atë. Sidoqoftë, ashtu siç ndodh që disa njerëz nuk planifikojnë me detaje paraprakisht një vizitë në një vend dhe vetëm pasi vendosen në atë vend fillojnë të

eksplorojnë, edhe ketu njerëzit mund të gjejnë një pjesë të *Indeksit* që atyre u intereson, ndoshta edhe një pyetje të vetme dhe t'i fillojnë shqyrtimet dhe veprimet e tyre të mëtejshme nga aty.

Indeksi nuk është një nismë shtesë por një mënyrë për t'i përmirësuar shkollat sipas vlerave gjithëpërfshirëse. Nuk është alternativë për të rritur arritjet por ka të bëjë me të gjitha arritjet e të gjithë fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve. Inkurajon të nxënësit aktiv ku fëmijët integrojnë atë që kanë mësuar nga përvoja e tyre dhe angazhohen me mjedisin dhe realitetet e botës së tyre. Është dokument praktik, kërkon reflektimin mbi atë se çfarë do të thotë vënia në veprim e vlerave për të gjitha aspektet e shkollave: në sallat e stafit, klasa, sheshe të lojërave, në marrëdhëniet brenda shkollës dhe me familjet dhe komunitetet. Thekson ndryshimet në kultura, në mënyrë që zhvillimet të jenë të qëndrueshme.

Në hyrje të shumë shkollave është një deklaratë e vlerave dhe pllakata që vërtetojnë se shkollla ka arritur një standard në promovimin e çështjeve të tilla si qëndrueshmëria mjedisore, të drejtat, shëndeti, organizimi i mirë. Kemi menduar nëse ka papajtueshmëri në dhënie e një shpërblimi për gjithëpërfshirje, sepse vënia në veprim e vlerave gjithëpërfshirëse mund të jetë shpërblim në vetvete. Nuk do të donim ndonjë certifikatë për të sugjeruar që një shkollë ka arritur një cak final të zhvillimit, ndonëse e mbështesim idenë e shkollave që e festojnë përfundimin e një periudhe pune me *Indeksin*, duke dizajnuar shënimin e arritjeve të tyre me kontributin e stafit, prindërve dhe fëmijëve. Shkollat ndryshojnë vazhdimisht; fëmijët dhe stafi vijnë e ikin; paraqiten forma të reja të përjashtimit; burime të reja mobilizohen. Zhvillimi gjithëpërfshirës është një proces i pafund. Një shkollë është 'gjithëpërfshirëse' vetëm kur ajo është e angazhuar për një rrugë zhvillimi të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse.

Sqarimi i gjithëpërfshirjes

Pra, gjithëpërfshirja në Indeks është një qasje parimore për zhvillimin e arsimit dhe shoqërisë. Lidhet me pjesëmarrjen demokratike brenda dhe përtej arsimit. Nuk ka të bëjë me një aspekt të arsimit që lidhet me një grup të caktuar fëmijësh. Ka të bëjë me koherencën në aktivitete zhvillimore që ndodhin nën një larmi titujsh në mënyrë që ato të inkurajojnë të nxënit dhe pjesëmarrjen e të gjithëve: fëmijëve dhe familjeve të tyre, stafit dhe administratorëve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit.

Gjithsecili e kupton gjithëpërfshirjen sipas mënyrës së vet. Koncepte komplekse si gjithëpërfshirja nuk mund të përmbliidhen me një fjali. Në fakt, shumë njerëz mendojnë se nocioni i tyre i gjithëpërfshirjes bëhet më i qartë kur ata punojnë me treguesit dhe pyetjet e *Indeksit*. Shqyrtimi i këtyre implikimeve praktike të gjithëpërfshirjes mund të sjellë të një konsensus më i madh se sa diskutimet e gjera teorike të trajtuara ndaras nga veprimet.

Figura 5	Gjithëpërfshirja në arsim përfshin:
<ul style="list-style-type: none"> ■ Vënia e vlerave gjithëpërfshirëse në veprim. ■ Konsiderimi i secilës jetë dhe vdekje me peshë të njëjtë. ■ Mbështetja e të gjithëve që të ndiejnë se i përkasin diçkaj. ■ Rritja e pjesëmarrjes në aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies, marrëdhëniet dhe komunitetet e shkollave lokale. ■ Përmirësimi i shkollave për stafin dhe prindërit/kujdestarët si dhe fëmijët. ■ Reduktimi i përjashtimit, diskriminimit, pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje. ■ Mësimi nga zvogëlimi i pengesave për disa fëmijë që fëmijët e tjerë të përfitojnë më shumë. ■ Ristrukturimi i kulturave, politikave dhe praktikave për t'iu përgjigjur diversitetit sipas mënyrave që i vlerësojnë të gjithë në mënyrë të barabartë. ■ Lidhja e arsimit me realitetet lokale dhe globale. ■ Shqyrtimi i dallimeve ndërmjet fëmijëve dhe të rriturve si burime për mësim. ■ Pranimi i të drejtave të fëmijëve për arsim cilësor në lokalitetin e tyre. ■ Theksimi i zhvillimit të komuniteteve dhe vlerave shkollore, si dhe arritjeve. ■ Nxitja e marrëdhënieve reciproke të qëndrueshme në mes shkollave dhe komuniteteve përreth. ■ Pranimi se gjithëpërfshirja në arsim është një aspekt i gjithëpërfshirjes në shoqëri. 	

Disa nga veçoritë e qasjes për gjithëpërfshirjen janë përmbledhur në Figurën 5. Ne e shohim gjithëpërfshirjen si një proces të pafund që ka të bëjë me përfshirjen e individëve, krijimin e sistemeve dhe shkollave pjesëmarrëse dhe promovimin e vlerave gjithëpërfshirëse. Në secilin rast përfshin rritjen e pjesëmarrjes për secilin në kulturat, komunitetet dhe kurrikulat e shkollave dhe reduktimin e të gjitha formave të përjashtimit dhe diskriminimit. Ka të bëjë me dëgjimin e zërave të fëmijëve dhe veprimin sipas tyre. Ka po aq të bëjë me familjet dhe me stafin në shkolla sa edhe me fëmijët. Mbështetja për pjesëmarrjen e fëmijëve ka gjasa të mos përkrahet në masë të madhe nëse të rriturit që punojnë me ta nuk e thonë fjalën e tyre në vendimet për hollësitë e punës së tyre. Sidoqoftë, njerëzit zakonisht mendojnë se gjithëpërfshirja kryesisht ka të bëjë me integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara ose të atyre që karakterizohen si fëmijë me 'nevoja të veçanta arsimore' në mesin e fëmijëve të tjerë. Këtë pikëpamje e shohim si problematike sepse ne mund ta përkufizojmë gjithëpërfshirjen në këtë kuptim të gushtë në lidhje me cilëndo nga shumë çështjet e avokimit që ka të bëjë me moshën, gjininë, orientimin seksual, etninë, klasën si dhe aftësinë e kufizuar. Këtë do ta diskutojmë më tej në faqet 40-43 kur e adresojmë idenë e përdorimit të 'pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje' për ta zëvendësuar nocionin e 'nevojave të veçanta arsimore'.

Thirrja për dialog

Në thelb të *Indeksit* janë qindra pyetje dhe secila prej tyre mund të jetë pikë fillimi për një reflektim më të gjerë. Materialet e *Indeksit* nuk përshkruajnë se çfarë njerëzit duhet të ndërmarrin apo të mendojnë; ato janë aty për ta nxitur dialogun. Kur ka dialog ka hulumtim reciprok të mendimeve dhe supozimeve të njëri-tjetrit në bazë të barazisë, ndershmërisë dhe besimit. Të dëgjuarit merr më shumë rëndësi sesa të folurit.

Lidhja me pozitat e mëparshme lirohet, të paktën përkohësisht, dhe ky hulumtim i përbashkët ndihet i hapur dhe i vërtetë.

Ajo që llogaritet si përparim në bisedë negociohet dhe bëhet përgjegjësi e përbashkët. Dialogu është krahasuar me diskutimin, që vjen nga e njëjta rrënjë si 'goditje' dhe 'përplasje'.⁶ Edhe pse diskutimi po ashtu mund të ketë një kuptim më të butë, krahasimi është orientues.

6 Boem, D., (1996) *On Dialogue* [Për Dialogun], London, Routledge.

Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Idetë për gjithëpërfshirjen janë konfuzë nga mënyra se si është përdorur termi 'gjithëpërfshirje sociale'. Nganjëherë nënkuptonte 'tejkalimin e privimit', siç është varfëria dhe strehimi joadekuat, edhe pse në raste të tjera duket se nënkuptonte tejkalimin e stigmës që lidhet me disavantazhin dhe jo vetë disavantazhin. Gjithëpërfshirja sociale përdoret po ashtu në dokumentet e nxjerra nga qeveria dhe nga edukatorët me kuptimin e tejkalimit të 'vështirëve me sjelljen'. Një mësimdhënës, pjesë e një projekti kërkimor, e prezantoi veten dhe një kolege me fjalët: 'Unë jam gjithëpërfshirja – nevojat e veçanta, ajo është gjithëpërfshirja sociale – djemtë e prapë'. Por ideja se 'gjithëpërfshirja' duhet t'i referohet një grupi ndërsa 'gjithëpërfshirja sociale' një tjetri, ka pak kuptim. Meqë gjithëpërfshirja shpesh duket se i referohet personave me aftësi të kufizuara ajo mund ta nxisë besimin se ata i nënshtrohen një lloj përjashtimi jo-social që vjen natyrshëm si rezultat i drejtpërdrejtë i aftësisë së tyre të kufizuar. Të gjitha format e gjithëpërfshirjes dhe përjashtimit janë sociale, që lindin nga ndërveprimet midis njerëzve dhe mjediseve.

Rritja e gjithëpërfshirjes përfshin reduktimin e përjashtimit. Përfshin luftimin e presioneve përjashtuese që pengojnë pjesëmarrjen. Meqenëse po përpiqemi të promovojmë një pamje koherente të mënyrës së zhvillimit të shkollave, ne parapëlqejmë t'i përcaktojmë konceptet tona për veten tonë. Megjithatë 'përjashtimi' shpesh përdoret në mënyrë specifike pas Ligjit të Arsimit të vitit 1986 për t'ju referuar 'përjashtimit disiplinor', largimit të përkohshëm ose të përhershëm të një fëmije nga një shkollë për shkak të shkeljes së rregullave të shkollës.

Megjithatë, largimi i fëmijëve nga shkollat për arsye disiplinore në përgjithësi shënon një fazë të veçantë në proceset përjashtimore.

Rritja e pjesëmarrjes për të gjithë nuk mund të kryhet duke u fokusuar tek individët. Pjesëmarrja e individëve që i janë nënshtuar presioneve përjashtuese do të jetë e kufizuar përveç nëse një shkollë është mirëpritëse dhe e përgjegjshme ndaj diversitetit sipas mënyrave që i vlerësojnë të gjithë në mënyrë të barabartë. Nuk mjafton të kërkohet që sistemet dhe shkollat thjesht t'i përgjigjen diversitetit të fëmijëve pasi që kjo mund të përmbushet përmes krijimit të një hierarkie të vlerave brenda dhe ndërmjet shkollave. Për shembull, shkollat mund t'i përgjigjen diversitetit duke përzgjedhur fëmijët sipas arritjeve,

aftësisë së kufizuar, religjionit dhe pasurisë. Ndarjet në bazë të arritjeve brenda dhe ndërmjet shkollave në përgjithësi janë forcuar nga vëniet e etiketimit për aftësitë e fëmijëve nga një moshë shumë e vogël. Kjo e kufizon të menduarit për të arriturat e ardhshme dhe ndikon në pritshmëritë për veten. Kur ata i vlerësojnë të gjithë në mënyrë të barabartë, shkollat i mirëpresin të gjithë fëmijët brenda komuniteteve të tyre përreth. Prandaj gjithëpërfshirja lidhet me zhvillimin e një shkolle të përbashkët për të gjithë; për arsimim gjithëpërfshirës të komunitetit në kopshte, shkolla fillore dhe të mesme.

Megjithatë, përveç përqendrimit në mirëqenien e individëve dhe përgjigjen e shkollave, gjithëpërfshirja më së shumti shihet si vënie në veprim e vlerave gjithëpërfshirëse. Kjo lidhje e përmirësimit të shkollës me vënien në veprim të një kuadri vlerash mund t'i transformojë shkollat. Është një përkushtim ndaj vlerave të veçanta që përbëjnë një dëshirë për ta kapërcyer përjashtimin dhe për ta promovuar pjesëmarrjen. Nëse nuk lidhet me vlerat e mbajtura thellë në vete, ndjekja e gjithëpërfshirjes mund të paraqesë konformitet me një mënyrë mbizotëruese ose pajtueshmëri me udhëzimet nga lart.



7 Ainscow, M., Booth, T. and Dyson, A. (2006) *Improving schools, developing inclusion* [Përmirësimi i shkollave, zhvillimi i gjithëpërfshirjes]. London, Routledge.

8 Hart, S., Dixon, A., Drummond, M.J. and McIntyre, D. (2006) *Learning without limits [Të nxënit pa kufij]*, Buckingham, Open University Press. <http://learningwithoutlimits.educ.cam.ac.uk>

Zhvillimi i një kuadri të vlerave


Vlerat janë udhëzuesit themelorë dhe nxitje për veprim. Ato nga shtyjnë përpara, na japin një ndjenjë oreintimi dhe përcaktojnë një destinacion. Nuk mund ta dimë se po bëjmë ose se kemi bërë gjënë e duhur pa e kuptuar marrëdhënien midis veprimeve dhe vlerave tona. Sepse të gjitha veprimet që prekin të tjerët mbështeten nga vlerat. Çdo veprim i tillë bëhet një argument moral me vetëdije apo pa vetëdije. Është një mënyrë për të thënë 'kjo është gjëja e duhur për t'u bërë'. Kur e zhvillojmë kuadrin e vlerave ne tregojmë se si duam të jetojmë dhe edukojmë njëri-tjetrin së bashku, tani dhe në të ardhmen. Vlerat janë pjesë e kulturës. Kur njerëzit në shkolla zhvillojnë një kuadër të përbashkët vlerash dhe kuptojnë lidhjen e tyre me veprime të detajuara, kjo ndihmon në mbështetjen e ndryshimeve që ata i bëjnë në politikën ose në praktikën e klasës.

Shumë shkolla tashmë e kanë një deklaratë të vlerave. Tipar dallues i vlerave në Indeks është se ato kanë për qëllim të ndikojnë në detajet e praktikës dhe të bëhen forcë për shtyrjen përpara të zhvillimit të shkollës. Të qenit i qartë në lidhje me marrëdhëniet midis vlerave dhe veprimeve është hapi më praktik që mund të ndërmerrem në arsim. Ne udhëzohemi të dimë se çfarë duhet të bëjmë në vijim dhe të kuptojmë veprimet e të tjerëve. *Indeksi* ju fton të arrini zhvillim arsimor në shkollat tuaja nga veprimet që lindin nga vlerat tuaja të brendshme e jo nga një sërë programesh ose iniciativash të dizajnuara nga të tjerët dhe të mbështetura nga vlerat të cilat ju mund t'i refuzoni kur t'i mësoni.

Një bashkërendim i kujdesshëm i një kuadri vlerash, të cilat së bashku përkrahin zhvillimin e arsimit, ka rezultuar në një listë të titujve që kanë të bëjnë me *barazinë, të drejtat, pjesëmarrjen, komunitetin, respektin për diversitetin, qëndrueshmërinë, jo-dhunën, besimin, dhembshurinë,*

sinqeritetin, guximin, gëzimin, dashurinë, shpresën/optimizmin, bukurinë dhe urtësinë. Secila prej këtyre fjalëve qëndron për një vlerë, e cila kuptohet vetëm përmes një hulumtimi më të detajuar të kuptimit të saj si më poshtë. Secila vlerë përmbledh një fushë veprimi dhe aspiratë për arsimin dhe shoqërinë më gjerësisht. Lista është rezultat i diskutimeve të shumta me mesimdhënësit, studentët dhe të tjerët në Mbretërinë e Bashkuar dhe në mbarë botën. Për shembull, vendimi përfundimtar për të përfshirë vlerat e ndërlidhura të sinqeritetit, besimit dhe guximit doli nga një sërë punëtorish të organizuara në një edicion të mëparshëm të *Indeksit*, në të cilin kolegët në pozita të larta në shkolla e përshkruan procesin e ndërtimit të guximit si sinqeritet për dobësitë si dhe pikat e forta në shkollat e tyre dhe si kjo pikë ishte ndihmuar në punëtori duke u angazhuar në detyra të përbashkët me të tjerët që besojnë të ishin mbështetës dhe jo kritikues dhe fajësues.

Figura 6 Kuadri i vlerave gjithëpërfshirëse



Shumë kanë shprehur pëlqimin e tyre për lulen e vlerave në faqe 11 por ne duam të paraqesim edhe një kuadër të vlerave gjithëpërfshirëse në tri dimensione si në Figurën 6. Kjo ndihmon për të krijuar një imazh të një universi gjithëpërfshirës me kuptim mbështetës dhe ndërveprues.

Në edicionin e fundit të *Indeksit* ne sugjeruam që disa vlera japin një kontribut më të madh në zhvillimin gjithëpërfshirës se të tjerat. Tani e shohim se kjo është e pavlerë.

Në shumë diskutime që kemi pasur në shkolla në vitet e fundit kemi parë se si njerëz të ndryshëm zgjedhin vlera të ndryshme si fillim për shqyrtimet e mënyrave të vënies në veprim të vlerave.

Zakonisht ata përfundojnë duke vënë në dukje ndërlidhjet ndërmjet të gjitha vlerave në kuadër. Nëse dyshoni për kontributin e një vlere të veçantë, provoni ta hiqni nga atë arsimi. Si do të ishte arsimi për shembull pa besim, sinqeritet, guxim, dhembshuri, gëzim, dashuri, shpresë apo bukurie? Na pëlqen të mendojmë se shkollat mund të përpiqen

të jenë vende që ushqejnë shpirtin njerëzor. Por do të ishte gjithashtu e çuditshme të argumentohej për një shqetësim me gjithëpërfshirjen e të gjithëve në shkolla dhe pastaj të heqim nga kuadri titujt e barazisë, të drejtave, pjesëmarrjes dhe komunitetit. Të drejtat lindin nga vlerësimi i barazisë por janë të përfshira veçmas për shkak të rëndësisë strategjike të konceptit të të drejtave në nxitjen e njohjes së vlerës së barabartë të njerëzve dhe luftimit të diskriminimit.

Gjatë zhvillimit të kësaj pune u tha nga disa se shqetësimi për qëndrueshmërinë mjedisore dhe reduktimin e degradimit mjedisor që po ndodh përmes ngrohjes globale nuk është i lidhur me idenë e gjithëpërfshirjes. Kjo ndoshta pse ne synojmë të mendojmë për çështjet në kutitë e tyre të veçanta, e cila në vete përbën tendencë përjashtuese. Por sapo të njihet rëndësia themelore për mbijetesë e gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme në mjedis të qëndrueshme atëherë ndërlihdja bëhet e qartë. Përmbytja që do të prekë zona të mëdha në mbarë botën, nëse rritja globale e temperaturës nuk kufizohet rreptësisht, do të marrë me vete komunitete, shtëpitë e tyre, shkollat dhe mënyrën e tyre të jetesës. Ne u japim disa vlerave siç është qëndrueshmëria statusin e imperativit për zhvillimin e arsimit.

Barazia

Barazia dhe nocionet e lidhura me barazinë, paanësinë dhe drejtësinë janë thelbësore për vlerat gjithëpërfshirëse.

Pabarazia, anësia dhe padrejtësia janë forma të përjashtimit. Barazia nuk ka të bëjë me atë që të gjithë të jenë të njëjtë apo të trajtuar në të njëjtën mënyrë por që të gjithë të trajtohen si persona me vlerë të njëjtë. Kjo ka implikime në mënyrën se si të rriturit dhe fëmijët sillen me njëri-tjetrin në shkolla. Ndikon në mënyrën se si fëmijët grupohen në mes dhe brenda shkollave dhe klasave, në mënyrë që të shmangen hierarkitë e vlerës. Ka të bëjë edhe me mënyrën se si menaxhohen shkollat. Një pikëpamje gjithëpërfshirëse e barazisë nuk ka të bëjë me 'mundësitë e barabarta' për statusin, pasurinë dhe kushtet jo të barabarta të jetesës por për reduktimin e pabarazive të tilla.

Reflektimi për pranueshmërinë e pabarazive nga njerëzit në nivel kombëtar dhe global, në pasuri ose në kushte jetese, shpalos mosmarrëveshje të thella rreth gjithëpërfshirjes. Shpesh, njerëzit nuk e konsiderojnë 'çdo jetë dhe çdo vdekje me vlerë të barabartë' jo sepse ata natyrshëm janë më të shqetësuar për ata që i kanë më afër

por sepse ata nuk mendojnë se vuajtjet e të tjerëve jashtë familjeve, lagjeve apo vendit të tyre duhet të nxisin veprim të menjëhershëm për t'i reduktuar ato.

Të drejtat

Fokusi në të drejtat bazohet në shqetësimin me barazinë. Është një mënyrë për të shprehur vlerën e barabartë të njerëzve sepse ata kanë të drejta të barabarta. Të kërkojë të drejta është të thuash që të gjithë kanë të drejta të barabarta për lirinë për të dashur dhe lirinë për të vepruar. Pra, të gjithë kanë të drejtë të barabartë për ushqim, strehim, mbrojtje dhe kujdes dhe për pjesëmarrje si qytetarë. Kur veprimet çojnë në pabarazi atëherë ato nuk mund të përfshijnë një të drejtë. Kjo është një pengesë për çdo ide të të drejtave të zgjedhjes ose pronësisë së pronës nëse kjo e përkeqëson pabarazinë që të tjerët të ushtrojnë të drejtat e tyre. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e arsimit publik cilësor falas (të ofruar nga shteti) në lokalitetin e tyre. Promovimi i të drejtave të njeriut brenda arsimit nxit zhvillimin e marrëdhënieve reciproke dhe të kujdesit.

Njerëzit nganjëherë dëshirojnë të lidhin të drejtat dhe përgjegjësitë, por kjo është e gabuar nëse ka implikime që kushtëzojnë dhënien e të drejtave me sjelljen në një mënyrë të caktuar. Të drejtat janë të pakushtëzuara, që i kemi si qenie njerëzore. Por të drejtat mund të bien në konflikt dhe kjo për shembull mund të nënkuptojë se një e drejtë e një personi për siguri mund të përfshijë kufizime në lirinë e një tjetri. Është e qartë se si barazia, ashtu edhe të drejtat kontestohen në praktikë, përkundër një angazhimi të dukshëm për t'iu bindur shprehjes së tyre në dokumentet e Kombeve të Bashkuara. Kjo është e dukshme nga mospërfillja e gjerë për to në mbarë botën dhe mungesa e përpjekjeve për t'i adresuar shkeljet e tyre. Konsiderimi i të drejtave të njeriut mund të sjellë po ashtu pyetje për trajtimin e qenieve jonjerëzore dhe idesë së shtrirjes së të drejtave për të gjitha format e jetës dhe madje edhe për integritetin e planetit (shih faqe 194). Të drejtat janë pika fillestare për përmirësimin e shkollave në shpërbllimin e ofruar nga UNICEF-i 'Shkollat që respektojnë të drejtat'.⁹

Pjesëmarrja

Shpesh nuk kërkohet pjesëmarrja në arsim e stafit, të rinjve dhe familjeve të tyre. Pjesëmarrja shkon përtej kësaj, por fillon duke qenë atje. Pjesëmarrja përfshin dy elemente që kanë të bëjnë me veprimin pjesëmarrës ose aktivitetin dhe veten si pjesëmarrës. Një person nuk merr pjesë

⁹ <http://www.unicef.org.uk/rights-respecting-schools/>

vetëm kur ai është i përfshirë në aktivitete të përbashkëta por edhe kur ndihet i përfshirë dhe i pranuar. Pjesëmarrja ka të bëjë me të tjerët dhe bashkëpunimin me ta. Ka të bëjë me angazhimin aktiv në mësim. Ka të bëjë me përfshirjen në vendimet për jetën e dikujt, duke përfshirë arsimin dhe lidhjet me idetë e demokracisë dhe lirisë. Gjithashtu përfshin të drejtën për të mos marrë pjesë, për të siguruar autonominë e personit kundër grupit duke thënë: 'jo'. Kjo mund të kërkojë guxim. Vetëdija për burimin dhe natyrën e veprimeve, synimeve dhe ndjenjave tona na ndihmon të marrim pjesë aktive. Pjesëmarrja përfshin dialog me të tjerët në baza të barazisë dhe si rrjedhim kërkon lënien e qëllimshme anash të dallimeve të statusit dhe të pushtetit. Pjesëmarrja rritet kur angazhimi me të tjerët përforcon ndjenjën e identitetit; kur ne pranojmë dhe vlerësojmë për atë që jemi.

Respekti për diversitetin

Respekti gjithëpërfshirës përfshin vlerësimin e të tjerëve dhe trajtimin mirë të tyre, njohjen e kontributeve të tyre për komunitetin për shkak të individualitetit të tyre si dhe përmes veprimeve të tyre pozitive. Nuk nënkupton nënshtrimin ndaj dikujt për shkak të statusit apo autoritetit të tyre. 'Diversiteti' përfshin dallimet dhe ngjashmëritë e dukshme dhe të padukshme midis njerëzve: diversiteti ka të bëjë me diferencën brenda njerëzores së përbashkët.

Diversiteti përfshin të gjithë, jo vetëm ata që ikin nga një normalitet iluzor. Megjithatë, përdorimi i tij ndonjëherë korruptohet ashtu që 'diversiteti' lidhet me 'tjetërsinë'; ata që nuk janë si 'ne'. Grupet dhe komunitetet shihen si homogjene kur dallimet brenda tyre nuk njihen.

Një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj diversitetit mirëpret krijimin e grupeve diverse dhe respekton vlerën e barabartë të të tjerëve pavarësisht nga diferenca e tyre e perceptuar. Në këtë pikëpamje diversiteti është një burim i pasur për jetën dhe të nxënit, e jo një problem që duhet kapërcyer. Kjo përgjigje është në kontrast me një pikëpamje selektive që përpiqet të ruajë uniformitetin duke kategorizuar dhe ndarë njerëzit dhe duke i caktuar ata në grupe të rregulluara sipas një hierarkie të vlerave.

Por vlerësimi i diversitetit ka kufijtë e vet. Nuk do të thotë që ne i pranojmë ose i vlerësojmë

përpyjekjet destruktive të njerëzve drejt të tjerëve ose mjedisit.

Refuzimi i ndryshimit zakonisht përfshin mohimin e tjetërsisë në veten tonë. Pra, kur njerëzit nuk duan të pranojnë potencialin e tyre për për t'u lënduar dhe për t'u plakur, ata përforcojnë dëshirën e tyre për t'u ndarë dhe për të diskriminuar të moshuarit ose personat me aftësi të kufizuara. Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj diversitetit përfshin kuptimin dhe kundërshtimin e rreziqeve tejet shkatërruese të konsiderimit të diferencave ose tjetërsisë si inferioritet.

Kur kjo futet thellë në një kulturë mund të çojë në diskriminim të madh ose edhe në gjenocid.¹⁰

Komuniteti

Shqetësimi në lidhje me ndërtimin e komunitetit përfshin njohjen se ne jetojmë në marrëdhënie me të tjerët dhe se miqësia është thelbësore për mirëqenien tonë. Komuniteti ndërtohet përmes kulturave që nxisin bashkëpunimin. Një qasje gjithëpërfshirëse e komunitetit shtrin afërsinë dhe detyrimin përtej familjes dhe miqësisë, te një ndjenjë më e gjerë. Lidhet me një ndjenjë përgjegjësie për të tjerët dhe për idetë e shërbimit publik, qytetarinë, qytetarinë globale dhe njohjen e ndërvarësisë globale. Një komunitet shkollor gjithëpërfshirës ofron një model të asaj që do të thotë të jesh qytetar i përgjegjshëm dhe aktiv, të drejtat e të cilit respektohen jashtë shkollës. Komunitetet gjithëpërfshirëse janë gjithmonë të hapura dhe pasurohen nga anëtarët e rinj që kontribuojnë në transformimin e tyre. Në arsim, gjithëpërfshirja përfshin zhvillimin e marrëdhënieve reciproke të qëndrueshme brenda shkollave dhe midis shkollave dhe komuniteteve të tyre përreth. Shqetësimi me komunitetin ka të bëjë me veprimin në bashkëpunim, me kolegialitet dhe solidaritet; ai bën të kuptohet se si përparimi në ndryshimin e institucioneve mund të arrihet më së miri kur njerëzit i bashkojnë veprimet e tyre.

Qëndrueshmëria

Qëllimi themelor i arsimit është përgatitja e fëmijëve dhe të rinjve për mënyra të qëndrueshme jetese brenda komuniteteve dhe mjediseve të qëndrueshme, në nivel lokal dhe global. Përkushtimi ndaj vlerave gjithëpërfshirëse

¹⁰ This last sentence requires a reference to Primo Levi 1996, *Survival in Auschwitz [Mbijetesë në Auschwitz]*, New York, Collier Books, p9: "Shumë njerëz – shumë kombe – e gjejnë veten duke menduar, pak a shumë me vetëdije, 'se çdo i huaj është armik". Për pjesën më të madhe, kjo bindje qëndron

thellë brenda vetes së tyre, si një infeksion i fshehur; që e tradhton vetëm në akte të rastësishme, të shkëputura dhe nuk bazohet në arsye. Por kur kjo ndodh, kur dogma e pashprehur bëhet premisë kryesore në një silogjizëm, atëherë në fund të zinxhirit është [kampi i vdekjes]."

duhet të përfshijë një angazhim ndaj mirëqenies së gjeneratave të ardhshme. Diskutimet e gjithëpërfshirjes gjithmonë shtrojnë pyetjen: 'gjithëpërfshirja në çfarë?' Shkollat që zhvillohen në mënyrë gjithëpërfshirëse janë vende që inkurajojnë zhvillimin e qëndrueshëm të të nxëniet dhe pjesëmarrjes së të gjithëve dhe reduktimin e vazhdueshëm të përjashtimit dhe diskriminimit. Ato shmangin ndërmarrjen e ndryshimeve të pakoordinuara për një periudhë afatshkurtër, hyrjen në programe dhe iniciativa të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me zotimet e tyre afatgjata. Qëndrueshmëria mjedisore është qendrore për gjithëpërfshirjen në një kohë kur degradimi mjedisor, shpyllëzimi dhe ngrohja globale kërcënojnë cilësinë e jetës së të gjithëve dhe tashmë po dëmtojnë jetën e miliona njerëzve në mbarë botën. Shkollat që zhvillohen në mënyrë gjithëpërfshirëse duhet të shqetësohen për ruajtjen e mjedisit fizik dhe natyror brenda dhe jashtë kufijve të tyre. Por 'vetëdija ekologjike' duhet të zhvillohet nga kuptimi dhe respekti për natyrën, e jo nga terrori i katastrofave. Duhet të lidhet me shpresën dhe optimizmin se rreziqet mund të tejkalohen. Për të qenë të qëndrueshme, të gjitha ndryshimet duhet të integrohen në kulturë dhe përmes saj në zhvillimin e identiteteve të ndryshuara.

Jo-dhuna

Jo-dhuna kërkon të dëgjosh dhe kuptosh pikëpamjen e të tjerëve dhe të peshosh pikat e forta të argumenteve, duke përfshirë argumentet tuaja. Kërkon zhvillimin e aftësive të negociimit, ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve tek fëmijët dhe të rriturit. Kërkon që të rriturit të modelojnë jo-dhunën në sjelljen e tyre. Brenda komuniteteve të barabarta, mosmarrëveshjet zgjidhen përmes dialogut dhe jo detyrimit që rrjedh nga dallimet në status dhe forcë fizike. Kjo nuk do të thotë që njerëzit të shmangin sfidimin ose të sfidohen dhe të mohojnë mosmarrëveshjet, por që ata të përdorin sfidat për të provokuar reflektimin dhe risitë.¹¹ Ngacmimi ndodh kur njerëzit e keqpërdorin pushtetin e tyre për ta bërë tjetrin të ndjehet i cenueshëm, në aspektin fizik ose psikologjik. Ngacmimi i personave për shkak të përkatësisë etnike, gjinisë, aftësisë së kufizuar, moshës, orientimit seksual, besimeve dhe religjionit janë të gjitha forma të dhunës. Përkushtimi ndaj jo dhunës mund të përfshijë mënyra sfiduese

të zgjidhjes së konflikteve të lidhura me disa versione të mashkullisë dhe kështu nevojën e ofrimit të rrugëve alternative për një identitet të fortë mashkullor. Çon në ndarjen e nocioneve të 'humbjes së fytyrës' dhe 'humbjes së respektit' dhe lidhjeve të tyre me 'hakmarrjen'. Kjo kërkon një ekuilibër mes vetëbesimit dhe agresionit. Zemërimi shihet si një tregues i rëndësishëm i forcës së ndjenjave të një personi për një person apo ngjarje por duhet të drejtohet në një veprim produktiv dhe larg reagimit agresiv. Dhuna institucionale ose ngacmimi institucional mund të ndodhin kur aspekti njerëzor dhe dinjiteti i atyre brenda institucioneve nuk respektohet; kur njerëzit trajtohen si mjet për të arritur një qëllim. Kjo mund të ndodhë kur shkollat ose institucionet e tjera arsimore trajtohen si biznese ose merren aq shumë me rezultatet saqë mirëqenia e studentëve apo stafit lihet pas dore. Institucionet jo të dhunshme zhvillohen në harmoni me nevojat e njerëzve brenda tyre, me mjedisin dhe me komunitetet e tyre përreth.

Besimi

Besimi mbështet pjesëmarrjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve dhe identitetit. Kërkon inkurajimin e mësimit të pavarur dhe të pa vëzhguar dhe krijimin e dialogut. Arsimimi mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit për fëmijët dhe të rinjtë të të tjerët jashtë familjeve të tyre dhe mund të përfshijë diskutime për natyrën e përballjeve të sigurt dhe të pasigurt me të tjerët. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për ata që ndihen të pambrojtur në shtëpi ose në të kaluarën për shkak të një përvoje të diskriminimit rutinë kanë zhvilluar mosbesimin. Besimi është i lidhur ngushtë me idetë e përgjegjësisë dhe besueshmërisë. Besimi është i nevojshëm për zhvillimin e vetë-respektit dhe respektit reciprok në praktikën profesionale. Sa më pak që u besojmë njerëzve, aq më pak të besueshëm ata mund të bëhen.¹³ Nevojitet besimi se të tjerët do të dëgjojnë dhe do të përgjigjen në mënyrë të drejtë nëse zbulohen dhe adresohen çështje të vështira që pengojnë zhvillimin arsimor: njerëzit ndihen të lirë të thonë mendimin e tyre kur besojnë se të tjerët do të angazhohen në dialog të respektueshëm pa kërkuar të përfitojnë nga kjo.

11 Këtu duhet bërë referencë me John Dewey, in Boydston, J. (ed) (1988) John Dewey, Human Nature and Conduct 1922 [Natyra njerëzore dhe sjellja], *Morals are human, Middle Works 1899-1924*, Vol.14, p. 207. Shih edhe DEWEY-L arkivi nga by Richard Hake (2005): 'Conflict is the gadfly of thought. It

stirs us to observation and memory. It instigates invention. It shocks us out of sheep-like passivity, and sets us at noting and contriving. [Konflikti është zekthi i mendimeve. Na nxit në vëzhgime dhe kujtime. Nxit shpikjen. Na zgjon nga pasiviteti i ngjashëm me delen dhe na bën të vërejmë dhe trillojmë.]

12 O'Neill, O. (2002) A question of trust [Çështje besimi], Reith Lectures

Sinqeriteti

Sinqeriteti nuk është vetëm shprehja e lirë e së vërtetës. Mungesa e sinqeritetit mund të ketë më shumë të bëjë me mosshpalosjen e qëllimshme të informacionit sesa me të gënjerit e drejtpërdrejtë. Mosshpalosja me qëllim e informacionit për të tjerët ose mashtrimi i të tjerëve pengon pjesëmarrjen e tyre. Mund të jetë një mjet për ata që kanë më shumë pushtet për t'i kontrolluar ata me më pak pushtet. Sinqeriteti përfshin shmangien e hipokrizisë, shmangien e avokimit për një gjë dhe veprimin në të kundërt. Përfshin mbajtjen e premtiveve. Derisa sinqeriteti është i lidhur me integritetin, ai lidhet edhe me vlerat e guximit dhe besimit. Është më e vështirë të jesh i sinqertë kur kjo kërkon guxim dhe është më e lehtë kur besojmë se të tjerët janë mbështetës. Sinqeriteti në arsim përfshin ndarjen e njohurive me të rinjtë rreth realiteteve lokale dhe globale; inkurajimin e tyre për të ditur çfarë po ndodh në botën e tyre në mënyrë që ata të mund të marrin vendime të informuara tani dhe në të ardhmen. Përfshin nxitjen për të shtruar pyetje të vështira dhe gatishmërinë për të pranuar gabimet dhe kufizimet e njohurive.

Guximi

Guximi shpesh kërkon të ngrihesh kundër peshës së konventës, pushtetit dhe autoritetit ose pikëpamjeve dhe kulturave të një grupi; për të pasur mendimin tënd dhe për ta shprehur atë. Guximi më i madh personal mund të jetë i nevojshëm për ta mbrojtur veten dhe të tjerët ku nuk ka kulturë të mbështetjes së ndërsjellë ose kur kjo ka humbur. Por shtrirja e guximit që kërkohet për të dhënë një mendim varet nga personaliteti i dikujt dhe shkalla në të cilën ai person ka zhvilluar frikën e të folurit në publik.

Ajo që quhet informim, raportimi i një keqpërdorimi në organizatën e dikujt, duke rrezikuar humbjen e avancimit, punës ose miqësisë, në përgjithësi kërkon guxim. Raportimi i keqpërdorimeve mund të shihet si i pabesë nga ata që kanë pushtet, ndonëse besnikëria gjithëpërfshirëse është për komunitetin më të gjerë dhe për ata më të cenueshmit brenda tij. Guxim mund të nevojitet për kundërshtimin e diskriminimit, së pari duke e pranuar se ka diskriminim dhe pastaj duke i dhënë emër dhe duke vepruar kundër tij.

Gëzimi

Vlerat gjithëpërfshirëse kanë të bëjnë me zhvillimin e gjithë njerëzve, duke përfshirë ndjenjat dhe emocionet e tyre; me rritjen e

shpirtit human; me angazhimin me vullnet në mësimnxënie, mësimdhënie dhe marrëdhënie. Përfshin mendimin për shkollat si vende kur duhet të 'jesh', të jetosh mirë në të tashmen dhe përgatitje për atë që do të 'bëhet' në të ardhmen. Arsimimi me vullnet e gëzim inkurajon nxënien përmes lojës dhe humorit. Nxit kënaqësinë në përfitimin e interesave të reja, njohurive dhe shkathtësive të reja si mënyra më e mirë për t'i mbështetur ato. Shkollat që fokusohen vetëm në një grup të ngushtë të arritjeve thelbësore, ose në rolin e arsimimit në sigurimin e statusit personal dhe përfitimeve ekonomike mund të jenë vende jo të gëzueshme, pa humor. Kjo mund t'i dobësojë të rriturit dhe fëmijët duke ngushtuar shprehjen e tyre dhe mund të çojë në pakënaqësi dhe mosangazhim.

Dhembshuria

Dhembshuria përfshin kuptimin e vuajtjes së të tjerëve dhe dëshirës që ajo të lehtësohet. Kërkon përpjekje të qëllimshme për ta njohur shkallën e diskriminimit dhe vuajtjes në nivel lokal dhe global dhe një gatishmëri për t'u angazhuar me perspektivat dhe ndjenjat e njerëzve të tjerë. Dhembshuria do të thotë se mirëqenia personale është e kufizuar nga shqetësimi për mirëqenien e të tjerëve, ndonëse jo në shkallën ku inkurajojmë mjerimin derisa të qeshin të gjithë në mbarë botën. Përkrahja e dhembshurisë përfshin zëvendësimin e qasjeve ndëshkuese për shkelje të rregullave nëpërmjet kujdesit dhe imaginatës. Përfshin marrjen e përgjegjësi nga ana e të rriturve kur ka prishje të marrëdhënieve me fëmijët dhe të rinjtë. Sado e dobët të duket marrëdhënia në mes një të riu dhe shkollës është detyrë e profesionistëve të vazhdojnë të pyesin: 'Si mund të mbështetet më mirë ky i ri për të zhvilluar marrëdhënie dhe për t'u angazhuar në mësim në këtë shkollë?' Arsimi ku ka dhembshuri është ai ku gabimet mund të pranohen, pavarësisht nga statusi i personit të përfshirë, kërkim-faljet pranohen, aplikohet kthimi dhe falja është e mundur.

Dashuria

Dhembshuria është e lidhur ngushtë me vlerën e dashurisë ose kujdesit. Dashuria si 'kujdes i thellë për të tjerët, pa kërkuar asgjë në këmbim', është motivimi kryesor për shumë edukatorë dhe bazë për një ndjenjë thirrjeje¹³.

13 Noddings, N (2005) The challenge to care in schools; an alternative approach to education [Sfida e kujdesit në shkollë; qasje alternative në arsim], New York, Cambridge University Press.

Përfshin nxitjen e të tjerëve që të jenë dhe të bëhen vetvetja, njohjen e mënyrës se si njerëzit përparojnë kur vlerësohen. Kjo rrit ndjenjën e identitetit, përkatësisë dhe promovon pjesëmarrjen. Vullneti për t'u kujdesur për të tjerët dhe për të pranuar kujdes në këmbim nënkupton krijimin e komuniteteve të lidhura me ndjenjën e njëri-tjetrit si aktivitete të përbashkëta. Por si vlerë për edukatorët, 'dashuria' ose 'kujdesi' është veçori e një marrëdhënie asimetrike. Mund të jetë detyrë profesionale që edukatorët të kujdesen njësoj për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë brenda shkollave të tyre, pavarësisht afërsisë, mirënjohjes ose progresit që ata shfaqin në këmbim.

Shpresa/optimizmi

Vlera që lidhet me shpresën dhe optimizmin mund të shihet po ashtu si detyrë profesionale për edukatorët dhe detyrë personale për prindërit dhe kujdestarët: ne mund ta kemi si detyrim përcjelljen e ndjenjës se vështirësitë personale, lokale, kombëtare dhe globale mund të lehtësohen. Ka të bëjë me tregimin e rasteve se si njerëzit mund të bëjnë dallimin në jetën e tyre dhe të njerëzve të tjerë. Kjo nuk do të thotë që ne nuk angazhohemi me realitetet e botës ose me motivet cinike të të tjerëve dhe 'e shikojmë vetëm anën e ndritshme të jetës'. Shpresa dhe optimizmi kërkojnë një dëshirë të zjarrtë për anagazhim me realitetin si bazë për veprime parimore. Qartësia për vlerat gjithëpërfshirëse mund të ofrojë një kuadër për veprim, duke bashkuar veprimet me vlera të ngjashme por me tituj të ndryshëm për aktivitetet e tyre. Kjo mund të rrisë fuqinë kolektive për të kundërvepruar ndaj presioneve të frikshme përjashtuese që manifestohen në nivel lokal dhe global. Mund të bëjë ndryshime në dobi të njerëzve dhe planetit gjithashtu. Kështu shpresa mbështet mundësinë që një e ardhme në të cilën njerëzit mund të përparojmë mund të jetë e arritshme.

Bukuria

Shqetësimi për bukurinë mund të duket kontestues meqë është e qartë se bukuria është në sytë dhe mendjen e atij që e sheh ose e koncepton atë. Po ashtu është e qartë se sa shtypës dhe përjashtues për shumë njerëz është marketingu i nocioneve të veçanta të bukurisë. Megjithatë, është e qartë se ndërmarrja e veprimeve të mundshme për t'i zbukuruar mjediset e shkollave tona është e rëndësishme për mirëqenien e

secilit. Është po ashtu pjesë e kësaj liste të vlerave sepse njerëzit ndonjëherë identifikojnë arritjet e tyre më të mëdha në arsim, një sekuençë të veçantë të aktiviteteve të të nxëniet për shembull, si diçka që përfshin krijimin e diçkaje të bukur dhe takimet ose observimet e tyre më motivuese gjatë ditës i shohin si diçka që përmban momente të bukura. Përfshirja e saj gjithashtu u lejon njerëzve të lidhin vlerat me interpretimin e tyre të përmbushjes shpirtërore. Bukuria mund të shihet në akte të sjelljes së mirë, në raste të çmuara ku komunikimi tejkalon interesin vetjak, në veprimin kolektiv dhe mbështetjen për të kërkuar të drejtat, kur njerëzit gjejnë dhe përdorin zërin e tyre. Bukuri është kur dikush e pëlqen diçka që ai vetë ose dikush tjetër e ka punuar, vlerësimi i artit dhe muzikës. Bukuria gjithëpërfshirëse qëndron larg stereotipeve në diversitetin e personave dhe në diversitetin e natyrës.

Urtësia

Urtësia përfshin zgjedhjen midis rrjedhave të veprimit duke e peshuar arsyetimin dhe pasojat e secilit: lejimi i kohës për reflektim, dhe mbledhja e perspektivave alternative para formimit të një mendimi për një person ose situatë: ne reflektojmë për përvojën tonë ose të të tjerëve për të shmangur përsëritjen e gabimeve: zgjidhim mosmarrëveshjet përmes ndërmjetësimit, dialogut dhe kthimit e jo përmes ndëshkimit, agresionit ose pushtetit. Duke mësuar të jemi të urtë ne lidhim vlerat me veprimet dhe përpqemi të veprojmë sipas vlerave që mbështesim: i bazojmë argumentet dhe vendimet në vlera, arsye dhe dëshmi: jemi të ndershëm në lidhje me limitet e njohurive tona dhe vlerësojmë njohuritë e të tjerëve, si fëmijë ashtu edhe të rritur: pyesim dhe dëgjojmë: e kuptojmë se jemi trupa dhe mendje dhe jemi pjesë e botës natyrale: përpqemi të përballemi e jo t'i mohojmë realitetet e vështira në vetën tonë dhe në botë, në mënyrë që të gjejmë burime përmirësimi: nuk i marrim të mirëqena të vërtetat e pranuar; bëjmë lidhje në mes fushave të mendimit që zakonisht janë të ndara: eksplorojmë atë që është e rëndësishme në jetën tonë dhe për të tjerët në jetën e tyre: kërkojmë njohuri që na ndihmojnë të jetojmë mirë së bashku në shtëpitë, komunitetet, shkollat, shoqëritë dhe në planetin tonë.

Përgjigja ndaj kuadrit të vlerave në Indeks

Kuadri nuk është menduar si një përshkrim por si thirrje për dialog. Jo të gjithë pajtohen me të edhe pse nganjëherë njerëzit mund të pajtohen me përshkrimet e vlerave të marra së bashku – universi i kuptimeve - duke preferuar të përdorin tituj të ndryshëm për ato të cilat lidhen më fort me fijet e mendimit, motivimit dhe përvojës në jetën e tyre. Meqë vlerat duhet të nxisin veprim, fjalët e përdorura për t'i përmbledhur ato ndryshojnë midis njerëzve të ndryshëm. Kur disa njerëz e shqyrtojnë listën ata mund të thonë se një ose disa nga vlerat e tyre kryesore si 'përgjegjësia', 'liria' dhe 'bashkëpunimi' nuk janë përmendur. Ata mund të duan ta ndryshojnë listën ndonëse duke e shqyrtuar më nga afër e shohin se shqetësimet e tyre mbulojnë nga kuptimi i vlerave. Për shembull, 'liria' është e lidhur me 'të drejtat' dhe 'pjesëmarrjen', dhe 'përgjegjësia' dhe 'bashkëpunimi' me 'komunitetin'.

Ata mund të shohin po ashtu se ato mbështesin vlera të ndryshme. Kjo mund të jetë çështje detajesh. Njerëzit kanë ide shumë të ndryshme për shkallën e reduktimit të pabarazisë në mes njerëzve ose sa duhet të nxitet pjesëmarrja e njerëzve në shkolla dhe shoqëri. Përcaktimi i kuptimit të vlerave gjithëpërfshirëse ka për qëllim

të paraqesë dallimet e tilla. Sa më shumë që i i këmbëjmë detajet e vlerave tona, aq më shumë ka gjasa që të dalin dallime në këndvështrimet tona.

Një kuadër i negociuar i vlerave mund të rezultojë nga dialogu me stafin, fëmijët, familjet dhe administratorët. Kjo mund të shprehet në deklarata të thjeshta, si në figurën 7, që janë më lehtë të qasshme se kuadri ynë. Mund të shkruhen nën titujt e përpiluar në një shkollë filllore¹⁴ në Figurën 8. Një shkollë që punon me *Indeksin* i ka përdorur vlerat e respektit për të hartuar një politikë të sjelljes në shkollë: 'respekti për veten, respekti për të tjerët, respekti për mjedisin dhe respekti për gjërat personale'¹⁵.

Megjithatë, një angazhim më i detajuar në kuptimin e vlerave është i nevojshëm nëse duhet të ofrohet një kuadër për veprim për fëmijët dhe të rriturit, i mjaftueshëm për të përfshirë kompleksitetin e jetës në shkolla.

Është e qartë se disa njerëz veprojnë në bazë të vlerave krejtësisht të ndryshme nga kuadri gjithëpërfshirës i përshkruar këtu.

Ka dëshmi se jo të gjithë njerëzit përqipen të veprojnë me besimin se çdo jetë dhe çdo vdekje ka vlerë të barabartë në komunitetin, vendin e tyre dhe në vendet e tjera. Disa njerëz janë më të zellshëm se të tjerët në ndjekjen e hakmarrjes dhe ndëshkimit për gabimet e perceptuara ose në ndjekjen me çdo kusht të parasë dhe pasurive të tjera, për qëllime afatshkurtra me interes vetanak.

Figura 7 Vlerat në shkollën tonë

- Ne duam që të gjithë të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të ndihen pjesë e komunitetit.
- Ne kujdesemi për fëmijët dhe të rriturit në shkollën tonë.
- Na pëlqen të dimë për njëri-tjetrin, për gjërat e përbashkëta dhe dallimet.
- Ne veprojmë me mendimin se ndajmë planetin me të gjitha qeniet e tjera të gjalla
- Shqetësohemi kur njerëzit vuajnë nga uria, sëmundjet dhe varfëria.
- Mësojmë nga njëri-tjetri dhe ndajmë atë që dimë.
- Ndërlidhim atë që mësojmë në shtëpi dhe në shkollë.
- I zgjidhim problemet duke dëgjuar njëri tjetrin dhe duke gjetur zgjidhje së bashku.
- Flasim kur shohim se diçka është e gabuar.
- Lu gëzohemi të gjitha bimëve dhe kafshëve të ndryshme në botë.
- Përqipemi të kursejmë energji dhe të shmangim mbeturinat.
- Ndhimojmë që shkolla dhe bota të bëhen vende më të mira për të jetuar.

14 Vlerat nga shkolla Harbinger, Tower Hamlets, London.

15 Politika e sjelljes, Dereham St. Nicholas Junior School, Norfolk.


Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Figura 8 Vlerat tona në Shkollën Harbinger		
Së bashku	Mirëqenia	Mësimi
Shohim një komunitet të larmishëm që kënaqet nga puna së bashku	Shohim veprimet e dhembshura	Shohim që të gjithë janë të angazhuar me padurim në mësimnxënie
Dëgjojmë që njerëzit kontribuojnë	Dëgjojmë zëra me besim dhe të guximshëm	Dëgjojmë kur nuk flitet dhe kur flitet
Vërejmë nivele të larta të pjesëmarrjes	Vërejmë se secili dëgjohet	Vërejmë besim dhe gatishmëri për të provuar
Ndjehemi të vlerësuar dhe si në shtëpi	Ndjehemi të sigurt	Ndjehemi krenarë për suksesin tonë individual dhe të shkollës

Është e rëndësishme të njihen si vlera ato shtytje për veprim që ne i shohim negativisht sepse ekzistojnë shumë kuadro të ndryshme vlerash që po ashtu i përgjigjen pyetjes: **“Si duhet të jetojmë së bashku?”** Nuk ka një set universal të vlerave.

Vlerat gjithëpërfshirëse mund të krahasohen me vlerat përjashtuese. Një kuadër i vlerave përjashtuese është paraqitur në Figurën 9 edhe pse disa tituj nuk janë në mënyrë strikte të kundërt me vlerat gjithëpërfshirëse. Njerëzit i njohin këto vlera si vlera që veprojnë në shumë shkolla në MB dhe vendet e tjera. Në këtë kuadër *barazia* është zëvendësuar nga *hierarkia*, *të drejtat* në praktikë nga *mundësia* në teori, *pjesëmarrja* nga *konsumi* i mallrave dhe ‘njohuria’,

detyrimet ndaj një *komuniteti* gjithnjë në rritje nga besnikëria ndaj një *grupi të brendshëm*, *respekti për diversitetin* nga dëshira për një *monokulture*, *qëndrueshmëria* mjedisore nga *shfrytëzimi* i vazhdueshëm, *jo dhuna* nga *diskriminimi*, *besimi* nga *mbikëqyrja* përmes vëzhgimit të vazhdueshëm, vlerësimit dhe inspektimit, *sinqeriteti* nga preokupimi me *imazhin*, *guximi* nga *pajtueshmëria* me shumicën ose opinionin zyrtar, *gëzimi* në mësimnxënie dhe mësimdhënie nga kërkimi i *shpërblimit* dhe administrimit ose shmangies së *ndëshkimit*, *dhembshuria* nga *interesi* vetanak, *dashuria* nga *autoriteti*, *shpresa/optimizmi* nga *fatalizmi*, *bukuria* nga *efikasiteti* dhe *urtësia* nga besimi në ushtrimin e *pushtetit* për të arritur atë që e dëshiron.



Zhvillimi i vetëdijes për vlerat

Procesi i vënies në veprim të vlerave gjithëpërfshirëse përfshin lidhjen e veprimeve tona me vlerat gjithëpërfshirëse dhe shkëputjen e tyre nga vlerat përjashtuese. Këtë e quajmë proces të 'njohjes së vlerave' – për të përshkruar atë që njerëzit bëjnë kur hetojnë dallimin që mund të bëjë kuptimi dhe zbatimi i një vlere në atë që ndodh brenda shkollave të tyre. Grupet e administratorëve, mësuesve, prindërit dhe fëmijët kanë punuar së bashku për t'i bërë këto lidhje, duke identifikuar një vlerë që është me interes për ta, duke menduar për domethënien e saj dhe pastaj duke e sfiduar veten dhe njëri-tjetrin për të gjetur se çfarë ndryshimi do t'i bënte ajo vlerë veprimeve në shkollë nëse do të vihej me të vërtetë në veprim (shih pjesa 3, aktiviteti 7, faqe 62) 'Ecjet e të nxënit'¹⁶, mund të përdoren në shkolla si pjesë e një strategjie bashkëpunimi për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien. Një nga shkollat me të cilat kemi punuar doli me idenë paralele të 'ecjeve të vlerave', ku të rriturit dhe fëmijët i vëzhgojnë aktivitetet dhe shfaqjet shkollore, vërejnë vlerat që ato duket se përfshijnë dhe pastaj dialogojnë në lidhje me to. Shkolla të tjera kanë angazhuar fëmijë dhe të rinj në një ditë aktivitetesh për vlera dhe janë befasuar me sofistikimin që të rinjtë kanë treguar në diskutimet e tyre për vlerat.



Në një shkollë, dita e tyre u vu në fokus nga vizatimi që bëri një ndihmës mësimdhënës ku përfshiu kuadrin e vlerave gjithëpërfshirëse të *Indeksit* në degët e një peme, një jehonë e pemës së tyre të dashur në ofrimin e strehimit dhe vend takimit në mjediset e shkollës..

“ Më pëlqen libri juaj ... Për të i kam treguar edhe familjes sime ... është një libër për ta bërë shkollën një vend më të mirë... ku e doni njëri-tjetrin në mënyrë që të gjithë të kenë miq, dhe nëse vjen nga një vend tjetër kjo nuk është problem sepse njerëzit thjesht mund të jenë miq me ty... është për atë që është më e rëndësishme për ty ... si e do familjen tënde.”

– Travis, 8 vjeç gjatë një dite pune me vlerat.

Lidhja me skemat e tjera të bazuara në vlera

Mbështetja jonë e zhvillimit të arsimit mbi vlerat gjithëpërfshirëse laike ka shumë të përbashkëta me qasjet e tjera ndaj arsimit të bazuar në vlera, duke përfshirë 'Vlerat e jetës'¹⁷ që rrjedhin nga grupi fetar/shpirtëror Brahma Kumaris dhe Imaginor, një organizatë e krishterë e lidhur edhe me shkrimet për 'vlerat e jetës'¹⁸. Figura 10 krahason titujt e vlerave në *Indeks* me këto dy skema. Ky ushtrim është i kufizuar pa krahasim të kuptimeve më të thella për secilin titull. Por derisa në disa ka mbivendosje, në listat e tjera të ideve të pjesëmarrjes dhe qëndrueshmërisë ka mangësi. Titujt e vetëm të përbashkët në të tri skemat kanë të bëjnë me komunitetin, respektin dhe sinqeritetin. Në fakt ne e prezantuar vlerën e jo-dhunës në skemën tonë pas angazhimit me Vlerat e jetës dhe vlerën e 'paqes', pastaj e zhvilluam si imperativë për arsimin. Në 'Vlerat e jetës', vlerat konsiderohen universale ndërsa ne i shohim vlerat si të diskutueshme me shumë kuadro të ndryshëm që ndikojnë në veprimet e

16 <https://www.teachingchannel.org/videos/the-learning-walk>
<https://creativeteachersupport.wordpress.com/2012/11/18/lets-go-for-a-learning-walk/>

17 Hawkes, N. (2003) *How to inspire and develop positive values in your classroom* [Si të frymëzoni dhe zhvilloni vlera pozitive në klasën tuaj], Cambridge, LDA. Frances Farrer (2000): Një revolucion i qetë, *The story of the development of values education at West Kidlington Primary School in Oxfordshire* [Historia e zhvillimit të vlerave të arsimit në shkollën fillore West Kidlington në Oxfordshire], Oxford, Rider.

18 <http://www.imaginer.co.uk/values/> Vickery, S, Ed. (2011) *Living values, a practical guide to rooting your school in Christian values*, [Vlerat e jetës, udhëzues praktik për të rrënjësuar vlerat e krishtera në shkollën tuaj],

grupeve të ndryshme të njerëzve. Po ashtu *Indeksi* është unik në përcaktimin se çfarë kuadri i tij i vlerave nënkupton për detaje praktike përmes shtatëdhjetë treguesve të tij dhe 2,000 pyetjeve.

Në të dy skemat e tjera, të rriturit dhe fëmijët ftohen të angazhohen edhe në ushtrime të njohjes së vlerave, përmes fokusit të vëmendjes në një titull tjetër të vlerës në secilin muaj, që përbën një pikë reference konstante në aktivitetet formale dhe aktivitetet më pak formale. Në praktikë, disa nga shkollat që e miratojnë këtë qasje negociojnë kuadrin e tyre të vlerave me stafin dhe/ose fëmijët.

Disa i konsiderojnë rezultatet e negociimit të tillë si një set vlerash që zbatohen vetëm për fëmijët për ta përmirësuar sjelljen e tyre. Kuadri ynë i vlerave, si edhe skemat e tjera, ka për synim të aplikohet për të gjithë.

Figura 10		Krahasimi i titujve të vlerave	
Indeksi për gjithëpërfshirje	Imaginer	Vlerat e jetës	
Barazia	Drejtësia	Përgjegjësia	
Të drejtat	Miqësia	Liria	
Komuniteti	Respekti	Bashkëpunimi	
Respekti për diversitetin	Qëndrueshmëria	Toleranca	
Qëndrueshmëria	Besimi	Respekti	
Pjesëmarrja	Dhembshuria	Përlësia	
Besimi	Falja	Paqja	
Dhembshuria	Mirënjohja	Sinqeriteti	
Jo-dhuna	Vërtetësia	Dashuria	
Sinqeriteti	Guximi	Lumturia	
Guximi	Bujaria	Thjeshtësia	
Bukuria	Shërbimi	Uniteti	
Dashuria			
Gëzimi			
Shpresa			
Urtësia			



Mburojat e fëmijëve të Roydon School për ato që ata vlerësojnë

Parimet pedagogjike plotësuese

Ka implikime që rrjedhin nga vlerat gjithëpërfshirëse në lidhje me atë se si dhe çfarë u mësojmë fëmijëve dhe çfarë ata nxënë. Vlerat gjithëpërfshirëse mund të përdoren për të nxjerrë parime pedagogjike - rregulla për të udhëzuar mësimdhënien dhe mësimnxënien me diversitet. Në disa raste kjo është relativisht e drejtpërdrejtë, ashtu që idetë e gëzimit, kujdesit dhe pjesëmarrjes, për shembull, kanë implikime të qarta për ndërveprimet e mësimdhënies dhe mësimnxënies siç pasqyrohen brenda treguesve dhe pyetjeve. Por ne dhe të tjerët e kemi parë të dobishme që të përcaktohen disa parime gjithëpërfshirëse *shtesë* të mësimdhënies dhe mësimnxënies që nuk dalin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kuadri i vlerave të *Indeksit* por janë të rëndësishme për t'u marrë parasysh për zhvillimin e shkollave tona. Ashtu si kuadri i vlerave, këto parime janë nxjerrë nga leximi dhe reflektimi për shumë vite si mbështetje për zhvillimin e shkollave në mënyra

gjithëpërfshirëse. Ndërsa vlerat janë përgjigje më e zgjeruar në pyetjen: Si duhet të jetojmë së bashku?, parimet kanë një fokus më të ngushtë për 'mënyrën se si duhet të mësojmë dhe të nxëmë së bashku'. Figura 11 është përpiluar pas reduktimit të një liste të gjatë të parimeve derisa ajo që mbeti arriti të ofrojë një udhëzues shtesë për veprim krahas kuadrit të vlerave.

Sikurse secila nga vlerat, ashtu edhe parimet mund të krijojnë një pikë fillimi për të menduar për zhvillimin e arsimit. Për shembull, ideja e shkollave për nxitjen e aktiviteteve dhe interesave të momentit dhe të përhershme (14) është një temë e bartur nga *Indeksi*. Ka të bëjë me pranimin se shkollat kanë për qëllim zhvillimin e interesave tek fëmijët dhe të rinjtë që i kontribuojnë jetës së aktivitetit. Për shumë prej tyre, puna e paguar do të jetë e rëndësishme krahas interesave dhe aktiviteteve të tjera.

Figura 11. Parimet pedagogjike gjithëpërfshirëse: Mësimdhënia dhe mësimnxënia me diversitet

Arsimi:

- 1 nuk duhet të vendosë limite për atë se çfarë mund të arrijnë fëmijët dhe të rriturit.
- 2 duhet ta bazojë të nxënit në përvojat personale dhe të përbashkëta.
- 3 duhet të përfshijë aktivitete mësimore jashtë klasave.
- 4 duhet të bazohet në diversitet si burim për të mësuar.
- 5 duhet të zhvillojë kapacitetin për dialog.
- 6 duhet të krijojë njohuri teorike nga zhvillimi i shkathtësive praktike.
- 7 duhet t'i vlerësojë shkathtësitë praktike njëjtë sikur njohuritë akademike.
- 8 duhet të ndërlihdë kuptimin në lëndë dhe kontekste të ndryshme.
- 9 duhet t'i shohë marrëdhëniet e mira si të rëndësishme në vetvete dhe si mbështetje për mësimin.
- 10 duhet ta njohë rëndësinë e identiteteve të sigurta për të mësuarit dhe mirëqenien.
- 11 duhet ta lidhë të nxënit me emocionin.
- 12 duhet t'i lidhë aktivitetet e shkollës me jetën sociale, kulturore, politike dhe ekonomike përtej shkollave.
- 13 duhet ta lidhë atë që ndodh në nivel lokal me atë që ndodh në nivel global.
- 14 duhet t'i nxisë aktivitetet dhe interesat momentale dhe të përhershme.
- 15 duhet ta bëjë jetesën e mirë në të tashmen po aq të rëndësishme sa përgatitja për të ardhmen.
- 16 duhet ta pranojë se të nxënit në fazat e hershme të jetës e formëson atë që jemi dhe atë që bëjmë në jetë më tutje.
- 17 duhet të fokusohet në mundësimin e lojës, mësimnxënien dhe mësimdhënien për të përparuar, më shumë se në arritjet.
- 18 duhet t'i konceptojë shkollat si mbështetje për të gjithë në komunitetet.
- 19 duhet të mbështesë qytetarinë aktive, lokale dhe globale.
- 20 duhet të theksojë ndërvarësinë e njerëzve, kafshëve të tjera, bimëve dhe mjedisit.

Vëmendja ndaj gjërave të domosdoshme

Kuadri i vlerave ose seti i parimeve pedagogjike është një mënyrë për të shprehur përkushtimet dhe për të përcaktuar si dhe çfarë duhet të mësojmë dhe nxëmë. Por nganjëherë mund të jetë e rëndësishme të frysh pak zjarr në to, për t'i parë disa nga gjërat si të domosdoshme. Në fund të jetës së tij, Theodor Adorno, teoricien social, mbajti një fjalim duke shprehur shqetësim për mënyrën se si arsimit iu ka përgjigjur mësimëve të nxjerra nga Holokausti:

“Kërkesa kryesore për arsimin është që Auschwitz-i të mos përsëritet më. Prioritetin e kësaj para gjithë kërkesave të tjera besoj nuk ka nevojë dhe nuk duhet ta arsyetoj. Nuk e kuptoj pse kësaj i është kushtuar kaq pak deri tani.”¹⁹

Adorno e përdori Holokaustin si një metaforë për konfliktet shkatërrimtare, zemërthyesë nëpër botë ku arsimimi mund të ndihmojë në shmangie. Ai na kërkon që t'i lejojmë njohuritë tona se shoqëritë mund të bien në barbarizëm, ta bëjnë dallimin në mënyrën se si i edukojmë fëmijët tanë. *Indeksi* ka tregues që janë të lidhur drejtpërdrejt me vlerat e jo-dhunës dhe respektin për diversitetin, të cilat mund të lidhen më së afërmi me shqetësimin e Adorno-s.

Argumentet për sjelljen e njerëzve në një marrëdhënie të re me mjedisin e tyre, nëse burimet e jetës së tyre duhet të ruhen, janë po aq bindëse sa nevoja për të shmangur racizmin dhe konfliktet e tjera. Kjo përfshin të mësuarit për efektet e asaj që konsumojmë dhe si mund të bëjmë zgjedhje të reja. Në literaturën e saj, një qeveri e kaluar inkurajoi zhvillimin e shkollave të qëndrueshme, të ndërgjegjshme për mjedisin dhe aktive dhe, sikur ne, sugjeroi që qëndrueshmëria të bëhet një parim udhërrëfyes për rishikimin e kurrikulës së tërë.

“Zhvillimi i qëndrueshëm është një dimension ndër sektorial i Kurrikulës Kombëtare...Një kurrikulë e hartuar për të arritur...një të ardhme ku asgjë nuk mund të merret si e mirëqenë ...do të dallonte nga ajo që mësohet në shumë shkolla.”²⁰

Ne bazohemi në vlerat gjithëpërfshirëse, parimet dhe të domosdoshmet për krijimin e një kurrikule - një mënyrë e ndarjes së njohurive - për shekullin e 21-të.



18 Adorno, T. (1966) Së pari i prezantuar si leksion radioje më 18 prill 1966, me titullin 'Padagogik nach Auschwitz'. [Arsimimi pas Auschwitz-it] në Adorno, T. (2005) *Critical Models: Interventions and Catchwords* [Modelet kritike: ndërhyrjet dhe motot], New York,

Columbia University Press. [E qasshme online në: http://ada.evergreen.edu/~arunc/texts/frankfurt/auschwitz/AdornoEducation.pdf](http://ada.evergreen.edu/~arunc/texts/frankfurt/auschwitz/AdornoEducation.pdf)

19 Department for Children, Schools and Families (2009): S3: Sustainable school self-evaluation [Departamenti për Fëmijë, Shkolla dhe Familje (2009): S3: Vetëvlerësimi i shkollave të qëndrueshme], Londër, DCSF

Pjesëmarrja në kurrikulë

Cilat janë implikimet e vlerave gjithëpërfshirëse, parimeve dhe imperativëve, në atë se si mësojmë dhe nxëmë? Nëse vlerat kanë të bëjnë me mënyrën se si duhet të jetojmë së bashku, atëherë kurrikula ka të bëjë me atë se *çfarë mund të mësojmë për të jetuar mirë së bashku*. Pas publikimit të botimeve të mëhershme të *Indeksit*, nganjëherë kemi thënë se *Indeksi* ka përcaktuar implikimet e vlerave gjithëpërfshirëse për të gjitha aspektet e një shkolle. Por kemi lënë një boshllëk të madh, sepse nuk kemi përcaktuar implikimet e kuadrit tonë të vlerave në përmbajtjen e aktiviteteve të mësimnxënies dhe mësimdhënies. Pas një periudhë të gjatë ngurtësie për planifikimin e kurrikulës në shkolla, pas prezantimit të Kurrikulës Kombëtare në Angli në fund të viteve 1980, duke e pamundur të konsideroheshin alternativa për ta kundërshtuar peshën e determinimit të qeverisë për atë që duhet të mësohet.

Ne jemi përpjekur të plotësojmë boshllëkun e kurrikulës edhe pse e bëjmë këtë në një kohë kur ka kufizime të vazhdueshme të risive në kurrikulë, sidomos në shkollat e mesme. Sugjerimet e kurrikulës formojnë një seksion të ri në Dimensionin C në këtë edicion të rishikuar të *Indeksit* (shih faqe 124-158). Shpresojmë se kjo do të nxisë dialogun në MB dhe në vende të tjera në lidhje me natyrën e kurrikulave gjithëpërfshirëse, çfarë mësohet në shkolla dhe pse, dhe cila është kurrikula e duhur për shekullin 21. E shohim nevojën për të ndryshuar mënyrën e strukturimit të njohurive dhe shkathtësive në shkolla si çështje urgjente nëse arsimimi do të jetë pjesë e zgjidhjes së problemeve mjedisore dhe sociale në nivel kombëtar dhe global. Prandaj shpresojmë që idetë tona do të kenë valën e tyre të ndikimit dhe kjo do të marrë forcë duke u bashkuar me valët e krijuara nga të tjerët. Kuptimi i 'kurrikulës së shkollës' ka dy elemente. Zakonisht i referohet qëllimeve formale të mësimdhënies, aktiviteteve të planifikuara mësimore dhe se si këto janë të strukturuar nën titujt e lëndëve. Por mund të tregojë edhe gjithçka që mësohet nga fëmijët dhe të rriturit përmes përvojës së tyre të të qenit në një shkollë. Mënyra e mësimdhënies dhe e nxënies mund të jetë pjesë e kësaj kurrikule më pak formale. *Indeksi* ofron mundësi që të rriturit dhe fëmijët të marrin kontrollin e zhvillimit të aspekteve më pak formale por që nganjëherë janë aspektet më me ndikim të kurrikulës. Për shembull, *Indeksi* sfidon krijimin e hierarkive të

fëmijëve dhe të rriturve. Promovon dialogun në lidhje me mënyrën se si arsimi mund të transformojë e jo thjesht t'i riprodhojë modelet ekzistuese të marrëdhënies shoqërore jashtë dhe pas shkollës.

Kemi shikuar edhe implikimet transformuese të kuadrit të vlerave gjithëpërfshirëse, parimeve dhe imperativëve, përvojën tonë dhe leximin, për të menduar për strukturën më formale dhe përmbajtjen e aktiviteteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kuadri ynë nxit të menduarit për lidhjet mes kurrikulës dhe përvojës së fëmijëve dhe familjeve të tyre, e cila është një lëvizje kritike në largimin e pengesave për të nxënë dhe pjesëmarrjen në shkolla. Donim të krijojmë një burim për të rritur kontrollin që kanë fëmijët në jetën e tyre: duke i përgatitur ata që të jenë qytetarë aktivë kombëtarë dhe globalë. Kurrikula e ndryshuar pasqyron të drejtat e njeriut, inkurajon veprimin për qëndrueshmërinë e mjedisit, i lidh njerëzit në nivel global, eliminon dallimet mes arsimit akademik, praktik dhe profesional dhe na lidh me realitetin e botës, duke përfshirë mënyrën se si njerëzit fitojnë para.

Jemi ndikuar nga shumë biseda me mësimdhënësit dhe kolegë të tjerë. Për shembull, një kolege në Hong Kong iu përgjigj draft skemës duke e lidhur kurrikulën me nevojat njerëzore për ushqim, ujë, veshje, strehim, shëndet dhe kujdes. Ajo sugjeroi që 'Sun Yatsen²¹ kishte thënë se nevojat bazë ishin ushqimi veshja, strehimi dhe transporti.²² Përmes këtij diskutimi, transporti u përfshi si një lëndë thelbësore e kurrikulës së zgjeruar për të përfshirë 'kur, pse dhe si lëvizin njerëzit në lokalitetin e tyre dhe nëpër botë'. Përfshin mënyrat e transportit, tregtisë dhe migrimit brenda dhe në mes vendeve. I mundëson kurrikulës që të adresojë një nga pyetjet më të rëndësishme të gjithëpërfshirjes për të gjitha vendet: 'çfarë është një politikë etike e imigracionit?' Duke eksploruar pyetje të tilla, fëmijët ndihmohen të reflektojnë për nivelet e mosbesimit dhe mospëlqimit ndaj të gjithë atyre që ikin nga konflikti apo varfëria dhe kërkojnë azil ose punë në një vend tjetër.

E shohim krijimin e kurrikulave si një shprehje të asaj se si ne, të rriturit dhe fëmijët,

20 Lider politik kinez i mesit të shekullit të 20-të.

21 Heung, V. (2000) komunikimi personal

Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Figure 12 Krahasimi i lëndëve të kurrikulës

Kurrikulë e bazuar në të drejtat globale		Kurrikulë tradicionale
Ushqimi		Matematika
Uji		Gjuha dhe Letërsia
Veshja		Gjuhët e huaja moderne
Strehimi/ndërtesat		Fizika
Transporti		Kimia
Shëndeti dhe marrëdhëniet	→	Biologjia
Toka, sistemi diellor dhe universi		Gjeografia
Jeta në Tokë	←	Historia
Burimet e energjisë		Dizajni dhe Teknologjia
Komunikimi dhe teknologjia e komunikimit		Arti
Letërsia, arti dhe muzika		Muzika
Puna dhe aktiviteti		Religjioni
Etika, pushteti dhe qeveria		Edukata fizike
		Edukimi personal, Shëndetësor dhe Social

mund të strukturojmë mësimin dhe njohuritë tona rreth botës. Pra kurrikulat nuk janë thjesht një tipar i shkollimit formal por kanë të bëjnë me dijen për të gjithë. Ato reflektojnë burimet që mësimdhënësit-qytetarët i sjellin në mbështetje të edukimit të fëmijëve.

Titujt e lëndëve në kurrikula

Në Figurën 12 kemi paraqitur titujt e lëndëve në dy kurrikula. Në të djathtë është një grup tradicional i titujve të lëndëve. Ato do të ishin të njohura për shkollat në çdo kohë në njëqind vitet e mëparshme dhe janë të njohura për njerëzit në shumë vende. Kur mendojmë për zanafillën e tyre, mund të vijmë në përfundim se ato nuk ishin dizajnuar për të tërhequr interesin e të gjithë fëmijëve por për të përgatitur një grup të elitës së kaluar për një arsimim universitar tradicional. Në të majtë janë titujt e një kurrikule të bazuar në të drejta, global, të qëndrueshmërisë. Këta tituj nuk janë lëndë por kanë për qëllim të kenë të njëjtin status si lëndët ose disiplinat tradicionale.

Titujt në të majtë të Figurës 12 përmbledhin shqetësimet e njerëzve kudo. Ato mund të përdoren për të ndërtuar një kurrikulë në qytete dhe fshatra në Kinë, Filipine

ose Republikën Demokratike të Kongos, si dhe në Angli dhe Gjermani dhe kështu t'i lidhin njerëzit mes këtyre vendeve. Ato formojnë bazë për një kurrikulë për njerëzit nga tre në njëqind e tre, për arsim parashkollor, fillor, të mesëm dhe të lartë. Janë tituj që mund të lidhen me përvojat e përbashkëta për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga arritjet e tyre. Kanë të bëjnë me aktivitetet e njerëzve në komunitetet rreth shkollave dhe kështu përforcojnë kontributet që mund t'i bëhen kurrikulës nga familjet e fëmijëve. Siç u sugjerua më herët, aktiviteti dhe puna konsiderohen së bashku, në mënyrë që shkollat të përgatisin fëmijët të mendojnë për punën si aktivitet i paguar në mesin e aktiviteteve të tjera përmbushëse në jetën e tyre. Duke reflektuar llojet e punës që bëjnë njerëzit zakonisht, kjo kurrikulë mund të eliminojë dallimet midis arsimit profesional dhe akademik. Kurrikula e bazuar në të drejta në Figurën 12 dhe 13 është paraqitur përmes treguesve dhe pyetjeve në seksioni 1 të Dimensionit C: Hartimi i një kurrikule për të gjithë (shih Figurën 10). Ndoshta doni ta shikoni këtë pjesë të kurrikulës shpejt e shpejt tani. Faqet e saj kanë një ngjyrë të veçantë, për ta dalluar për statusin e saj të veçantë si një fushë e Indeksit që

shkollat mund ta trajtojnë ndryshe. C1 ofron disa faqe të udhëzimeve për secilin tregues, që mund të zgjerohen dhe adaptohen sipas rrethanave të shkollës. Çdo fushë është e ndarë nën një numër titujsh dhe kjo është një tipar tjetër dallues i kësaj fushe të *Indeksit*. Rezultati është një kurrikulë përmbledhëse e prezantuar në detaje të mjaftueshme që një shkollë të përpilojë kurrikulën e saj, të rikrijë mënyrat me të cilat shkollat punonin para se t'i nënshtroheshin drejtimit qendror të kurrikulës kombëtare. Secila fushë është konsultuar sa më shumë që ka qenë e mundur me ekspertë dhe përmes një literature të gjerë.

Figura 13.

Treguesit për dimensionin C, Seksioni 1: Përpilimi i një kurrikule për të gjithë

- 1 Fëmijët eksplorojnë ciklet e prodhimit dhe konsumin e ushqimit.
- 2 Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit.
- 3 Fëmijët i studiojnë veshjet dhe stolitë e trupit.
- 4 Fëmijët mësojnë rreth banimit dhe mjedisit të ndërtuar.
- 5 Fëmijët shqyrtojnë si dhe pse njerëzit lëvizin në lokalitetin e tyre dhe botë.
- 6 Fëmijët mësojnë për shëndetin dhe marrëdhëniet.
- 7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin.
- 8 Fëmijët studiojnë jetën në Tokë.
- 9 Fëmijët hetojnë rreth burimeve të energjisë.
- 10 Fëmijët mësojnë rreth komunikimit dhe teknologjisë së komunikimit.
- 11 Fëmijët angazhohen dhe merren me krijime në literaturë, art dhe muzikë.
- 12 Fëmijët mësojnë për punën dhe e lidhin atë me zhvillimin e interesave të tyre.
- 13 Fëmijët mësojnë për etikën, pushtetin dhe qeverinë.

Por ekziston mundësia të gjeni lëshime dhe çështje të cilat mendoni se nuk janë shprehur siç duhet. Përfshirja juaj është e mirëpritur. Ju lutem na kontaktoni në

info@indexforinclusion.org

Secila fushë ndjek një model të çështjeve që lidhen në nivel lokal dhe global, duke marrë në konsideratë etikën dhe politikën dhe duke lidhur të kaluarën me të tashmen dhe të ardhmen.²³ Në shumë lëndë, shtrohen pyetje për biznesin dhe ekonominë. Megjithatë qeveritë mendojnë se po nxisin aktivitetin ekonomik duke u përqendruar në nxitjen e rezultateve në matematikë, shkencë dhe shkrim-lexim në testet e Programit për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve (PISA), kjo mund të vihet në pikëpyetje për shkak të marrëdhënies së dobët në mes përmbajtjes së asaj që mësohet në shkolla dhe aktiviteteve ekonomike që ndodhin me të vërtetë në shoqërinë tonë.

Forma e kurrikulës pasqyron një traditë të gjatë të inkurajimit të zhvillimit të aktiviteteve mësimore nga përvoja e përbashkët e fëmijëve. Mjaft hapësirë i jepet çështjeve mjedisore. Çdo shkollë inkurajohet ta lidhë veten me një burim uji: lumë lokal ose lumë në një pjesë tjetër të botës.²⁴ Kuptimi i lumenjve në vendet e tjera ofron informacione për jetën e atyre njerëzve, klimën dhe ndoshta origjinën e konflikteve të tyre. Aktiviteteve të tilla mund t'u jepet shtytje e madhe përmes rrjeteve ndër-shkollore kombëtare dhe globale.

Përshtatja e kurrikulës tradicionale

Shkollat fillore dhe të mesme në Angli zgjerojnë kurrikulat e tyre përmes aktiviteteve 'ndër-kurrikulare' që mund të përfshijë lëndë me tituj në anën e majtë të Figurës 12. Shumë shkolla tashmë kanë integruar në lëndë ndër-kurrikulare, projekte dhe zgjidhjen e problemeve aspektet e propozimeve të *Indeksit* në aktivitetet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies në lidhje me qytetarinë, qëndrueshmërinë, promovimin e shëndetit dhe dimensionin global. Shkollat caktojnë ditë të gjelbra dhe javë të qëndrueshmërisë dhe ndjekin

22 Kari Nes-i ka përshkruar një diskutim lidhur me një kurrikulë parimore të zhvilluar në Norvegji: Nes, K. (2003) Why does education for all have to be inclusive education? [Pse arsimit për të gjithë duhet të jetë arsim gjithëpërfshirës?] In Allan, J. (ed.) Inclusion, Participation and Democracy: What is the purpose? [Gjithëpërfshirja, Pjesëmarrja dhe Demokracia: Cili është qëllimi?] London, Kluwer Academic Publishers.

23 Ideja për lidhjen me një lumë lokal vjen nga 'Ecological Literacy': Stone M. and Barlow, Z. (2005) Ecological Literacy: Educating our children for a sustainable world. [Edukimi i fëmijëve tanë për një botë të qëndrueshme.] San Francisco, Sierra Club Books. Gjithashtu i kushton vëmendje praktikës maore të identifikimit të lumit të dikujt, si një burim i jetës së atyre njerëzve, si një hap i parë një hyrje formale.

dekadën e biodiversitetit, përdorin dramën për të eksploruar ndërvarësinë, financat, ushqimin, etikën, pushtetin dhe qeverinë. Krijojnë projekte teknologjike për ta përcjellur informacionin dhe për të shqyrtuar riciklimin dhe ruajtjen e energjisë. Ata mund ta përdorin materialin për të lidhur një kurrikulë më tradicionale me jetën dhe përvojën e fëmijëve, duke marrë ide nga fushat që kanë marrë më pak vëmendje si 'veshja dhe stolisja e trupit' dhe 'lëvizja dhe transportimi'.

Udhëtimi në kohë për të krijuar kurrikulën e shekullit 21

Megjithatë, në Figurën 12 janë paraqitur dy shigjeta. Në skicimin e një kurrikule alternative ne jemi munduar të sigurojmë që njohuritë e ndërlidhura me kurrikulat tradicionale të përfshihen në skemën e re. Përmbajtja e fizikës dhe kimisë mund të përshtatet për të kuptuar Tokën, sistemin diellor dhe universin, por ato gjithashtu paraqiten në disa fusha dhe veçanërisht për fizikën gjatë shqyrtimit të energjisë. Biologjia lidhet në të kuptuarit e ciklit të ushqimit dhe shëndetit por edhe me të kuptuarit e jetës në Tokë. Sigurisht që çdo shkollë dëshiron që fëmijët të dinë shkrim-lexim dhe të numërojnë. Në këtë skemë, shkrim-leximit i kushtohet vëmendje në fushën e komunikimit dhe në të gjitha fushat e tjera të kurrikulës.

Edhe matematika bëhet një temë ndër-kurrikulare. Janë shprehur shqetësime se natyra hierarkike e njohurive të matematikës kërkon që ajo të mësohet si një lëndë e ndarë dhe se konsiderimi i saj si plotësim në shumë lëndë të ndryshme do ta pengonte të kuptuarit. Në të njëjtën kohë, është shprehur shqetësim për motivimin e fëmijëve për të kuptuar matematikën, dhe arritjet e kufizuara të mundshme, kur matematika mësohet si lëndë e shkëputur nga bota reale. Konsiderimi i matematikës si burim ndër-kurrikular nuk është në përputhje me fëmijët që ndjekin matematikën si një sistem kompleks të mendimit gjatë ecjes përpara në shkollë. Kur i bëjmë gjërat ndryshe përballemi me probleme të reja që duhet të zgjidhen.

Historia shfaqet në çdo fushë për ta lidhur të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen,

një lëvizje që siç duket është në përputhje me qëndrimin e Shoqatës për Historinë dhënë në rishikimin e kurrikulës për shkollat fillore në vitin 2009:

“Mbështesim plotësisht ...zhvillimin e një Kurrikule Kombëtare më pak përkrahuese dhe më fleksibile që bazohet në lëndë si historia si mjete për mësim.”²⁵



Krahasimi

Rose Review është një nga tre rishikimet e shkollave fillore që ka dhënë propozime për një kurrikulë të rishikuar në fund të dekadës së parë të shekullit 21. Strukturat e tyre të propozuara janë paraqitur në Figurën 14. Të gjitha këto rishikime bazohen në parime që përputhen me kuadrin e vlerave të *Indeksit*. Megjithatë, ato janë të strukturuar me tituj më të njohur të kurrikulës. Përkundër theksimit të lëndëve të ndërlidhura, titujt mbajnë peshën e pritjeve tradicionale. Secili ishte i preokupuar që kurrikulat e shkollave fillore të jenë 'në përputhje' me kurrikulën e shkollave të mesme të bazuar në lëndë dhe kjo i kufizonte aspiratat e tyre.

Çfarë mund të arrihet duke propozuar ndryshime në kurrikulë?

As *Rose Review* e as *Alexander Review* që ishte më e zgjeruar nuk janë zbatuar nga qeveria kështu që ne nuk presim që sugjerimet tona të aplikohen menjëherë nga ana e shtetit. Të vetmin pushtet e kemi fuqinë e ideve tona për të angazhuar të tjerët në dialog. Ne inkurajohemi nga njohuria se kurrikula që ne

²⁵ Shoqata për Historinë (në *Rishikimi i pavarur i Kurrikulës për shkollat fillore*) DCSF 2009

propozojmë është më afër asaj që njerëzit zakonisht mësojnë jashtë shkollës dhe në arsim përtej shkollës sesa kurrikula tradicionale. Është një kurrikulë që më nga afër pasqyron jetën, përvojën dhe të ardhmen e fëmijëve. Ne besojmë po aq fuqishëm se kurrikula e shkollës duhet të ndryshojë ashtu siç duhet njerëzit të largohen

nga varësia nga nafta, nga besimi se ata mund të vazhdojnë të rrisin konsumin e burimeve të tjera të shterueshme të planetit të tyre dhe që planeti i tyre mund të absorbojë sasi të gjithnjë në rritje të mbetjeve jobiodegraduese. Besojmë se këto çështje janë të ndërlidhura dhe mbesim optimistë.

Figura 14. Kurrikulë e re për të vjetrën?

Rishikimi i pavarur i kurrikulës së shkollave fillore (nismë e qeverisë) (Rose Review)	Rishikimi i shkollave fillore i Cambridge-it (Alexander Review)	International Baccalaureate Primary Years Programme ²⁶
Kuptimi i gjuhës angleze, komunikimi dhe gjuhët	Gjuha, oratoria dhe shkrim-leximi	Gjuha
Kuptimi i matematikës	Matematika	Matematika
Kuptimi shkencor dhe teknologjik	Shkenca dhe teknologjia	Shkenca
Të kuptuarit historik, gjeografik dhe social	Vendi dhe koha	Studimet sociale
Kuptimi i zhvillimit fizik, shëndetit dhe mirëqenies	Shëndeti fizik dhe emocional	Arsimi personal, social dhe fizik.
Kuptimi i arteve	Artet dhe kreativiteti	Artet
Edukimi fetar	Besimi	
Qytetaria	Qytetaria dhe etika	



25 www.ibo.org/pyp/curriculum/Index.cfm

Formimi i aleancave

Indeksi ndihmon për të mbledhur së bashku të gjitha aktivitetet që nxisin vlerat gjithëpërfshirëse dhe kështu redukton fragmentimin e politikave dhe mbingarkimin me nisma. Figura 15 përmban një listë të aktiviteteve të cilat mund të futen nën një titull të zhvillimit gjithëpërfshirës.

Kur shkollat zhvillohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, ato në mënyrë aktive promovojnë arsimin demokratik dhe

Figura 15.

Aleanca për zhvillimin arsimor gjithëpërfshirës?

- Arsimi i bazuar në vlera
- Përmirësimi i shkollës/zhvillimi i shkollës
- Edukimi demokratik
- Qytetaria/Edukimi për qytetarinë globale
- Arsimi i bazuar në të drejta²⁷
- Arsimi gjithëpërfshirës i komunitetit
- Kohezioni i Komunitetit²⁸
- Paqja/arsimi pa dhunë
- Shkollat që promovojnë shëndetin²⁹
- Shkollat miqësore për fëmijët³⁰
- Arsimi për të gjithë³¹
- Edukimi shpirtëror, moral, social dhe kulturor³²
- Aspektet sociale dhe emocionale të të nxënësve (SEAL)³³
- Anti-diskriminimi/arsimi pa paragjykim³⁴
- Edukimi për barazinë
- Edukimi mjedisor, edukimi për qëndrueshmërinë mjedisore
- Mësimi jashtë klasës³⁵
- Shkolla në pyje³⁶
- Mësimi bashkëpunues
- Mësimi i bazuar në përvojë
- Filozofia për fëmijët³⁷
- Të menduarit inovativ³⁸
- Mësimi pa etiketim të aftësive³⁹

26 www.unicef.org/rrsa

27 Ligji i arsimit dhe inspeksionit 2006 përfshinte një seksion të ri 21(5) në Ligjin e Arsimit 2002 duke paraqitur detyrën e organeve qeverisëse të shkollave për të promovuar kohezionin e komunitetit.

28 http://www.who.int/school_youth_health/gshi/hps/en/

29 <http://www.unicef.org/cfs/>

30 <http://www.unesco.org/new/en/education/themes/leading-the-international-agenda/education-for-all/>

31 <http://www.doingsmsc.org.uk>

32 <http://www.sealcommunity.org>

edukimin për qytetarinë dhe qytetarinë globale, bazuar në njohjen e të drejtave të njeriut. Shkollat mbështesin të gjithë në komunitetet të tyre në mënyrë që komunitetet dhe shkollat të formojnë një marrëdhënie reciprokisht mbështetëse. Ky është kontributi më i mirë që ata mund të bëjnë për 'kohezionin e komunitetit'.

Duke i eliminuar ndarjet midis grupeve brenda komuniteteve të tyre, ata promovojnë shëndetin, duke u kujdesur për mirëqenien e të rriturve dhe fëmijëve dhe për shëndetin e trupave të tyre.

Ata bëhen pjesë e lëvizjeve ndërkombëtare për zhvillimin e shkollave, si ato që promovohen nga UNICEF-i 'shkolla miqësore për fëmijët'

ose shtytja globale e udhëhequr nga UNESCO-ja për arsim cilësor për të gjithë e quajtur 'Arsimi për të gjithë'. Ata integrojnë 'edukimin shpirtëror, moral, social dhe kulturor' dhe 'mësimin social dhe emocional' në mënyrën se si zhvillohen marrëdhëniet dhe aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ka shqetësime për t'i reduktuar të gjitha format e diskriminimit në mënyrë që ato t'i tejkalojnë kërkesat e legjislacioni për 'barazinë'.

Aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies i përgjigjen një imperativi mjedisor që i lidh fëmijët në mjediset lokale dhe globale dhe i bashkon këto me përdorimin e hapësirave, energjisë, ushqimit nga ana e shkollës dhe me qasjen e shkollës për mbeturinat. Të gjitha këto janë të lidhura në kurrikulën e shkollës. 'Shkolla në pyje' bëhet opsion për të promovuar ndjeshmërinë mjedisore, mësimin bashkëpunues, angazhimin shpirtëror dhe rivlerësimin e rrezikut. Kjo njohje e rëndësishme së 'mësimi jashtë klasës' lidh mësimin me përvojën, e cila i zgjeron lidhjet që fëmijët dhe të rinjtë i bëjnë kur mendojnë, flasin, shkruajnë dhe shprehin në mënyrë artistike. Fëmijët dhe të rriturit zhvillojnë kompetencat e tyre të mendimit kritik që mund të mbështeten përmes dialogut të inkurajuar në qasjen e mësimi të bazuar në hulumtime të 'Filozofisë për fëmijët'. Kur ata kalojnë nga identifikimi i vështirësive të fëmijëve si diçka që vjen nga 'nevojat e tyre të veçanta arsimore' në shqetësime për pengesat që vijnë kudo brenda

33 Derman-Sparks, L. and Olsen Edwards, J. (2010) Anti-Bias education for young children and ourselves [Arsimi i paanshëm për të rinjtë dhe veten], Washington, National Association for the Education of Young Children

34 <http://www.lotc.org.uk>

35 www.forestschoollassociation.org/what-is-forest-school/

36 <http://www.philosophy4children.co.uk>, <http://p4c.com/>

37 Hart, S. (1996) Beyond special needs: enhancing children's learning through innovative thinking [Përtej nevojave të veçanta: rritja e të nxënësve të fëmijëve përmes të menduarit inovativ], London, Paul Chapman Publishing.

Hart, S. (2000) *Thinking through teaching: a framework for enhancing participation and learning* [Mendimi përmes mësimdhënies: kuadër për rritjen e pjesëmarrjes dhe të nxënësve], London, David Fulton.

38 Hart, S., Dixon, A., Drummond, M.J. and McIntyre, D. (2006) *Learning without limits [Të nxënësve pa limite]*, Buckingham, Open University Press., Swann, M., Peacock, A., Hart, S and Drummond, M. Buckingham, Open University Press.

kulturës, politikave dhe praktikave të shkollës, ata ofrojnë burime për të gjetur zgjidhje krijuese për vështirësitë arsimore siç tregohet në ‘të menduarit inovativ’. Ata i shmangen etiketimit të fëmijëve bazuar në aftësitë e tyre, që mund të çojë në krijimin e një hierarkie të vlerave të fëmijëve, nxit pakënaqësinë, limiton pritjet e të tjerëve dhe ndikon negativisht në identitetin e vetë fëmijëve.

‘Zhvillimi Gjithëpërfshirës Arsimor’ është përdorur si titull për Figurën 15 sepse ‘gjithëpërfshirës’ mund të përdoret si një koncept me renditje më të lartë për një kuadër vlerash që promovon një gamë të gjerë aktivitetesh arsimore të përcaktuara zakonisht me etiketime të tjera. Të tjera terme mund të përdoren për të njëjtin qëllim – si ‘demokratik’ ose ‘i bazuar në vlera’ ose ‘i qëndrueshëm’ ose ‘jo i anshëm’ për të nënkuptuar një qasje të përgjithshme. Nuk ka rëndësi cili term përdoret për ta kryer këtë funksion integrues, me kusht që të njihet nevoja për t’i mbledhur bashkë këto aktivitete.

Shumë organizata ofrojnë ‘programe’ ose nismat e tyre për një ose disa nga fushat në Figurën 15 për të ndihmuar zhvillimin e shkollave. Mësimdhënësit duhet të integrojnë çështjet e ngritura dhe mësimet e nxjerra në planet e tyre të ardhshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Shumë programe të tilla shqyrtohen me kujdes dhe janë frymëzuese. Por qëndrueshmëria e tyre mund të vihet në pikëpyetje nëse nuk ka hapësirë dhe përkushtim për t’i integruar ato në aktivitetet mësimore në shkollë. Momenti i përfshirjes së tillë është kritik, andaj ato inkorporohen në shkollë në një pikë kur ato mund të shtyjnë përpara atë që tashmë ka filluar të ndodhë. Mund të ndodhë që një risi e vogël në një fushë, e hulumtuar nga stafi dhe e vendosur fortë brenda kurrikulës dhe

planit të tyre, të ketë ndikime që zgjasin më gjatë. *Indeksi* tregon se si aktivitetet e tilla mund të lidhen së bashku, siç ilustron në shembujt që pasojnë.

Mësimi për të drejtat

Indeksi inkurajon zhvillime të ngjashme me Shpërblimin për Shkollat që respektojnë të drejtat e njeriut, nismë e UNICEF-it në MB, por e fut këtë në ndryshime më të gjera në kulturën, politikat dhe praktikat e shkollës që mund të çojnë në ndryshime që zgjasin më gjatë. E identifikon idenë e ‘të drejtave’ si titull për një vlerë të lidhur në kuadrin e pesëmbëdhjetë vlerave të tjera. Mësimi për të drejtat mund të jetë një aktivitet i njohur në disa shkolla, prandaj është prezantuar si tregues A2.2 (faqe 92) ‘Shkolla e nxit respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut’. Faqet 192–193 prezantojnë dokumentet e të drejtave të njeriut dhe faqja 194 i referohet të drejtave planetare ose ‘të drejtave të nënës Tokë’, të lidhura me treguesin A2.3, ‘Shkolla inkurajon respektimin e integritetit të planetit Tokë’ (faqe 93).

Bashkimi i qëndrueshmërisë, vetëdijesimit global dhe zhvillimit të udhëhequr nga vlerat

Figura 16 tregon lidhjet ndërmjet mënyrës se si dokumentet e kaluara të qeverisë i ndanin shqetësimet e Kornizës Kombëtare për shkolla të qëndrueshme dhe Dimensionin global të shkollave. Figura 17 dhe 18 pastaj liston treguesit e *Indeksit* që lidhen me secilin nga këto programe, duke treguar mënyrën gjithëpërfshirëse të paraqitjes të tyre. Ndërhyrjet e tjera të paraqitura në Figurën 15 mund të reflektohen ngjashëm në tregues të veçantë



Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Figura 17.

Treguesit për tetë portat për shkolla të qëndrueshme⁴⁰

Dimensioni global

- A1.8 Shkolla e inkurajon kuptimin e ndërlidhjeve në mes njerëzve në mbarë.
- C2.6 Mësimet zhvillojnë aftësinë për të kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve.
- C1.7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin.
- C1.8 Fëmijët studiojnë jetën në Tokë.

Gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja

- A2.4 Gjithëpërfshirja shihet si pjesëmarrje në rritje për të gjithë.
- Të gjithë treguesit e tjerë

Blerjet dhe mbeturinat

- B1.13 Shkolla kontribuon në reduktimin e mbeturinave.

Energjia dhe uji

- B1.12 Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit.
- C1.2 Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit.
- C1.9 Fëmijët hetojnë rreth burimeve të energjisë.

Ushqimi dhe pijet

- C1.1 Fëmijët eksplorojnë ciklet e prodhimit dhe konsumin e ushqimit.
- C1.8 Fëmijët studiojnë jetën në tokë.

Udhëtimi dhe trafiku

- C1.5 Fëmijët shqyrtojnë si dhe pse njerëzit lëvizin në lokalitetin e tyre dhe botë.

Ndërtesat

- B1.11 Ndërtesat dhe terreni janë zhvilluar për të mbështetur pjesëmarrjen e të gjithëve.
- C1.4 Fëmijët mësojnë rreth banimit dhe mjedisit të ndërtuar.

Mirëqenia lokale

- A1.10 Shkolla dhe komunitetet lokale zhvillojnë njëra tjetrën.
- A2.9 Shkolla inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten.
- A2.10 Shkolla kontribuon në shëndetin e fëmijëve dhe të rriturve.
- C1.6 Fëmijët mësojnë për shëndetin dhe marrëdhëniet.



39 <http://esdgc.escalate.ac.uk/doorways>

Figura 18.

Treguesit për tetë konceptet kryesore për dimensionin global⁴¹

Qytetaria globale

- A1.7 Shkolla është model i qytetarisë demokratike.
 - A1.8 Shkolla e inkurajon kuptimin e ndërlidhjeve në mes njerëzve në mbarë botën.
- Dimensioni C, ku të gjithë treguesit duhet të lidhen në nivel lokal dhe global.

Diversiteti

- A1.9 Të rriturit dhe fëmijët i përgjigjen mënyrave të ndryshme të përjetimit të gjinisë.
- C2.6 Mësimet zhvillojnë aftësinë për të kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve.

Zhvillimi i qëndrueshëm

- A2.3 Shkolla inkurajon respektin për integritetin e planetit Tokë.
- B1.12 Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit.
- B1.13 Shkolla kontribuon në reduktimin e mbeturinave.
- C1.7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin.
- C1.8 Fëmijët studiojnë jetën në Tokë.
- C1.9 Fëmijët hetojnë rreth burimeve të energjisë.

Vlerat dhe perceptimet

- A2.1 Shkolla zhvillon vlera të përbashkëta gjithëpërfshirëse.

Të drejtat e njeriut

- A2.2 Shkolla nxit respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut

Drejtësia sociale

- A2.7 Shkolla lufton të gjitha format e diskriminimit.

Ndërvarësia

- A1.8 Shkolla e inkurajon kuptimin e ndërlidhjeve në mes njerëzve në mbarë.
- C1.1 Fëmijët eksplorojnë ciklet e prodhimit dhe konsumin e ushqimit.
- C1.2 Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit.
- C1.3 Fëmijët i studiojnë veshjet dhe stolitë e trupit.
- C1.5 Fëmijët shqyrtojnë si dhe pse njerëzit lëvizin në lokalitetin e tyre dhe botë.
- C1.7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin

Zgjidhja e konflikteve

- A2.8 Shkolla nxit ndërveprimet dhe zgjidhjet jo të dhunshme të mosmarrëveshjeve.

41 <https://globaldimension.org.uk/pages/8444>

Pengesat, burimet dhe mbështetja

'Pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje', 'burimet për të mbështetur të nxënit dhe pjesëmarrjen' dhe 'mbështetja për diversitetin' janë tre konceptet kryesore në *Indeks*. Ato ndihmojnë në orientimin e njohurive të përbashkëta të të rriturve dhe fëmijëve. Pyetjet në Figurën 19 i lidhin ato së bashku. Kur bisedohen përmes një procesi pjesëmarrës dhe lidhen me zhvillimin e vlerave gjithëpërfshirëse, ato mund të gjenerojnë ide për rishikim, planifikim dhe implementim edhe pa ndihmën e treguesve dhe pyetjeve në Pjesën 4.

Nganjëherë ka shumë probleme që e pengojnë zhvillimin e shkollës, të cilat dihen pothuajse nga të gjithë por mbeten të pashprehura. Ato janë si elefantët në dhomë, të cilat mund t'i zbulojë qasja bashkëpunuese dhe e bazuar në besim e *Indeksit*.

Pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje

Pengesat në të nxënit mund të paraqiten në ndërveprim me çdo aspekt të shkollës: ndërtesat dhe terrenin e saj, mënyrën e organizimit, marrëdhëniet në mes dhe midis fëmijëve dhe të rriturve dhe qasjen ndaj mësimnxënies dhe mësimdhënies. Pengesa mund të gjenden edhe jashtë kufijve të shkollës, brenda familjeve dhe komuniteteve dhe brenda ngjarjeve dhe politikave kombëtare dhe ndërkombëtare. Por mund të na duhet t'i rezistojmë tundimit që t'i shohim pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje vetëm jashtë

përgjegjësisë dhe pushtetit tonë për të vepruar. Përpjekjet tona për të hequr pengesat e shkollës duhet të përqendrohen në ato pengesa ku stafi, fëmijët dhe familjet e tyre mund të bëjnë diçka, sidomos kur punojnë së bashku.

Identifikimi i pengesave në mësimnxënie dhe pjesëmarrje nuk ka të bëjë me gjetjen e gabimeve në një shkollë. Gjithëpërfshirja është një proces i pafund, që përfshin zbulimin progresiv dhe heqjen e kufijve në pjesëmarrjen dhe të nxënit brenda bashkësive bashkëpunuese.

Zbulimi i pengesave dhe hartimi i planeve për t'i reduktuar ato janë gjithmonë lëvizje pozitive.

Zëvendësimi i nevojave të veçanta arsimore

Shfrytëzimi i 'pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje' për të zgjidhur vështirësitë arsimore mund ta zëvendësojë identifikimin e fëmijëve si 'fëmijë me nevoja të veçanta arsimore'. Ideja që vështirësitë arsimore mund të zgjidhen duke etiketuar fëmijët në këtë mënyrë dhe pastaj duke aplikuar ndërhyrje individuale ka kufizime të konsiderueshme. Konsiderimi i aftësive të kufizuara të fëmijëve si shkaku kryesor i vështirësive të tyre arsimore na largon nga pengesat në të gjitha aspektet e mjedisve dhe sistemeve dhe nuk le të shihen vështirësitë e përjetuara nga fëmijët pa etiketim. Kjo bën që fëmijët të shihen përmes një lente të 'mangësisë' dhe jo si persona që mund t'i nënshtrohen një sërë presionesh përjashtimi.

Figura 19. Pengesat, burimet dhe mbështetja

- Cilat pengesa të të nxënit dhe pjesëmarrjes paraqiten brenda shkollës dhe komuniteteve të saj?
- Kush i përjeton pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje?
- Si mund të minimizohen pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje?
- Cilat burime i kemi në dispozicion për mbështetjen e të nxënit dhe pjesëmarrjes?
- Si mund të mobilizohen burimet shtesë për ta mbështetur të nxënit dhe pjesëmarrjen?
- Si duhet të shpërndahen këto burime për ta mbështetur të nxënit dhe pjesëmarrjen?

Në kategorizimin e fëmijëve si fëmijë me 'nevoja të veçanta arsimore' ne mund t'i injorojmë mbipërfaqësimet në kategori sipas gjinisë, klasës dhe përkatësisë etnike. Për shembull, në Angli pothuajse dy herë më shumë djem se vajza janë të kategorizuar si fëmijë 'me nevoja të veçanta arsimore'.⁴² Ky mosbalancim ka qenë i njejtë te ata që nuk janë identifikuar të tillë por shihet se janë relativisht ulët në arritje ose kanë vështirësi në sjelljen e tyre. Këto shifra kanë vazhduar për dekada me radhë, dhe ju është dhënë relativisht pak vëmendje. Ato sugjerojnë se vështirësitë arsimore mund të kenë lidhje me ndërveprimin midis gjinisë dhe mënyrës se si fëmijët mësojnë në shkolla dhe se reduktimi i pengesave varet nga mendimi dhe veprimi ndryshe në lidhje me gjininë. *Indeksi* e nxit stafin në shkolla që të rishqyrtojnë mënyrën se si i promovojnë dhe i përgjigjen formave të mashkullisë dhe femërisë dhe identiteteve të tjera gjinore.

Etiketimi i fëmijëve si 'fëmijë me nevoja të veçanta arsimore' mund të çojë në pritje më të ulëta. Kur lidhet me kategorizimin e fëmijëve 'me dhunti dhe të talentuar', mund të jetë pjesë e krijimit të një hierarkie të vlerës së fëmijëve të parë si nxënës 'më pak se normalë', 'normalë' dhe 'supernormalë'. Kjo mund të ndodhë ndonëse në praktikë disa fëmijë mund të kategorizohen në të dyja, si fëmijë që 'kanë nevoja të veçanta arsimore' dhe kanë 'dhunti ose janë të talentuar'. Shumë shkolla punojnë shumë për t'i vlerësuar të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë pavarësisht etiketimeve dhe po punojnë për të kapërcyer perceptimet se kategorizimi ndihmon për nxitje.

Duhet të reflektojmë me kujdes para se ta etiketojmë dikë si person që 'ka nevoja të veçanta arsimore' ose 'SEN' ose ndonjë shkurtesë tjetër për kategoritë e 'anormalitetit' si 'EBD' (vështirësi/çrregullime emocionale të sjelljes, nganjëherë me prefiksin S që nënkupton Sociale) ose 'ADHD' (Çrregullimi hiperaktiviteti me mungesë përqendrimi) dhe sugjerimi më i fundit se fëmijët që nuk pajtohen 'kanë ODD' (Çrregullimi i kundërshtimit të mendimit opozitar). Barazimi i një fëmije me një akronim, praktikë e zakonshme kjo, paraqet një akt të veçantë të mungesës së respektit për atë fëmijë.

Përgjigja stereotipike për vështirësitë arsimore ka ndodhur në aspektin e kurrikulave individuale të veçuara, 'të diferencuara' dhe

vëmendja e madhe nga ana e ndihmës mësimdhënësit që mund të pengojë marrëdhëniet me fëmijët dhe të rriturit e tjerë. Kur një aktivitet i klasës kërkon punë në grup një ndihmës mësimdhënës, zakonisht më pak i kualifikuar se një mësimdhënës, shpesh gjendet duke punuar me fëmijët e grupuar së bashku sepse ata mendohet se kanë më së shumti vështirësi. Qëndrueshmëria e një modeli të asistimit të fëmijëve që duket se kanë vështirësi, pavarësisht këshillave të shumta për përdorimin e qasjeve të tjera, është çmimi për forcën e konceptit të 'nevojave të veçanta arsimore' në kufizimin e mendimit krijues për atë se si duhet të ofrohet mbështetja.

Koncepti i 'nevojave arsimore *individuale*' e ka zëvendësuar nocionin e 'nevojave të veçanta arsimore' në aspektet e praktikës së disa Autoriteteve lokale dhe disa shkollave. Kjo ka meritën e bashkimit të politikave dhe praktikave për të gjithë fëmijët e cenueshëm ndaj presioneve përjashtuese. Por mban fokusin në një përgjigje individuale e jo në eliminimin e pengesave dhe mobilizimin e burimeve në kulturën, politikën dhe praktikën e shkollës si tërësi.

Nocioni se vështirësitë arsimore duhet të kapërcehen me 'heqjen e pengesave në të nxënët dhe pjesëmarrje' u përdor më gjerësisht gjatë dekadës pas botimit të parë të *Indeksit* për përfshirje në vitin 2000, pjesërisht për shkak të ndikimit të tij. Megjithatë, përdorimi i idesë brenda dokumenteve zyrtare nuk është shoqëruar me kontestimin korrespondues të mënyrave të mëparshme të të menduarit dhe njëjtë kanë mbetur edhe presionet për të vazhduar përdorimin e termit 'nevoja të veçanta arsimore'. Kjo gjuhë përdoret në këshillën për shkrimin e 'Planeve të arsimit, shëndetit dhe kujdesit'⁴³, në identifikimin e vështirësive të nxënësve në Kodin e praktikës për nevojat e veçanta arsimore dhe aftësinë e kufizuar⁴⁴, në përdorimin e Planeve individuale arsimore dhe në informacionin që shkollat duhet ta sigurojnë për shpenzimet e tyre. Megjithëse me ligj nuk duhet ta përdorin titullin, shkollat inkurajohen që në 'Kodin e praktikës' ta përcaktojnë dikë si 'koordinator për nevoja të veçanta arsimore' zakonisht me shkurtesën 'SENco'. Termat alternative 'koordinator për mbështetjes në të nxënët', 'koordinator për zhvillimin e të nxënët

⁴² Office for standards in education, (2010) The special educational needs and disability review [Zyra për standarde në arsim, (2010) Rishikimi i nevojat e veçanta arsimore dhe aftësisë së kufizuar], London, Ofsted.

⁴³ Department for Education (2014) Children and families Act [Departamenti për Arsim, Departamenti i Shëndetësisë (2015) Kodi i praktikës për nevojat e veçanta arsimore dhe aftësisë së kufizuar: 0-25 vjeç], London, HMSO.

⁴⁴ Department for Education, Department of Health (2015) Special educational needs and disability code of practice: 0-25 years [Departamenti për Arsim, Departamenti i Shëndetësisë (2015) Kodi i praktikës për nevojat e veçanta arsimore dhe aftësisë së kufizuar: 0-25 vjeç], London, HMSO

ose 'koordinator për gjithëpërfshirje' janë të preferueshme sepse inkurajojnë një përgjigje më imagjinative dhe fleksibile ndaj pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje, mënyrën e reduktimit të tyre dhe mobilizimit të burimeve.

Nëse stafi merr kontrollin për mënyrën se si ata mendojnë për vështirësitë arsimore, atëherë ata mund të përdorin gjuhën e 'nevojave të veçanta arsimore' vetëm kur i përmbushin kërkesat zyrtare dhe të lejojnë të menduarit alternativ bazuar në pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje të përhapet në kulturën, politikën dhe praktikën e shkollës së tyre. Reflektimi për përdorimin e koncepteve është i rëndësishëm nëse duam që mënyrat e vjetra të të menduarit të mos thellohen. 'Një fëmijë që përjeton pengesa në të nxënit dhe pjesëmarrje' shumë lehtë mund të shndërrohet në 'një fëmijë me pengesa' si eufemizëm për 'një fëmijë me nevoja të veçanta arsimore'.

Modelet sociale dhe individuale të aftësisë së kufizuar

Përdorimi i konceptit 'pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje' për vështirësitë me të cilat ballafaqohen fëmijët në vend të termit 'nevoja të veçanta arsimore', krahason një vështrim social me një vështrim 'mjekësor' ose 'deficit individual' të vështirësive arsimore. Kjo mund të lidhet me modelet sociale dhe mjekësore të aftësisë së kufizuar. Aftësia e kufizuar mund të përkufizohet si term i gjatë 'kufizim i funksioneve fizike, intelektuale ose ndijore',⁴⁵ ndonëse nocioni aftësi të kufizuara intelektuale është problematik dhe mund të sugjerojë një bazë fizike të pajustificuar ndaj vështirësive në të nxënit. Aftësia e kufizuar mund të shihet si pengesë për pjesëmarrje për njerëzit me aftësi të kufizuara, dhimbje ose sëmundje kronike.

Një model mjekësor ose individual i aftësisë së kufizuar i sheh pengesat me të cilat ballafaqohen njerëzit me aftësi të kufizuara si pasojë e drejtpërdrejtë e aftësisë së tyre të kufizuar. Shpesh, aftësitë e kufizuara krijohen tërësisht brenda mjedisit në formë të qëndrimeve dhe praktikave diskriminuese dhe dështimit për të hequr pengesat në qasje dhe pjesëmarrje. Në raste të tjera, ato lindin nga ndërveprimi mes mjedisit dhe një personi me aftësi të kufizuara, dhimbje ose sëmundje kronike.

⁴⁵ Adaptuar nga Disabled People's International, (1982) Nga Kongresi i parë botëror, Singapore: Disabled People's International.

⁴⁶ Department for Education and Skills (2006) Implementing the Disability Discrimination Act in schools and early years settings [Departamenti për arsim dhe shkollësi (2006) Zbatimi i Ligjit kundër diskriminimit ndaj aftësisë së kufizuar në shkolla dhe në mjediset në vitet e hershme],

Shkollat mund të bëjnë relativisht pak për të kapërcyer aftësitë e kufizuara, ndonëse parandalimi i sëmundjeve dhe vëmendja ndaj një mjedisi të sigurt mund të ndihmojë në parandalimin e tyre për disa fëmijë. Megjithatë, shkollat mund të zvogëlojnë ndjeshëm pengesat e paraqitura nga qëndrimet dhe veprimet diskriminuese dhe pengesat institucionale të vendosura në rrugën e të rriturve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Shkollave iu kërkohet me ligj që të bëjnë 'rregullime të arsyeshme' për ta mbështetur pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.⁴⁶ Ndryshimet në kulturën e shkollës mund të ndihmohen pa masë duke siguruar që stafi me aftësi të kufizuara të mirëpritët si punonjës.

Diskriminimi institucional

Pengesat që ndikojnë në pjesëmarrjen e grupeve të veçanta dhe lindin nga mënyra se si institucionet janë të strukturuar ose të drejtuara përfshin 'diskriminimin institucional'. Raporti Macpherson⁴⁷ pas hetimit të mënyrës së trajtimit të rastit të vrasjes së adoleshentit me ngjyrë Stephen Lawrence nga ana e policisë, fokusoi vëmendjen në 'racizmin institucional' brenda forcave të policisë dhe arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale, edhe pse sigurisht diskriminimi i tillë nuk është i kufizuar vetëm në sektorin publik. Racizmi institucional u përcaktua si shërbim diskriminues 'përmes paragjyqimeve të padenja, injorancës, moskonsideratës dhe stereotipeve raciste, që i vë në disavantazh personat nga etnitë pakicë'⁴⁸ sipas një përkufizimi nga Stokely Carmichael në SHBA dyzet vjet më parë. Por diskriminimi institucional është më i gjerë se racizmi. Përfshin mënyrat se si institucionet i vënë njerëzit në disavantazh për shkak të varfërisë së tyre, gjinisë, aftësisë fizike, klasës, etnisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, religjionit, besimit dhe moshës. Diskriminimi institucional ngulitet në kulturë dhe ndikon në mënyrën se si njerëzit perceptohen dhe përgjigjen ndaj tyre. Diskriminimi institucional është përgjegjësi e të gjithë anëtarëve të institucioneve. Pra edhe pse mund t'i paraprijë bashkimit të një anëtari të caktuar në një institucion dhe mund të veprojë si presion në veprimet e tyre, secili person mbetet përgjegjës për diskriminimin dhe lëndimet e shkaktuara nga praktikat diskriminuese që ata mund t'i trashëgojnë pa e menduar. Diskriminimi

London, DFES.

⁴⁷ Macpherson, W. (1999) Stephen Lawrence inquiry (Macpherson report) Command Paper 4261, vol 1 [Hetimet për Stephen Lawrence (raporti Macpherson) Dokumenti 4261, vol 1], London, Stationery Office.

⁴⁸ Ibid para 6.34

institucional krijon pengesa në pjesëmarrje dhe në arsim mund të pengojë të nxënit. Diskriminimi serik mund të krijojë histori të varfër arsimore dhe kualifikime të reduktuara që i bëjnë njerëzit më pak të aftë për të fituar një vend pune. Mund të bëjë që stafi në shkolla të mos jetë përfaqësues i komuniteteve të tyre. Zhvillimi i përfshirjes mund t'i përfshijë personat në një proces të dhimbshëm të kontestimit të vetë praktikave, qëndrimeve të tyre diskriminuese dhe kulturës institucionale.

Racizmi, seksizmi, diskriminimi me bazë gjinore, klasizmi, homofobia, transfobia, diskriminimi në relacion me aftësinë e kufizuar, fenë dhe besimin, kanë një rrënjë të përbashkët që është jotoleranca ndaj të qenit ndryshe dhe përdorimi i pushtetit për të krijuar dhe për të përjetësuar pabarazitë. Për shkak se njerëzit shpesh janë më të informuar për diskutime mbi racizmin ose seksizmin sesa diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar, ata mund të jenë më pak të vetëdijshëm për përfshirjen e njerëzve dhe institucioneve në krijimin e aftësisë së kufizuar. Pranimi i përgjithshëm akritik brenda një shkolle i përjashtimit të fëmijëve sepse ata kanë një aftësi të kufizuar ose kategorizohen si fëmijë që 'kanë vështirësi arsimore' përbën diskriminim institucional.

Jotoleranca ndaj ndryshimit është e lidhur me 'mono- kulturalizmin' ku institucionet ose grupet e njerëzve e përcaktojnë një mënyrë të veçantë jetese dhe

të identiteteve që ajo mbështet si të vetmen mënyrë të pranueshme të të qenit. Kur njerëzit nuk ndihen të pranuar brenda institucioneve mono-kulturore ata mund të përjetojnë këtë refuzim si racizëm, diskriminim për shkak të aftësisë fizike, seksizëm etj. Në dekadat e para të shekullit 21 zërat e politikanëve evropianë por edhe një numër i njerëzve dhe organizatave që interesohen për reduktimin e pabarazisë, u ngritën kundër 'multi-kulturalizmit'.⁴⁹ U sugjerua se multikulturalizmi ka dështuar si mënyrë e bashkimit të njerëzve të etnive të ndryshme. Por duke e refuzuar një formë të veçantë të multikulturalizmit, ata me vetëdije ose pa dashje promovonin vazhdimin e monokulturizmit dhe diskriminimin institucional që ai krijon.

Indeksi i ndihmon shkollat për të zhvilluar multi-kultura komplekse të hapura, të mbështetura nga zhvillimi i politikave anti-diskriminuese. Natyra e këtyre politikave mund të shkojë më tej, por të jetë e plotësuar, nga instrumentet e qeverisë siç është Ligji i barazisë 2010. Të gjitha këto kërkesa mund të vendosen në kontekstin e një shkolle përgjegjëse ndaj diversitetit të çmuar të të gjithë anëtarëve të saj. Andaj politikat kundër diskriminimit mund të përpilohen sepse ato promovojnë vlerat e përbashkëta brenda një shkolle, e jo për të qenë në përputhje me legjislacionin.



⁴⁹ Alibhai-Brown, Y. (2000) *After multi-culturalism [Pas multikulturalizmit]*, London, Foreign Policy Centre.
Phillips. T (2004) *Guardian*, 28 maj 2004

Burimet për mbështetjen e të nxënit dhe pjesëmarrjes

Reduktimi i pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje përfshin mobilizimin e burimeve. Kur vlerat bëhen të qarta dhe të përbashkëta në komunitetet e shkollës, ato bëhen burim i madh për një shkollë. Krijon një drejtim të përbashkët për zhvillim, formëson vendimet dhe ndihmon në zgjidhjen e konflikteve. Vlerat gjithëpërfshirëse bëhen një nxitje e vazhdueshme për rritjen e pjesëmarrjes në mësim dhe në jetën më të gjerë të një shkolle.

Ngjashëm, bashkimi i ndërhyrjeve parimore në një shkollë, duke përfshirë programet me lëndë të ndryshme brenda një qasjeje të vetme, bëhen burim përmes qartësisë dhe koherencës së rritur. Ashtu si me pengesat, burimet mund të gjenden në çdo aspekt të shkolles; në kulturën, politikat dhe praktikën e saj; në ndërtesa, pajisjet e klasës, libra, kompjuterë; në stafin e mësimdhënies dhe jo të mësimdhënies, fëmijët dhe të rinjtë, prindërit/kujdestarët, administratorët dhe komunitetet më të gjera.

Në përgjithësi ekzistojnë më shumë burime brenda një shkolle për të mbështetur të nxënit dhe pjesëmarrjen sesa që përdoren aktualisht. Brenda një shkolle ka një pasuri të njohurive, për atë çfarë e pengon të nxënit dhe pjesëmarrjen. Një nga qëllimet kryesore të *Indeksit* është t'i ndihmojë shkollat që të bazohen në këto njohuri për zhvillimin e tyre. Ideja se diversiteti mund të jetë burim për të nxënit përshkon treguesit që përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet dhe midis fëmijëve dhe të rriturve. Burimet në fëmijët, në aftësinë e tyre për të drejtuar të nxënit e tyre dhe lojën dhe për ta mbështetur lojën, të nxënit dhe pjesëmarrjen e njëri-tjetrit mund të jenë veçanërisht të nënvleftësuar, siç edhe është potenciali i stafit për të mbështetur zhvillimin e njëri-tjetrit.

Propozimet për një program të ristrukturuar të bazuar në parimet gjithëpërfshirëse lidhin secilën fushë të kurrikulës në nivel lokal dhe global dhe kjo bën që shkollat të bazohen në burimet lokale për ta mbështetur kurrikulën. Meqenëse kurrikula e re lidhet ngushtë me jetën e fëmijëve dhe jetën e njerëzve në komunitetet, bëhet e qartë se njerëzit vendorë dhe mjedisi fizik bëhet burim për kurrikulën. Kufijtë e klasës shtrihen në lokalitet dhe përtej kësaj nëpër botë.



Mbështetja për diversitetin

Kur vështirësitë arsimore mendohet se vijnë nga 'nevojat e veçanta arsimore' të fëmijëve dhe të rinjve, mund të duket e natyrshme të mendohet për mbështetje nga njerëz shtesë për të punuar me fëmijët individualë që ata t'i tejkalojnë problemet. Ne përdorim një nocion shumë më të gjerë të 'mbështetjes' që thotë:

'të gjitha aktivitetet që rrisin kapacitetin e një shkolle për t'iu përgjigjur diversitetit të fëmijëve dhe të rinjve në mënyra që i vlerësojnë ata në mënyrë të barabartë'. Pra përpjekjet për të zbuluar dhe reduktuar pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje dhe mobilizimi i burimeve janë aktivitete mbështetëse.

Meqenëse në përkufizimin tonë zhvillimi gjithëpërfshirës i mësimdhënies dhe mësimnxënies janë aktivitete mbështetëse, mbështetja përfshin të gjithë stafin, fëmijët dhe familjet e tyre. Nëse aktivitetet mësimore janë të dizajnuara për të mbështetur pjesëmarrjen e tërë fëmijëve, reduktohet nevoja për mbështetje individuale. Mbështetja ofrohet kur mësimdhënësit planifikojnë mësimet duke i pasur parasysh të gjithë fëmijët, duke i njohur pikat e tyre të ndryshme të fillimit, interesat, përvojën dhe qasjet e tyre ndaj të nxënit. Ajo jepet kur fëmijët e ndihmojnë njëri-tjetrin. Ka një ekuivalencë midis uljes me një fëmijë që mundohet të kuptojë terminologjinë e një mësimi mbi biodiversitetin dhe rishikimit të aktivitetit në mënyrë që ai të rrenjoset në një përvojë të përbashkët për fëmijët, kjo shtrin të nxënit e të gjithëve dhe fjalët e përdorura kuptohen në përgjithësi. Mbështetja individuale për fëmijët duhet të jepet me synim inkurajimin e pavarësisë më të madhe: rritjes së kapacitetit të fëmijës për të mësuar dhe kapacitetit të të rriturve dhe fëmijëve për t'i përfshirë ata brenda aktiviteteve të të nxënit.

Materialet për shqyrtim

Zhvillimi i një shkolle duke u bazuar në një kuadër vlerash ose përmes identifikimit të pengesave, burimeve dhe mundësive për mbështetje mund të bëhet pak a shumë në mënyrë sistematike. Mund të përfshijë individë, grupe ose shkolla të tëra. Dimensionet, seksionet, treguesit, pyetjet dhe pyetësorët e *Indeksit* ofrojnë një grup mbështetjesh shtesë që mund të kontribuojnë në dialog për atë se çfarë të rriturit dhe fëmijët duan të bëjnë më tutje në zhvillimin e shkollës së tyre. Ata mund të përdoren sistematikisht për të rishikuar shkollën, për të hartuar një plan zhvillimi gjithëpërfshirës dhe për ta zbatuar atë. Nëse nuk e keni bërë këtë ende, kjo mund të jetë një ide për të kaluar nëpër listën e treguesve në faqe 12–13 dhe treguesve me pyetjet në Pjesën 4, për të shikuar se si ato janë të strukturuar dhe se si ato shërbejnë si tituj për pyetjet që u japin atyre kuptim.

Dimensionet dhe seksionet


Shqyrtimi i një shkolle duke përdorur materialet e *Indeksit* eksploron mundësitë për zhvillim në tri dimensione të ndërlidhura: **krijimin e kulturës gjithëpërfshirëse,**

hartimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse.

Figura 20 përsërit trekëndëshin nga përmbledhja dhe ilustron mënyrën e lidhjes së dimensioneve dhe Figura 21 në anën e pasme jep një përmbledhje të përmbajtjes së secilit.

Përvoja me *Indeksin* në shumë shkolla në vende të ndryshme konfirmon se këto dimensione shihen gjerësisht si domethënëse për strukturimin e zhvillimit të shkollës. Megjithëse secila përfaqëson një fushë të rëndësishme për zhvillim, ato mbivendosen. Vetëm nga dëshmitë e praktikës mund të hetojmë ndikimin e kulturave dhe të politikave. Ashtu si vlerat që duhet të kuptohen nga vëzhgimi i veprimeve, edhe kuptimi i natyrës së politikave varet nga vëzhgimi i përpjekjeve për të ndikuar në praktikë. Vetëm vënia e titullit 'politikë' në krye të një dokumenti nuk e bën atë një politikë në kuptimin e plotë të saj, përveç nëse paraqet një synim të qartë për të rregulluar praktikën. Pa një strategji zbatimi një dokument i ashtuquajtur dokument i politikave bëhet retorikë, ndoshta i përdorur vetëm për të bërë përshtypje te inspektorët dhe vizitorët.

Figura 20. Dimensionet e zhvillimit të shkollës në Indeks



Dimensioni A: Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse

Ky dimension ka të bëjë me krijimin e komuniteteve të sigurta, pranuese, bashkëpunuese, stimuluese dhe mirëpritëse, ku të gjithë janë të vlerësuar. Vlerat gjithëpërfshirëse të përbashkëta zhvillohen dhe përcillen te i gjithë stafi, fëmijët dhe familjet e tyre, administratorët, komunitetet përreth dhe të gjithë të tjerët që punojnë në shkollë dhe me shkollën. Vlerat e kulturave gjithëpërfshirëse udhëzojnë vendimet për politikën dhe praktikën ashtu që zhvillimi të jetë koherent dhe i vazhdueshëm. Përfshirja e ndryshimeve në kulturën e shkollës siguron që ajo të integrohet në identitetet e të rriturve dhe fëmijëve dhe të kalojë te të sapoardhurit në shkollë.

Dimensioni B: Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse

Ky dimension siguron që vlerat gjithëpërfshirëse të përfshihen në të gjitha planet për shkollën. Politikën inkurajojnë pjesëmarrjen e fëmijëve dhe stafit nga momenti që ata i bashkohen shkollës. Ata inkurajojnë shkollën të përfshijë të gjithë fëmijët në lokalitet dhe të minimizojnë presionet përjashtuese. Politikën mbështetëse përfshijnë të gjitha aktivitetet që rrisin kapacitetin e një shkolle për t'iu përgjigjur diversitetit të atyre që përfshihen në të, në mënyra që i vlerësojnë të gjithë në mënyrë të barabartë. Të gjitha format e mbështetjes janë të lidhura në një kuadër të vetëm që synon pjesëmarrjen e të gjithëve dhe zhvillimin e shkollës si një e tërë.

Dimensioni C: Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse

Ky dimension ka të bëjë me zhvillimin e asaj që mësohet dhe mënyrën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, që ajo të reflektojë vlerat dhe politikën gjithëpërfshirëse. Implikimet e vlerave gjithëpërfshirëse për strukturimin e përmbajtjes së aktiviteteve mësimore janë përpunuar në një seksion të quajtur 'Përpilimi i një kurrikule për të gjithë' (shih faqe 125-162). Kjo e lidh të nxënit me përvojën, në nivel lokal dhe global, të drejtat dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Të nxënit është orkestruar ashtu që aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies t'i përgjigjen diversitetit të të rinjve brenda shkollës. Fëmijët inkurajohen të jenë nxënës aktivë, kritikë dhe të reflektojnë dhe konsiderohen si burim për të nxënit e njëri-tjetrit. Të rriturit punojnë së bashku në mënyrë që të gjithë të marrin përgjegjësinë për të nxënit e tërë fëmijëve.

Rëndësia e kulturës

Në Figurën 20 kemi paraqitur kulturat në bazën e trekëndëshit dhe rëndësia e tyre është e nënvizuar. Kjo ndodh kur politikën dhe praktikën bëjnë dallimin në kulturën e një shkolle që ka gjasa të jetë i qëndrueshëm. Por qëndrueshmëria relative e kulturës e bën zhvillimin e komuniteteve, institucioneve dhe sistemeve sa të mundur aq edhe të vështirë. Përmes kulturave ndryshimi jo vetëm nuk është i qëndrueshëm por atij edhe i bëhet rezistencë.

Kulturën janë mënyra relativisht të përhershme të jetesës që krijojnë dhe ndërtohen nga komunitetet e njerëzve. Kulturën krijohen dhe shprehen përmes gjuhës dhe vlerave, në tregime, histori, njohuri, shkathtësi, besime, tekste, art, objekte, rregulla formale dhe joformale, rituale, sisteme dhe institucione të përbashkëta. Kulturën mund të sjellin, përforcojnë ose kundërshtojnë dallimet në pushtet. Ato krijojnë një ndjenjë kolektive se si gjërat bëhen dhe duhet bërë.

Kontribuojnë në formimin e identiteteve

në mënyrë që njerëzit të shohin veten të reflektuar dhe afirmuar nga aktivitetet e një grupi. Identifikimi me aktivitetet e një grupi siguron një motiv për t'ju treguar të sapoardhurve mënyrat e komunitetit. Ashtu si identitetet, kulturën formohen nga ndikime të shumta ndërvepruese dhe janë komplekse. Ato reflektojnë ndikimet e ndryshme dhe ato të ngjashme që veprojnë tek njerëzit dhe në përgjithësi përfshijnë rrjete të nënkulturave të mbivendosura. Ne përdorim 'kulturën' për të pasqyruar këtë pluralitet. Zakonisht ne shmangim fjalët 'etos' ose 'klime' që mund të pasqyrojnë një pamje të kufizuar të shkollës, një imazh të përcjellë nga menaxherët e institucionit e jo një pasqyrim të përvojës së përbashkët të të gjithëve.

Kulturën përfshijnë rregulla të qarta ose të nënkuptuara për identifikimin dhe reagimin ndaj vizitorëve dhe të huajve. Kulturën gjithëpërfshirëse inkurajojnë pranimin se disa mënyra të jetës dhe forma të identitetit mund të bashkëjetojnë, se komunikimi ndërmjet tyre është pasurues dhe kërkon që dallimet e pushtetit të lihen anash. Kur fleksibiliteti dhe shumëllojshmëria në

aktivitete përjashtohet, çdo ndryshim mund të përjetohet si humbje e identitetit nga anëtarët e komunitetit dhe ata i rezistojnë asaj.

Kulturat gjithëpërfshirëse të mbledhura së bashku përmes vlerave të përbashkëta janë mirëprirëse për anëtarët e rinj dhe për këtë arsye gjithmonë përfshijnë një parapërgatitje për ndryshim.

Secili dimension në Indeks është i ndarë në dy seksione siç ilustron në Kuadrin e planifikimit në Figurën 22 dhe në faqe 179. Kuadri mund të inkurajojë shkollat që përpiqen të zhvillojnë një aspekt të shkollës së tyre që lidhet me një dimension të *Indeksit*, për të parë se çfarë duhet të zhvillohet në fushat e tjera nëse aspekti që është shpresuar të ndryshohet do të zbatohet dhe pastaj të mbështetet.

Treguesit dhe pyetjet

Secili seksion përmban deri në 14 tregues. Treguesit dhe pyetjet në Pjesën 4 të *Indeksit* përbëjnë pjesën më të madhe të faqeve të tij dhe janë kontributi ynë për t'iu përgjigjur pyetjes: 'çfarë nënkuptojnë vlerat gjithëpërfshirëse për aktivitetet e të gjitha aspekteve të shkollave?' Treguesit janë sugjeruar si aspirata për zhvillim. Ata mund të përdoren për të shqyrtuar rregullimet ekzistuese në mënyrë që të përcaktohen prioritetet e zhvillimit. Janë tituj të dizajnuar për të arritur një qëllim të mundshëm, për një shkollë të përkushtuar të zhvillohet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Nganjëherë rëndësia e një çështjeje të tillë si përkatësia etnike ose aftësia e kufizuar reflektohet e shpërndarë nëpër treguesit në tërësi, në vend se të jepet treguesi i saj ndaras. Shqetësimeve gjinore u jepet treguesi i tyre por ato gjithashtu paraqiten në shumë vende të tjera. Përfshirja e çështjeve nëpër pyetje kufizon përcaktimin e përparësive për zhvillim duke u fokusuar vetëm në treguesit.

Pyetjet përcaktojnë kuptimin e treguesve. Ato shtyjnë të mendohet për një tregues të caktuar dhe të kuptohen njohuritë ekzistuese për shkollën. Ato e përforcojnë hetimin e situatës aktuale në shkollë, ofrojnë ide shtesë për aktivitetet zhvillimore dhe shërbejnë si kritere për vlerësimin e progresit. Shpesh, vetëm kur njerëzit fillojnë t'i përdorin pyetjet ata e shohin fuqinë praktike të *Indeksit*. Disa shkolla që përdorin *Indeksin* fillojnë nga dialogu rreth

një ose disa pyetjeve të zgjedhura nga një grup kolegësh që punojnë së bashku. Treguesit dhe pyetjet mund të përdoren për të filluar dialogun rreth vlerave dhe lidhjes në mes vlerave dhe veprimeve.


Në fund të secilit grup të pyetjeve ofrohet mundësi për të shtuar pyetje të tjera. Në këtë mënyrë të rriturit dhe fëmijët në çdo shkollë mund ta përshtasin versionin e tyre të *Indeksit*, duke i ndryshuar pyetjet ekzistuese dhe duke shtuar të vetat.

Disa tregues dhe pyetje i referohen çështjeve për të cilat shkollat kanë përgjegjësi të përbashkët me autoritetet lokale, siç janë qasja në ndërtesat e shkollës, planet e arsimit, shëndetësisë dhe kujdesit dhe politikat e pranimi. Ne shpresojmë që shkollat dhe autoritetet lokale të punojnë së bashku në mënyrë konstruktive për të nxjerrë plane, procedura për zhvillimin e planeve të arsimit, shëndetësisë dhe kujdesit dhe politika të pranimi, të cilat inkurajojnë pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve nga lokaliteti i shkollës.

Në disa shkolla, stafi dhe administratorët mund të arrijnë në përfundim se nuk duan të punojnë me tregues të veçantë për momentin, ose se ata tregues nuk çojnë në drejtimin që ata duan. Shkollat pritët të përgjigjen në mënyra të ndryshme dhe të përshtatin materialet sipas kërkesave të tyre. Megjithatë, përshtatja nuk duhet të bëhet vetëm pse një tregues apo pyetje paraqet një sfidë të mundimshme.

Në shkolla të tjera, treguesit dhe pyetjet mund të mos zbatohen për shkak të karakterit të shkollës. Shkollat ku vijon mësimin vetëm një gjini e caktuar dhe shumë shkolla fetare nuk janë të përcaktuara të përfshijnë të gjithë nxënësit nga lokaliteti i tyre. Sidoqoftë, stafi në këto shkolla shpesh dëshiron të planifikojë zhvillimin gjithëpërfshirës të shkollës së tyre dhe mund të dëshirojnë t'i përshtatin treguesit dhe pyetjet sipas qëllimeve të tyre. Kur *Indeksi* u publikua për herë të parë nuk ishte parashikuar se do të përdoret për të nxitur zhvillimin e shkollave speciale. *Indeksi* është i qartë në inkurajimin e shkollave për të përfshirë të gjithë fëmijët në lokalitetet e tyre. Megjithatë, disa shkolla speciale e kanë përdorur këtë për të eliminuar kufizimet në pjesëmarrjen e fëmijëve dhe stafit brenda shkollave të tyre.

Figura 22. Kuadri i planifikimit



Pyetësorët

Në pjesën 5 të *Indeksit* (faqe 180–186) janë katër pyetësorë, të cilët mund të përdoren për të stimuluar dialogun dhe shprehjen fillestare të prioriteteve për zhvillim nga fëmijët, prindërit/kujdestarët, administratorët dhe stafi. Pyetësori i parë bazohet në treguesit dhe është për çdo person të përfshirë në shkollë. Duhet të përdoret duke iu referuar pyetjeve, ashtu që kuptimi i treguesit të veçantë të mund të eksplorohet. Tre të tjerët janë për prindërit dhe fëmijët. Si treguesit dhe pyetjet u përpiluan duke menduar për implikimet e kuadrit të vlerave të *Indeksit* në natyrën e shkollave. Si rrjedhim, pyetësorët shpejt u bënë shumë të gjerë dhe duhej të reduktoheshin. Mënyra se si kuadri i vlerave u përkthye në këto deklarata praktike na ka inkurajuar shumë. Shkollat mund t'i shkurtojnë ato akoma ose t'i përshtatin për qëllimet e tyre.

Angazhimi me materialet

Përdorimi i pyetësorëve diskutohet edhe në pjesën tjetër të *Indeksit*, duke e përshkruar mënyrën se si mund të përdoret ai në proceset pjesëmarrëse. Kemi theksuar se nuk ka vetëm një mënyrë të drejtë të përdorimit të materialeve. Zhvillimi gjithëpërfshirës i shkollave mund të nxitet nga: puna me vlera, rëndësia e integritetit të nismave të mbivendosura; kontestimi i natyrës së kurrikulës së planifikuar dhe të kaluar; përdorimi i koncepteve të 'pengesave në të nxëniet dhe pjesëmarrje', 'burimeve për mbështetjen e të nxëniet dhe pjesëmarrjes' dhe 'mbështetjes' për të ndryshuar mënyrën e konsiderimit të vështirësive arsimore; dhe mbështetja në rolin e kulturave për mbështetjen dhe rezistencën ndaj ndryshimeve. Të gjitha këto aktivitete mund të bëhen veç e veç. Por ato janë çështjet që kanë nxitur zhvillimin e treguesve dhe pyetjeve të *Indeksit*. Prandaj janë të mbledhura bashkë në përdorimin e materialeve të shqyrtimit për të mundësuar një eksplorim të detajuar të asaj që ndodh në një shkollë dhe asaj që mund të ndryshohet për të nxitur zhvillimin gjithëpërfshirës.

3 Përdorimi i *Indeksit* për të ndërmarrë veprim



Përdorimi i *Indeksit* për të ndërmarrë veprim

Në Pjesën 3 sugjerojmë mënyra për të punuar me materialet e *Indeksit*. Mijëra njerëz e kanë përdorur *Indeksin* kështu që ne e dimë se ai përdoret në shumë mënyra të ndryshme. Përdoret si burim idesh në shumë kontekste nga shkollat deri te detyrat e studentëve universitarë dhe për formësimin e kurseve universitare. Një mënyrë e përdorimit të *Indeksit* në shkolla fillon nga angazhimi i përbashkët për t'i vënë këto vlera gjithëpërfshirëse në veprim dhe çon në përpilimin e një plani shkollor gjithëpërfshirës të nxjerrë dhe të zbatuar përmes bashkëpunimit me të gjithë ata që janë të përfshirë në komunitetet e shkollës. Por përdorimi i *Indeksit* mund të përqendrohet edhe në një aspekt të vetëm të shkollës ose të punës së një mësimitdhënësi të vetëm, dhe kjo mund të kontribuojë në dialog që në fund do të rezultojë në përhapjen e vlerave gjithëpërfshirëse më gjerësisht dhe më thellë. Por cilado qoftë mënyra e përdorimit të *Indeksit*, qëllimi duhet të jetë zhvillimi i qëndrueshëm, e jo përfundimi i një projekti gjithëpërfshirës.

Këtu ne përfshijmë një numër të përvojave të tjerëve që kanë përdorur *Indeksin*. Si çdo gjë tjetër në këtë libër, këto përvoja janë aty për të stimuluar idetë e jo pse ato përfaqësojnë një praktikë të përsosur.

Rrugët drejt zhvillimit të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse	55
Faza 1: Fillimi	56
Faza 2: Kuptojmë së bashku	67
Faza 3: Përpilimi i një plani	73
Faza 4: Ndërmarrja e veprimit	73
Faza 5: Shqyrtimi i zhvillimit	75

Rrugët drejt zhvillimit të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Ju përfshiheni në zhvillimin e udhëhequr nga vlerat qysh nga fillimi i punës suaj me *Indeksin*, kur e shikoni se si ai mund të ndihmojë në zgjidhjen e shqetësimeve tuaja momentale, kur lidhni veprimet me vlerat gjithëpërfshirëse, parimet pedagogjike dhe imperativët, kur mendoni si të eliminoni pengesat dhe të mobilizoni burimet, integroni programet dhe iniciativat dhe bashkëpunoni me të tjerët në planifikimin zhvillimor dhe zbatimin e tij. Treguesit dhe pyetjet e *Indeksit* promovojnë të gjitha këto aktivitete siç përshkruhet në Figurën 23. Në bazën e këtij diagrami është një fjali ku thuhet se çdo zhvillim është rezultat i përpjekjeve të të rriturve dhe fëmijëve dhe i takon atyre. Diagrami kombinon një

qasje sistematike me mënyrën se si zhvillimi arrihet teksa vlerat gjithëpërfshirëse dhe konceptet e *Indeksit* ndikojnë në praktikë nga momenti në moment.

Procesi i zhvillimit të shkollave i udhëhequr nga vlerat përshkruhet në ciklin në Figurën 23, edhe pse në shkollat që zhvillohen vazhdimisht aktivitetet në secilën Fazë mund të zhvillohen njëkohësisht. Faza 1 ka të bëjë me një grup planifikimi zhvillimor që mëson se si të punojë me *Indeksin*, që përfshin punën me kuadrin e vlerave. E kemi ndarë secilën Fazë në një sërë detyrash siç tregohet në Figurën 24 dhe secila prej tyre elaborohet më tej në Figurën 25.

Figura 23. Mbështetja e zhvillimit gjithëpërfshirës me *Indeksin* për gjithëpërfshirje





Figura 24 Cikli i planifikimit zhvillimor në *Indeks*



Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Figura 25. Fazat e Indeksit për zhvillim

Faza 1: Fillimi

- Filloni ku të mundeni dhe si të mundeni
- Zhvilloni grupin tuaj të planifikimit
- Gjeni mbështetje
- Punoni në mënyrë gjithëpërfshirëse
- Mbani shënime
- Përdorni treguesit dhe pyetjet
- Merrni pjesë në dialogun për vlerat
- Zhvilloni një gjuhë të përbashkët: gjithëpërfshirje, pengesa, burime dhe mbështetje për diversitetin
- Rishikoni ndryshimin dhe zhvillimin në shkollë
- Konsideroni integrimin e ndërhyrjeve
- Eksploroni Kuadrin e planifikimit
- Adresoni pengesat e përdorimit të Indeksit

Faza 2: Kuptojmë së bashku

- Rritni ndërgjegjësimin
- Ofroni materialet e Indeksit
- Shqyrtoni idetë e stafit dhe administratorëve
- Shqyrtoni idetë e fëmijëve/të rinjve
- Shqyrtoni idetë e prindërve/kujdestarëve dhe anëtarëve të komuniteteve lokale
- Negocioni prioritetet për zhvillim
- Integroni konsultimet në rutinën e shkollës

Faza 3: Hartimi i një plani

- Vendosni prioritetet në planin e zhvillimit

Faza 4: Ndërmarrja e veprimit

- Vini në veprim prioritetet
- Vazhdoni zhvillimin

Faza 5: Shqyrtimi i zhvillimit

- Shqyrtoni dhe festoni progresin
- Reflektoni për punën me Indeksit
- Shqyrtoni hapat e ardhshëm

Faza 1: Fillimi

Filloni ku të mundeni dhe si të mundeni

Shtytja për zhvillim në një shkollë mund të vijë jo vetëm nga mësimdhënësit senior, por edhe nga prindërit/kujdestarët, administratorët ose këshilli i fëmijëve/të rinjve i shkollës. Llogaria 1 e Indeksit është një raport i mbledhjes së parë të organizuar nga një koordinatore për gjithëpërfshirje, e emëruar nga shkolla e saj për të punuar me Indeksit. Më herët do ta kishim konsideruar mënyrën e saj oportuniste të mbledhjes së grupit të Indeksit si mënyrë e kufizuar e fillimit të punës. Por për shkak se përbën një fillim, ajo është ideale. Një takim, ku ka dialog, është një arritje dhe mund të ketë ndikim të përhershëm.

Zhvilloni grupin tuaj të planifikimit

Megjithatë, siç thotë edhe raporti i mësimdhënësit, synimi në punën me Indeksit është që të aplikohet një qasje e vetme, gjithëpërfshirëse për zhvillimin e shkollave. Shtimi i një grupi punues në një shkollë paralel me aktivitetet e rregullta të rishikimit dhe zhvillimit e rrit punën e përgjithshme të stafit. Kjo ngre shqetësime lidhur me koherencën e aktiviteteve të shkollës dhe qëndrueshmërinë e ndryshimeve të bëra.

Shpesh puna me Indeksit nisët nga anëtarët e një ekipi ekzistues të planifikimit zhvillimor të shkollës. Pavarësisht si fillon, anëtarësimi mund të zgjerohet që ai të përfaqësojë personelin mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës, prindërit, fëmijët dhe të rinjtë dhe administratorët. Është e rëndësishme që një grup të pasqyrojë përbërjen gjinore dhe etnike të shkollës. Persona të rinj mund t'i bashkohen grupit me vazhdimin e punës. Në një shkollë të mesme të madhe secili departament mund të ketë grupin e vet të planifikimit, të ndërlidhur me një grup qendror.

Materialet e Indeksit duhet të jenë të qasshme për të gjithë ata që punojnë me të. Shkollat inkurajohen të fotokopjojnë materialet për përdorimin e tyre; ato gjithashtu mund të shpërndahen në formë elektronike dhe mund të vihen në dispozicion në një kompjuter në hollin e shkollës ose në sallën e prindërve.

Pata një takim të parë shumë interesant. I shfrytëzova rrethanat me ata që i ftova të vinin. Menaxherja ime e linjës ishte atje, duke përfaqësuar Ekipin senior të menaxhmentit. Kisha një fëmijë që kishte mbështetje për nevoja të veçanta. Një vajzë aziatike e regjistruar në regjistrin e fëmijëve 'me dhunti dhe të talentuar' dhe një prind, udhëheqësin për praktikantët dhe udhëheqësin për mbrojtjen e fëmijëve i cili është në stafin tonë administrator. I ftova mësimdhënësit që ishin të lirë në atë kohë.

Desha të ishte joformale andaj i shërbeva me pije freskuese – është e mahnitshme çfarë mund të bëni me disa pako biskotash dhe një qese rrush. Bëra një hyrje të thjeshtë dhe shfrytëzova idenë nga nisja e projektit në zonën tonë ku njerëzit i tregojnë njëri-tjetrit dy të vërteta dhe një gënjeshtër për veten e tyre për ta thyer akullin dhe për t'i shtyrë të gjithë të flasin. Bëra që të këmbëjnë idetë e tyre për gjithëpërfshirjen – të gjithë u pajtuan se do të thoshte 'përfshirjen e të gjithëve'.

Kur i diskutuam pengesat, fëmijët thanë se ishte e padrejtë që nxënësit e kolegjit mund t'ia hidhnin me sjelljet që nuk toleroheshin në klasat e mëposhtme dhe prindërit dhe mësimdhënësit u pajtuan. Ishte e mrekullueshme që mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit shpalosën të njëjtat shqetësime rreth komunikimit. Nëse një fëmijë largohet nga klasa, letra e njoftimit për këtë u shkon prindërve një javë më pas. Shkolla kishte kaluar në një sistem kryesisht pa letër dhe kjo supozonte se prindërit kishin qasje në internet ndërkohë që shumë nuk kishin kompjuterë në shtëpitë e tyre. Edhe pse kompjuterët ishin në dispozicion në shkollë, ata nuk kishin besim t'i përdorin ata. Edhe në mbrëmjet e prindërve asgjë nuk u jepej prindërve për fëmijët e tyre – ata pritej ta kontrollonin emailin në shtëpi. Çështja e pirjes së duhanit u hap. Disa nga stafi i kafeterisë pinin duhan në të njëjtat vende ku rrinin studentët e kolegjit.

Kishte pika pozitive dhe negative; për çështjet e 'nevojave të veçanta arsimore' u dakordua që komunikimi ishte i mirë dhe këshilli i nxënësve dhe këshilli i shkollës po përparonin. Kishte shumë burime të mira në shkollë edhe pse këto ishin nën presion me rritjen e shkollës për shkak të popullaritetit të saj.

U dakordua që takimet të mbahen çdo gjysmë periudhe për të punuar më tej. Ata e kuptuan se ky ishte vetëm fillimi dhe puna me *Indeksin* do të përfshinte ndryshime më të thella pas punës më të detajuar me materialet. Ia tregova *Indeksin* drejtuesit tonë të vetëvlerësimit dhe ai mendon se *Indeksi* me të vërtetë mund ta përmirësojë atë proces. Na jepte një mundësi për t'u larguar nga mënyra lart-poshtë me të cilën është përpiluar plani i zhvillimit të shkollës. Këtu ndodh e kundërta. Nuk do ta kishim bërë këtë pa mbështetjen e *Indeksit*. Mund ta kishim bërë – dhe duhet ta kishim bërë – por na ka dhënë një arsye për të punuar në këtë mënyrë dhe më pëlqen.

– Koordinatorja për gjithëpërfshirjen, Winterburn High School

Gjeni mbështetje

Mund të jetë veçanërisht e dobishme të merrni këshillën e dikujt që ka përvojë në përdorimin ose prezantimin e *Indeksit* në shkollë. Një mbështetës i tillë mund të ndihmojë në gjetjen e mënyrës për të lëvizur gjërat dhe për të angazhuar stafin dhe të tjerët në proces. Ai ose ajo mund të lehtësojë qasjen në materiale dhe të lehtësojë frikën për ngarkesat shtesë të punës. Kjo mund të ndihmojë për të pasur në shkollë një proces bashkëpunues të zhvillimit të udhëhequr nga vlerat.

Disa e kanë parë të dobishme që të përfshijnë një 'mik kritik' në ekipin e tyre të planifikimit. Mund të jetë dikush jashtë shkollës që e njej mirë shkollën dhe është mbështetës dhe sfidues. Njerëzit të cilëve u është kërkuar të përmbushin rolin e mikut kritik përfshijnë mësimdhënësit nga shkollat e tjera,

këshilltarët arsimorë, psikologët në arsim dhe akademikët. Një shkollë fillore dhe e mesme zgjedhën të përdornin mundësinë e ofruar nga *Indeksi* për të krijuar lidhje më të ngushta ndërmjet tyre, duke e angazhuar koordinatoren e zhvillimit në secilën shkollë si mikut kritik të shkollës tjetër.

Megjithatë, dikush nga jashtë shkollës duhet të jetë i përkushtuar për ta përcjellur procesin përgjatë një periudhe të konsiderueshme dhe është më mirë që anëtarët e grupit të planifikimit të bëhen miq kritik për njëri-tjetrin në vend se të merret si mik kritik dikush tjetër që nuk mund të ketë interesim për një kohë më të gjatë për mënyrën se si puna me *Indeksin* po zhvillohet në shkollë. Të gjithë anëtarët e grupit mund t'i sfidojnë kolegët e tyre për të nxjerrë dëshmi për mendimet dhe konkluzionet e tyre rreth shkollës.

Punoni në mënyrë gjithëpërfshirëse

Të bëhesh mik kritik për njëri-tjetrin, kalimi nga diskutimi në dialog, është një proces gjithëpërfshirës. Grupi i planifikimit duhet të jetë model për praktikën gjithëpërfshirëse brenda shkollës, duke vepruar në bashkëpunim, duke siguruar që të gjithë dëgjohen me kujdes pa marrë parasysh gjininë, prejardhjen apo statusin dhe që askush nuk e dominon ndërveprimin. Anëtarët e grupit duhet të ndajnë se mund t'i besojnë njëri-tjetrit dhe se është e mundshme të flasim lirshëm dhe në besim. Secili anëtar i grupit duhet të ofrojë mendimet e tij në një mënyrë që nxit dialogun. Dallimet në pikëpamje duhet të mirëprehen si burim për ta çuar grupin përpara në mendimet e tyre.

Mbani shënime

Shënimet do të ishin shumë të vlefshme kur vjen puna për të reflektuar mbi çdo përparim të bërë në tre muajt, gjashtë muajt ose vitin e mëparshëm. Dëshmitë e mbledhura ndihmojnë për ta paraqitur progresin para të tjerëve, duke përfshirë inspektorët. Dosja mund të përmbajë përmbledhje të mbledhjeve dhe ndërhyrjeve, reflektimeve, pyetjeve, fotove, incizimeve. Gjatë avancimit të punës, disa persona mund të kontribuojnë duke përpiluar një përmbledhje ose një blog. Është e rëndësishme që ajo të jetë specifike, duke përmendur treguesit dhe pyetjet që janë përdorur për nxitjen e zhvillimit. Puna me Indeksën në një shkollë mund të rritet kur stafi që diplomon apo është duke kryer ndonjë kurs tjetër e përdorë punën për temën e diplomës dhe detyrat që i ndajnë me kolegët. Pyetjet në Figurën 26 mund të jenë të dobishme për mbajtjen e shënimeve për intervenimet.

Figura 26.


Çfarë ndryshime janë arritur si rezultat i përdorimit të Indeksit në shkollë?

- Cila ishte fusha e aktivitetit apo shqetësimit?
- Kush ishte i përfshirë?
- Si ishte gjendja para përdorimit të Indeksit?
- Çfarë ishte bërë?
- Çfarë ndryshime rezultuan nga përdorimi i Indeksit?
- Cilat janë dëshmitë e ndryshimit?
- Cilat ishin pengesat e hasura?
- Si u tejkaluan ato?

Përdorni treguesit dhe pyetjet

Në mbledhjen e parë është mirë që qysh në fillim të kalohet në pjesën bazë të Indeksit, duke i prezantuar treguesit dhe pyetjet. Gjatë punës me Indeksën në Norfolk, Judith Carter-i, Këshilltare e lartë, zhvilloi një hyrje pesë minutëshe për Indeksën siç shihet në Aktivitetin 1. Kjo anashkalon shqetësimin që njerëzit kanë për numrin e çështjeve të ngritura nga Indeksit dhe shkon drejtpërsëdrejti në qëllimin kryesor – të ndihmojë mesimdhënësit, administratorët, fëmijët dhe familjet e tyre për të ndërmarrë veprime në fushat që i prekin ata. Kur e shohin se ai mund të ofrojë ndihmë për përmbushjen e një shqetësimi konkret njerëzit ndihen të inkurajuar për ta integruar atë në planifikimin afatgjatë. Figura 27 mund të ndihmojë me këtë përmbledhje të shpejtë.

Figura 27. Struktura e Indeksit



Nga vlerat në veprime

Aktiviteti 1: Hyrja pesë-minutëshe për Indeksën

Shikoni kuadrin e vlerave në Indeks në faqe 11 si bazën e Indeksit. Detyra e punës me Indeksën është vënia e vlerave të kuadrit si kjo në veprim. Shikoni te treguesit në faqe 12-13 dhe shikoni mënyrën se si ato organizohen në dimensione dhe seksione. Zgjidhni një tregues për shkak se ai lidhet me një shqetësim konkret ose me një interes të veçantë për zhvillim, pastaj kthehuni te faqja(et) e pyetjeve për ta thelluar eksplorimin tuaj.

Mbledhja mund të fillojë edhe me aktivitetin 2, në të cilin pjesëmarrësve u kërkohet të sjellin në mbledhje një pyetje të preferuar. Llogaria 2 e *Indeksit* tregon se si një ndihmës drejtor e ka prezantuar *Indeks*in para mësimeve skeptike në një shkollë të mesme të madhe, ndërsa Llogaria 3 e *Indeksit* tregon se si pikëpamjet e mësimeve ndryshuan shumë shpejt pasi ata u angazhuan me treguesin e parë.



Aktiviteti 2: Pyetjet e preferuara

Anëtarëve të grupit të planifikimit mund t'u kërkohet të shikojnë treguesit dhe pyetjet në Pjesën 4 të *Indeksit* para mbledhjes dhe të vijnë me një pyetje të preferuar për diskutim, që ata mendojnë se ngre një çështje të rëndësishme për shkollën. Secili person mund ta prezantojë pyetjen e tij dhe arsyen pse ajo është e rëndësishme. Përndryshe, personi që drejton grupin mund të vijë me tre ose më shumë pyetje nga pjesë të ndryshme të *Indeksit* që ata mendojnë se do të provokojnë diskutime dhe do t'i shtojnë njerëzit t'i njohin më mirë materialet. Disa persona kanë vërejtur se pavarësisht pyetjeve të përzgjedhura, diskutimi i tyre përgjithësisht çon në shqyrtimin e disa prej sfidave kryesore me të cilat përballen shkollat.

Llogaria 2 e *Indeksit*

Transformimi i pikëpamjeve të gjithëpërfshirjes

Në shkollën Garside Comprehensive School, zëvendësdrejtoreja drejtoi një mbledhje të stafit pasi pyetësorët ishin shpërndarë te të gjithë ata. Ajo filloi duke sugjeruar se procesi i *Indeksit* ishte një mënyrë për të përforcuar dhe mbështetur arritjet:

“Fillova duke thënë se gjithëpërfshirja nuk është aty ku duam që të gjithë të jenë të lumtur gjatë gjithë kohës dhe ku askush nuk ka rregulla për t'ju bindur. E prezantova [*Indeks*in] si mundësi që një shkollë të shoh në mënyrë kritike se ku është si komunitet në lehtësimin e arritjeve gjithëpërfshirëse. Prezantimi u bë. Drejtoreja pastaj dha kontributin e saj, u largua dhe e la takimin të vazhdojë. Nëse mund të imagjinoni të gjithë këta 140 njerëz në sallën e mbledhjeve duke argumentuar se çfarë do të përfshijnë në pyetësor. Nga një situatë ku përfshirja ishte shumë, shumë e lënë anash, ajo u bë shumë qendrore. Disa njerëz vazhdonin të ishin atje deri në orën gjashtë pa pesëmbëdhjetë0, qysh nga ora tre e njëzet kur iu kishin bashkuar grupit, sepse diçka në proces kishte nxitur një reagim intelektual që thoshte ‘Hej, kjo na takon neve – ka të bëjë me mua njëjtë si me atë vajzën atje [të kategorizuar si person me nevoja të veçanta arsimore]. Ka të bëjë me të gjithë ne’.”

Llogaria 3 e *Indeksit*

Ballafaqimi me realitetin

Në shkollën St. Simon's School, ndihmësdrejtori e prezantoi *Indeks*in para stafit pas një sesioni trajnimi të autoriteteve lokale. Një grup koordinues ishte formuar duke përfshirë drejtorin, ndihmësdrejtorin, një mësimeve, asistentin që ofron fizioterapi dhe mbështetje tjetër për fëmijët, punonjësin ndërlidhës për personat me dëgjim të dëmtuar, një mbikëqyrës në kohë të drekës që ishte edhe prind dhe një kujdestar që ishte edhe administrator. Një koleg nga autoriteti lokal arsimor vepronte si mik kritik. Shkolla ishte angazhuar në diskutime rreth gjithëpërfshirjes, që më parë mendohej se nënkuptonte që fëmijët e kategorizuar me ‘nevoja të veçanta arsimore’ duhet të edukoheshin në klasat e rregullta. Ndihmësdrejtorit tregoi për prezantimin e *Indeksit*:

“Në mbledhjen e parë e shpjegova tërë procesin. Bëmë një ushtrim të vogël [me treguesit]... dhe pastaj kaluam në pyetjet që lidhen me treguesin A1.1 ‘Të gjithë janë të mirëseardhur’, dhe biseduam rreth tyre. Kur filluam ishim të sigurt se ishim gjithëpërfshirës, se nuk e kemi larguar askënd asnjëherë, dhe mund të mendonim për shumë gjëra që i bënim. Por kur filluam të shikonim pyetjet e *Indeksit*, filluam të shohim edhe gjërat që nuk i bënim...”

Aktiviteti 3 prezanton pjesën e kurrikulës së *Indeksit*, Aktiviteti 4 diskuton dëshminë për mendimet rreth shkollës të paraqitura në mbledhje dhe Aktiviteti 5 i kërkon grupit të familjarizohet me *Indeks*in.

Aktiviteti 3: Përgjigja ndaj Seksionit C1: Përpilimi i një kurrikule për të gjithë

Grupi mund ta shqyrtojë në mënyrë specifike se si u janë përgjigjur treguesve në Seksionin C1. Kjo ka të ngjarë të ndryshojë në shkollat fillore dhe të mesme ndonëse të dyja punojnë sipas kufizimeve të kurrikulës. Ata mund të rishikojnë argumentet për një kurrikulë alternative në faqet 36-40 në Pjesën 2.

- Deri në çfarë mase treguesit dhe pyetjet në C1 ofrojnë një mënyrë të arsyeshme për ta strukturuar kurrikulën?
- Deri në çfarë mase mund të përdoren aspektet e C1 për ta përmirësuar një kurrikulë më tradicionale?
- Si mund ta përdorë grupi *Indeks*in për t'i angazhuar të tjerët në dialog rreth përmbajtjes së kurrikulës?

Aktiviteti 4: Diskutimi i dëshmimeve

Grupi mund të pajtohet për një tregues ku mendojnë se shkolla është duke performuar mirë dhe një tjetër ku mendojnë se ka hapësirë të konsiderueshme për zhvillim. Në secilin rast ata mund të japin dëshmi për ta mbështetur pikëpamjen e tyre. Ata duhet të përdorin pyetjet në secilin tregues për të ndihmuar në gjetjen e fushave përkatëse të dëshmimeve.

Aktiviteti 5: Rishikimi i treguesve dhe pyetjeve të mbetura

Ky aktivitet mund të kryhet ndërmjet mbledhjeve. Anëtarët e grupit koordinues duhet të njoftohen vetë me treguesit dhe pyetjet e *Indeksit* nëse nuk e kanë bërë këtë për aktivitetin e parë. Ata do të shohin se si ndonjëherë pyetjet sugjerojnë një aspekt të shkollës që mund të ndryshohet lehtë, ndërsa pyetjet e tjera mund të nxisin reflektimin për ndryshime të thella dhe përfshirëse që duhet të bëhen. Në mbledhjen e radhës ata mund t'i ndajnë këto me të tjerët.

Aktiviteti 6 ofron mundësi për të diskutuar vlerën e përdorimit të pyetësorëve. Analiza e hollësishme e pyetësorëve, grafikët, tabelat mund të marrin shumë kohë dhe mund ta vonojnë fillimin e punës zhvillimore. Kur përdoren për t'u konsultuar me stafin, prindërit ose fëmijët, janë prioritetet e tyre ato që duhet të mblidhen e jo të gjitha përgjigjet e tyre në një pyetësor. Të gjitha pyetjet janë shkruar në mënyrë që dakordimi se ato janë të vërteta për shkollën të shihet si vlerësim pozitiv. Njerëzit ndonjëherë e paraqesin shkollën e tyre si më gjithëpërfshirëse sesa që është. Kur anëtarët e grupit krijojnë besim dhe ndihen në gjendje të jenë të sinqertë me njëri-tjetrin atëherë gjithëpërfshirja në shkollë mund të duket se po pakësohet. Kjo e kufizon masën e përdorimit të pyetësorëve të *Indeksit* pa bërë hetime të mëtejshme për ta vlerësuar progresin në zhvillimin e gjithëpërfshirjes.

Llogaria 4 e *Indeksit* ofron një shembull të përfitimeve të mbështetjes në treguesit dhe pyetjet në një shkollë.

Aktiviteti 6: Përdorimi i pyetësorëve të treguesve për të identifikuar prioritetet për ndryshim

Qëllimi i këtij aktiviteti është përdorimi i treguesve për të identifikuar shqetësimet që duhet të shqyrtohen më tutje. Lista e plotë e treguesve nga faqja 12-13 është gjithashtu në formularin e Pyetësorit në faqe 180-181. Njerëzit mund të punojnë individualisht për t'u përgjigjur pyetësorëve dhe pastaj të krahasojnë përgjigjet e tyre me të tjerët, dhe kështu mund të diskutohen dallimet. Katër opsione janë në dispozicion për t'ju përgjigjur secilit tregues: 'pajtohem plotësisht', 'pajtohem dhe nuk pajtohem', 'nuk pajtohem' dhe 'kam nevojë për më shumë informacion'. Përndryshe treguesit mund të shkruhen në karta dhe të renditen në grumbuj me këta tituj të njëjtë. Kam nevojë për më shumë informacion' zgjedhet kur kuptimi i treguesit është i paqartë ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të marrë një vendim.

Në fund të pyetësorit ka hapësirë për të përmendur tri gjëra që pëlqehen dhe tre prioritetet për zhvillim në shkollë. Grupi duhet t'i ndajë dhe diskutojë prioritetet e tyre për ndryshim.

Në këtë shkollë, një mësimitdhënies senior dhe një ndihmës mësimitdhënës e udhëhoqën punën me *Indeks*n. Ata filluan pasi u dakorduan me stafin që ta shikojnë treguesin C2.9, 'Stafi planifikojnë, japin mësim dhe rishikojnë së bashku', dhe veçanërisht në dy nga pyetjet d) dhe e): 'A i planifikojnë mësimitdhënësit aktivitetet në mënyrë që të shfrytëzojnë njohuritë dhe shkathhtësitë e njëri-tjetrit?', dhe 'A e përdorin mësimitdhënësit mësimitdhënien bashkëpunuese si një mundësi për të mësuar nga njëri-tjetri?' Kjo e shtyri një mësimitdhënës të ndajë anët e forta të saj në ICT me një koleg që ishte specialist i PE-së, duke dhënë mësim në klasat e njëri-tjetrit. Kolegët së shpejti filluan të punonin në këtë mënyrë 'duke u mbështetur në forcat e njëri-tjetrit'.

Pyetjet në Indeks ishin veçanërisht tërheqëse:

"Një nga gjërat më të dobishme me këtë burim, në krahasim me të tjerët me të cilët kemi punuar, është se gjithçka është pyetje. Vetëm fakti që është shkruar si një pyetje të bën ta shqyrtosh ashtu siç duhet".

Pyetjet e *Indeksit* po e ndihmonin edhe 'një grup bazë të administratorëve për t'u bërë më të mirë në kontestim' dhe nga ana tjetër pyetjet u ndihmonin mësimitdhënësve që ta mbështesin atë që thoshin se po ndodhte me dëshmi.

Ata kishin filluar ta përdorin *Indeks*n për ta mbështetur fokusin mjedisor të shkollës. Stafi tashmë i kishte shfrytëzuar shumë hapësirat e shkollës, duke e shndërruar sheshin e lojërave me pajisje të palestrës, duke e zhvilluar hapësirën e gjelbëruar me dru frutor, zonë të egër, kuzhinë me baltë, një karrige masive të tregimeve dhe një teatër. Treguesi: 'A1.7 Shkolla është model i qytetarisë demokratike' i shtyri ata të lidhnin aktivitetet në mjedis me qytetarinë dhe pjesëmarrjen e prindërve. Stafi kishte diskutuar pyetjen l) 'A angazhohen fëmijët në punë që kontribuojnë në zhvillimin e shkollës?'

"Nuk është një eko-lidhje e dukshme por gjithsecili që kujdeset për mjedisin tënd ka të bëjë me qytetarinë. Pastaj shikua listën e punëve dhe menjëherë aty është plehërimi, gatimi i ushqimit, mbjellja e pemëve, ka shumë gjëra aty...Ose në pyetjen b) nën atë indikator –'A krijojnë stafi, fëmijët dhe familjet me vetëdije një kulturë të pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit?' Mendoj se jemi bërë më të mirë në angazhimin e prindërve por kryesisht ato janë nëna, prandaj ndoshta duke punuar në kopsht, aktivitete praktike në mjedise të jashtme, këtu mund t'i tërheqim baballarët dhe t'i përfshijmë edhe ata..."

Por më së shumti *Indeksi* i ndihmoi ata që të marrin kontrollin e zhvillimit të tyre:

"Na është dashur të bëjmë zgjidhje të vetëdijshme gjatë viteve të fundit që të ndalojmë së bëri atë që na thuhet të bëjmë dhe të fillojmë të shohim se çfarë funksionon me të vërtetë për fëmijët tanë dhe ku duam të shkojmë. Interesante, në pikën ku ne filluam të zhvillohemi për veten tonë dhe e shikua *Indeks*n dhe shkollat e tjera, atëherë ndalua së qeni Kënaqshëm dhe u bëmë Mirë. Po lëvizim me shpejtësi drejt realizimit të gjërave të jashtëzakonshme. *Indeksi* me të vërtetë na ka ndihmuar të arrijmë të mendojmë për veten tonë."

Merrni pjesë në dialogun për vlerat

Shqyrtimi i treguesve dhe pyetjeve mund të sjellë diskutimin e vlerave edhe nëse kjo nuk ka qenë pjesë e diskutimeve në grup nga fillimi. Grupi mund ta vazhdojë këtë diskutim me mbështetjen e treguesit A2, 'Shkolla zhvillon vlera të përbashkëta gjithëpërfshirëse'. Ata mund të shikojnë në kuadrin e vlerave në faqe 24-33 dhe si kjo përkthehet në deklarata për një shkollë në Figurën 7 në faqe 30. Ata mund të angazhohen në ushtrime të njohjes së vlerave si në Aktivitetin 7 ose të bëjnë një 'ecje të vlerave' në ndërtesat e shkollës siç përshkruhet në faqen 32.



Aktiviteti 7: Vlerat dhe veprimi

Grupi mund të ndahet në nëngrupe, ku secili dakordohet ta shqyrtojë një vlerë të veçantë. Ata mund të shkruajnë titullin e vlerës në qendër të një faqe të madhe, ta shqyrtojnë kuptimin e saj dhe të mendojnë se cilat veprime në shkollë i inkurajon ose shkurajon miratimi i një vlere të tillë. Mund ta shkruajnë rreth titullit të vlerës dallimin që do të bënte absorbimi i vlerës thellësisht në kulturën e shkollës në atë që ndodh në klasat, sallat e stafit, rreth shkollës dhe në marrëdhënie. Rezultatet e këtyre diskutimeve mund të ndahen me grupin. Ata mund t'i shqyrtojnë pyetjet e mëposhtme.

- Si do të ndryshonin aktivitetet në shkollë nëse do të kishte dakordim të përgjithshëm për një kuadër të vlerave gjithëpërfshirëse?
- Në çfarë mase dialogu i vlerave në mes stafit dhe me fëmijët i promovon ndryshimet në veprime në shkollë?

Krijoni një gjuhë të përbashkët

Mund të jetë ide e mirë që grupi koordinues të ndajë pikëpamjen e tyre të koncepteve të Indeksit para se t'i prezantojnë ato te të tjerët. Aktivitetet 8, 9 dhe 10 mund të funksionojnë më mirë pasi njerëzit të kenë lexuar treguesit dhe pyetjet që i mbështesin këto koncepte. Personat që përdorin Indeksën kanë vërejtur se ata e rishikojnë dhe zhvillojnë qasjen e tyre ndaj pengesave, burimeve, mbështetjes për diversitetin dhe përfshirjen gjatë punës me të.

**Aktiviteti 8: Pengesat dhe burimet**

Grupi koordinues mund të shqyrtojë pengesat në të nxëniet dhe pjesëmarrje dhe burimet për mbështetjen e të nxëniet dhe pjesëmarrjes pas leximit për to në Pjesën 2 të Indeksit, faqe 44-48. Ata mund të shqyrtojnë:

- Cilat pengesa të të nxëniet dhe pjesëmarrjes paraqiten në shkollë?
- Kush i përjeton pengesat në të nxëniet dhe pjesëmarrje?
- Cilat burime për të mbështetur të nxëniet dhe pjesëmarrjen ekzistojnë brenda të rriturve, fëmijëve dhe mjediseve në dhe rreth shkollës?
- Si mund të mobilizohen burimet shtesë për ta mbështetur të nxëniet dhe pjesëmarrjen në shkollë?

Ideja e mobilizimit të resurseve brenda të rriturve, fëmijëve dhe mjediseve theksohet në tërë Indeksën dhe mund t'ja vlejë që anëtarët e grupit të shqyrtojnë se si ideja është paraqitur te treguesit dhe pyetjet. Theksohet në të gjithë kurrikulën për shembull se fushat e kurrikulës në seksionin C1 duhet të lidhen në nivel lokal dhe global, se secili ka një punë në shkollë në treguesin A1 'Shkolla është model i qytetarisë demokratike', dhe në shumë tregues të tjerë.

Aktiviteti 9: Çfarë është mbështetja për diversitetin?

Nocioni i gjerë i mbështetjes është paraqitur në faqen 48 si: 'të gjitha aktivitetet që rrisin kapacitetin e një shkolle për t'iu përgjigjur diversitetit në mënyra që i vlerësojnë të gjithë në mënyrë të barabartë'. Grupi koordinues mund të shqyrtojë:

- Cilat aktivitete brenda shkollës llogariten si mbështetje?
- Cilat janë implikimet e përkufizimit të Indeksit për mbështetjen në punën e stafit?
- Cilat janë implikimet e përkufizimit të Indeksit për mbështetjen në koordinimin e tij?

Aktiviteti 10: Çfarë është përfshirja?

Grupi koordinues mund të ndajë pikëpamjet e tyre për përfshirjen dhe ato të të tjerëve në shkollë duke përdorur treguesin A.2.4 'Gjithëpërfshirja shihet si pjesëmarrje në rritje për të gjithë.' Ata mund të shikojnë figurën 4 në faqen 22 e cila përmbledh aspekte të qasjes së gjithëpërfshirjes në Indeks. E para i referohet idesë së gjithëpërfshirjes si vlera në veprim siç është diskutuar në faqet 24-33.

Bisedat rreth gjithëpërfshirjes shpesh shpalosin pikëpamje të mbështetura fuqishëm. Nuk mund të ndodhë që të gjithë të bien dakord për çdo aspekt të gjithëpërfshirjes në Indeks. Megjithatë, ata do të dakordohen se ai ka të bëjë me të gjithë fëmijët dhe të rriturit, me vlerat themelore dhe se përfshin realizimin e ndryshimeve në kulturat, politikat dhe praktikat e shkollës.

Rishikoni ndryshimin dhe zhvillimin në shkollë

Indeksi mund të jetë një mundësi për ta rishikuar planifikimin zhvillimor si në Aktivitetin 11. Shkollat dallojnë në qasjen e tyre të planifikimit zhvillimor. Disa përfshijnë një grup të gjerë njerëzish që punojnë së bashku në mënyrë relativisht sistematike. Në shkollat e tjera, një dokument me shkrim mund të nxirret nga disa persona ose kryesisht nga një person i vetëm. *Indeksi* mund të ndihmojë këdo që të shkruajë një plan zhvillimor. Shpresojmë që një angazhim i tillë do të inkurajojë njerëzit të shohin përfitimet në zgjerimin dhe thellimin e përfshirjes së stafit, fëmijëve dhe të rinjve dhe familjeve të tyre ashtu që njohuritë dhe idetë të mund të bëjnë ndryshimin.

Shumë nga shkollat janë të përfshira në një sërë aktivitete të zhvillimit të shkollave ose programe që nuk shfaqen në planin e tyre zhvillimor. Këto mund të kenë qenë nisma brenda shkollës ose përgjigje të një nisme lokale ose kombëtare ose të vizitave inspektuese. Aktiviteti 11 mund të ndihmojë në shqyrtimin e këtyre çështjeve.

Llogaria 5 e *Indeksit* përshkruan rrugën e suksesshme të një shkolle në integrimin e *Indeksit* në planin e tyre zhvillimor.

Aktiviteti 11: Rishikimi i planifikimit të zhvillimit të shkollës

Anëtarët e grupit mund të rishikojnë planin e tyre zhvillimor aktual të shkollës duke iu përgjigjur pyetjeve në Treguesin B1.1: 'Shkolla ka një proces zhvillimi me pjesëmarrje'. Ata mund të reflektojnë mbi udhëzimet në figurën 28 dhe të shqyrtojnë planifikimin duke përdorur pyetjet e mëposhtme:

- Si ka ndryshuar shkolla gjatë vitit të kaluar dhe pse?
- Cila është përmbajtja e planit dhe në çfarë mase reflekton të gjitha ndryshimet që janë duke ndodhur?
- Deri në çfarë mase përparësitë në plan ndihmojnë vënien në veprim të vlerave gjithëpërfshirëse?
- Si mund të kontribuojë *Indeksi* në zbatimin e prioriteteve që janë pjesë e planit?
- Si mund të ndikojë *Indeksi* në përmirësimin e planit?
- Si mund të hartohet një plan që është i qasshëm për të gjithë të rriturit dhe fëmijët e lidhur me shkollën dhe që ngre moralin e tyre? Shih faqen në vijim.

Figura 28.

Udhëzimet për një plan zhvillimi të udhëhequr nga vlerat


Një plan mund të përmbajë:

- Kuadrin e vlerave që udhëheq zhvillimin e shkollës.
- Prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për zhvillimin e kulturave, politikave dhe praktikave.
- Referencën për treguesit dhe pyetjet që mbështesin zbatimin.
- Veprimet e nevojshme:
 - çfarë do të bëhet
 - kush do ta marrë përgjegjësinë
 - burimet që mund të mobilizohen në mbështetje
 - afatet kohore.
- Rezultatet e shqyrtimit 3-mujor - dëshmitë për ndryshime, prioritetet e reja.

Shkolla Turner Infant School e vendosën *Indeksin* në qendër të qasjes së saj për përmirësimin e shkollës. Ata krijuan një ekip të ri për të zgjeruar konsultimet me administratorët, prindërit dhe fëmijët por pasi një fëmijë pyeti ‘e çfarë të bëjmë ne derisa të rriturit janë duke folur’ ata e rishikuan qasjen e tyre duke përfshirë pikëpamjet e këtyre fëmijëve të vegjël. Prindërit plotësuan pyetësorët dhe u përfshinë në fokus grupe. Pikëpamjet e prindërve dhe të fëmijëve për sjelljen, ngacmimin dhe shfrytëzimin e sheshit të lojërave çuan në ndryshime thelbësore. Një veprim i hershëm ishte ndarja e sheshit të lojërave në zona me aktivitete të ndryshme dhe rritja e mbikëqyrjes nga të rriturit. Ata i kthyen këto konsultime në rutina vjetore me fokus grupet e prindërve të drejtuara nga prindër të tjerë dhe kjo shënoi një pikë të rëndësishme në ndërtimin e besimit ndërmjet mësimit dhe prindërve në shkollë.

Shkolla e integroi *Indeksin* në ato që duhej të bënin për të fituar shpërblimin ‘Shkollat që respektojnë të drejtat’. Ata flisnin me prindërit dhe administratorët kur po dilnin nga shkolla në një moment sinqeriteti dhe reflektimi për të ofruar mendime të reja për atë që mund ta përmirësonin. Kishte lëvizje për ta shfrytëzuar më me efikasitet ekspertizën e stafit pasi drejtori kishte thënë stafit: ‘nuk jeni duke dhënë mjaftueshëm nga vetja’. Kështu që stafi ftoi të tjerët që të vijnë dhe të shohin aktivitetet mësimore që i konsideronin veçanërisht të suksesshme. Një anëtar i stafit udhëhoqi në çështjet mjedisore; duke rregulluar një kopsht të komunitetit, duke ricikluar mbeturinat ushqimore nga klasa dhe kuzhina, të nxitura nga treguesi për mbeturinat (B1.13) që gjithashtu çoi në diskutimin për përdorimin e shujtave të drekës të papaketuara nga fëmijët.

Pas një sërë aktiviteteve, *Indeksi* tashmë është integruar në Planin e përmirësimit të shkollës. Plani përfshin një kolonë për kontributin e *Indeksit* për të përmbushur prioritetet të veçanta kështu që ‘i detyron personat që janë përgjegjës për atë fushë të planit që ta shikojnë *Indeksin* dhe ta përdorin atë’. *Indeksi* ka ndihmuar në thurjen së bashku të përmirësimit të shkollës. Siç e tha edhe drejtori: ‘Duhet të funksionojë sepse ndajmë vlera të përbashkëta me të’.



Plan për zhvillimin e një shkolle i shkruar nën titujt e kulturave, politikave dhe praktikave nga kolegët nga Azerbajxhani. Pëllumbi i zhvillimit ka pengesa që peshojnë poshtë këmbëve të tij.

Konsideroni integrimin e ndërhyrjeve

Shkollat mund të angazhohen në aktivitete të iniciuara për arsye të ndryshme: për shkak të entuziazmit të stafit dhe prindërve, shfaqjes së mundësive të financimit ose presioneve nga qeveria. Nganjëherë nismat nuk mund të bazohen atë që është duke u bërë nga stafi për një çështje të caktuar. Për shembull, promovimi i 'të nxëniet jashtë klasës'⁵⁰ mund të mos integrohet me mënyrën me të cilën stafi ka përdorur aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies për t'ju përgjigjur të nxëniet që ndodh në shtëpitë e fëmijëve – shih Aktivitetin 12.

Eksploroni Kuadrin e planifikimit

Në faqen 179 është një Kuadër i planifikimit të cilin grupi mund ta fotokopjojë dhe ta përdorë për të regjistruar përparësitë e tyre për zhvillim. Ata mund të shqyrtojnë se si zhvillimet duhet të ndodhin në secilin dimension dhe seksion të *Indeksit* nëse do të jenë të qëndrueshme. Prioriteti mund të vendoset në aspektin e një çështjeje që mund të lidhet me një tregues ose grup treguesish, një pyetje apo grupi pyetjesh.

Adresoni pengesat e përdorimit të *Indeksit*

Pas shqyrtimit të materialeve, grupi mund të dëshirojë të shkëmbejë ide për mënyrat më të mira për t'ja prezantuar *Indeksit* të tjerëve në shkollë, pengesat me të cilat ata mund të përballen dhe strategjitë për tejkalimin e tyre.



⁵⁰ Department for Education and Skills (2006). *Learning outside the classroom*. [Departamenti për arsim dhe shkollë (2006). Të nxëniet jashtë klasës.] London, DfES.

Aktiviteti 12: Menaxhimi i përpjekjeve

Grupi mund të shqyrtojë nismat në shkollë në vitin e kaluar dhe ato të planifikuara për të ardhmen brenda dhe jashtë planit zhvillimor të shkollës. Ata pastaj mund të shohin aktivitetet nën titullin e zhvillimit arsimor gjithëpërfshirës në figurën 15 në faqen 41. Mund të shqyrtojnë se si shqetësimet për të rritur angazhimin e shkollave në çështje globale dhe të qëndrueshmërisë mbivendosen me njëra-tjetren në faqet 42-43 dhe se si të dyja mund të nxiten nga një qasje e vetme parimore për zhvillimin e Indeksit.

- *Deri në ç'masë mbivendosen ndërhyrjet, nismat dhe programet në shkollë?*
- *Si mund të koordinohen më mirë nismat dhe programet?*
- *Si mund të integrohen më mirë nismat dhe programet në aktivitetet e rregullta të shkollës?*
- *Si mund të ndihmojë një kuadër vlerash për të bashkuar ndërhyrjet dhe për ta mbështetur zbatimin e tyre?*

Aktiviteti 13: Mbështetja e prioriteteve dhe planifikimi i ndërhyrjeve

Kur një prioritet zgjidhet nga një dimension, mund të jetë e qartë se zhvillimet duhet të ndodhin në dimensione të tjera për ta mbështetur atë. Për shembull, nëse zhvillimi i një politike kundër ngacimit miratohet si prioritet për zhvillim nga dimension B, ajo duhet të lidhet me treguesit e lidhur me dimensionin A. Grupi mund të zgjedhë një prioritet të propozuar për zhvillim, ndoshta duke u nisur nga diskutimet e përgjigjeve të tyre të mëparshme në Pyetësorin e Treguesve, ta vendosin atë brenda Kuadrit të planifikimit dhe pastaj të shqyrtojmë si në vijim:

- *Cilat ndryshime duhet të ndodhin në seksione të tjera për të siguruar që zhvillimi të mbështetet?*
- *Si mund të zbatohet prioriteti për zhvillim?*

Llogaria 6 e Indeksit Përmirësimi i arsimit në Aspen School

Aspen School është pjesë e një nisme të qarkut të quajtur 'vënia e vlerave gjithëpërfshirëse në qendër të përmirësimit të shkollës', ku shkollat janë ftuar për të punuar me *Indeksin* me qëllim që të shtojnë mënyra më gjithëpërfshirëse të punës në një autoritet lokal të vlerësuar lartë në tabelën e ligës kombëtare të arritjeve. Zyrtarët e qarkut ishin të vetëdijshëm se një pakicë e nxënësve nuk përfitonte nga qasjet ekzistuese. Ata ishin në dijeni dhe e kishin pëlqyer *Indeksin për gjithëpërfshirje* shumë vite më parë dhe kishin parë adoptimin e tij të gjerë në qarkun e tyre si mënyrë për të forcuar të nxënit dhe pjesëmarrjen për të gjithë dhe përballimin e sfidave të sistemit të inspektimit.

Iniciativa u përhap me shpejtësi, me njëqind e pesëdhjetë shkolla që u regjistruan të punonin me *Indeksin* në masë më të madhe apo më të vogël. Aspen School ishte mjaft e përfshirë. Ata nuk përputheshin me modelin mesatar të shkollave, duke qenë në një zonë të njohur si zonë e privimit të konsiderueshëm. Një drejtoreshë e re kishte marrë përsipër punën e rigjallërimit të shkollës që konsideroj se 'kishte nevojë për përmirësim'. Marrëdhëniet me familjet ishin përshkruar si "toksike". Drejtoresha e pa *Indeksin* si një shtysë të madhe në drejtimin që po negocionte me stafin e saj dhe me shpejtësi krijoi disa tregues në planifikimin e saj zhvillimor. Ajo po zhvillonte një fokus mbi vlerat dhe *Indeksi* e përforcoi rëndësinë e diskutimeve të vlerave për ndryshimin e veprimeve. Shkolla ishte pjesë e një 'federate' që përbëhej nga një shkollë e mesme dhe shkollat e saj fillore, që u pajtuan për një plan të përbashkët për ta mbështetur njëri-tjetrin në zbatimin e elementeve kryesorë të *Indeksit*. Proces i përmirësimit të marrëdhënieve me prindërit u ndihmua me mbledhjet e rregullta të 'zërit të prindërve', ku diskutimi filloi me disa pyetje të zgjedhura me kujdes të *Indeksit*. Angazhimi i fëmijëve filloi të përparojë përmes një kurrikule të re më tërheqëse, një këshilli aktiv të shkollës dhe rotacionit të nxënësve ambasadorë për të mirëpritur vizitorët. Duke e shpjeguar rolin e vlerave në shkollën e tyre, një fëmijë komentoi: "të gjithë ishim në një udhëtim për të gjetur se çfarë duam të bëhemi kur të rritemi." Një tjetër shtoi: "Unë e di përgjigjen, është të jesh ai që je me të vërtetë".



Faza 2: Kuptojmë së bashku

Rritni ndërgjegjësimin

Para se të merren vendimet përfundimtare të planifikimit, komuniteti më i gjerë shkollor duhet të informohet për *Indeks*n. Sesioni i ndërgjegjësimit mund të drejtohet nga një ose disa anëtarë të ekipit të planifikimit që i njohin materialet e *Indeksit* që modelojnë bashkëpunimin. Mund të përfshijë dikë nga jashtë shkollës, tek i cili pjesëmarrësit kanë besim për mendimet e tyre të hapura, si dikush nga Autoriteti Lokal, që konsiderohet se nuk ka rol inspektues, ose një koleg nga një shkollë tjetër që ka punuar tashmë me *Indeks*n. Stafi duhet të sigurohet se përdorimi i *Indeksit* nuk ka të bëjë me shtimin e ngarkesës së punës për ta por ndihmon në zgjedhjen e prioriteteve për planin zhvillimor të shkollës dhe për të bërë ndryshimeve gjithëpërfshirëse dhe koherente. Me këtë rast mund të bëhen shtohen anëtarë në grupin e planifikimit.



Ofroni materialet e *Indeksit*

Diskutimet rreth *Indeksit* funksionojnë më mirë kur njerëzit kanë qasje në materialet. Mund të jetë më e lehtë të negociosh mënyrën e dikujt me një libër përpara, por kur blihet një kopje e një libri jepet edhe versioni pdf në mënyrë që një grup më i gjerë të ketë qasje në të. Kjo i lejon njerëzit të përdorin kompjuterët, laptopët dhe tabletat për të punuar me të dhe për t'i bërë materialet të qasshme për prindërit ose secilin që ka lidhje me shkollën e që nuk ka kopje të shtypur. Edhe

pyetësorët dhe faqe të tjera për diskutim në mbledhje mund të fotokopjohen. Kur të blihet libri i shtypur mund të kërkohet versioni pdf në info@indexforinclusion.org

Një ditë zhvillimi e stafit dhe administratorëve

Një ditë zhvillimi e stafit, dita kur stafi dhe administratorët punojnë së bashku, është një mënyrë për të filluar zgjerimin e konsultimeve. Një paraqitje e kësaj ngjarje është dhënë në figurën 27. Dita mund të përfshijë disa shkolla që punojnë në bashkëpunim. Qëllimi i kësaj dite mund të jetë ndarja e prioriteteve për zhvillimin e shkollës që do të ndërlihen bashkë nga ekipi i planifikimit. Por shtytja e krijuar nga kjo ditë mund të shtyjë zhvillimin në drejtime të papritura.

Para kësaj dite, aktivitetet do të duhet të përzgjidhen dhe të përshtaten. Duhet të merren vendime nëse dhe si të iniciohet dialogu për vlerat dhe zhvillimin e një kuadri vlerash; si të eksplorohehen treguesit dhe nëse janë të nevojshme kopje të pyetësorit të Treguesit, kuadrit të planifikimit dhe planit zhvillimor të shkollës.

Për pjesëmarrësit mund të ofrohet një prezantim pesë minutësh për *Indeks*n, si në Aktivitetin 1, dhe mund të kërkohet që në takim pjesëmarrësit të sjellin një pyetje të preferuar, si në Aktivitetin 2. Organizatorët e ditës mund të kenë disa pyetje të përzgjedhura që ata i shohin si më të rëndësishme për çështjet e shkollës. Duhet të mendohet për mbajtjen shënime të pikëpamjeve të shprehura nga grupe të ndryshme.

Grupi koordinues do të mund të gjykojë nga përvoja e tyre e punës me materialet se sa kohë do t'ju duhet të tjerëve për të kryer detyrat. Ata duhet t'i kalojnë njerëzit nëpër detyra, në mënyrë që aktivitetet të përfundohen.

Prezantimi i *Indeksit*, që mund të jetë një prezantim bashkëpunues, mund të fillojë me ilustrimin në faqe 9, ku përmblihen disa nga mënyrat e kontributit të *Indeksit* në zhvillimin e shkollave. Mund të diskutohet kuadri i vlerave, mënyra e integritit të nismave dhe përdorimi i koncepteve të pengesave, burimeve dhe mbështetjes.

Figura 29.

Dita e zhvillimit e stafit dhe administratorëve: vlerat gjithëpërfshirëse në veprim

9 – 9.30	<i>Prezantimi i Indeksit</i> (plendar)
9.30 – 10.30	Pyetjet e preferuara (Aktiviteti 2) Përdorimi i treguesve për të identifikuar shqetësimet (Aktiviteti 3)
10.30 – 11.00	Çaj/kafe
11.00 – 11.30	Vlerat në veprim (Aktiviteti 7)
11.30 – 12.30	Gjithëpërfshirja, pengesat, burimet dhe mbështetja (Aktivitetet 8, 9,10)
12.30 – 1.30	Dreka
1.30 – 2.30	Rishikimi i planifikimit të zhvillimit të shkollës (Aktivitetet 11, 12, 13)
2.30 – 3.30	Këmbimi i ideve rreth prioriteteve për zhvillim dhe hetim të mëtejshëm (grupet, pastaj plenare)
3.30 – 3.45	Hapat e mëtejshëm në proces (udhëhequr nga grupi koordinues)
3.45	Çaj/kafe

Fushat e përkohshme për zhvillim dhe hetimet e mëtejshme

Në përgjithësi, pasi të kenë punuar me treguesit dhe pyetjet, njerëzit janë në gjendje të identifikojnë fusha specifike ku mendojnë se nevojitet zhvillim në shkollë por mund të shohin edhe vetë ose me kolegët gjëra të cilat duan të fillojnë të ndryshojnë menjëherë. Mund të identifikohen disa fusha ku nevojitet hetim i mëtejshëm para se të merret vendimi. Megjithatë, disa prioritete do të shfaqen vetëm pas mbledhjes së informacioneve nga grupet e ndryshme dhe pas konsultimeve dhe përfundimit të tyre.

Planifikimi i hapave të ardhshëm

Në fund të ditës, kryesuesi i grupit të planifikimit mund të përshkruajë se çfarë do të ndodhë me informacionin e mbledhur dhe pikëpamjet e shprehura. Grupi koordinues duhet të kryejë mbledhjen e informacionit nga stafi dhe administratorët dhe t'i ndërlidhë ato. Mund të identifikohen fusha ku nevojitet më shumë informacion nga fëmijët, prindërit/kujdestarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit. Grupi duhet të planifikojë të marrë edhe pikëpamjet e atyre që nuk mund të marrin pjesë në këtë ditë.

Eksploroni idetë e fëmijëve

Sipas shkollave që përdorin *Indeksin*, konsultimet me fëmijët dhe të rinjtë mund të shpalosin fusha të rëndësishme për zhvillim, duke përfshirë pengesat në të nxënëit që nuk janë shqyrtuar më parë dhe burimet për t'i kapërcyer ato. Mbledhja e informacionit për shkollën nga fëmijët mund të integrohet në kurrikulë, për shembull në punën me gjuhët, kërkimin e dëshmimeve në shkencë ose si pjesë e shkollës që bëhet model i demokracisë si në treguesin A1.7. Të gjithë fëmijët në shkollë duhet të kenë mundësi të kontribuojnë në një farë mënyre, edhe nëse vetëm disa angazhohen në dialog të detajuar.

Pyetësorët mund të jenë të dobishëm për mbledhjen e informacionit nga fëmijët por mund të kontribuojnë më shumë kur përdoren në grup për të nxitur dialogun. Dy pyetësorë janë përfshirë në pjesën 5; një në përgjithësi për fëmijë më të mëdhenj të shkollës fillore dhe të mesme dhe një tjetër për fëmijë më të vegjël. Fëmijët mund të kenë nevojë për ndihmë për t'i kuptuar deklaratat në pyetësor. Me fëmijët e vegjël mund të jetë më mirë të lexohet çdo pyetje dhe t'ju ofrohet ndihmë atyre që kanë vështirësi me gjuhën ose udhëzimet ose në shkrimin e prioriteteve të tyre në fund të pyetësorëve. Fëmijët mund të kenë nevojë për inkurajim që të japin një pikëpamje të sinqertë dhe të menduar e jo një përgjigje që do t'i pëlqente stafit ose fëmijëve të tjerë. Pyetësorët mund të bëhen më të shkurtër dhe përshtaten, për shembull për një grup moshe të caktuar dhe të reflektojnë

Në Leander, shkollë e mesme në qytet, shumica e fëmijëve kishin prejardhje nga Bangladeshi edhe pse brenda zonës së shkollës një pakicë e konsiderueshme e fëmijëve ishin të bardhë. Po ashtu kishte më shumë djem se vajza në shkollë, pasi disa nga prindërit në zonë preferonin që vajzat e tyre të shkonin në shkollë të vajzave. Kishte shqetësim për anëtarësimin nga djemtë e bandave lokale dhe mënyrën se si kjo krijonte konflikt në shkollë. Anëtarët e bashkësisë lokale fajësuan për këto probleme pjesërisht mungesën e hapësirës në banesa dhe shtëpi dhe mungesën e kushteve për të rinjtë në zonë. Kishte mendime të ndryshme në shkollë se pse kaq pak fëmijë e zgjedhnin gjuhën Bengali at GCSE. Drejtori për gjuhët moderne sugjeroi se fëmijët nuk ishin të interesuar për të, ndërsa stafi tjetër me prejardhje nga Bangladeshi mendonin se kjo ndodhte për shkak nuk i ishte dhënë vlerë e mjaftueshme gjuhës që fëmijët e përdornin në shtëpi, Sylhetit, që ishte dialekt i gjuhës Bengali. Prindërit u ankuan shumë për mungesën e modestisë të lejuar nga marrëveshjet për dushat.

Deklaratat specifike të mëposhtme iu shtuan pyetësorit të përgjithshëm për shkollat:

- Do të doja të kishte numër të barabartë të djemve dhe vajzave në këtë shkollë.
- Do të doja të kishte një përzierje më të madhe të fëmijëve me prejardhje të ndryshme.
- Do të më pëlqente të studioja gjuhën bengali në GCSE.
- Familja ime e di mirë se çfarë ndodh në shkollë.
- Mësimdhënësit i njohin komunitetet rreth kësaj shkolle.
- Duhet të mundësohet që fëmijët të bisedojnë në dialektin Sylheti gjatë mësimave.
- Fëmijët që mësojnë anglisht marrin ndihmën që u nevojitet.
- Ndihem mirë me marrëveshjen për dushat për edukatën fizike.
- Nuk ndihem mirë në disa mësimet për shkak të besimeve të mia fetare.
- Shqetësohen se mos futem në telashe me bandat.
- Mund të rri me fëmijët brenda shkollës që nuk jetojnë në zonën time.
- Mund të rri me fëmijët jashtë shkollës që nuk vijnë nga zona ime.
- Familja ime nuk do t'i pranonte ata me të cilët unë rri në shkollë.
- Është më e lehtë të rri me fëmijët e gjinisë së kundërt brenda se sa jashtë shkollës.
- Kam një vend ku mund të kryej detyrat e shtëpisë në shtëpi.

çështjet e një fushe të caktuar si në Llogarinë 7 të Indeksit.

Përveç pyetësorëve, ka shumë mënyra të tjera përmes të cilave mësimdhënësit mund t'i shtojnë fëmijët të shprehin gjërat që ata i pëlqejnë ose nuk i pëlqejnë për shkollën dhe vlerësimin e tyre për pengesat dhe burimet për mësim.

Dëgjimi i kujdesshëm dhe i vëmendshëm i asaj që thonë dhe nuk thonë fëmijët mund të jetë udhëzuesi më i fuqishëm për shqetësimet e tyre, siç mund të jetë edhe për shqetësimet e të rriturve.

Aktiviteti 14 ka të bëjë me përdorimin e fotove për të treguar vende që preferohen dhe shmangen në shkollë dhe në zonën përreth. Idetë

Aktiviteti 14: Fotot e pengesave dhe burimeve

Kamerat digjitale mund të përdoren si mënyrë e fuqishme për të marrë pikëpamjet për shkollën. Fëmijët mund të bëjnë foto në lidhje me pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë të ndihmon për të mësuar?
- Çfarë të ndalon për të mësuar?
- Çfarë të bën të ndjehesh mirë për shkollën?
- Çfarë do të doje të ndryshoje?

për mënyrën e përmirësimit të shkollës mund të merren duke përdorur harta, vizatime, drama, shfaqje kukullash dhe përgjigje ndaj tregimeve dhe filmave. Të gjithë mund të përfshihen në vëzhgimin, dokumentimin dhe raportimin në praktikë, në mënyrë që të angazhohen në rishikimin dhe sugjerimet e përbashkëta për ndryshim. Në shkollat fillore dhe veçanërisht në shkollat e mesme, qëndrimi me një grup për një ditë mund t'ju bëjë të kuptoni përvojën e tyre të aktiviteteve të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, sheshit të lojërave, mësimdhënësve dhe ndihmës mësimdhënësve. Një kombinim i pikëpamjeve të përvojës së fëmijëve mund të vihet në një mozaik.⁵¹

Shqyrtoni idetë e prindërve/kujdestarëve dhe anëtarëve të komuniteteve lokale

Konsultimi me prindërit/kujdestarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit mund të shpalosë perspektiva të mëtejshme në shkollë nga njerëz që mendojnë shumë për arsimimin e fëmijëve. Në pjesën 5, faqe 182-3, është i përfshirë edhe një pyetësor për prindërit/kujdestarët, 'shkolla e fëmijës tim'. Si pyetësorët e tjerë, kjo mund të përdoret si ftesë për prindërit për një dialog më të detajuar për pengesat dhe burimet në shkollë.

Shkollat kanë provuar mënyra të ndryshme për t'i inkurajuar prindërit që të plotësojnë pyetësorët. Në një shkollë pikëpamjet e prindërve u mbledhën gjatë 'Ekspozitës verore vjetore' të shkollës. Në një shkollë tjetër, pyetësorët iu dhanë prindërve gjatë mbrëmjes së konsultimeve të shkollës, dhe ata i plotësuan ato kur po prisnin për takimin e tyre me mësimdhënësin. Ditën vijuese pyetësorët iu dërguan me postë prindërve që nuk kishin ardhur. Secili pyetësor kishte një pjesë shkëputëse që i bënte ata pjesëmarrës në tërheqjen e një çmimi.

Grupi i planifikimit mund të ketë idetë e veta për rritjen e përfshirjes së prindërve, veçanërisht kur pjesëmarrja në takimet e shkollës më herët ka qenë e ulët. Ata mund të organizojnë takime me prindërit jashtë shkollës nëse pjesëmarrja ka gjasa të jetë më e madhe në një mjedis tjetër. Mund të duhet të organizohen disa mundësi për të kontribuar. Në një shkollë, një punëtor i shkollës për ndërlidhje me prindërit dhe një anëtar i grupit të planifikimit, organizuan

përkthimin e pyetjeve për ata prindër/kujdestarë që nuk flisnin gjuhën angleze dhe u angazhuan si interpretë gjatë grupeve të diskutimit. Shkollat e tjera shkëmbyen përkthimet e pyetësorëve.

Mbledhjet mund të organizohen si bashkëpunim midis stafit dhe prindërve/kujdestarëve. Në mbledhje mund të shtjellohen pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë pikat e forta të shkollës?
- Çfarë do të ndihmonte për ta përmirësuar të nxënërit e fëmijës/fëmijëve tuaj në këtë shkollë?
- Çfarë mund të bëhet për ta bërë fëmijën/fëmijët tuaj më të lumtur në shkollë?
- Çfarë do të donit të ndryshonit në lidhje me këtë shkollë?

Në mbledhje mund të vijnë prindërit që kanë plotësuar pyetësorin ose mbledhja mund të përdoret për ta bërë këtë, ose si mënyrë për të mbledhur informacione nga ata që nuk janë në gjendje të marrin pjesë. Ata mund të njoftohen me *Indeksin* dhe disa nga pyetjet e tij në mbledhje.

Ashtu si me prindërit/kujdestarët, mund të jetë e dobishme të dini pikëpamjet e të tjerëve në komunitetet përreth shkollës. Popullata e fëmijëve mund të mos pasqyrojë përbërjen e zonës, në aspektin e etnisë, aftësisë së kufizuar ose klasës. Kuptimi i pikëpamjeve të anëtarëve të komunitetit mund ta ndihmojë shkollën në përpjekjet e saj për të qenë sa më përfaqësuese e zonës.



51 Clark, A. and Moss, P. (2005) *Spaces to Play, More listening to young children using the mosaic approach* [Hapësirat e lojës, Dëgjojmë më shumë fëmijët duke përdorur qasjen mozaik], London, National Children's Bureau.

Në shkollën e mesme Redlands High, ndihmësdrejtoresha, e cila ishte edhe mësimdhënëse e gjeografisë, ishte e shqetësuar për mungesën e përfshirjes së prindërve. Ajo vendosi se ndoshta prindërit do të donin të provonin se si është të jesh nxënës në shkollë prandaj u dërgoi një ftesë prindërve që të vinin dhe të provonin një mësim gjeografie. Tetëdhjetë nga prindërit pranuan dhe u caktuan në tri mësim të ndara në mbrëmje. Ajo ishte një mësimdhënëse me shumë vetëbesim dhe kjo ide nuk do të ishte tërheqëse për të gjithë, mirëpo të tjerët mund të kenë mënyrat e tyre për përfshirjen më të madhe të prindërve. Ajo e kishte përmendur risinë e saj gjatë një diskutimi për ndikimin e përdorimit të *Indeksit* në shkollën e saj dhe ishte theksuar se ndonëse kishte shumë inkurajim që shkollat të kishin marrëdhënie më të afërta me familjet ky sugjerim specifik nuk ishte i përfshirë aty. Ajo u përgjigj: “Keni të drejtë, nuk është, por *Indeksi* më ndihmoi të guxoj ta bëja.”

Negocioni prioritetet për zhvillim

Për të hartuar një plan, grupi koordinues duhet të mbledhë dhe analizojë prioritetet për zhvillim të përzgjedhura nga të gjithë ata që janë konsultuar. Kjo mund të bëhet më së miri menjëherë pas mbledhjes së informacionit. Dallimi i perspektivave të fëmijëve, prindërve/kujdestarëve, stafit dhe administratorëve duhet të shqyrtohet. Mund të jetë e rëndësishme të shikoni dallimet e pikëpamjeve midis mësimdhënësve dhe ndihmës mësimdhënësve ose ndërmjet stafit në departamente të ndryshme të shkollave të mesme.

Një përkrahës nga jashtë shkollës mund të zgjedhet për analizimin e këtij informacioni, edhe pse është e rëndësishme të inkurajohet pronësia e zhvillimit nga i gjithë stafi, prindërit/kujdestarët, fëmijët dhe administratorët. Me përhapien e pronësisë, mund të shfaqen oferta të reja për pjesëmarrje në punën zhvillimore.

Mund të nevojiten informacione shtesë para se të mund të finalizohen prioritetet. Gjatë konsultimeve do të identifikohen çështje që mund të qartësohen duke mbledhur informacione të mëtejshme. Për shembull, mund të jetë e nevojshme të analizohen të dhënat për vijueshmërinë ose rezultatet e testimit të fëmijëve sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike. Nevoja për të mbledhur informacion shtesë mund të dalë gjatë procesit të konsultimit, siç është nevoja për të pyetur stafin e ri për suksesin e trajnimit të tyre të informimit. Mbledhja e informacionit të mëtejshëm mund të bëhet aktivitet zhvillimor, për shembull kur mësimdhënësit dhe ndihmës mësimdhënësit ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies duke vëzhguar, shënuar dhe reflektuar për praktikën e njëri-tjetrit.

Grupi koordinues duhet të sigurohet që mendimet e grupeve më pak të fuqishme janë të përfshira dhe në veçanti zërat e fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve të janë të pasqyruar në planin përfundimtar, duke dëshmuar se mendimet e tyre me të vërtetë vlejné.

Në figurën 30 janë dhënë shembuj të prioritetëve të identifikuar nga shkollat.



Figura 30.

Shembuj të prioriteteve të shkollës

- Organizimi i ritualeve për të mirëpritur fëmijët dhe stafin e ri dhe shënuar largimin e tyre.
- Krijimi i aktiviteteve të zhvillimit të stafit që mësimet t'i përgjigjen më shumë diversitetit.
- Prezantimi i strukturave të karrierës për ndihmës mësimdhënësit.
- Lidhja e punës për kultivimin e perimeve me oborrin e shkollës, gatimi në kuzhinën e shkollës, plehërimi, prodhimi i ushqimit në fermat lokale.
- Përmirësimi i qasjes në shkollë për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara.
- Integrimi i të gjitha formave të mbështetjes brenda shkollës.
- Prezantimi i aktiviteteve të vetëdijesimit për vlerat për të rriturit dhe fëmijët, duke përfshirë 'vlerat e muajit'.
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për ndihmës mësimdhënësit dhe mësimdhënësit.
- Zhvillimi i të nxënit bashkëpunues për fëmijët.
- Hulumtimi i ngacmimeve dhe rishikimi i politikës kundër ngacmimeve.
- Rritja e përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje për politikën e shkollës.
- Promovimi i pikëpamjeve pozitive të diversitetit etnik në mësimdhënie dhe shfaqjeve.
- Përmirësimi i komunikimit ndërmjet shkollës dhe prindërve/kujdestarëve.



Integroni konsultimet në rutinën e shkollës

Inkurajimi i përfshirjes së gjerë në planifikim është një aspekt i zhvillimit të një komuniteti gjithëpërfshirës dhe duhet të mbështetet kur të përfundojë stuhia fillestare e konsultimit. Pra, zgjerimi i mënyrës se si këto grupe në mënyrë rutine japin idetë e tyre është po aq i rëndësishëm sa edhe konsultimi i gjerë. Grupi koordinues mund të shqyrtojë mundësitë për të dëgjuar zërat e tërë stafit, fëmijëve, prindërve/kujdestarëve dhe administratorëve dhe të shikojë mundësi për rritjen e tyre. Ata mund të ndajnë ide me shkollat e tjera ose me autoritetin lokal. Fëmijët mund ta hulumtojnë pjesëmarrjen në shkollë si një ushtrim në qytetari. Mund të krijohet një sallë për prindërit. Një herë në muaj hollë mund të shndërrohet në një forum demokratik. 'Pjesëmarrja' është një nga vlerat kryesore në *Indeks* dhe treguesit dhe pyetjet përmbajnë shumë sugjerime për t'ju dhënë të rriturve dhe fëmijëve një hapësirë më të madhe për t'u shprehur në shkollat e tyre.



Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

Faza 3: Hartimi i një plani

Vendosni prioritetet në planin e zhvillimit

Për të rritur mundësitë që veprimet e reja të ndërmarrë nga shkolla të jenë të qëndrueshme, plani ekzistues zhvillimor i shkollës duhet të ndryshohet. Kjo do të kërkojë përfshirjen e drejtorit dhe anëtarëve të tjerë të lartë të shkollës.

Për secilin prioritet të ri grupi duhet të marrë parasysh kohën, burimet, ndarjet e përgjegjësive dhe implikimet e zhvillimit profesional. Përcaktimi i qëllimeve afatshkurtra dhe afatmesme mund të ndihmojë për ta ruajtur fokusin në prioritetet më ambicioze.

Përgjegjësia për ta kontrolluar progresin e secilit prioritet mund t'i ndahet një anëtar të ekipit të planifikimit por zbatimi i planit do të jetë përgjegjësi e të gjithëve në shkollë.

Duhet të caktohen kriteret për vlerësimin e zbatimit. Pyetjet e *Indeksit* mund të përbëjnë bazën e këtyre kriterëve kur prioritetet kanë dalë nga tregues të veçantë. Mund të jetë e dobishme të shikohen ndërlidhjet mes treguesve pasi që pyetjet relevante mund të gjenden tek një numër treguesish.



Faza 4: Ndërmarrja e veprimit

Vini në veprim prioritetet

Njerëzit nuk duhet të presin një plan shkolle për të vepruar në zhvillimin e vlerave të përbashkëta, për shembull në mënyrën se si shfrytëzohen burimet apo se si aktivitetet mësimore lidhen në nivel lokal dhe global me njerëzit, mjediset dhe ngjarjet. Mbajtja shënimeve dhe punës me *Indeks* mund të përmbledhë ndikimet e tilla. Disa nga raportet e punës me *Indeks* janë paraqitur në llogaritë në këtë seksion dhe janë mbledhur nga dokumentet e shtypura⁵² dhe nga faqja indexforinclusion.org.

Vazhdoni zhvillimin

Pas vënies në veprim të prioritetëve, ai përkushtim duhet të ruhet dhe të vazhdojë. Aktivitetet për të krijuar kultura më gjithëpërfshirëse mund të mbështesin dhe të mbështeten nga përfshirja aktive e stafit, administratorëve, fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve. Aty ku prioritetet sfidojnë besimet e ngulitura thellë, mund të kërkohej përpjekje e konsiderueshme për të kapërcyer rezistencën. Ekipi i planifikimit mund ta inkurajojë dialogun rreth dallimeve dhe mund të ketë nevojë të përmirësojë zhvillimet në mënyrë që ato të mbështeten gjerësisht. Llogaria 9 e *Indeksit* ofron një shembull ku puna me *Indeks* ka mbështetur të rriturit dhe fëmijët në një shkollë për të bërë shumë ndryshime pas fillimeve të vështira.



⁵² Rustemier, S. and Booth, T. (2005) *Learning about the Index in use, a study of the use of the Index in schools and LEAs in England* [Indeksi në përdorim, studim për përdorimin e Indeksit në shkolla dhe LEA në Angli], Bristol, CSIE.

Llogaria 9 e Indeksit Ofrimi i një ndjenje të re të drejtimit

Para përdorimit të *Indeksit*, Shkolla fillore Hind Primary School ishte në 'masa speciale', dhe konsiderohej të kishte probleme me personelin dhe disiplinën. Marrëdhëniet në mes të stafit, administratorëve dhe prindërve ishin të dobëta. Drejtoresha pranoi se stafi 'supozonte se dinin' çfarë dëshironin prindërit. Stafi i ishte 'kërkuar të bënin gjëra në të cilat ata nuk besonin'. Mësimdhënësit shprehnin zhgënjim me performancën e fëmijëve dhe i injoronin arritjet e tyre pozitive. Grupi koordinues i *Indeksit* përfshinte administratorët, prindërit dhe stafin dhe udhëhoqej nga një mik kritik, i respektuar brenda shkollës dhe autoritetit lokal. Konsultimet ishin të shumta, dhe rezultatet 'shumë sfiduese'. Për shembull, prindërit/kujdestarët mbanin mend pikëpamjet e tyre për qëndrimet e stafit ndaj fëmijëve të tyre: 'nuk duan t'ia dinë për ta', 'kanë të preferuarit e tyre'.

Shqetësimi i parë i drejtoreshës ishte komunikimi me prindërit, që kërkonte vëmendje të veçantë. Ajo filloi duke u siguruar që prindërit/kujdestarët dhe administratorët të ishin të më të informuar. Broshura e shkollës u rishkrua duke përdorur një anglishte të qartë, ajo caktoi kohën kur do të diskutohej për kurrikulën dhe detyrat e shtëpisë dhe mundësitë që prindërit të bashkoheshin në aktivitetet me fëmijët e tyre. Ajo supozonte se stafi ndihej i përfshirë në atë që po ndodhte por mendonte se nevojiteshin takime të rregullta të stafit sepse ndiheshin të lënë jashtë planeve të saj.

Pranimi dhe largimi nga shkolla nisën të konsideroheshin si 'rite të rëndësishme të kalimit'. Mëngjesi prezantues për fëmijët e rinj përfshinte prindërit, mësimdhënësit, kryeadministratorin dhe kryetarin e shoqatës së prindërve dhe mësimdhënësve. Fillonte me një takim të përbashkët dhe përfundonte me një drekë të përbashkët. Prindërit ftoheshin në takimin e radhës kur fëmijëve u jepej një dosje leximi me logon e shkollës. Në fund të vitit organizohej një festë me skarë dhe me muzikë live për fëmijët që largoheshin nga shkolla, duke i ftuar prindërit dhe administratorët.

Stafi bëri edhe ndryshime të mëtejshme: fotot e tërë stafit u vunë gjithandej, në hyrje të shkollës u vu një interfon dhe CCTV në derë për të mënjanuar shqetësimet e prindërve/kujdestarëve për sigurinë; fëmijët krijuan një portfolio të punës së tyre më të mirë gjatë gjithë shkollës; një gazetë javore e shkollës ishte nxjerrë nga Klubi i ICT-së Viti 6; qasja për tek drejtoresha ishte më e madhe dhe ajo paraqitej në fillim dhe në fund të ditës; koha e rrethit përfshinte informacionet pozitive për sjelljen dhe punën e mirë; dy ndihmës mësimdhënës ishin në dispozicion për ta lehtësuar ditën për fëmijët që kishin vështirësi në shtëpi.

Stafi e ndjente se *Indeksi* e kishte ndihmuar shkollën për ta vënë 'fëmijën në qendër':

"me gjithsecilin, mbikëqyrësit e sallave të ngrënies, stafin mësimdhënës, ndihmës mësimdhënës, stafin e kuzhinës, kujdestarët, pastruesit, të gjithë në një rreth rreth fëmijës, të gjithë me pjesën e tyre për të kontribuar. Të gjitha për fëmijën që mëson dhe ka pritshmëri të larta por edhe për fëmijën që thotë fjalën e vet, që nuk pret vetëm që të tjerët të bëjnë gjëra për të por bën gjëra edhe vetë."

Këshilli i shkollës ishte planifikuan dhe fëmijët e përzgjedhur ishin trajnuar për vetëbesim dhe menaxhim të konflikteve në mënyrë që ata të mund t'i ndihmonin të tjerët që ishin të izoluar ose që ngacmoheshin. Drejtoresha e ndjente se përdorimi i *Indeksit* 'po na mblidhte së bashku në një fokus të përbashkët':

"Teksa shoh përfitimet në të gjitha shkollat, mendoj se për shkollat që kanë kaluar nëpër periudha të trazirave dhe çrregullimeve, si kjo, *Indeksi* ofron një rrugë të mirë përpara."

Faza 5: Shqyrtimi i zhvillimit

Shqyrtoni dhe festoni progresin

Personi përgjegjës për zbatimin e një prioriteti në planin zhvillimor do ta udhëheqë kontrollimin dhe regjistrimin e progresit dhe të propozojë rregullime në plan. Raporti i progresit i përgatitur çdo gjysmë periudhe mund të shpërndahet në buletinet, mbledhjet, mbledhjet e stafit, ditët e zhvillimit të stafit, regjistrimet/udhëzimet për punë praktike, kohën e rrethit, këshillat e fëmijëve, bordet e njoftimeve, faqet e internetit dhe organizatat e komunitetit. Ndryshimet gjithëpërfshirëse në kulturat e një shkolle mund të shkojnë përtej prioritetëve të planifikuara dhe shpalosen përmes këmbimit të observimeve dhe storieve për përparimin në vënien e vlerave gjithëpërfshirëse në veprim.

Ekipi mund të ftojë shkolla të tjera që përdorin *Indeks*n për të festuar arritjet për vitin e kaluar. Mund të përfshijnë stafin, prindërit/kujdestarët, fëmijët, administratorët dhe pjesëtarët e komunitetit në prezantimin e përvojës së tyre të punës, në mënyrë verbale ose përmes vizatimit.

Shpërblimi vjetor për gjithëpërfshirje i shkollës mund të jetë njëra nga fotot në sallën e hyrjes.

Reflektoni për punën me *Indeks*n

Ekipi i planifikimit mund të rishikojë punën e kaluar dhe të vendosë se si mund të përdoren më së miri materialet për ta mbështetur zhvillimin në të ardhmen në lidhje me pyetjet në figurën 31 më poshtë.

Shqyrtoni hapat e ardhshëm

Faza përfundimtare e procesit mund të përkohet me fundin e një viti pune me *Indeks*n. Në disa shkolla, shumica e stafit do të jenë të njoftuar me *Indeks*n në këtë pikë, por për stafin e ri procesi mund të shpjegohet gjatë trajnimit të tyre njoftues me kulturat, politikat dhe praktikatat e shkollës. Rishikimi i treguesve dhe pyetjeve, si pjesë e rishikimit të progresit, mund të çojë në prioritetet e reja për zhvillim në ciklin e planifikimit të zhvillimit të kombinuar me procesin e vazhdueshëm të *vënies së vlerave gjithëpërfshirëse në veprim*.


Figura 31. Rishikimi i punës me *Indeks*n

Si dhe në çfarë mase:

- a ka pasur sukses grupi i planifikimit i shkollës në përbërjen e tij, barazinë e pjesëmarrjes, ndarjen e detyrave, konsultimin me të tjerët dhe mbështetjen e zhvillimit gjithëpërfshirës?
- a ka ndikuar *Indeksi* në ndryshime në shkollë?
- a ka pasur ndryshim në përkushtimin ndaj mënyrave më gjithëpërfshirëse të punës në shkollë?
- a ka ndikuar *Indeksi* në dialogun për vlerat?
- a ka ndihmuar *Indeksi* për të mbledhur së bashku ndërhyrjet, nismat dhe programet?
- a ka nxitur *Indeksi* vëmendje më të madhe ndaj kulturave të shkollës?
- a kanë ndikuar konceptet e *Indeksit* (gjithëpërfshirja, pengesat, burimet dhe mbështetja për diversitetin) në pikëpamjen për politikatat dhe praktikatat e shkollës?
- a ka qenë gjithëpërfshirës procesi i zhvillimit?
- a kanë ndihmuar treguesit dhe pyetjet për të identifikuar prioritetet që nuk ishin marrë parasysh?
- a kanë qenë të dobishme dimensionet dhe seksionet e *Indeksit* në strukturimin e planifikimit të zhvillimit të shkollës?
- a kanë qenë të qëndrueshme zhvillimet?



4 Treguesit me pyetjet



Treguesit me pyetjet

Pjesa 4 përmban treguesit me pyetjet që përcaktojnë kuptimin e tyre dhe sigurojnë një rishikim të detajuar të një shkollë.

Lista e treguesve është dhënë në faqet 12-13. Nën shumicën e treguesve në këtë seksion iu kemi referuar shumë treguesve të tjerë për të treguar ndërlidhjet brenda dhe nëpër Dimensione. Ata që i kemi përmendur janë ofruar si sugjerime, duke ju inkurajuar që të krijoni lidhjet tuaja kur të bëni planifikimin zhvillimor të shkollës tuaj. Secili dimension është i veçuar me ngjyrë në pjesën anësore të faqes dhe një ndryshim në nuancë tregon ndryshim të seksionit. Për të gjithë treguesit në Dimensionin A dhe B dhe për Seksionin 2 në Dimensionin C kemi ndalur pyetjet e tjera kur pothuajse është mbushur një faqe. Po ashtu nuk kemi shkuar përtej z-së në numërim dhe kjo do të thotë që disa pyetje janë kombinuar. Pyetje të tjera të rëndësishme mund t'ju vijnë ndër mend, të cilat ju mund të doni t'i përfshini në hetimin e kulturave, politikave dhe praktikave të shkollës suaj dhe rreshtat në fund të secilit tregues ju inkurajojnë ta bëni këtë.

Seksioni 1 i Dimensionit C bën përjashtim. Përmban një paraqitje në vija të trasha të një kurrikule, me secilin tregues që përmban pyetje të panumërta, duke nxjerrë në pah një fushë tematike, të grupuara nën një numër nën-titujsh, por gjithnjë duke filluar me 'Lidhja në nivel lokal dhe global' dhe duke përfunduar me 'Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes'. Secilës fushë i janë kushtuar të paktën dy faqe.

Dimensioni A: Krijimi i kulturës gjithëpërfshirëse 79

A1: Ndërtimi i komunitetit	80
A2: Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse	91

Dimensioni B: Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse 101

B1: Zhvillimi i shkollës për të gjithë	102
B2: Organizimi i mbështetjes së diversitetit	115

Dimensioni C: Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse 124

C1: Përpilimi i një kurrikule për të gjithë	125
C2: Orkestrimi i të nxënësve	163

Dimensioni A: Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse

A1: Ndërtimi i komunitetit

- 1 Të gjithë janë të mirëpritur.
- 2 Stafi bashkëpunon.
- 3 Fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin.
- 4 Stafi dhe fëmijët respektojnë njëri-tjetrin.
- 5 Stafi dhe prindërit/kujdestarët bashkëpunojnë.
- 6 Stafi dhe administratorët punojnë mirë së bashku.
- 7 Shkolla është model i qytetarisë demokratike.
- 8 Shkolla e inkurajon kuptimin e ndërlidhjeve në mes njerëzve nëpër botë.
- 9 Të rriturit dhe fëmijët i përgjigjen mënyrave të ndryshme të përjetimit të gjinisë.
- 10 Shkolla dhe komunitetet lokale zhvillojnë njëra tjetrën.
- 11 Stafi e ndërlidh atë që ndodh në shkollë me jetën e fëmijëve në shtëpi.

A2: Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse

- 1 Shkolla zhvillon vlera të përbashkëta gjithëpërfshirëse.
- 2 Shkolla nxit respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut.
- 3 Shkolla inkurajon respektin për integritetin e planetit Tokë.
- 4 Gjithëpërfshirja shihet si pjesëmarrje në rritje për të gjithë.
- 5 Pritjet janë të larta për të gjithë fëmijët.
- 6 Fëmijët vlerësohen në mënyrë të barabartë.
- 7 Shkolla lufton të gjitha format e diskriminimit.
- 8 Shkolla nxit ndërveprimet dhe zgjidhjet jo të dhunshme të mosmarrëveshjeve.
- 9 Shkolla inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten.
- 10 Shkolla kontribuon në shëndetin e fëmijëve dhe të rriturve.

A1.1 Të gjithë janë të mirëpritur.

A2.9 Shkolla i inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mire me veten; B1.6 Shkolla përpqet të pranojë të gjithë fëmijët nga lokaliteti i saj.

- a) A është mirëpritës kontakti i parë që njerëzit kanë me shkollën?
- b) A krijojnë stafi, fëmijë dhe familjet një ndjenjë të komunitetit në shkollë?
- c) A është shkolla mirëpritëse ndaj të gjithë prindërve/kujdestarëve dhe anëtarëve të tjerë të komuniteteve të saj lokale?
- d) A i mirëpret shkolla ata që sapo kanë ardhur nga ndonjë pjesë tjetër e vendit apo ndonjë vend tjetër?
- e) A e përshëndesin stafi, fëmijët dhe prindërit/kujdestarët njëri-tjetrin në mënyrë të sjellshme dhe miqësore?
- f) A bëjnë përpjekje stafi, fëmijët, prindërit dhe administratorët për të mësuar emrat e njëri-tjetrit?
- g) A ndihen mirë njerëzit pas një vizite në shkollë?
- h) A konsiderohet cilësia e marrëdhënieve më e rëndësishme për t'i bërë njerëzit të ndjehen të mirëpritur sesa cilësia e ndërtesave dhe e pajisjeve?
- i) A është shkolla mirëpritëse për të gjithë fëmijët nga komunitetet e saj lokale, pavarësisht nga rrethanat financiare, gjendja familjare, prejardhja dhe arritjet?
- j) A është e interesuar shkolla të mirëpresë ata që mund të jenë përballur me përjashtimin dhe diskriminimin, si pjesëtarët e komunitetit romë, refugjatët, azilkërkuesit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara?
- k) A tregojnë dokumentet, njoftimet dhe afishet se shkolla mirëpret njerëzit me prejardhje dhe identitete që aktualisht nuk përfaqësohen në shkollë?
- l) A e bëjnë të qartë informacionet që u ofrohen prindërve/kujdestarëve dhe aplikuesve për punë se pranimi i fëmijëve dhe stafit me prejardhje dhe interesa të ndryshme është i rëndësishëm për shkollën?
- m) A është informacioni i shkollës i qasshëm për të gjithë, për shembull duke u përkthyer, në sistemin breil ose në shkronja të mëdha kur është e nevojshme?
- n) A mundësohen përkthyes për përkthim në gjuhën e shenjave ose në gjuhë të tjera amtare kur është e nevojshme?
- o) A pasqyrohen përmes shenjave dhe afisheve të gjithë anëtarët e shkollës dhe komunitetet e saj në hollin e hyrjes?
- p) A e lidhin afishet shkollën me pjesë të tjera të vendit dhe botës?
- q) A është hyrja e dizajnuar me qëllim që të jetë e pëlqyeshme për të rriturit dhe fëmijët e ndërlidhur me shkollën e jo për të impresionuar inspektorët?
- r) A e shmangin zhargonin dhe klishetë shenjat dhe afishet e vendosura?
- s) A ka ceremoni pozitive për të mirëpritur fëmijët dhe stafin e ri dhe për të shënuar largimin e tyre sa herë që kjo ndodh dhe për këdo që e përfshin?
- t) A e ndjejnë fëmijët se kanë pjesën e tyre në klasat e tyre ose sallat e udhëzimeve praktike?
- u) A e ndjejnë fëmijët, prindërit/kujdestarët, administratorët dhe pjesëtarët e komunitetit se kanë pjesën e tyre në shkollë?
- v) _____
- w) _____
- x) _____

A1.2 Stafi bashkëpunon.

C2.9 Stafi planifikojnë, japin mësim dhe rishikojnë së bashku;
C2.10 Stafi zhvillon burime të përbashkëta për ta mbështetur të nxënit.

- a) A krijon stafi kulturë bashkëpunimi për të gjithë në shkollë?
- b) A i shikon stafi cilat janë pengesat për më shumë bashkëpunim dhe a përpiqet t'i zgjidhë ato?
- c) A shërben puna në grup midis stafit si model për bashkëpunimin e fëmijëve?
- d) A janë tërë stafi dëgjues të mirë?
- e) A kanë marrëdhënie të mira stafi mes tyre?
- f) A interesohet stafi për jetën dhe punën e njëri-tjetrit?
- g) A kënaqen duke punuar së bashku stafi mësimdhënës dhe jo mësimdhënës?
- h) A e trajtojnë stafi me respekt njëri-tjetrin pavarësisht roleve të tyre dhe statusit të perceptuar?
- i) A e respektojnë stafi njëri-tjetrin pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, etnisë apo aftësisë së kufizuar?
- j) A ndjehet tërë stafi i vlerësuar dhe i mbështetur?
- k) A angazhohet stafi në një dialog eksplorues në vend të dialogut konkurrues?
- l) A kuptohet që stafi nga zona lokale jep një kontribut të veçantë në zhvillimin e kulturave të shkollës?
- m) A mendon stafi që vjen nga zona përreth shkollës se njohuritë e tyre lokale vlerësohen?
- n) A ndjehet i tërë stafi i mirëpritur në ngjarjet sociale të stafit?
- o) A ndajnë rregullisht stafi ide për aktivitetet në klasë dhe jashtë shkollës?
- p) A i kushtohet e njëjta vëmendje ngjarjeve të rëndësishme si lindjet, ditëlindjet, vdekjet, martesat dhe partneritetet civile pavarësisht rolit dhe statusit të perceptuar të stafit?
- q) A ftohen i tërë stafi në mbledhjet e stafit, a marrin pjesë dhe a kontribuojnë?
- r) A ndjehet stafi rehat për të shprehur mospajtimet e tyre në mbledhje?
- s) A ndjehet stafi rehat për të kërkuar këshilla nga njëri-tjetri për mësimdhënien dhe mësimnxënien?
- t) A ndjehet stafi rehat për të diskutuar me koleget vështirësi që kanë në marrëdhëniet e tyre me fëmijët?
- u) A e vëren stafi kur kolegët janë të stresuar ose kur kanë vështirësi, dhe a ofrojnë mbështetje?
- v) A diskutohen dhe zgjidhen në mënyrë konstruktive vështirësitë në bashkëpunimin ndërmjet stafit?
- w) A e shqyrton stafi në shkollë si t'i tejkalojë pengesat në bashkëpunim me rastin e largimit apo pranimit të stafit të ri në shkollë?
- x) A e mbështetin stafi njëri tjetrin nëse ngacmohen nga ndonjë staf tjetër?
- y) A inkurajohet stafi i rregullt i furnizimit dhe stafi i përkohshëm që të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në jetën e shkollës?
- z) A inkurajohen sindikatat për të kontribuar në jetën e shkollës?

aa) _____

ab) _____

ac) _____

A1.3 Fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin.

B1.7 Të gjithë fëmijët e rinj ndihmohen që të vendosen në shkollë;
C2.5 Fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri.

- a) A interesohen fëmijët për jetën e njëri-tjetrit dhe çfarë tjetri mëson?
- b) A i identifikojnë fëmijët dhe të rriturit pengesat për një bashkëpunimin më të madh të fëmijëve?
- c) A e kuptojnë fëmijët se pranimi dhe vlerësimi i të tjerëve i ndihmon ata të ndjehen mirë me veten e tyre?
- d) A nxiten në mënyrë aktive miqësitë mbështetëse?
- e) A mësojnë fëmijët të kenë miq të përbashkët dhe jo të konkurrojnë për ta?
- f) A i ftojnë fëmijët të tjerët që të bashkohen në lojërat e tyre kur e shohin se nuk kanë askënd që të flasin ose të luajnë në kohën e pushimeve ose drekës?
- g) A e inkurajon stafi ndërtimin e marrëdhënieve mes fëmijëve në kohën e pushimeve dhe para dhe pas shkollës?
- h) A e kuptojnë fëmijët si t'i shohin gjërat nga këndvështrimi i dikujt tjetër?
- i) A angazhohen fëmijët në aktivitete së bashku jashtë shkollës të cilat ata i zhvillojnë në shkollë?
- j) A kërkojnë fëmijët ndihmë nga njëri-tjetri?
- k) A janë fëmijët të vetëdijshëm për gjërat që mund të bëjnë për të ndihmuar të tjerët dhe mënyrat se si të tjerët mund t'i ndihmojnë ata?
- l) A ndajnë fëmijët vullnetarisht njohuritë dhe shkathtësitë e tyre?
- m) A e ndihmojnë fëmijët njëri-tjetrin kur mendojnë se është e nevojshme pa pritur asgjë në këmbim?
- n) A e refuzojnë me edukatë fëmijët ndihmën e dikujt kur nuk kanë nevojë për të?⁵³
- o) A kënaqen fëmijët për arritjet e njëri-tjetrit?
- p) A e shfaqin afishet punën bashkëpunuese të fëmijëve dhe arritjet individuale?
- q) A i vlerësojnë fëmijët përpjekjet e fëmijëve të tjerë pavarësisht nga niveli i tyre i arritjes?
- r) A e kuptojnë fëmijët se shkallë të ndryshme të pajtueshmërisë me rregullat e shkollës mund të priten nga fëmijë të ndryshëm?
- s) A i tregojnë fëmijët një anëtar të stafit kur ata ose dikush tjetër ka nevojë për ndihmë?
- t) A e ndejnë fëmijët se mosmarrëveshjet ndërmjet tyre trajtohen me drejtësi?
- u) A mësojnë fëmijët se si të zgjidhin mosmarrëveshjet që lindin mes tyre?
- v) A mësojnë fëmijët të ngrenë zërin për të tjerët, ata që sipas tyre janë trajtuar padrejtësisht nga fëmijët ose të rriturit e tjerë?

- w) _____
- x) _____
- y) _____

⁵³ Kjo pyetje erdhi nga Sapon-Shevin, M. (1999) Because we can change the world: a practical guide to building co-operative, inclusive classroom communities [Sepse ne mund ta ndryshojmë botën: udhëzues praktik për ndërtimin e komuniteteve bashkëpunuese, gjithëpërfshirëse në klasë], Boston, Allyn and Bacon.

A1.4 Stafi dhe fëmijët respektojnë njëri-tjetrin.

A2.9 Shkolla inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten.

C2.8 Disiplina bazohet në respekt të ndërsjellë.

- a) A adresohet secili me respekt, me emrin që ata pëlqejnë, me shqiptimin e saktë?
- b) A referohen të gjithë me përemrin gjinor që ata preferojnë të përdoret për ta?
- c) A i sheh stafi fëmijët si qenie njerëzore si veten e tyre e jo si qenie më inferiore?
- d) A e shohin fëmijët stafin si qenie njerëzore si veten e tyre e jo si armiq apo shtypës?
- e) A i respektojnë fëmijët dhe të rriturit nevojat e tjetrit për privatësi?
- f) A i respektojnë fëmijët dhe të rriturit gjërat personale të njëri tjetrit?
- g) A njihet mirë secili fëmijë nga disa anëtarë të stafit?
- h) A e ndjejnë fëmijët se mësimdhënësit dhe stafi tjetër i pëlqen ata?
- i) A e trajtojnë fëmijët tërë stafin me respekt pavarësisht nga rolet e tyre në shkollë?
- j) A e ndihmojnë fëmijët stafin kur kjo iu kërkohet?
- k) A ofrojnë ndihmë fëmijët kur e shohin se është e nevojshme?
- l) A kujdesen stafi dhe fëmijët për mjedisin fizik të shkollës?
- m) A mbahen në gjendje të mirë hapësirat për fëmijët dhe të rriturit si tualetet, dushet dhe dollapët?
- n) A e dinë fëmijët ku duhet të drejtohen kur kanë ndonjë problem?
- o) A janë të bindur fëmijët se kur thonë se kanë një problem, ai problem merret seriozisht?
- p) A janë të bindur fëmijët se do të ndihmohen nëse hasin vështirësi?
- q) A shihen të gjithë anëtarët e shkollës edhe si nxënës dhe edhe si mësimdhënës?
- r) A pranohen në mënyrë të përshtatshme ngjarjet e rëndësishme, si lindjet, martesat, partneritetet civile, vdekjet dhe sëmundjet, divorci, ndarja dhe sëmundja?
- s) A pranohet se secili, jo vetëm pjesëtarët e 'minoriteteve etnike', kanë kulturë apo kultura?
- t) A pranohet se të gjitha kulturat dhe religjionet përfshijnë një sërë pikëpamjesh dhe shkallësh respektimi?
- u) A mund të mbështeten fëmijët dhe të rriturit që të pranojnë se janë të lënduar, të dëshpëruar apo të zemëruar në një ditë të caktuar?
- v) Kur stafi nuk ndihet mirë ose është i irrituar a vazhdon t'u drejtohet fëmijëve me respekt?
- w) A pranohet që ndjenjat personale negative për të tjerët mund të shprehen në mënyrë private si një mënyrë për t'i kapërcyer ato?
- x) A e respektojnë stafi dhe fëmijët konfidencialitetin e bisedave private, përveç nëse kjo do të rezultojë në dëm të një tjetri?
- y) _____
- z) _____
- aa) _____

A1.5 Stafi dhe prindërit/kujdestarët bashkëpunojnë

B1.1 Shkolla ka një proces zhvillimi me pjesëmarrje;
Pjesa C1 (Lidhja në nivel lokal dhe global).

- a) A e respektojnë prindërit/kujdestarët dhe stafi njëri tjetrin pavarësisht nga klasa apo statusi i tyre?
- b) A e ndjejnë prindërit/kujdestarët se fëmijët e tyre vlerësohen nga shkolla?
- c) A e ndjen stafi se prindërit/kujdestarët e vlerësojnë punën e tyre?
- d) A janë prindërit/kujdestarët të informuar mirë rreth asaj që ndodh në shkollë?
- e) A janë prindërit të informuar në mënyrë të qartë dhe të menjëhershme kur në shkollë paraqitet ndonjë çështje me interes të gjerë?
- f) A ka mundësi të ndryshme që prindërit/kujdestarët të përfshihen në shkollë?
- g) A vlerësohen në mënyrë të barabartë kontributet e ndryshme që prindërit/kujdestarët mund të japin në shkollë?
- h) A e përdor stafi përvojën e vet si prind për t'i përmirësuar marrëdhëniet me prindërit/kujdestarët e fëmijëve në shkollë?
- i) A e shmang stafi vënien e fajit për problemet e fëmijëve te fakti se ata vijnë nga 'një familje me një prind' apo nga 'një familje e ndarë'?
- j) A e vlerëson stafi mbështetjen që fëmijët e marrin nga prindërit/kujdestarët qoftë nëse ata jetojnë gjithë kohën me dy prindërit në shtëpinë e tyre ose jo?
- k) A di stafi për shumëllojshmërinë e familjeve të gjera të fëmijëve?
- l) A flasin stafi dhe prindërit/kujdestarët për mënyrën si ata parapëlqejnë që t'ju adresohet tjetri?
- m) A e shmang stafi 'mami-n' dhe 'babi-n' e përgjithshëm si term për t'ju drejtuar apo për të folur për prindërit?
- n) A janë prindërit/kujdestarët të qartë se kujt t'i drejtohen për të diskutuar shqetësimet e tyre?
- o) A e ndjejnë prindërit/kujdestarët se shqetësimet e tyre merren seriozisht?
- p) A ftohen prindërit/kujdestarët në diskutime dhe a informohen për arsimimin e fëmijëve?
- q) A janë anëtarët e familjeve të gjera të mirëpritur si kontribues në arsimimin e fëmijëve?
- r) A e shmangin stafi kontaktimin e prindërve/kujdestarëve vetëm për t'u ankuar për një fëmijë?
- s) A ka shkëmbime të rregullta informacioni mes shtëpive dhe shkollave?
- t) A ka ndonjë vend ku prindërit/kujdestarët mund të takohen, shkëmbejnë ide dhe të shërbehen me kafe/çaj ose pije të ftohtë?
- u) A i inkurajojnë prindërit/kujdestarët prindërit/kujdestarët e tjerë për të marrë pjesë në aktivitetet e shkollës në mënyrë që askush të mos ndihet i lënë anash ose i marginalizuar?
- v) A shkëmbehen njohuri për fëmijët në takimet me prindërit/kujdestarët në vend që vetëm të përcjellen njohuritë nga stafi te prindërit/kujdestarët?
- w) A e kanë të qartë prindërit/kujdestarët se si mund të mbështesin të nxënit e fëmijëve në shtëpi?
- x) A e rrit stafi përfshirjen me prindërit/kujdestarët duke mbajtur takime në kohë dhe vende të ndryshme?
- y) A e adreson stafi frikën që prindërit/kujdestarët mund të kenë për t'i vizituar shkollat dhe mësimdhënësit?
- z) A e shmang stafi ndjenjën e kërcënimit nga prindërit/kujdestarët që ata i konsiderojnë si persona me status më të lartë apo më të ditur se veten e tyre?

aa) _____

ab) _____

ac) _____

Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

A1.6 Stafi dhe administratorët punojnë mirë së bashku.

A1.2 Stafi bashkëpunon;

A1.5 Stafi dhe prindërit/kujdestarët bashkëpunojnë.

- a) A i takojnë dhe a njihet stafi me administratorët?
- b) A janë të shfaqura në shkollë fotot e administratorëve dhe interesat e tyre?
- c) A ju është dhënë administratorëve informacioni i nevojshëm për ta kuptuar rolin e tyre dhe për ta bërë punën e tyre?
- d) A e kuptojnë administratorët mënyrën e organizimit të shkollës?
- e) A e dinë, dhe a pajtohen, stafi dhe administratorët për kontributet dhe kompetencat e tyre përkatëse?
- f) A njoftohen administratorët e rinj me shkollën dhe si operohet ajo nga fëmijët dhe të gjitha kategoritë e stafit?
- g) A e pasqyrojnë administratorët përbërjen e komuniteteve të shkollës?
- h) A përpiqen administratorët të lënë mënjanë çdo dallim në status të perceptuar mes tyre?
- i) A vlerësohet në mënyrë të barabartë kontributi i të gjithë administratorëve?
- j) A janë të udhëhequra mirë takimet e administratorëve me kohën e dakorduar për pikat, duke përfshirë çështjet e tjera dhe një kohë përfundimi të dakorduar?
- k) A janë të kënaqshme mbledhjet e administratorëve?
- l) A u tregojnë administratorët të tjerëve kënaqësinë e të qenit administrator në mënyrë që të rritet numri i personave që kërkojnë të bëhen të tillë?
- m) A inkurajohen anëtarët për të ngritur çështje shqetësuese, për të cilat jepet kohë e duhur, edhe nëse ato nuk janë përfshirë më parë në rendin e ditës?
- n) A ofrohet ushqim dhe pije për ata që vijnë në takim të uritur dhe të etur?
- o) A e inkurajojnë mbledhjet e administratorëve pjesëmarrjen nga të gjithë anëtarët e tyre?
- p) A ndjehen të lirë administratorët që janë staf i shkollës të shprehin një zë të pavarur?
- q) A merren vendimet me votim të fshehtë kur është e përshtatshme?
- r) A kanë krijuar administratorët një mënyrë të caktuar për ta vizituar shkollën dhe për të kontribuar në jetën e shkollës?
- s) A përpiqen administratorët për t'i njohur fëmijët në shkollë?
- t) A njihen dhe vlerësohen shkathtësitë dhe njohuritë e administratorëve?
- u) A ndihen të përfshirë të gjithë administratorët në hartimin dhe rishikimin e politikave të shkollës?
- v) A ftohen administratorët që të ndajnë mundësitë e zhvillimit profesional me stafin?
- w) A ndajnë stafi dhe administratorët një qasje se si shkolla duhet t'i përgjigjet vështirësive të përjetuara nga fëmijët dhe si duhet të sigurohet mbështetja?
- x) A është qëllim i stafit dhe administratorëve minimizimi i kategorizimit të fëmijëve si fëmijë 'me nevoja të veçanta arsimore'?
- y) A e kundërshtojnë stafi dhe administratorët njëri-tjetrin nëse ata shfaqin qëndrime diskriminuese?
- z) _____
- aa) _____
- ab) _____

A1.7 Shkolla është model i qytetarisë demokratike.

B1.1 Shkolla ka një proces zhvillimi me pjesëmarrje;
C1.13 Fëmijët mësojnë për etikën, pushtetin dhe qeverinë.

- A mësojnë të gjithë të kenë marrëdhënie të mira dhe të jenë qytetarë të mirë duke qenë në shkollë?
- A krijojnë qëllimisht fëmijët dhe familjet një kulturë të pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit?
- A mësojnë fëmijët të jenë qytetarë aktivë nga njëri-tjetri dhe nga të rriturit?
- A e mirëpret stafi pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe të rriturve?
- A është e dukshme pjesëmarrja aktive e fëmijëve dhe të rriturve në klasa, sallat e stafit, oborrin e shkollës, para dhe pas shkollës, në afishe dhe ngjarje të shkollës?
- A i ndajnë fëmijët dhe të rriturit kuptimet e demokracisë?
- A e shqyrtojnë fëmijët dhe të rriturit shkallën në të cilën shkolla e tyre inkurajon pjesëmarrjen demokratike?
- A ka shkolla forume publike ku të rriturit dhe fëmijët i ndajnë rregullisht idetë e tyre?
- A e feston shkolla përparimin në njohjen e të drejtave dhe demokracisë duke përfshirë zhvillimet kryesore në historinë e vet?
- A ka kohë të rregullt kur klasat dhe e tërë shkolla angazhohen në votimin për çështjet me rëndësi për shkollën?
- A kanë mundësi të gjithë fëmijët për t'u përfshirë në Këshillin e shkollës ose në Parlamentin e Fëmijëve?
- A angazhohen të gjithë fëmijët në punë të cilat kontribuojnë në zhvillimin e shkollës?

Punët mund të përfshijnë:

Koordinimi i lidhjeve ndër-shkollore

Vizita në komunitet

Plehërimi

Gatimi, shërbimi, pastrimi i ushqimit

Krijimi i artit

Kujdesi për koleksionin e thesareve të shkollës

Zhvillimi/rregullimi i fushës së shkollës

Dokumentimi i vizitorëve të kafshëve dhe zogjve

Dokumentimi i të kaluarës së shkollës

Rritja e biodiversitetit

Udhëzimet në sport

Intervistimi për punë

Ambasadorë të gjuhës

Kujdesi për bibliotekën

Kujdesi për kafshët e shkollës

Kujdesi për pellgun e shkollës

Monitorimi i përdorimit të energjisë

Teknikët e rrjetit

Organizimi i postës së shkollës

Kryesimi i lojës

Krijimi dhe mësimi i artit

Shkrimi për gazetën e shkollës

Ofrimi i argëtimit në komunitet

Leximi për të tjerët

Riciklimi

Zgjidhja e konflikteve

Kthimi i gjërave të humbura

Kujdesi për kopshtin e shkollës

Guidat e shkollës

Menaxhimi i skenës

Inskeni i dramave

Mësimi i shahut

Mbjellja e pemëve

Reduktimi i mbeturinave, p.sh. drekat pa mbetje

Urimi i mirëseardhjes për stafin e ri/pranimi i vizitorëve

Shkrimi i poezive, kronikës së shkollës

Ej, etj, etj...

m) _____

n) _____

Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

A1.8 Shkolla e inkurajon kuptimin e ndërlidhjeve në mes njerëzve në mbarë botën.

Seksioni C1 (Lidhja në nivel lokal dhe global);

C2.6 Mësimet zhvillojnë aftësinë për të kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve.

- a) A përdoren lidhjet e të rriturve dhe fëmijëve në shkollë me të tjerët në mbarë botën si pikë fillimi për zgjerimin e kuptimit të lidhjeve globale?
- b) A shihet vendndodhja e shkollës në rajonin e saj, vendin dhe lidhjet me botën nga një sërë perspektivash historike dhe gjeografike dhe a është kjo e dukshme në afishe?
- c) A fitojnë fëmijët një ide se si ndërlidhjet globale ndërmjet njerëzve ndryshojnë me kalimin e kohës?
- d) A janë të vetëdijshëm fëmijët se si jeta e njerëzve në një pjesë të botës ndikon në atë të të tjerëve?
- e) A i eksplorojnë fëmijët ndikimet globale në atë që mësojnë, fjalët që flasin, artin që e shikojnë, muzikën që dëgjojnë, energjinë që konsumojnë, ushqimin që hanë, gazetatat dhe librat që lexojnë, sportet dhe lojërat që luajnë dhe shikojnë?
- f) A e shohin të rriturit dhe fëmijët se si të qenit një qytetar global përfshin veprime të përditshme?
- g) A janë fëmijët fqinjë të mirë për njerëzit që vijnë në vendin e tyre nga një pjesë tjetër e botës?
- h) A e eksplorojnë fëmijët natyrën e marrëdhënieve konstruktive dhe shtypëse në mes vendeve?
- i) A ndihmohen fëmijët të kuptojnë kuptimin e racizmit dhe ksenofobisë dhe si ndikon kjo në qëndrimet midis popujve dhe vendeve?
- j) A mësojnë fëmijët për mënyrën se si vendet janë të lidhura përmes tregtisë?
- k) A eksplorojnë të rriturit dhe fëmijët mundësitë që blerjet e tyre të jenë etike?
- l) A ka shkolla përkushtim për tregti të drejtë në aktivitetet e saj blerëse dhe bankare?
- m) A e dinë fëmijët se çfarë ndodh me huatë dhe ndihmën e dhënë vendeve të varfra ekonomikisht?
- n) A e mësojnë fëmijët shkallën në të cilën marrëdhëniet mes shteteve bazohen në përkushtimin ndaj vlerave të barazisë, pjesëmarrjes dhe jo-dhunës?
- o) A mësojnë fëmijët për rëndësinë e tregtisë së armëve në vendin e tyre?
- p) A e kuptojnë fëmijët mënyrën se si aktivitetet e korporatave dhe bankave si dhe qeverive mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në jetën e njerëzve në mbarë botën?
- q) A është e lidhur shkolla me një shkollë tjetër në rrethana shumë të ndryshme ekonomike, në nivel kombëtar dhe/ose ndërkombëtar?
- r) A siguron shkolla që marrëdhëniet me të rriturit dhe fëmijët në çdo shkollë të lidhur janë të bazuara në barazi, respekt dhe zhvillim të dialogut e jo në bamirësi?
- s) A është e lidhur shkolla me një shkollë tjetër që ndodhet brenda vendit të vet, qoftë urbane apo rurale?
- t) _____
- u) _____
- v) _____

A1.9 Të rriturit dhe fëmijët i përgjigjen mënyrave të ndryshme të përjetimit të gjinisë.

A2.9 Shkolla inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten.

C1.6 Fëmijët mësojnë për shëndetin dhe marrëdhëniet.

- a) A e kuptojnë të rriturit dhe fëmijët se jo të gjithë mendojnë për veten e tyre si mashkull apo femër?
- b) A reflekton stafi për kompleksitetin e identiteteve të tyre si qenie me gjini?
- c) A është në gjendje stafi t'ju lejojë fëmijëve lirinë për të zhvilluar gjininë e tyre sipas mënyrave që i ndihmojnë fëmijët të ndihen më rehat?
- d) A e kuptojnë fëmijët se njeriu mund të ketë një sens të fuqishëm të gjinisë së tij si mashkull, femër apo transgjinior pa e përcaktuar kjo mënyrën e sjelljes, shprehjes së ndjenjave, interesave dhe qëndrimeve të tij ndaj arritjeve?
- e) A e diskuton stafi masën në të cilën ata kanë pikëpamje stereotipike të roleve gjinore dhe si shprehja e qëndrimeve të tilla mund të ngushtojë mënyrat në të cilat fëmijët shprehin gjininë e tyre?
- f) A e shmangin të rriturit dhe fëmijët pengimin e njerëzve të tjerë që të kenë një stil të veçantë të të qenit djalë apo vajzë duke i etiketuar ata, për shembull si një djalosh?
- g) A janë të përfshirë të rriturit dhe fëmijët në gjetjen e mënyrave për të zvogëluar mbipërfaqësimin e djemve në ata që shihet të jenë 'të këqij' apo që përjetojnë vështirësi në të nxënimit?
- h) A kanë të rriturit dhe fëmijët një gjuhë për të folur për gjininë, ambiguitetin dhe fluiditetin gjinor, mashkullinë dhe femërinë?
- i) A ka stafi një listë alfabetike të fëmijëve në regjistra dhe jo lista të ndara të djemve dhe vajzave?
- j) A kanë fëmijët mundësinë të përfshihen në sporte dhe PE me gjini të ndryshme?
- k) A i sfidojnë të rriturit dhe fëmijët idetë se burrat dhe gratë duhet të kenë role të ndryshme në shkollë, në punë të tjera, në kujdesin për fëmijët apo në punët e shtëpisë?
- l) A vlerësohet puna që bëjnë të rriturit dhe fëmijët si kujdestarë, pavarësisht gjinisë së tyre?
- m) A i edukojnë stafi të gjitha gjinitë që të kuptojnë se të qenit prind/kujdestar i fëmijëve të vegjël është ndër aktivitetet më të rëndësishme dhe më të kënaqshme që bëjnë njerëzit në jetën e tyre?
- n) A kuptohet se gjinia është aspekt më i rëndësishëm i identitetit të disa njerëzve se të tjerët dhe kjo mund të ndryshojë me kohë, si rëndësia e një feje apo etnie?
- o) A e inkurajojnë në mënyrë aktive institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme emërimin e burrave në role të ndryshme?
- p) A e shmang shkolla inkurajimin e stileve stereotipike gjinore të veshjes në uniformat e shkollës?
- q) A i diskutojnë stafi dhe fëmijët presionet kulturore të burrave dhe grave për të mbuluar apo zbuluar pjesët e trupit të tyre?
- r) A inkurajohen fëmijët të vijnë në shkollë me rroba dhe këpucë që u lejojnë atyre të lëvizin lirshëm?
- s) A dekurajohen fëmijët për ta parë një gjini apo formë mashkullore ose femërie si më të rëndësishme se një tjetër?
- t) _____
- u) _____
- v) _____

A1.10 Shkolla dhe komunitetet lokale zhvillojnë njëra tjetrën.

Seksioni C1 (Lidhja në nivel lokal dhe global);
C2.14 Burimet në lokalitetin e shkollës njihen dhe shfrytëzohen.

- Ⓐ A angazhohet shkolla në aktivitete për të përfshirë komunitetet përreth, duke përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, dyqanet dhe bizneset lokale dhe etnitë lokale?
- Ⓑ A bazohet shkolla në përvojat e ndryshme të njerëzve lokalë për t'i mbështetur aktivitetet e kurrikulës në shkollë?
- Ⓒ A i thekson gazeta e shkollës njerëzit, eventet dhe bizneset lokale?
- Ⓓ A ka shkolla kalendar të festave dhe ditëve me interes të veçantë apo javë të aktiviteteve që ndahen me komunitetet lokale?
- Ⓔ A marrin pjesë në mënyrë të barabartë komunitetet lokale në shkollë, pavarësisht nga klasa, religjioni apo etnia e tyre?
- Ⓕ A ndjejnë njerëzit në komunitetet lokale se shkolla u takon atyre edhe nëse nuk kanë fëmijë në shkollë?
- Ⓖ A ofron shkolla ngjarje muzikore, drama, evente kërcimi dhe ekspozita arti për njerëzit në komunitetet përreth?
- Ⓗ A organizon shkolla orë mësimore për art, gjuhë, shkrim-lexim dhe numërim që prindërit dhe anëtarët e komunitetit i duan?
- Ⓙ A jep shkolla kontribut në ngjarjet e organizuara nga komunitetet e saj lokale?
- Ⓚ A është e vetëdijshme shkolla për planet ekzistuese të zhvillimit të komunitetit në të cilat ajo mund të kontribuojë?
- Ⓛ A konsultohet shkolla me njerëzit lokalë, duke përfshirë këshilltarët, komunitetin dhe punëtorët e rinj, policinë dhe bamirësitë lokale për planifikimin e përfshirjes së saj me komunitetin?
- Ⓜ A bashkëpunon shkolla për sigurimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për njerëzit lokalë?
- Ⓝ A i ndajnë pjesëtarët e komuniteteve lokale objektet si biblioteka, holli dhe kafeneja së bashku me stafin dhe fëmijët?
- Ⓟ A përdor shkolla fruta dhe perime nga kultivuesit dhe ofruesit lokal të tyre për përgatitjen e shujtave?
- Ⓠ A shihen të gjitha seksionet e komuniteteve lokale si burim për shkollën?
- Ⓡ A ka mendime pozitive për shkollën brenda komuniteteve lokale?
- Ⓒ A ka mendime pozitive për komunitetet lokale brenda shkollës?
- Ⓙ A inkurajon shkolla aplikimet për punë në shkollë nga njerëzit lokalë?
- Ⓢ A i mbështet shkolla projektet për përmirësimin dhe ruajtjen e mjedisit lokal, për shembull për rrëqe, lumenj dhe kanale?
- Ⓣ A punon shkolla me të tjerët për ta mbajtur një zonë në lokalitetin e tyre pa mbeturina dhe objekte të hedhura?
- Ⓤ A e inkurajon shkolla mbjelljen e pemëve?
- Ⓨ A ndihmon shkolla në zhvillimin e zonave të gjelbra lokale duke mbjellur pemë, fara?
- Ⓟ _____
- Ⓡ _____
- Ⓨ _____

A1.11 Stafi e lidh atë që ndodh në shkollë me jetën e fëmijëve në shtëpi

A1.5 Stafi dhe prindërit/kujdestarët bashkëpunojnë; B1.7 Të gjithë fëmijët e rinj ndihmohen të vendosen në shkollë; Seksioni C1 (Lidhja në nivel lokal dhe global); C2.4 Fëmijët përfshihen në mënyrë aktive në të nxëniet e tyre.

- a) A janë të vetëdijshëm stafi për shumëllojshmërinë e kulturave në shtëpi të fëmijëve dhe rrethanave familjare?
- b) A e kupton stafi se disa fëmijë mund ta ndjejnë veten më shumë si në shtëpi kur janë në shkollë sesa të tjerët?
- c) A e pranojnë të rriturit dhe fëmijët se njerëzit mund të ndihen shumë ngushtë kur kulturat dhe identitetet e tyre nuk respektohen?
- d) A sigurojnë të rriturit se të gjithë fëmijët e shohin veten dhe prejardhjen e tyre të reflektuar në shkollë, në materiale dhe afishe dhe në lidhjet e bëra me njohuritë e tyre nga shtëpia në aktivitetet mësimore?
- e) A e kuptojnë shkollat se për disa fëmijë shkollat mund të jenë strehë e sigurt krahasuar me shtëpinë?
- f) A e kuptojnë të rriturit se fëmijët mund të shfaqin shkathtësi dhe interesa në shtëpi që nuk i shfaqin në shkollë, si bisedat, shakatë, kujdesi, menaxhimi, gatimi, leximi, numërimi, dizajnimi, përgatitja, mbledhja, rritja e bimëve?
- g) A përpiqen të rriturit t'u mundësojnë fëmijëve të përdorin tërë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre që i shfaqin në shtëpi në të nxëniet dhe marrëdhëniet në shkollë?
- h) A e kuptojnë të rriturit dhe fëmijët se për ta njohur një person tjetër kërkohet interesim për të hyrë në dialog me të e jo njohuri të hollësishme paraprake për gjendjen e tij kulturore ose specifike në shtëpi?
- i) A i debaton stafi tendencat për t'i bërë aktivitetet mësimore më të përshtatshme për fëmijët që ata i shohin si të ngjashëm me veten?
- j) A e kupton stafi që vjen nga jashtë zonës se ata mund të shihen si vizitorë në komunitet nga të rriturit dhe fëmijët nga zona lokale?
- k) A i shmang stafi supozimet rreth aktiviteteve dhe besimeve të një fëmije të caktuar bazuar në prejardhjen e tyre?
- l) A e kuptojnë të rriturit dhe fëmijët shqetësimin e mundshëm të atyre që janë larguar nga familja dhe/ose miqtë?
- m) A i kuptojnë të rriturit dhe fëmijët ndjenjat e zhvendosjes kulturore që mund të përjetojnë nga njerëzit që iu kanë bashkuar shkollës, siç janë refugjatët dhe azilkërkuesit?
- n) A e reflektojnë kulturat e shkollës përzierjen e gjinive, klasave, etnive, prejardhjeve, marrëdhënieve familjare, orientimeve seksuale mes fëmijëve, prindërve/kujdestarëve dhe stafit?
- o) A janë të shënuara ngjarje të rëndësishme në jetën e fëmijëve sipas mënyrave që respektojnë kulturat e tyre?
- p) A respektohen normat kulturore dhe preferencat personale për modestinë në rregullimin e dushëve dhe notit?
- q) A i inkurajon stafi fëmijët të kenë qasje në klube dhe ngjarje afër shtëpive të tyre, edhe nëse shkolla nuk është në zonën e shtëpisë së tyre?
- r) _____
- s) _____
- t) _____

A2.1 Shkolla zhvillon vlera të përbashkëta gjithëpërfshirëse.

I ndërlidhur me të gjithë treguesit e tjerë

- Ⓐ A u jep kohë stafi, administratorët, prindërit/kujdestarët dhe fëmijët bisedave për vlerat, implikimet e tyre për veprim, natyrën e vlerave të tyre dhe si ato dallojnë mes njerëzve?
- Ⓑ A kuptohet se vlerat shpalosen përmes veprimeve dhe jo fjalëve?
- Ⓒ A është secili në shkollë i angazhuar për barazinë e vlerës së të gjithë njerëzve dhe për pjesëmarrjen e të gjithëve?
- Ⓓ A i eksplorojnë të rriturit dhe fëmijët vlerat prapa mënyrave të tyre të punës dhe veprimit në shkollë?
- Ⓔ A i shmangin të rriturit dhe fëmijët supozimet se secili në komunitet ndan të njëjtat vlera?
- Ⓕ A kuptohet se duhet praktikë dhe besim për të shprehur sinqerisht vlerat që i mbështesin veprimet?
- Ⓖ A kuptohet se marrëveshja për vlerat është zakonisht e pjesshme, pasi dallimet e pikëpamjeve, për shembull rreth pjesëmarrjes dhe barazisë, mund të shfaqen kur bisedat thellohen?
- Ⓗ A pajtohen stafi, fëmijët, prindërit/kujdestarët dhe administratorët për një kuadër vlerash, mbi të cilin mund të bazohet formësimi i veprimeve brenda shkollës?
- Ⓙ A përdoret kuadër i dakorduar i vlerave për t'i rezistuar presioneve nga jashtë shkollës për të vepruar sipas vlerave të ndryshme?
- Ⓚ A i rishikon stafi praktikat e tyre në bazë të vlerave të tyre të dakorduara dhe propozon ndryshime ku praktikat bazohen në vlera që ata i refuzojnë?
- Ⓛ A kuptohet se zbatimi i vlerave të përbashkëta mund të përfshijë drejtimin në mes interesave konkurruese, për shembull, kur pjesëmarrja e një fëmije ndërhyt me atë të një tjetri?
- Ⓜ A i kushtojnë vëmendje të rriturit dhe fëmijët veprimeve brenda dhe jashtë shkollës që nuk janë në përputhje me kuadrin e dakorduar të vlerave?
- Ⓝ A janë bërë ndryshimet në shkollë në përputhje me kuadrin e dakorduar të vlerave?
- Ⓟ A vazhdojnë diskutimet përtej titujve të vlerave deri te kompleksiteti i kuptimeve të tyre?
- Ⓡ A e lidhin stafin dhe fëmijët deklaratën përmbledhëse të vlerave të shkollës me kuptime më të detajuara?
- Ⓣ A eksplorojnë kufizimet e ideve të vlerave kombëtare, globale ose perëndimore?
- Ⓤ A i publikon shkolla vlerat e saj dhe i inkurajon të tjerët të angazhohen me stafin dhe fëmijët në bazë të vlerave të dakorduara brenda shkollës?
- Ⓥ A zbatohet kuadri i dakorduar i vlerave në mënyrë të barabartë për të rriturit dhe fëmijët?
- Ⓦ A kuptohet se duhet të punojmë shumë për të vepruar në përputhje me vlerat tona?
- Ⓧ A kuptohet se një kuadër i fortë vlerash mund të mbështetet nga njerëzit që nuk kanë një fe ose shumëllojshmëri të feve?
- Ⓨ A kuptohet se të kesh një fe ose një pozitë të veçantë politike nuk i siguron vlerat gjithëpërfshirëse?
- Ⓩ A i ndërlidhin njerëzit mënyrat si veprojnë jashtë shkollës me mënyrën se si ata veprojnë brenda saj?
- ⓞ A kuptohet se implikimet e disa vlerave, si kujdesi në mënyrë të barabartë për të gjithë dhe inkurajimi i shpresës në të ardhmen, janë aspekte të detyrave profesionale të stafit?
- ⓧ _____
- ⓨ _____

A2.2 Shkolla nxit respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut.

A2.3 Shkolla inkurajon respektin për integritetin e planetit Tokë.

- a) A e inkurajon shkolla besimin se të gjithë kanë të drejta dhe ato janë të barabarta?
- b) A inkurajohet respektimi i të drejtave në mënyrën se si të rriturit dhe fëmijët e trajtojnë njëri-tjetrin?
- c) A kuptohet që nocioni i të drejtave presupozon një grup të përbashkët të vlerave që kanë të bëjnë me barazinë, dhembshurinë dhe respektin për diversitetin?
- d) A kuptohet se të drejtat e një personi mund të kufizohen vetëm kur ushtrimi i tyre mund të shkelë drejtpërsëdrejti të drejtat e personit tjetër?
- e) A konsiderohet se kufizimi i të drejtave të dikujt, veprimet e të cilëve ne nuk i miratojmë (për shembull, në lidhje me të drejtën e të burgosurit për të votuar), redukton respektimin e të drejtave për të gjithë?
- f) A e shohin fëmijët dhe të rriturit përkushtimin për të drejtat si mënyrë për t'i vlerësuar të gjithë në mënyrë të barabartë pavarësisht prejardhjeve, mendimeve dhe identiteteve të tyre?
- g) A kuptohen të drejtat themelore si e drejta për ushqim, veshje, strehim, kujdes, arsimim, siguri, shprehje të lirë të pikëpamjeve, punë me pagesë, përfshirje në vendime dhe respektim të identitetit dhe dinjitetit?
- h) A mësojnë fëmijët për historinë e skllavërisë dhe shtrirjen e pranisë së saj të vazhdueshme në vendin e tyre dhe në mbarë botën?
- i) A mësojnë fëmijët për fushatat e tanishme dhe të kaluara për të drejtat e njeriut në MB dhe vendet e tjera?
- j) A mësojnë fëmijët se si mund të kontribuojnë në fushatat për të drejtat e njeriut?
- k) A e lidh shkolla drejtësinë kombëtare dhe globale me idenë e të drejtave?
- l) A mësojnë fëmijët se si do të ndryshonte bota nëse do të kishte më pak padrejtësi?
- m) A lidhet nocioni i të drejtave me idenë e qytetarisë globale?
- n) A kuptohet që pabarazitë në shoqëri privojnë njerëzit nga mundësia për të ushtruar të drejtat e tyre?
- o) A kuptohet që të drejtat zakonisht nuk njihen?
- p) A eksplorohet në shkollë shtrirja e urisë dhe sëmundjeve të parandalueshme?
- q) A mësojnë fëmijët për dokumentet e të drejtave të njeriut siç është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (shih listën në faqen 188)?
- r) A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët shkallën në të cilën përmbajtja e dokumenteve të të drejtave të njeriut mund të përmirësohet?
- s) A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët se si mbështetja për të drejtat e njeriut është e përfshirë në ligjet kombëtare?
- t) A janë fëmijët të vetëdijshëm për abuzimin e të drejtave të njeriut në vendin e tyre dhe vendet e tjera edhe kur dokumentet për të drejtat e njeriut janë nënshkruar dhe miratuar nga qeveritë?
- u) A kuptohet që të gjithë fëmijët kanë të drejtë të vijojnë mësimin në shkollën e tyre lokale ose një nga shkollat e tyre lokale?
- v) A ngrenë zërin fëmijët dhe të rriturit për të tjerët të cilët trajtohen padrejtësisht brenda shkollës?
- w) A gjejnë mënyra fëmijët dhe të rriturit për të ngritur zërin për të tjerët të cilët trajtohen padrejtësisht në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar?
- x) A përdoret rëndësia e të drejtave për të kundërshtuar pabarazitë dhe paragjykimet si seksizmi, racizmi, islamofobia, diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, homofobia dhe transfobia?
- y) A ndihmon këshilli i shkollës në promovimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës?
- z) _____

A2.3 Shkolla inkurajon respektin për integritetin e planetit Tokë.

A2.2 Shkolla inkurajon respektimin e të gjitha të të drejtave të njeriut; C1.7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin; C1.8 Fëmijët studiojnë jetën në tokë.

- a) A i kuptojnë fëmijët të drejtat e natyrës së gjallë dhe jo të gjallë?
- b) A e eksplorojnë të rriturit dhe fëmijët kuptimin e qëndrueshmërisë mjedisore, në aspektin e vazhdimësisë dhe mungesës së çrregullimit të specieve, ekosistemeve dhe peizazheve?
- c) A reflektojnë të rriturit dhe fëmijët për Deklaratën Universale të të Drejtave të Nënës Tokë (shih ekstraktin në faqe 190)?
- d) A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët se sa janë të varur ata nga mirëqenia e planetit?
- e) A e miratojnë të rriturit dhe fëmijët detyrën e kujdesit ndaj deteve dhe tokës së planetit?
- f) A reflektojnë të rriturit dhe fëmijët për pikëpamjen se Toka është aty për t'u zbutur, shfrytëzuar dhe pushtuar nga njerëzit?
- g) A reflektojnë të rriturit dhe fëmijët për pikëpamjen se njerëzit duhet të jetojnë në harmoni me Tokën midis specieve të tjera dhe formacioneve natyrore të planetit?
- h) A vijnë të rriturit dhe fëmijët në përfundimet e tyre vetanake për marrëdhënien e tyre me Tokën?
- i) A e diskutojnë të rriturit dhe fëmijët pikëpamjen se ekonomitë dhe fitimet duhet të zhvillohen vetëm në atë masë kur ruhet shëndeti i planetit?
- j) A konsiderojnë të rriturit dhe fëmijët se nëse të gjithë do të konsumonin në masën e vendeve të pasura atëherë njerëzve do t'ju duhej të kërkonin disa Toka të tjera për të mbijetuar?
- k) A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët se ndërsa disa burime të planetit janë të shtershme, arsimi, kultura, muzika, lojërat, informacioni, miqësia dhe dashuria nuk janë?
- l) A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët pikëpamjen se sjellja e cila ndot, tejzhvillon dhe e vë në rrezik mbijetesën e jetës duhet të klasifikohet si krim ndërkombëtar?
- m) A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët mundësinë që ndotja e tokës dhe ujit të jetë krim pavarësisht nëse mund të provohet apo jo se ajo dëmton njerëzit?
- n) A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët se kush mund të zotërojë tokën, detet, lumenjtë dhe liqenet në Tokë?
- o) A i shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët të drejtat historike të shfrytëzimit të tokës të njerëzve vendës të cilët nuk kanë pasur kontrata formale të pronësisë?
- p) A i shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët pasojat e humbjes së qasjes në tokat e përbashkëta të ndara në mes qytetarëve në vendet e tyre dhe në vendet e tjera?
- q) A i shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët se kush e zotëron dhe kush pretendon të ketë pronësinë e ajrit dhe ujit?
- r) A i shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët se si njerëzit mund ta kundërshtojnë ndotjen e mjedisit dhe çfarë ndodh kur e bëjnë?
- s) A i shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët implikimet e përkushtimit nga secila gjeneratë për ta pasuar një planet të lulëzuar te gjeneratat e ardhshme?
- t) A merren parasysh krimet kundër gjeneratave të ardhshme që rrezikojnë shëndetin e tyre, mbijetesën dhe sigurinë, dëmtojnë rëndë mjedisin, shterojnë burimet, presin pyjet dhe kërcënojnë mbijetesën e specieve dhe ekosistemeve të tjera?
- u) A e konsiderojnë të rriturit dhe fëmijët borxhin ekologjik që kanë gjeneratat e tanishme ndaj planetit dhe gjeneratave të ardhshme të cilin ata duhet ta paguajnë?
- v) A e kuptojnë të rriturit dhe fëmijët se borxh më të madh ndaj planetit kanë ata që kanë konsumuar më së shumti?
- w) A i konsiderojnë të rriturit dhe fëmijët pikat kritike, se si një ndotje e vogël shtesë e tokës, deteve dhe ajrit mund të ketë efekte joproporcionale?
- x) _____
- y) _____

A2.4 Gjithëpërfshirja shihet si pjesëmarrje në rritje për të gjithë.

A2.1 Shkolla zhvillon vlera të përbashkëta gjithëpërfshirëse.

- a) A kuptohet gjithëpërfshirja si proces i pafund për rritjen e pjesëmarrjes së të gjithëve?
- b) A kuptohet pjesëmarrja përtej mundësive për të jetuar dhe për të mësuar në mënyrë bashkëpunuese dhe vlerësimit të identiteteve të njëri-tjetrit?
- c) A kuptohet gjithëpërfshirja si një qasje parimore për zhvillimin e të gjitha aspekteve të një shkolle, si dhe arsimit dhe shoqërisë më gjerësisht?
- d) A konsiderohet se gjithëpërfshirja ka të bëjë po aq me atë se si shkollat, familjet dhe shoqëria më e gjerë mund të zhvillohet për të nxitur dhe vazhduar pjesëmarrjen sa edhe me inkurajimin e pjesëmarrjes së individëve?
- e) A konsiderohet se gjithëpërfshirja ka të bëjë me pjesëmarrjen e të rriturve dhe të fëmijëve po ashtu?
- f) A vlen gjithëpërfshirja për të gjithë, jo vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara ose ata që shihen si persona 'me nevoja të veçanta arsimore'?
- g) A e shmang stafi konsiderimin e pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje si pengesa të shkaktuara nga mangësitë ose aftësitë e kufizuara tek fëmijët?
- h) A kuptohet që çdokush mund të përjetojë pengesa në të nxënit dhe pjesëmarrje?
- i) A kuptohet se kush përjeton pengesa në të nxënit dhe pjesëmarrje ndryshon nga konteksti?
- j) A konsiderohet se pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje mund të lindin potencialisht në ndërveprime në të gjitha aspektet e një shkolle: kulturat, politikat, kurrikulat dhe qasjet ndaj mësimdhënies dhe mësimnxënies?
- k) A shihen pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje se lindin nga politikat kombëtare, kulturat dhe vlerat lokale dhe kombëtare dhe presionet e tjera jashtë shkollës?
- l) A sfidohen qëndrimet rreth limitimit në anëtarësimin në komunitetin dominues, siç është pikëpamja se fëmijët me aftësi të kufizuara serioze ose të shumta nuk mund të jenë pjesë e komunitetit dominues?
- m) A kuptohet një 'shkollë gjithëpërfshirëse' si shkollë që 'ecën drejt gjithëpërfshirjes' e jo si shkollë që përpiqet të arrijë një destinacion?
- n) A kuptohet që përfshirja e rritur përfshin kundërshtimin e përjashtimit dhe diskriminimit?
- o) A kuptohet përjashtimi si proces që mund të fillojë në klasa, sheshe të lojërave dhe salla të stafit dhe përfundon me një fëmijë ose të rritur që largohet nga shkolla?
- p) A njihen presionet përjashtuese si gjithmonë të pranishme dhe gjithnjë si diçka që duhet të kundërshtohet?
- q) A theksohet vlerësimi i diferencave në vend të pajtueshmërisë me një 'normalitet' të vetëm?
- r) A vlerësohet diversiteti dhe a shihet si burim për të mësuar e jo si problem?
- s) A ka vendosmëri të përbashkët për të minimizuar pabarazitë e mundësive në shkollë?
- t) _____
- u) _____
- v) _____

A2.5 Pritjet janë të larta për të gjithë fëmijët

C2.2 Aktivitetet mësimore inkurajojnë pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve; C2.7 Vlerësimet inkurajojnë arritjet e të gjithë fëmijëve; C2.12 Detyrat e shtëpisë caktohen që të kontribuojnë në të nxënit e të gjithë fëmijëve.

- a) A e ndjen çdo i rritur dhe fëmijë që arritjet më të mëdha janë të mundshme në shkollën e tyre?
- b) A e kuptojnë të gjithë fëmijët dhe të rriturit se nuk ka kufi për atë që mund ta arrijnë?
- c) A i kupton stafi përpjekjet që duhet të bëhen për të kundërshtuar çdo pritshmëri të ulët për fëmijët, duke përfshirë ata që jetojnë në varfëri, fëmijët në kujdesin publik, pjesëtarët e komunitetit romë, ata që e mësojnë gjuhën angleze si gjuhë shtesë dhe fëmijët e kategorizuar 'me nevoja të veçanta arsimore'?
- d) A e shmang stafi dërgimin e fëmijëve që kanë pengesa të mëdha në të nxënit dhe pjesëmarrje për mësim te stafi më pak i kualifikuar dhe me përvojë?
- e) A e kuptojnë të rriturit dhe fëmijët se sa më shumë arrijnë kur ndihen të vlefshëm për atë që bëjnë dhe për atë që janë?
- f) A ndihen krenar të rriturit dhe fëmijët në arritjet e tyre?
- g) A e shmang stafi përcjelljen e ndjenjës së dështimit të fëmijët dhe familjet e tyre duke i parë ata si fëmijë që nuk mund ta ndjekin hapin me 'zhvillimin normal'?
- h) A vlerësohen arritjet e fëmijëve në vete e jo si krahasim me të tjerët?
- i) A e pranon stafi se kur fëmijët e shohin veten si 'jo mirë' në një fushë të kurrikulës, kjo ndjenjë mund të marrë një jetë të tërë për t'u larguar?
- j) A i shmang stafi krahasimet në mes arritjes së një fëmije dhe vëllait ose motrës apo fqinjit?
- k) A bëjnë përpjekje stafi dhe fëmijët për të kundërshtuar pikëpamjet negative të fëmijëve që hasin vështirësi në mësimet?
- l) A e shmang stafi etiketimin e fëmijëve si fëmijë me më shumë aftësi ose me më pak bazuar në arritjet e tyre aktuale?
- m) A e shmang stafi dhe fëmijët përdorimin e etiketimeve nënçmuese të arritjeve të ulëta?
- n) A i kundërshtojnë stafi dhe fëmijët pikëpamjet negative dhe përdorimin e etiketimeve nënçmuese për fëmijët që kanë ambicie, janë entuziast dhe arrijnë shumë në mësimet?
- o) A e shmang stafi krijimin e një shtrese të fëmijëve të konsideruar si fëmijë me 'nevoja të veçanta arsimore' dhe që kanë 'potencial' të limituar?
- p) A e shmang stafi krijimin e një shtrese të fëmijëve të konsideruar si fëmijë 'me dhunti apo të talentuar' dhe që kanë potencial' më të madh se të tjerët?
- q) A e inkurajon stafi pikëpamjen se të gjithë kanë dhunti dhe talente?
- r) A hyjnë fëmijët në provime publike kur janë të gatshëm dhe jo në një moshë të caktuar?
- s) A ka përpjekje për ta adresuar frikën nga dështimi të disa fëmijëve?
- t) _____
- u) _____
- v) _____

A2.6 Fëmijët vlerësohen në mënyrë të barabartë.

B1.8 Grupet e mësimeve dhe mësimeve janë të organizuara drejt për ta mbështetur të nxënësit e të gjithë fëmijëve.

- a) A jep shumëllojshmëria e prejardhjeve të të rriturve dhe fëmijëve kontribut pozitiv në shkollë dhe në komunitet?
- b) A shihen theksi dhe dialektet kombëtare dhe rajonale si pasurim i shkollës dhe shoqërisë?
- c) A ka përkushtim për të vlerësuar të gjitha gjuhët e fëmijëve të pasqyruara në aktivitetet mësimore dhe në klubet dhe provimet e ofruara?
- d) A i shmangin të rriturit parapëlqimet e tyre dhe a i lënë mënjanë ndjenjat e mospëlqimit për fëmijët e caktuar?
- e) A inkurajohet nxënia e fëmijëve më të qetë si për ata që janë më të zëshëm në kontributin e tyre?
- f) A i shmangen të rriturit demonizimit të fëmijëve të veçantë kur tregojnë për aktet e tyre negative?
- g) A janë të ndjeshëm stafi për të gjitha gjendjet familjare të fëmijëve kur flasin për ngjarje të tilla si Dita e nënës apo e babait?
- h) A kanë mundësi të gjithë fëmijët të marrin pjesë në eventet shkollore dhe muzikë, dramë dhe vallëzim?
- i) A njihen dhe vlerësohen dallimet në strukturën familjare?
- j) A e shmang stafi konsiderimin e fëmijëve të klasës së mesme si më të çmuar për shkollën sesa fëmijët e klasës punëtore?
- k) A e shmangin stafi përdorimin e niveleve të kurrikulës ose arritjeve në provimet publike si mënyrë për t'i bërë disa fëmijë të ndihen më të vlefshëm dhe të tjerët më pak?
- l) A vlerësohen brenda shkollës personat homoseksualë, lesbike, biseksualë, transgjinorë dhe intergjinorë dhe a janë të përfaqësuar brenda kurrikulës?
- m) A e shmang stafi paraqitjen e një religjioni ose mungesën e religjionit si më të rëndësishme se të tjerat?
- n) A janë të mirëpritur në shkollë fëmijët, stafi dhe prindërit/kujdestarët me aftësi të kufizuara si ata pa aftësi të kufizuara?
- o) A ka shumë raste për të vlerësuar përpjekjet e fëmijëve që arrijnë rezultate më të ulëta si për fëmijët me arritje më të mëdha duke përfshirë ata që dalin mirë në provime?
- p) A i përfshin të gjithë fëmijët raportimi i arritjeve brenda dhe përtej shkollës?
- q) A prezantohet puna e të gjithë fëmijëve brenda shkollës dhe klasave?
- r) A e përfundojnë të gjithë fëmijët shkollën e mesme me një akreditim të njohur?
- s) A i jepet e njëta mbështetje dhe përparësi të barabarta arritjeve të fëmijëve pavarësisht nga gjinia?
- t) A e shmang stafi krijimin e hierarkisë së fëmijëve duke i krahasuar fëmijët e zakonshëm me fëmijët 'me nevoja të veçanta' apo edhe fëmijët 'e përfshirë'?
- t) _____
- u) _____
- v) _____

A2.7 Shkolla lufton të gjitha format e diskriminimit.

A1.8 Shkolla e inkurajon kuptimin e ndërlidhjeve në mes njerëzve nëpër botë; A1.9 Të rriturit dhe fëmijët i përgjigjen mënyrave të ndryshme të përjetimit të gjinisë; A2.4 Gjithëpërfshirja shihet si pjesëmarrje në rritje për të gjithë; A2.2 Shkolla e inkurajon respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut.; B2.9 Ngacmimi është minimizuar; C2.6 Mësimet zhvillojnë aftësitë për të kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet në mes njerëzve.

- a) A kuptohet se secili ka paragjykime për të tjerët, për identifikimin dhe reduktimin e të cilave nevojiten përpjekje?
- b) A i shqyrtojnë të rriturit qëndrimet e tyre ndaj diversitetit dhe a i identifikojnë paragjykimet për t'i mbështetur më mirë fëmijët në identifikimin dhe zvogëlimin e paragjykimeve të tyre?
- c) A i identifikojnë të rriturit dhe fëmijët fushat e diskriminimit të cilat duhet të adresohen?
- d) A kuptohet që të gjitha diskriminimet përfshijnë mungesën e tolerancës ndaj ndryshimit dhe shpërdorimin e pushtetit?
- e) A i kushtohet vëmendje mënyrës si mund të ndihet personalisht një mungesë e përgjithshme e tolerancës ndaj ndryshimit, siç është klasizmi, seksizmi, racizmi, homofobia, transfobia, islamofobia etj?
- f) A kuptohet se diskriminimi institucional mund të rrjedhë nga kulturat dhe politikat të cilat nënvlerësojnë identitetet ose diskriminojnë disa grupe të njerëzve?
- g) A kuptohet se një kulturë në të cilën respektimi i diversitetit ndahet gjerësisht si vlerë është mënyra më e mirë për ta parandaluar dhe zvogëluar diskriminimin?
- h) A janë pjesë e planeve gjithëpërfshirëse për luftimin e të gjitha formave të diskriminimit kërkesat ligjore për të reduktuar 'pabarazitë' në lidhje me përkatësinë etnike, aftësinë e kufizuar, gjininë, orientimin seksual, identitetin seksual, religjionin, besimet dhe moshën?
- i) A identifikohet si diskriminim dhe a kundërshtohet nënçmimi i njerëzve për shkak të peshës së tyre?
- j) A e shmang stafi sugjerimin se ka një identitet të vetëm kombëtar apo mënyrë për të qenë në shkollë?
- k) A i shmang stafi rolet stereotipike për fëmijët në produksione të shkollës, për shembull, sipas ngjyrës së flokëve, ngjyrës së lëkurës ose gjinisë?
- l) A kuptohet se njohuritë për aftësitë e tyre të kufizuara japin vetëm një kontribut të kufizuar në planifikimin e arsimit për fëmijët?
- m) A i kundërshton stafi qëndrimet stereotipike ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara kur ata përshkruhen, për shembull, si objekte të keqardhjes ose luftëtarë heroikë kundër vështirësive?
- n) A kuptohet se aftësitë e kufizuara mund të lindin në ndërveprime midis njerëzve me aftësi të kufizuara dhe mjediseve të tyre por që mund të paraqiten edhe nga qëndrimet diskriminuese dhe pengesat institucionale?
- o) A kuptohet përjashtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara të rënda nga shkolla më shumë si kufizim i kulturës, qasjes dhe politikave sesa si vështirësi praktike?
- p) A e shmangin fëmijët përdorimin e emrave fyjes racist, seksist, homofobik, diskriminues në aspektin e aftësisë së kufizuar dhe formave të tjera diskriminuese?
- q) A i shmang shkolla sistemet e filtrimit që në mënyrë të padrejtë kufizojnë qasjen në faqet e internetit, për shembull ato relevante me përvojën e personave lesbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë dhe intergjjinorë?
- r) _____
- s) _____

A2.8 Shkolla nxit ndërveprimet dhe zgjidhjet jo të dhunshme të mosmarrëveshjeve.

A1.9 Të rriturit dhe fëmijët i përgjigjen mënyrave të ndryshme të përjetimit të gjinisë.
B2.9 Ngacmimi është minimizuar.

- a) A kuptohet jo dhuna si ndërveprim jo i detyrueshëm si dhe mungesë e konfliktit fizik?
- b) A zgjidhen mosmarrëveshjet në shkollë përmes dialogut e jo përmes detyrimit bazuar në dallimet në statusin e perceptuar dhe forcën fizike?
- c) A shërbejnë të rriturit si model i ndërveprimit jodetyrues?
- d) A mësojnë njerëzit t'i përgjigjen kundërshtimit të ideve të tyre duke reflektuar për atë që duhet menduar dhe bërë ndryshe?
- e) A mësojnë të gjithë shkathtësitë e negociimit, zgjidhjes së konflikteve dhe ndërmjetësimit të mosmarrëveshjeve?
- f) A kuptohen abuzimi, diskriminimi, ngacmimi seksual dhe ngacmimi si forma të dhunës?
- g) A kuptohet se bashkëpunimi është më i lehtë kur njerëzit ndihen të sigurt në identitetet e tyre?
- h) A kryesohen diskutimet pa u dominuar nga ndonjë individ, grup apo gjini?
- i) A ndihmohen ata që shpesh janë tejet të zemëruar për të gjetur mënyra të tjera për të shprehur veten e tyre?
- j) A udhëzohen fëmijët drejt aktiviteteve dhe klubeve të arteve marciale si mënyrë për ta zhvilluar besimin dhe vetësigurinë pa agresivitet?
- k) A e ndihmojnë njerëzit njëri-tjetrin për të dhënë kontribute që respektojnë kontributet e të tjerëve?
- l) A reflektojnë njerëzit për mënyrën se si ndjenjat e tyre ndaj të tjerëve ndikojnë në ndërveprimet me ta?
- m) A mbështeten fëmijët në poezi, literaturë, muzikë, dramë, shfaqje me kukulla për të kuptuar ndjenjat?
- n) A mësojnë fëmijët për pasojat e kërkimit të hakmarrjes për konflikte të vazhdueshme individuale dhe ndërkombëtare?
- o) A i diskutojnë fëmijët dhe të rriturit limitimet e portretizimit të pranueshëm të dhunës, duke përfshirë marrëdhëniet degraduese mes gjinive, në filma dhe lojëra kompjuterike?
- p) A i thekson shkolla prioritetet njerëzore ndaj atyre afariste?
- q) A e shmang shkolla trajtimin e fëmijëve si material për provime?
- r) A iu mësohet fëmijëve për origjinën e konflikteve për territoret, identitetet, burimet dhe jotolerancën ndaj dallimeve dhe si mund të zvogëlohen ato me anë të paqes?
- s) A mësojnë fëmijët të vënë në dyshim nevojën e dominimit të një gjinie ndaj tjetrës?
- t) A e shqyrtojnë fëmijët dhunën midis gjinive dhe si mund të ndërpriten këto forma të dhunës?
- u) A eksplorohet se si disa identitete mashkullore inkurajojnë dhunën ndaj meshkujve dhe femrave?
- v) A eksplorohet se si burrat dhe gratë mund të kontribuojnë në formimin e aspektit mashkullor agresiv tek fëmijët?
- w) A e eksplorojnë fëmijët çfarë fitojnë dhe humbasin kur i bashkohen bandave dhe si mund të shmangët dhuna mes bandave brenda dhe jashtë shkollës?
- x) A mbështeten fëmijët për të gjetur aktivitete jashtë shkollës që reduktojnë përfshirjen në dhunë midis bandave?
- y) A ndihmohen fëmijët që të mos mbajnë thika ose armë të tjera?
- z) A konsiderohet se dhuna, e drejtuar përbrenda, mund të prodhojë depresion dhe vetëdëmtim?

A2.9 Shkolla inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten.

A1.4 Stafi dhe fëmijët respektojnë njëri-tjetrin; A2.10 Shkolla kontribuon në shëndetin e fëmijëve dhe të rriturve; B2.9 Ngacmimi është minimizuar; C1.6 Fëmijët mësojnë për shëndetin dhe marrëdhëniet.

- Ⓐ A i inkurajon shkolla të rriturit dhe fëmijët që të përjetojnë kënaqësi në mësim dhe marrëdhënie?
- Ⓑ A i ndihmon shkolla fëmijët dhe të rriturit të ikën nga tirania e ideve të normalitetit?
- Ⓒ A mësojnë fëmijët se është e zakonshme dhe në rregull që të ndihen ndryshe nga të tjerët?
- Ⓓ A e shmangin të rriturit dhe fëmijët mbivlerësimin e shtatit të hollë?
- Ⓔ A ndihmojnë të rriturit dhe fëmijët për të kundërshtuar stereotipet e bukuri në media dhe në kulturat e tyre?
- Ⓕ A ndihen të rriturit dhe fëmijët të pasuruar nga gama e identiteteve, prejardhjeve, etnive, gjinive dhe mënyrave të këndvështrimit të botës në shkollë?
- Ⓖ A e ndjejnë të rriturit dhe fëmijët se është në rregull të shprehin dallimet e identitetit dhe pikëpamjeve?
- Ⓗ A e inkurajon shkolla mirëqenien personale që lidhet me mirëqenien pozitive të të tjerëve në shkollë, komuniteteve të saj dhe në nivel global?
- Ⓙ A e inkurajon shkolla mirëqenien personale që lidhet me përmirësimin e mjedisit dhe integritetin e planetit?
- Ⓚ A bëhen përpjekje për të siguruar që të gjithë në shkollë mund të kenë miq?
- Ⓛ A mësojnë fëmijët për marrëdhëniet e mira që vijnë nga mënyra se si njerëzit e trajtojnë njëri-tjetrin në shkollë?
- Ⓜ A mundohet shkolla të rrisë vetëbesimin e fëmijëve dhe të rriturve që përjetojnë vështirësi?
- Ⓝ A e kuptojnë të rriturit dhe fëmijët se humbja e vetëbesimit mund të ulë arritjet dhe të rritë ngacmimin?
- Ⓟ A e kuptojnë të rriturit dhe fëmijët se dukja e një personi apo mënyra si atyre iu adresohen të tjerët mund të mos pasqyrojë gjininë që ata ndiejnë?
- Ⓡ A janë të vetëdijshëm stafi se përdorimi i tualeteve ose dhomave të ndërrimit sipas gjinisë mund të jetë burim shqetësimi për disa fëmijë që janë transgjinorë apo intergjinorë?
- Ⓢ A janë të rriturit dhe fëmijët të ndjeshëm ndaj stresit që rritja dhe puberteti mund të shkaktojë në këndvështrimin e disa njerëzve për gjininë e tyre?
- Ⓣ A ka vende të mjaftueshme, të pastra, të sigurta për të rriturit dhe fëmijët që të kujdesen për veten kur janë me perioda?
- Ⓤ A janë fëmijët dhe të rriturit të ndjeshëm ndaj streseve që periodat mund të shkaktojnë te disa persona?
- Ⓡ A shmangen udhëtimet e gjata për fëmijët me aftësi të kufizuara për në shkollë dhe nga shkolla, duke nxitur pikëpamjen se fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën të vijnë në mësimin në shkollën e tyre lokale?
- Ⓚ A i kushtohet kujdes djemve dhe vajzave të përfshira në shtatzëni në moshë shkollë?
- Ⓛ A e shmang shkolla stigmatizimin e vajzave që mbesin shtatzënë apo kanë fëmijë?
- Ⓜ A i diskuton me ndjeshmëri stafi dhe fëmijët çështjet e humbjes së një të afërmi të dashur në mënyrë që ata të dinë ta mbështesin njëri-tjetrin nëse vdes një fëmijë apo i rritur në shkollë?
- Ⓝ A kuptohet se vdekja e një miku, anëtarit të familjes ose personi tjetër të rëndësishëm mund të ndikojë te dikush për shumë vite dhe më shumë në momente të shënuara, siç janë përvjetorët?

A2.10 Shkolla kontribuon në shëndetin e fëmijëve dhe të rriturve.

A2.9 Shkolla inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten;
C1.1 Fëmijët eksplorojnë ciklet e prodhimit dhe konsumin e ushqimit; C1.6 Fëmijët mësojnë për shëndetin dhe marrëdhëniet.

- a) A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët sa kontribuon në shëndet mjedisi i shëndetshëm, loja, aktivitetet që ofrojnë kënaqësi, miqësia, mungesa e stresit, një dietë e mirë dhe palestra fizike?
- b) A e shmangin të rriturit dhe fëmijët perceptimin se disa njerëz nuk janë të shëndetshëm apo kanë probleme shëndetësore vetëm sepse ata duken ndryshe?
- c) A identifikohen pengesat për shëndetin brenda shkollës, komuniteteve të saj dhe mjedisit përreth?
- d) A ka procedura të qarta për shpërndarjen dhe monitorimin e përdorimit të ilaçeve nga fëmijët?
- e) A trajtohen të rriturit dhe fëmijët për ndihmën e parë dhe dinë si t'u përgjigjen krizave shëndetësore, për shembull në lidhje me diabetin ose epilepsinë?
- f) A ka hapësira të qeta private për fëmijët dhe të rriturit kur presioni është shumë i madh apo ku është dikush për bisedë nëse ndihet e nevojshme?
- g) A konsiderohet se stresi dhe zemërim lindin nga rrethanat e vështira të disa fëmijëve?
- h) A ju jepet fëmijëve mundësi të meditojnë dhe të mësojnë për meditimin?
- i) A ofrohen këshillime për ata që përjetojnë shqetësim për një kohë të gjatë apo janë vazhdimisht të zemëruar?
- j) A ka salla për kujdes mjekësor, përkujdesje ose fizioterapi të rregullt?
- k) A ka ujë të pijshëm të qashtë dhe të mjaftueshëm?
- l) A krijojnë stafi, fëmijët dhe familjet dieta promovuese të shëndetit në shkollë dhe në shtëpi?
- m) A ofrohen mundësi që njerëzit të ndajnë shqetësimet e tyre shëndetësore siç është ngrënia si rezultat stresi?
- n) A ndihmohen fëmijët t'i rezistojnë presioneve nga prodhuesit për të konsumuar jo shëndetshëm?
- o) A promovohen aktivitetet fizike për kënaqësi si dhe përfitimet shëndetësore që ato sjellin?
- p) A marrin pjesë rregullisht fëmijët në aktivitetet jashtë klasës duke përfshirë aktivitetet në mjedise të hapura?
- q) A e inkurajojnë lojërat dhe orët e edukatës fizike sportin dhe palestrën për të gjithë dhe a përfshijnë vallëzim, aerobi, arte marciale, Tai Chi dhe joga?
- r) A inkurajohen fëmijët dhe të rriturit që të angazhohen në aktivitet fizik çdo ditë dhe ta shijojnë ecjen dhe ngasjen me biçikletë në shkollë?
- s) A ndihen fëmijët të sigurt në të gjitha mjediset e shkollës?
- t) A ka ekuilibër midis shqetësimeve të sigurisë dhe inkurajimit të përvojës së fëmijëve?
- u) A vlerësohen dhe adresohen rreziqet gjatë rrugës për në shkollë dhe nga shkolla?
- v) A parkohen prindërit larg nga shkolla kur i dërgojnë dhe marrin fëmijët?
- w) A kontrollohet rregullisht siguria e automjeteve të shkollës?
- x) A ofrohen mësim për ngasjen e sigurt të biçikletës?
- y) A mbajnë helmetë të rriturit dhe fëmijët kur ngasin biçikletën për në shkollë?
- z) A mësojnë fëmijët se si t'i shmangin rreziqet e rrjeteve online dhe faqeve të tjera të internetit?

aa) _____

ab) _____

Dimenzioni B: Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse

B1: Zhvillimi i shkollës për të gjithë

- 1 Shkolla ka një proces zhvillimi me pjesëmarrje.
- 2 Shkolla ka qasje gjithëpërfshirëse në udhëheqje.
- 3 Emërimet dhe promovimet janë të drejta.
- 4 Ekspertiza e stafit njihet dhe përdoret.
- 5 Stafi i ri ndihmohet për t'u vendosur në shkollë.
- 6 Shkolla përpiket të pranojë të gjithë fëmijët nga lokaliteti i saj.
- 7 Të gjithë fëmijët e rinj ndihmohen të vendosen në shkollë.
- 8 Grupet e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të organizuara drejt për të mbështetur nxënien e të gjithë fëmijëve.
- 9 Fëmijët janë të përgatitur mirë për të kaluar në shkolla të tjera.
- 10 Shkolla është bërë fizikisht e qasshme për të gjithë.
- 11 Ndërtesat dhe terreni janë zhvilluar për të mbështetur pjesëmarrjen e të gjithëve.
- 12 Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit.
- 13 Shkolla kontribuon në reduktimin e mbeturinave.

B2: Organizimi i mbështetjes së diversitetit

- 1 Të gjitha format e mbështetjes janë të koordinuara.
- 2 Aktivitetet e zhvillimit profesional e ndihmojnë stafin t'i përgjigjet diversitetit.
- 3 Gjuha angleze si mbështetje shtesë gjuhësore është burim për tërë shkollën.
- 4 Shkolla mbështet vazhdimësinë në arsimimin e fëmijëve në kujdesin publik.
- 5 Shkolla siguron që politikat për 'nevojat e veçanta arsimore' mbështesin gjithëpërfshirjen.
- 6 Politika e sjelljes është e lidhur me mësimin dhe zhvillimin e kurrikulës.
- 7 Presionet për përjashtim disiplinor janë ulur.
- 8 Pengesat për vijimin e shkollës janë zvogëluar..
- 9 Ngacmimi është minimizuar.

B1.1 Shkolla ka një proces zhvillimi me pjesëmarrje.

A1.4 Stafi dhe fëmijët respektojnë njëri-tjetrin; A1.5 Stafi dhe prindërit/kujdestarët bashkëpunojnë; A1.6 Stafi dhe administratorët punojnë mirë së bashku; A1.10 Shkolla dhe komunitetet lokale e zhvillojnë njëra tjetrën; A2.4 Gjithëpërfshirja shihet si pjesëmarrje në rritje për të gjithë; Seksioni C (Lidhja në nivel lokal dhe global).

- a) A ka 'plan zhvillimor' për shkollën dhe rrethinën e saj i cili është i njohur dhe i pranuar nga stafi, administratorët, prindërit dhe fëmijët?
- b) A kërkohen mendimet e fëmijëve, prindërve/kujdestarëve dhe administratorëve për natyrën e pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje dhe si mund të përmirësohet shkolla?
- c) A kërkohen pikëpamjet e anëtarëve të komunitetit për mënyrën se si shkolla dhe komunitetet e saj mund të kontribuojnë në zhvillimin e njëra-tjetrës?
- d) A bëjnë diferencë mendimet e stafit, fëmijëve, prindërve, administratorëve dhe komuniteteve në atë që ndodh në shkollë?
- e) A mendojnë prindërit/kujdestarët, fëmijët, administratorët se konsultimi me ta është pjesë e rregullt e përfshirjes së tyre në shkollë?
- f) A është aktiv zbatimi i planit zhvillimor të shkollës dhe a rishikohet rregullisht me përfshirjen e modifikimeve kur është e nevojshme?
- g) A reflektojnë pjesëtarët e shkollës për ndryshimet që kanë ndodhur në dymbëdhjetë muajt e mëparshëm dhe arsye për to?
- h) A e shqyrton stafi cilat ndryshime kanë ndodhur si rezultat i planit zhvillimor dhe cilat ndryshime kanë ndodhur për arsye të tjera?
- i) A mendon stafi se ndryshimi bëhet zhvillim kur reflekton vlerat e dëshiruara?
- j) A e rrisin të rriturit dhe fëmijët ndikimin e tyre në zhvillimin e shkollës së tyre duke e mbështetur ndikimin në një kuadër të përbashkët vlerash gjithëpërfshirëse?
- k) A kuptohet se lidhja e vlerave me veprime në kulturat, politikat dhe praktikat e shkollës mund të kontribuojë në zhvillimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të shkollës?
- l) A e kupton stafi se pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje të përjetuara nga fëmijët mund të reduktohen duke përmirësuar aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe qasjet ndaj tyre?
- m) A reflektojnë pjesëtarët e shkollës për mënyrën se si kulturat e shkollës mund ta pengojnë ose nxisin zhvillimin gjithëpërfshirës?
- n) A hartohen politikat me synim të përmirësimit të kulturave dhe praktikave të shkollës, e jo për të dalë mirë para inspektorëve?
- o) A janë të gjitha politikat të lidhura me strategji të qarta të implementimit?
- p) A monitorohen dhe ndryshohen sipas nevojës efektet e politikave të shkollës në kulturat dhe praktikat e shkollës?
- q) A ndajnë të rriturit dhe fëmijët ide me shkollat partnere dhe a i vizitojnë ato (ndoshta në një vend tjetër) me qëllim që të ndihmojnë në zhvillimin e shkollave dhe mjediseve të njëra-tjetrës?
- r) _____
- s) _____
- t) _____

B1.2 Shkolla ka qasje gjithëpërfshirëse në udhëheqje.

A1.2 Stafi bashkëpunon; B1.4 Ekspertiza e stafit njihet dhe përdoret;
C2.9 Stafi planifikojnë, japin mësim dhe rishikojnë së bashku.

- a) A kuptohet që liderët e fortë mund të jenë bashkëpunues dhe jo autokratik?
- b) A i shmang shkolla kufizimet në marrëdhënie dhe të nxënit që mund të dalin nga një hierarki e ngurtë e menaxhmentit të lartë, menaxhimit të mesëm, jo menaxhmentit (punëtorëve) dhe fëmijëve?
- c) A ndahen njohuritë e rëndësishme për shkollën midis stafit në mënyrë që të minimizohen çrregullimet nëse një person mungon ose lë shkollën?
- d) A i shmang shkolla presionet drejt pajtueshmërisë së pakuptueshme qoftë me menaxhmentin e shkollave ose direktivat e qeverisë?
- e) A e shmang drejtori kalimin e direktivave nga jashtë shkollës sikur ato të ishte e pamundur të përshtaten me kulturat, politikat dhe praktikatat e shkollës?
- f) A ndihmon stafi i lartë që të zvogëlohet koha që e kalon stafi në punë me shkresa?
- g) A i reziston stafi presioneve për të bërë gjëra që janë në konflikt me vlerat e tyre?
- h) A janë të kujdesshëm njerëzit që promovohen që të mos sillen sikur një rritje e statusit automatikisht nënkupton njohuri më të mëdha?
- i) A janë të kujdesshëm stafi i lartë të shmangin favorizimin e një stafi mbi të tjerët?
- j) A vazhdojnë njerëzit që promovohen të tregojnë gatishmëri për ta pranuar kur bëjnë gabime?
- k) A merren vendimet në bazë të argumenteve të parashtruara e jo sipas ushtrimit të pushtetit?
- l) Kur njerëzit kanë punuar shumë për çështje të veçanta a respektohet kjo në marrjen e vendimeve?
- m) A respektohen njohuritë dhe shkathtësitë e stafit në marrjen e vendimeve?
- n) A i drejtohen mbledhjet nga staf i ndryshëm dhe a sigurojnë që të gjithë mund të kontribuojnë?
- o) A janë mësimdhënësit senior atje për të mbështetur dhe këshilluar e jo për t'i inspektuar dhe menaxhuar detajet e punës të personave të tjerë?
- p) A pritët që të gjithë të rriturit dhe fëmijët të jenë ose të bëhen vetë-menaxhues?
- q) A shihet autoriteti si diçka që qëndron në njohuri, mençuri dhe shkathtësi e jo në një pozitë të veçantë pune?
- r) A zgjidhen drejtori dhe stafi tjetër i lartë pjesërisht për shkak të shkathtësive të tyre për ta ndihmuar stafin tjetër për nxitjen e mësimin në grupe të ndryshme?
- s) A ka ekspertizë drejtori dhe stafi tjetër i lartë në inkurajimin e dialogut?
- t) A dëgjon me kujdes stafi argumentet e njëri-tjetrit dhe a kërkojnë sqarime përpara se të mos pajtohen?
- u) A ka mënyra jo detyruese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?
- v) A ka shpërndarje të hapur dhe të barabartë të burimeve në shkollë?
- w) _____
- x) _____
- y) _____

B1.3 Emërimet dhe promovimet janë të drejta.

A1.2 Stafi bashkëpunon; B1.2 Ekziston një qasje gjithëpërfshirëse për udhëheqjen.

- a) A janë mundësitë për emërimet të hapura për të gjithë ata që kualifikohen, brenda dhe jashtë shkollës?
- b) A i shmang stafi përpjekjet për të përfituar nga promovimi i tepruar i njohurive dhe përvojës së tyre?
- c) A dekurajohen stafi që të mos kërkojnë përfitime duke kaluar orë të tepërta në shkollë të cilat stafi me angazhime në shtëpi ose prioritete të ndryshme nuk mund t'i ofrojë?
- d) A e bën të qartë shkolla për të gjithë përkushtimin e saj ndaj emërimeve pa paragjykitje për gjini, etni, aftësi të kufizuara, moshë, orientim seksual ose ndonjë aspekt tjetër jorelevant?
- e) A e shmang shkolla diskriminimin në emërimet në bazë të moshës, për shembull për të shmangur pagat më të larta të fituara nga stafi më i vjetër?
- f) A i pasqyron përbërja e stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës komunitetet në lokalitetin e shkollës?
- g) A inkurajohen dhe mentorohen njerëzit për t'u paraqitur për promovim pa marrë parasysh gjininë, rrethanat familjare, prejardhjen etnike apo ndonjë aspekt tjetër jorelevant?
- h) A e shohin të natyrshme stafi, veçanërisht në shkollat fillore dhe parashkollore, që meshkujt të marrin rolin e kujdesit me fëmijët e vegjël?
- i) A inkurajohen ata që mendojnë se mund të duan të aplikojnë për një post që ta bëjnë këtë?
- j) A e shmangin drejtorët dhe stafi tjetër inkurajimin e veçantë të miqve të ngushtë ose aleatëve për të kërkuar promovim?
- k) A është organi qeverisës krijues në nxitjen e prindërve dhe mësimdhënësve për të parë kënaqësinë dhe rëndësinë e punës si administrator ashtu që një numër njerëzish të paraqiten për këtë funksion?
- l) A e reflektojnë postet e promovuara balancin e gjinive dhe prejardhjes së stafit në shkollë?
- m) A janë postet me status më të lartë pasqyruese të të gjitha seksioneve të komuniteteve të shkollës?
- n) A ka përfaqësim nga stafi i shkollës, administratorët dhe këshilli i shkollës i fëmijëve në komisionet për emërimet?
- o) A i paguhet secilit që punon në shkollë të paktën një pagë reale e jetesës.⁵⁴
- p) Kur shkolla ka lidhje me një besim të veçantë a minimizohet diskriminimi në emërimet në bazë të besimit?
- q) A kanë panelet e emërimeve pjesëmarrje të përzier të gjinive, etnive dhe prejardhjeve që pasqyrojnë komunitetet e shkollës?
- r) A janë të përfshira sindikatat e stafit për të ndihmuar në hartimin e udhëzimeve për emërimet dhe promovimet?
- s) A ju kërkohet aplikantëve për punë të paraqesin një aspekt të punës së tyre para stafit, administratorëve, prindërve/kujdestarëve dhe fëmijëve?
- t) A ka strategji për heqjen e pengesave në emërimin e stafit me aftësi të kufizuara?
- u) A është vlerësimi i diversitetit një kriter thelbësor për emërimin e stafit?
- v) A gjenden zëvendësime të përkohshme për stafin e munguar si dhe mësimdhënësit e klasës dhe lëndës?
- w) _____
- x) _____

⁵⁴ Shih www.livingwage.org.uk

B1.4 Ekspertiza e stafit njihet dhe përdoret.

B1.2 Shkolla ka qasje gjithëpërfshirëse në udhëheqje.

- a) A janë vërtet të interesuar stafi në njohuritë dhe ekspertizën e njëri-tjetrit?
- b) A njihen shkathtësitë, njohuritë dhe interesat e stafit mësimdhënës dhe jo mësimdhënës, jo vetëm ato që nënkuptohen nga pozita e tyre e punës apo të dhënat në përshkrimin e tyre të punës?
- c) A konsultohet stafi se si të përdorin më mirë shkathtësitë dhe njohuritë e tyre për të mirën e shkollës dhe komuniteteve të saj?
- d) A inkurajohen mësimdhënësit dhe ndihmës mësimdhënësit që të shfrytëzojnë të gjitha shkathtësitë dhe njohuritë e tyre për të mbështetur të nxënit e fëmijëve dhe të rinjve?
- e) A inkurajohet stafi për të zhvilluar ekspertizë dhe interesa të reja?
- f) A inkurajohet stafi për të ndarë njohuritë, interesat dhe ekspertizën e tyre të re?
- g) A ofrojnë anëtarët e stafit njohuritë dhe shkathtësitë e tyre?
- h) A janë të kujdesshëm stafi të mos anashkalojnë njohuritë dhe shkathtësitë e kolegëve, si mësimdhënësve të Artit dhe Edukatës fizike, në punën me grupe diverse të fëmijëve?
- i) A vendos stafi çfarë ekspertize shtesë dëshirojnë të përdorin nga jashtë shkollës?
- j) A kontribuon varieteti i gjuhëve të folura nga stafi në zhvillimin e një 'shkolle të mësimi të gjuhëve'?
- k) A kuptohet se është në rregull që njerëzit e ndryshëm të kenë pika të forta të ndryshme personale dhe profesionale?
- l) A takohen stafi për të mbledhur idetë dhe ekspertizën e tyre për ta përmirësuar mësimdhënien e njëri-tjetrit dhe zgjidhur vështirësitë e njëri-tjetrit në mësimdhënie?
- m) A e dëgjojnë stafin njëri-tjetrin dhe a ofrojnë perspektiva alternative për shqetësimet rreth fëmijëve pa gjykuar negativisht?
- n) A shqyrtohen dallimet në kulturën dhe prejardhjen e stafit gjatë hartimit të kurrikulave dhe aktiviteteve të të nxënit?
- o) A mëson stafi nga praktikat mësimore dhe përvoja në shkollat e tjera?
- p) A ftohet stafi i shkollave speciale lokale për të ndarë ekspertizën me stafin në shkollat e rregullta për mësimnxënien dhe mësimdhënien me grupet diverse?
- q) A kërkohen të jepen observime për shkollën kur stafi është duke u larguar apo është larguar nga shkolla, për të marrë njohuri të reja që ata mund të duan të ndajnë?
- r) A kuptohet se stafi i ri mund të japë kontribut të veçantë në jetën shkollore që dallon nga ajo e stafit të vjetër?
- s) A kuptohet se ajo që njerëzit i ofrojnë një shkolle mund të ndryshojë me moshë dhe kjo mund të jetë në avantazh të kolegëve?
- t) _____
- u) _____
- v) _____

B1.5 Stafi i ri ndihmohet për t'u vendosur në shkollë.

A1.2 Stafi bashkëpunon; C2.9 Stafi planifikojnë, japin mësim dhe rishikojnë së bashku.

- a) A ka politikë të dakorduar për njoftim me punën për stafin, administratorët dhe prindërit ndihmues?
- b) A e rrit vullnetin e stafit të ri politika e njoftimit me punën?
- c) A ju ofrohen stafit të ri të gjitha informacionet që ju nevojiten për shkollën duke përfshirë politikat shkollore dhe planin zhvillimor të shkollës dhe mjedisit?
- d) A pyetet stafi i ri se për çfarë informacionesh shtesë kanë nevojë dhe a ofrohen ato?
- e) A ftohet stafi i sapoemëruar që të vizitojnë shkollën para datës zyrtare të fillimit të punës?
- f) A i caktohet pjesëtarëve të rinj të stafit një mentor që i ndihmon ata të vendosen në shkollë dhe të takohet me ta në ditën e tyre të parë dhe rregullisht pas kësaj?
- g) A është mentori rregullisht i qashtëm personalisht ose me telefon në javët e para për t'iu përgjigjur pyetjeve?
- h) A takohet drejtori me stafin e ri sa më afër të jetë e mundur ditës së parë të tyre?
- i) A mirëprehen zyrtarisht stafi i ri nga administratori dhe përfaqësuesit e prindërve?
- j) A mirëprehen zyrtarisht stafi i ri nga përfaqësuesit e fëmijëve?
- k) A mbështetet stafi i ri për të kontribuar në mbledhjet e stafit?
- l) A i kupton stafi ekzistues vështirësitë që mund të ketë stafi i ri për t'u vendosur në një punë të re, që mund të jetë një vend apo lokalitet i ri?
- m) A e fton stafi që ka shërbyer më gjatë stafin e ri, sidomos ata që janë të ri në atë zonë ose në vend, në shtëpitë e tyre dhe të takohen shoqërisht jashtë shkollës?
- n) A e shmang stafi që ka shërbyer më gjatë gjërat që mund t'i bëjnë stafin e ri të ndjehet i huaj, për shembull duke përdorur 'ne' ose 'neve' që i përjashton ata?
- o) A ka vërtet interesim stafi ekzistues për ta njohur stafin e ri dhe asaj që mund të ofrojnë ata për shkollën?
- p) A inkurajohet stafi i ri të dinë se prania dhe kontributi i tyre do të bëjë diferencë në kulturat e shkollës?
- q) A ndihmohen mësimdhënësit e sapo kualifikuar të shfrytëzojnë mirë kohën e tyre shtesë të zhvillimit profesional?
- r) A janë të lidhur mësimdhënësit e ri dhe stafi mbështetës në struktura të themeluara për përkrahje të ndërsjellë, observim të praktikës dhe diskutim të mundësive për zhvillimin e aktiviteteve të mësimdhënies, mësimnxënies dhe aktiviteteve mbështetëse?
- s) A i trajton stafi i përhershëm stafin e përkohshëm, mësimdhënësit studentë në praktikë dhe ndihmës mësimdhënësit si kolegë?
- t) A kërkohen dhe vlerësohen observimet e stafit të ri dhe studentëve në praktikë për shkollën për të marrë përshtypjet të reja dhe mundësitë për veprim që ata mund t'i ofrojnë?
- u) _____
- v) _____
- w) _____

B1.6 Shkolla përpiqet të pranojë të gjithë fëmijët nga lokaliteti i saj.

A2.6 Fëmijët vlerësohen në mënyrë të barabartë.

- a) A ekziston dëshira për të përfshirë të gjithë fëmijët nga lokaliteti të paraqitur si politikë e shkollës?
- b) A pasqyrohet natyra gjithëpërfshirëse dhe komunitare e shkollës në emrin e saj?
- c) A inkurajohen të vijnë shkollën të gjithë fëmijët nga lokaliteti pavarësisht arritjeve, aftësisë fizike ose prejardhjes?
- d) A janë të mirëpritur në mënyrë aktive në shkollë fëmijët e pjesëtarëve të komunitetit romë që vizitojnë zonën?
- e) A përpiqet shkolla të kapërcejë pengesat në pjesëmarrje për varietetin e grupeve etnike në lokalitet?
- f) A inkurajohen fëmijët e azilkërkuesve dhe refugjatëve të vijnë shkollën?
- g) A inkurajohen fëmijët e familjeve përkohësisht me banim në zonë t'i bashkohen shkollës?
- h) A inkurajohen familjet nga lokaliteti me fëmijët që aktualisht janë në shkolla speciale të dërgojnë këta fëmijë në shkollë?
- i) A avokon stafi për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara që ata ta vijnë mësimin në shkollën e tyre lokale?
- j) Në rastet kur një fëmijë që ka pasur vështirësi në një shkollë tjetër i bashkohet shkollës, a e shmang stafi sugjerimin se anëtarësimi në shkollë është i përkohshëm?
- k) A e zbaton shkolla detyrën e saj ligjore për të siguruar që fëmijëve në kujdesin publik t'ju jepet prioritet për të vijuar shkollën?
- l) A e bën të ditur shkolla interesin e saj për të mirëpritur 'fëmijët në kujdes' në shkollë?
- m) A është shkolla në përputhje me ligjin për regjistrimet në shkollë, që u kërkon atyre të mos bëjnë intervista ose të përdorin informacion nga bisedat me prindërit, vëllezërit e motrat apo komentet nga dikush që njihet me të pranuarin e ardhshëm?
- n) A e shmang shkolla kërkimin e donacioneve nga familjet para se një fëmijë të mund t'i bashkohet shkollës?
- o) Kur statusi i besimit të një shkolle krijon një balanc të etnive që nuk përfaqësojnë komunitetet përreth, a lidh shkolla marrëdhënie të forta dhe a punon me shkollat e tjera të zonës?
- p) Kur një shkollë ka një lidhje të veçantë me një besim të caktuar, a ka përparësi afërsia me shkollën për pranimin në shkollë ndaj lidhjes fetare të familjes së fëmijës?
- q) A i shmang shkolla me lojalitet ndaj një besimi të veçantë kufizimet në emërimin e stafit nga një grupi i caktuar i besimit?
- r) A e minimizon ndarjen fetare një shkollë me lidhje besimi, për shembull duke mos e favorizuar një degë të veçantë të Krishterimit apo të Islamit?
- s) A ka rritje në përqindjen e fëmijëve nga lokaliteti të përfshirë në shkollë?
- t) A ka rritje në diversitetin e fëmijëve nga lokaliteti të përfshirë në shkollë?
- u) _____
- v) _____
- w) _____

B1.7 Stafi i ri ndihmohet për t'u vendosur në shkollë.

A1.3 Fëmijët e ndihmojnë njëri-tjetrin; A1.4 Stafi dhe fëmijët e respektojnë njëri-tjetrin; A2.6 Fëmijët vlerësohen në mënyrë të barabartë; C2.5 Fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri.

- a) A ka mundësi që fëmijët të vizitojnë shkollën përpara se t'i bashkohen asaj?
- b) A ka një program të miratuar për t'i ndihmuar fëmijët të vendosen?
- c) A i përshëndesin stafi të gjithë fëmijët në mënyrë miqësore?
- d) A ka një politikë të vetme të njoftimit me shkollën për fëmijët sa herë që ata i bashkohen shkollës dhe pavarësisht nga vijnë?
- e) A funksionon mirë programi i njoftimit me shkollën për fëmijët dhe për familjet e tyre qoftë nëse ata bashkohen në fillim të vitit shkollor ose në ndonjë moment tjetër?
- f) A i adresojnë stafi dhe fëmijët vështirësitë e ndërtimit të një komuniteti kur ka një numër të madh të fëmijëve që largohen dhe hyjnë në shkollë çdo vit?
- g) A shoqërohen fëmijët e rinj me fëmijët më me përvojë kur hyjnë së pari në shkollë?
- h) A ndihmohen të gjithë fëmijët të ndihen si në shtëpi?
- i) A kuptohet se disa fëmijë mund ta kenë më të vështirë të ndihen si në shtëpi sesa të tjerët?
- j) A inkurajohen fëmijët të mendojnë se kontributet e tyre bëjnë diferencën nga momenti i parë që hyjnë në shkollë?
- k) A ka informacione në dispozicion të prindërve/kujdestarëve për sistemet arsimore kombëtare dhe lokale, si dhe për shkollën?
- l) A i merr parasysh programi i njoftimit me shkollën dallimet në arritje dhe gjuhën amtare?
- m) A përfshihen të rriturit dhe fëmijët, që njihen tashmë me fëmijët e rinj, në mirëpritjen e këtyre fëmijëve kur ata vijnë në shkollë për herë të parë?
- n) A ndërmerren hapa, pas disa javëve, për të parë se si ndihen fëmijët e rinj në shkollë?
- o) A ka mbështetje për fëmijët që kanë vështirësi për të mësuar përmendësh strukturën e ndërtesës, veçanërisht në fillim kur nisin vijimin e shkollës?
- p) A ka harta të përshtatshme për fëmijët në dispozicion të tyre?
- q) A e kanë të qartë fëmijët se kë duhet ta kërkojnë në rast se kanë vështirësi?
- r) A iu bëhet e ditur fëmijëve se puna dhe pikëpamjet e tyre janë të rëndësishme që nga dita e para kur vijnë në shkollë?
- s) A iu jepen mundësi fëmijëve për të kontribuar në përmirësime në politikën e 'vendosjes në shkollë'?
- t) A përpiqen të rriturit dhe fëmijët të mësojnë emrat e personave që sapo kanë nisur vijimin e shkollës?
- u) A njoftohen fëmijët me vlerat e shkollës dhe si njerëzit pritët ta trajtojnë njëri-tjetrin kur nisin vijimin e shkollës?
- v) A është e integruar përvoja e fillimit të vijimit të mësimin në një shkolle të re në aktivitetet në klasë?
- w) _____
- x) _____
- z) _____

B1.8 Grupet e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të organizuara drejt për të mbështetur nxënien e të gjithë fëmijëve.

A2.6 Fëmijët vlerësohen në mënyrë të barabartë.

- a) A trajtohen drejtë grupet mësimdhënëse në përdorimin e objekteve, lokacionit të klasave të mësimi, alokimit të stafit mësimdhënës dhe mbulimit të stafit?
- b) A e shmang shkolla alokimin e vazhdueshëm të hapësirave më pak cilësore, për shembull të klasave të përkohshme, për fëmijët që perceptohen se kanë status më të ulët në shkollë për shkak të moshës, arritjeve ose aftësisë së kufizuar?
- c) A është i vetëdijshëm stafi për mesazhet në lidhje me identitetin dhe vetëvlerësimin që jep shfrytëzimi jo të barabartë i hapësirave në shkollë?
- d) A krijon stafi mundësi për fëmijët që të mësojnë dhe ta mësojnë njëri-tjetrit në grupe diverse?
- e) Në planifikimin e grupeve të të nxëniet, a i kushtohet vëmendje dëshirave të fëmijëve, miqësisë dhe pranisë së të tjerëve që flasin të njëjtat gjuhë?
- f) A është minimizuar organizimi i grupeve të mësimdhënies sipas niveleve të arritjes apo aftësisë së kufizuar?
- g) A e shmangin shkollat cilësimin e stafit jo mësimdhënës përgjegjës për përparimin e fëmijëve me arritjet më të ulëta ose që përjetojnë pengesat më të mëdha në të nxëniet dhe pjesëmarrje?
- h) A e shmangin shkollat identifikimin dhe grupimin e një numri joproportional të djemve si grup me arritje të ulëta ose si grup që kërkon një kurrikulë alternative?
- i) A e shmang stafi grupimin e fëmijëve në bazë të sjelljes së tyre sfiduese kur kjo kufizon mundësinë e fëmijëve për ta mbështetur njëri-tjetrin?
- j) Kur ndodh ndarja në nivele, a ka plane për të parandaluar efektet negative, si pakënaqësia në nivele më të ulëta?
- k) Kur ndodh ndarja në nivele, a kanë të gjithë fëmijët mundësi për të lëvizur mes niveleve?
- l) A e shmangin shkollat kufizimin e kurrikulës (si lënia jashtë e gjuhës së huaj) për fëmijët të cilëve u jepet mbështetje shtesë për shkrim-lexim ose janë në një nivel më të ulët për gjuhën angleze?
- m) A ndryshohet organizimi i ulëseve brenda klasave sipas nevojës për të dekurajuar krijimin e konfliktit ndërmjet grupeve, për shembull në lidhje me gjininë apo përkatësinë etnike?
- n) A ndryshohet organizimi i ulëseve brenda klasave sipas nevojës në mënyrë që fëmijët të mos e dekurajojnë të nxëniet e njëri-tjetrit?
- o) A janë shkollat të ndërgjegjshme për detyrimin e tyre për të edukuar së bashku fëmijët që kanë dhe nuk kanë vështirësi në të nxëniet?
- p) Kur ka mosbalancim të vajzave dhe djemve në një grup, a e kuptojnë fëmijët rëndësinë e respektit të ndërsjellë dhe nevojën për ta inkurajuar kontributin e secilit?
- q) Kur ka mosbalancim të theksuar të vajzave dhe djemve në regjistrimet e një viti të caktuar shkollor, a e konsiderojnë shkollat krijimin e disa klasave me fëmijë të gjinisë së njëjtë?
- r) Kur ka opsione për zgjedhje, a lejohen të gjithë fëmijët të bëjnë zgjedhje reale?
- s) _____
- t) _____
- u) _____

B1.9 Fëmijët janë të përgatitur mirë për të kaluar në shkollën tjetër.

C1.12 Fëmijët mësojnë për punën dhe e lidhin atë me zhvillimin e interesave të tyre.

- a) A e respekton stafi kontributin në të nxënit e fëmijëve të atyre që kanë punuar me fëmijët në vitet e mëparshme në të njëjtën ose në një shkollë tjetër?
- b) A bashkëpunon stafi në shqyrtimin e dosjes së transferimit, në mënyrë që të vlerësohet dhe përdoret nga mësimdhënësit pranues?
- c) A e shfrytëzon stafi mundësinë e përfshirjes së tyre në transferime për ta parë arsimin nga një këndvështrim tjetër?
- d) A e kupton stafi se fëmijët mund të kenë nevojë për ndihmë për t'u ri-angazhuar me kënaqësitë e të mësuarit pas provimeve në fund të shkollës fillore ose pas GCSE-ve?
- e) A ka broshura të qasshme të shkruara qartë, pa përdorimin e zhargonit, dhe faqe interneti për shkollat, me kontributet nga fëmijët?
- f) A njoftohen fëmijët me rutinat e shkollës së re para transferimit?
- g) A pajisen prindërit me informacion të saktë për shkollat e mundshme?
- h) A shërbejnë transferimet e fëmijëve mes shkollave për ta plotësuar kurrikulën e shkollave pranuese dhe dërguese, si krijimi i turneve virtuale, hartave, planifikuesve javorë dhe dramave krijuese për lëvizjen e njerëzve ndërmjet vendeve?
- i) A ka dialog në mes stafit dhe fëmijëve nga shkollat pranuese dhe dërguese për shkallën e vlerave të përbashkëta që këto shkolla ndajnë?
- j) A punon stafi për lidhjen e aktiviteteve para transferimit?
- k) A munden aktivitetet kurrikulare të filluara në një shkollë, si gjuhët e huaja moderne, të vazhdojnë përmes aktiviteteve jashtë-kurrikulare nëse është e nevojshme?
- l) A organizojnë shkollat ditë aktivitetsh para transferimit në mënyrë që fëmijët të mund ta takojnë stafin dhe fëmijët nga shkolla pranuese?
- m) A kthehen fëmijët e larguar nga një shkollë tjetër për t'i këshilluar fëmijët që do të transferohen?
- n) A ka shqetësime në lidhje me miqësitë dhe ngacmimin të reduktuar nga stafi dhe fëmijët nga shkolla pranuese?
- o) A i inkurajojnë shkollat marrëdhëniet ashtu që fëmijët të mos ndihen të cenueshëm duke qenë më të rinjtë apo më të vegjlit në një shkollë?
- p) A inkorporojnë vitet e hershme të shkollave të mesme elemente të shkollave fillore duke reduktuar lëvizjen e fëmijëve dhe stafit?
- q) A ka koordinim të mbështetjes për fëmijët që lëvizin midis shkollave?
- r) A i kushtohet kujdes transferimit të informacionit konfidencial?
- s) A mbështeten prindërit e fëmijëve që kanë deklarata të 'nevojave të veçanta arsimore' për të gjetur një shkollë mirëpritëse lokale të rregullt kur ata largohen nga shkolla?
- t) A kuptohet se fëmijët që kanë pasur shumë lëvizje mund ta kenë më të vështirë të lëvizin në një situatë të re?
- u) A i vazhdojnë fëmijët interesat dhe aktivitetet nëpër shkolla dhe kur ata largohen nga shkolla?
- v) A inkurajohen fëmijët të shqyrtojnë një sërë trajektoresh në vazhdimin e arsimit dhe punësimit?
- w) A ndihmohen fëmijët të jenë të pavarur kur ta kryejnë shkollën duke mësuar rreth buxhetimit, gatimit, pastrimit, shëndetit, marrëdhënieve, larjes së rrobave, kohës së lirë dhe punës?

B1.10 Shkolla është bërë fizikisht e qasshme për të gjithë.

A1.1 Të gjithë janë të mirëpritur; B1.6 Shkolla përpiqet të pranojë të gjithë fëmijët nga lokaliteti i saj; B1.11 Ndërtesa dhe terrenet e saj janë të zhvilluara për ta mbështetur pjesëmarrjen e të gjithëve.

- a) A ka plan të qasjes për të rritur lehtësimin e qasjes fizike në shkollë?
- b) A i kushton shkolla vëmendje kërkesave të legjislacionit për të bërë përparim çdo vit në qasjen e shkollës?
- c) A është pjesa e qasjes për persona me aftësi të kufizuara pjesë e planit të përmirësimit të ndërtesës, i cili është i integruar në planin zhvillimor të shkollës?
- d) A është plani i qasjes pjesë e përpjekjeve të përbashkëta për të siguruar që stafi dhe fëmijët me aftësi të kufizuara të dëshirojnë të vijnë në shkollë?
- e) A është plani i qasjes pjesë e përpjekjeve të përbashkëta për t'i mbështetur personat me aftësi të kufizuara për të shijuar vizitën dhe shfrytëzimin e objekteve të shkollës?
- f) A shqyrtohen nevojat e secilit për t'i bërë ndërtesat të qasshme, si personat e shurdhër dhe me dëgjim pjesërisht të dëmtuar, të verbër dhe me të parë pjesërisht të dëmtuar, prindërit me fëmijë të vegjël (duke përfshirë karrocet dyshe), të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara fizike?
- g) A konsultohen personat me aftësi të kufizuara të moshave të ndryshme, duke përfshirë ata brenda familjeve të fëmijëve dhe komuniteteve lokale, për qasjen në shkollë?
- h) A e kupton shkolla se personat me aftësi të kufizuara të ngjashme, duke përfshirë stafin dhe fëmijët në shkollë, mund të kenë pikëpamje të ndryshme për mënyrën se si mjedisi mund të bëhet i qasshëm për ta?
- i) A auditohet çdo vit qasja për personat me aftësi të kufizuara për të bërë përmirësime në planin e përmirësimit të ndërtesës?
- j) A janë pajisjet të adaptueshme ashtu që të mund të përdoren lehtë dhe në mënyrë të sigurtë nga personat e ndryshëm e gjatësi të ndryshme dhe ata në karrige me rrota?
- k) A janë bërë të qasshme të gjitha aspektet e shkollës, duke përfshirë hyrjet dhe daljet, klasat, korridoret, tualetet, kopshtet, sheshet e lojërave, kantinat, shenjat e afishet?
- l) A ka rrugica rreth shkollës që janë lehtësisht të kalueshme për personat me aftësi të kufizuara, për shembull përmes ndriçimit, skemave me ngjyrë dhe shiritave në tokë?
- m) A i kushtohet vëmendje e veçantë ruajtjes së dinjitetit të fëmijëve dhe të rriturve në objektet e qasshme?
- n) A i kushtohet vëmendje e veçantë natyrës së alarmeve, sigurisë dhe procedurave të evakuimit?
- o) A është e dizajnuar shkolla në mënyrë që përdorimi i hapësirave të jetë po aq i rehatshëm për njerëzit me aftësi të kufizuara sa edhe për ata pa aftësi të kufizuara?
- p) A merr parasysh qasja personelin me aftësi të kufizuara, administratorët, prindërit/kujdestarët, vizitorët në shkollë, pjesëtarët e tjerë të komunitetit, si dhe fëmijët?
- q) A janë projektet për përmirësimin e qasjes së ndërtesave shkollore, objekteve dhe terrenit, të integruara në kurrikulën e shkollës?
- r) _____
- s) _____
- t) _____

B1.11 Ndërtesat dhe terreni janë zhvilluar për të mbështetur pjesëmarrjen e të gjithëve.

A1.10 Shkolla kontribuon në shëndetin e fëmijëve dhe të rriturve;
 A2.4 Gjithëpërfshirja shihet si pjesëmarrje në rritje për të gjithë;
 B1.10 Shkolla është bërë fizikisht e qasshme për të gjithë.

- a) A është plani i zhvillimit të ndërtesës i dizajnuar për të rritur pjesëmarrjen e të rriturve dhe fëmijëve në shkollë?
- b) A i pasqyron plani i zhvillimit të ndërtesës kontributet nga stafi, fëmijët dhe prindërit/kujdestarët?
- c) A ka përpjekje që të gjitha pjesët e shkollës të duken tërheqëse për të rriturit dhe fëmijët, për shembull, përmes projekteve të artit dhe mbjelljes së luleve dhe gjelbërimit?
- d) A kanë stafi dhe administratorët e shkollës një plan afatgjatë që pasqyron shqetësimet mjedisore dhe financiare?
- e) A e respektojnë hapësirat në shkollë dhe terreni i saj gamën e interesave të fëmijëve, e jo favorizimin e grupeve?
- f) A e ndajnë fëmijët përgjegjësinë për të siguruar se bimët lulëzojnë në ndërtesat dhe rrethinën e shkollës?
- g) A inkurajohen të rriturit dhe fëmijët të shkojnë në vizita për të mësuar si t'i përmirësojnë sallat e stafit, klasat dhe terrenin e shkollës?
- h) A inkurajohen të rriturit dhe fëmijët të japin sugjerime për mënyrën se si ndërtesat dhe terreni i shkollës mund të përmirësohet?
- i) A i inkurajon shkolla ekspozitat dhe shfaqjet nga fëmijët dhe të rriturit dhe nga komunitetet e saj duke përfshirë shkollat dhe kolegjet e tjera?
- j) A ka pajisje në sheshin e lojërave për një sërë aktiviteteve më shprehëse dhe aktive siç është muzika?
- k) A është salla e stafit një hapësirë mikpritëse për tërë stafin?
- l) A mendon stafi se ata të gjithë kanë kushte të mira pune?
- m) A përfshijnë planet e ndërtesës një hapësirë ku mund të takohen prindërit/kujdestarët?
- n) A ka kopsht të shkollës me një shumëllojshmëri bimësh të kultivuara për ushqyerje dhe për bukurinë e tyre?
- o) A e ka shkolla pjesën e saj të tokës apo e ka të përbashkët nëse nuk ka tokë të mjaftueshme për të kultivuar ushqimin?
- p) A ka terreni i shkollës shumëllojshmëri zonash për ta nxitur një diversitet bimësh të egra, kafshësh dhe insektesh?
- q) A janë shkollat dhe klasat e mbushura me afishe, bimë dhe objekte që nxisin kuriozitetin, diskutimet dhe të nxënëit?
- r) A mund të ngrenë njerëzit shqetësime për përdorimin e hapësirës dhe a janë zgjidhur drejt shqetësimet e tyre?
- s) A është bërë shkolla e sigurt duke ruajtur në të njëjtën kohë atraktivitetin e saj?
- t) A janë ndërtesat dhe terreni në dispozicion për përdorim nga komuniteti?
- u) A ka ndonjë plan për ta mbështetur rritjen e sigurisë së shkollës përmes pronësisë së komunitetit?
- v) _____
- w) _____

B1.12 Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit.

B1.13 Shkolla kontribuon në reduktimin e mbeturinave; C1.2 Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit; C1.7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin; C1.8 Fëmijët e studiojnë jetën në tokë; C1.9 Fëmijët hetojnë rreth burimeve të energjisë.

- a) A kuptohet emetimi i dioksidit të karbonit nga ana e shkollës si masa e emetimeve të saj vjetore të gazrave serrë?
- b) A e kupton stafi se reduktimi i aktiviteteve që përfshijnë emetimet e gazrave serrë është më i rëndësishëm se matja e saktë e emetimit të dioksidit të karbonit?
- c) A përgatisin të rriturit dhe fëmijët tregues të suksesit në reduktimin e emetimit të gazrave serrë në shkollë, në jetën e tyre jashtë shkollës, duke ndikuar tek pjestarët e tjerë të komunitetit?
- d) A ka koordinatorë të rritur dhe fëmijë për uljen e emetimit të dioksidit të karbonit të shkollës?
- e) A planifikon stafi dhe fëmijët ta reduktojnë emetimin e tyre të dioksidit të karbonit në shkollë dhe në shtëpi duke kontrolluar përdorimin e lëndëve djegëse dhe energjisë jo të ripërtëritshme në ndërtesa, ruajtjen e energjisë, udhëtimin e nxënësve dhe të stafit, menaxhimin e mbeturinave dhe konsumin e mallrave dhe shërbimeve?
- f) A mendohet se mënyra kryesore për reduktimin e shfrytëzimit të energjisë është përmes reduktimit të prodhimit dhe konsumit të mallrave?
- g) A krijon lidhje shkolla me ekspertët lokalë të eficiencës së energjisë?
- h) A e prodhon shkolla energjinë elektrike dhe/ose ngrohjen e saj përmes turbinave të erës, paneleve diellore apo pompave të nxehtësisë?
- i) A ka shkolla furnizues që shpërndan energjinë elektrike nga burimet e ripërtëritshme?
- j) A reduktohet konsumi i lëndëve djegëse përmes zgjedhjes së bojlerit të ngrohjes dhe pajisjeve të tjera, tubave të izoluar, izolimit të nënçatisë dhe mureve, glazurave të dyfishta dhe ndërtimit të kulmit të gjelbër?
- k) A i përmbush ndonjë ndërtesë e re standardet më të larta për ruajtjen e energjisë?
- l) A i përgjigjet sistemi i ngrohjes ndryshimeve në temperaturë dhe rregullohet më ulët teksa njerëzit mësohen të veshin rroba shtesë?
- m) A përdor shkolla burime të ulëta energjie të ndriçimit dhe a instalon sensorë kur ndriçimi kërkohet rregullisht por jo vazhdimisht?
- n) A lobon shkolla që prodhuesit e gazit dhe energjisë ta kufizojnë prodhimin e energjisë?
- o) A monitorohen kërkesat për përdorimin e burimeve për teknologjinë kompjuterike dhe informatike dhe a minimizohen duke u shkyçur kur nuk përdoren?
- p) A reduktohen udhëtimet me vetura duke i përdorur bashkërisht veturat, duke përdorur transportin publik ngasjen e sigurt të biçikletave dhe ecjen?
- q) A ka shkolla dushe të përshtatshme për ta inkurajuar çiklizmin në shkollë?
- r) A insiston shkolla në kriteret për blerje që përfshijnë blerjen e ushqimeve sezonale të prodhuara në vend dhe duke e reduktuar rrugën për ushqimin dhe produktet?
- s) A e hetojnë fëmijët varësinë e ushqimeve organike dhe joorganike nga lëndët djegëse fosile?
- t) A është shkolla pjesë e një rrjeti lokal që përdorë fuqinë e saj blerëse të përbashkët?
- u) A e monitoron shkolla përdorimin e saj të ujit dhe a planifikon reduktimin e shfrytëzimit të tij për person?
- v) A e mbledh shkolla ujin e shiut për ta shfrytëzuar në kopshtin e shkollës?
- w) A instalon shkolla sistem për pastrimin e ujërave të përdorur për larje në mënyrë që ai të rishfrytëzohet në tualete dhe kopshtin e shkollës?
- x) A reduktohet shfrytëzimi i ujit në cisterna dhe tualete, duke kontrolluar dhe raportuar rrjedhjet dhe duke instaluar rubineta që mbyllen automatikisht?
- y) _____

B1.13 Shkolla kontribuon në reduktimin e mbeturinave.

B1.12 Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit; C1.1 Fëmijët eksplorojnë ciklet e prodhimit dhe konsumin e ushqimit; C1.2 Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit; C1.7 Fëmijët hetojnë për rëndësinë e Tokës, sistemit diellor dhe universit; C1.8 Fëmijët studiojnë jetën në tokë.

- a) A inkurajohen të rriturit dhe fëmijët për të reduktuar prodhimin e mbeturinave brenda dhe jashtë shkollës përmes riparimit, rishfytëzimit, kompostimit dhe riciklimit?
- b) A e inkurajon shkolla konsumin më të pakët si mënyra më e mirë për t'i reduktuar mbeturinat?
- c) A e hulumtojnë fëmijët se cilat nga mbeturinat ishin të bidegradueshme, të riciklueshme apo asnjëra nga to?
- d) A e thekson politika për reduktimin e mbeturinave reduktimin e mbeturinave që barten në deponi?
- e) A ka koordinatorë midis të rriturve dhe fëmijëve për auditimin e përbërjes së mbeturinave dhe mbledhjen, klasifikimin, reduktimin dhe riciklimin e mbeturinave?
- f) A e mësojnë fëmijët se çfarë ndodh me mbeturinat nëse riciklohen dhe nëse nuk ricikohen?
- g) A e shqyrton shkolla mundësinë e përfshirjes në një klub veprimi lokal për mbeturina të shkollës (SWAC)?
- h) A mësojnë fëmijët për fushatat për reduktimin e mbeturinave?
- i) A mësojnë fëmijët për reduktimin e mbeturinave përmes lidhjeve me shkollat e tjera?
- j) A e hulumtojnë fëmijët se çfarë riciklohet në vende të ndryshme të botës?
- k) A i blen shkolla produktet në enë mbajtëse të kthyeshme?
- l) A e maksimizon shkolla blerjen e artikujve të prodhuar nga burimet e riciklueshme duke përfshirë mobilet e renovuara?
- m) A e inkurajon shkolla blerjen dhe shfrytëzimin e ushqimit që ka paketimin minimal?
- n) A mbështeten fëmijët dhe familjet e tyre për të përgatitur dreka të paketuara që nuk krijojnë shumë mbeturina?
- o) A e inkurajon shkolla përdorimin e pjatave dhe enëve të rishfrytëzueshme të kuzhinës?
- p) A reduktohen mbetjet ushqimore duke negociuar me fëmijët dhe familjet për shujtat ose madhësinë e porcioneve?
- q) A ka pika grumbulluese të qasshme për ushqimin dhe mbetjet e tjera në pozita strategjike rreth shkollës?
- r) A shërben shkolla si pikë ricikluese për letër, karton, libra, veshje, qelq, plastikë (duke përfshirë ato që nuk merren në skemat e riciklimit në shtëpi), pajisje elektrike, ngjyrat e printerit, poqët elektrike, celularët, bateritë dhe CD-të/DVD-të?
- s) A e ka shkolla skemën e saj të këmbimit dhe a e inkurajon përdorimin e skemave të tjera si 'freecycle (dhënie e mallrave ose materialeve të përdorura falas personave që iu nevojiten)' dhe dhënie të artikujve për bamirësi?
- t) A bashkëpunon shkolla me familjet dhe grupet komunitare për ta mësuar riparimin, rinovimin, qepjen, arnimin dhe ndryshimin e veshjeve, brenda kurrikulës dhe në klube?
- u) A reduktohet përdorimi i letrës duke e printuar në të dy anët dhe etiketat për zarfe dhe dosje?
- v) A ka ekrane të qasshme ku dokumentet mund të lexohen lehtësisht online, edhe për prindërit dhe fëmijët për të mësuar se çfarë po ndodh në shkollë, duke iu ndihmuar nëse është e nevojshme?
- w) A përdoret emaili kur është e mundur për të komunikuar me prindërit/kujdestarët?
- x) A inkurajohet ripërdorimi i fishekëve të ngjyrës së printerit?
- y) A ka burime lehtësisht të qasshme dhe të pastra të ujit të pijshëm?
- z) A e dekurajon shkolla blerjen e ujit të prodhuar në shishe duke e inkurajuar mbushjen e shisheve nga çezma?
- aa) _____

B2.1 Të gjitha format e mbështetjes janë të koordinuara.

C2.5 Fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri; C2.9 Stafi planifikojnë, japin mësim dhe rishikojnë së bashku.; C2.10 Stafi zhvillon burime të ndara për ta mbështetur të nxënëit.

- a) A kuptohet mbështetja si aktivitetet që rrisin kapacitetin e shkollës për t'iu përgjigjur diversitetit të fëmijëve në mënyra që i vlerësojnë të gjithë në mënyrë të barabartë?
- b) A janë të koordinuara dhe adaptuara të gjitha format e mbështetjes në mënyrë që ato të kontribuojnë në zhvillimin gjithëpërfshirës të shkollës?
- c) A kuptohet se mbështetja përfshin mobilizimin e burimeve nga brenda dhe jashtë shkollës?
- d) A kuptohet se mbështetja jepet përmes zhvillimit të aktiviteteve mësimore gjithëpërfshirëse dhe kulturave bashkëpunuese në shkollë dhe klasë?
- e) A kuptohet se zhvillimi i kulturës bashkëpunuese dhe përgjegjshmëria ndaj diversitetit të aktiviteteve mësimore mund të nënkuptojë reduktim të nevojës për mbështetje individuale?
- f) A i jepet prioritet zhvillimit të mbështetjes ndërmjet bashkëmoshatarëve që ven nga kultura bashkëpunuese e shkollës ndaj ofrimit të mbështetjes së të rriturve për individët?
- g) A e minimizon shkolla nevojën për mbështetje individuale nga një i rritur për ta mbështetur të nxënëit e fëmijëve?
- h) A kuptohet mbështetja si diçka që përshin heqjen e pengesave për lojë, të nxënëit dhe pjesëmarrje?
- i) A shihet mbështetja si zhvillim i kurrikulës që përfshin interesat e fëmijëve dhe mbështetet në përvojën e tyre?
- j) A është e integruar mbështetja nga shërbimet e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimet sociale për fëmijët dhe familjet?
- k) A janë të koordinuara të gjitha aktivitetet mbështetëse në një politikë mbështetëse të vetme?
- l) A negociohet dhe dakordohet me prindërit politika e mbështetjes?
- m) A është bërë e qartë politika e mbështetjes për ata jashtë shkollës, të cilët e mbështesin të nxënëit dhe pjesëmarrjen brenda saj?
- n) A udhëhiqet koordinimi i mbështetjes nga një anëtar i lartë i stafit?
- o) A është i vetëdijshëm stafi për të gjitha burimet njerëzore të të rriturit dhe fëmijët që mund të mobilizohen për ta mbështetur zhvillimin e të nxënëit dhe pjesëmarrjes?
- p) A shfrytëzohen të rriturit mentorë dhe vullnetarë, duke përfshirë përdoruesit e gjuhës amtare dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, si burime për shkollën?
- q) A i redukton shkolla pengesat në komunikim në mes profesionistëve me prejardhje të ndryshme?
- r) A ngre stafi shqetësimet e tyre nëse mendojnë se veprimet e të tjerëve udhëhiqen më shumë nga ruajtja e territoreve profesionale sesa nga veprimi për të bërë atë që është më e mira për fëmijët?
- s) A kërkohet nga mbështetësit jashtë shkollës që të koordinojnë përpjekjet e tyre me ndërhyrjet e tjera të mbivendosura në mënyrë që ato të integrohen në shkollë?
- t) _____
- u) _____
- v) _____

B2.2 Aktivitetet e zhvillimit profesional e ndihmojnë stafin t'i përgjigjet diversitetit.

C2.9 Stafi planifikojnë, japin mësim dhe rishikojnë së bashku.; C2.10 Stafi zhvillon burime të përbashkëta për ta mbështetur të nxënit.

- a) A e ndihmojnë aktivitetet për zhvillim profesional stafin që të punojë me grupe diverse?
- b) A e zhvillon stafi praktikën e tyre në njohjen dhe luftimin e diskriminimit dhe ngacmimit, duke përfshirë klasizmin, diskriminimin sipas moshës, aftësisë së kufizuar, racizmin, seksizmin, homofobinë, transfobinë dhe diskriminimin në lidhje me religjionin dhe besimin?
- c) A e eksplorojnë stafi shkallën e besimeve dhe veprimeve të tyre diskriminuese?
- d) A e adresojnë gjithmonë aktivitetet e zhvillimit të kurrikulës pjesëmarrjen dhe të nxënit e fëmijëve që dallojnë për nga prejardhja, përvoja, gjinia, arritjet dhe aftësia e kufizuar?
- e) A janë të përfshirë stafi dhe administratorët në planifikim e zhvillimit të tyre profesional?
- f) A e adresojnë aktivitetet e zhvillimit të kurrikulës reduktimin e pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje?
- g) A e zhvillon stafi shfrytëzimin e hapësirave të jashtme për ta bazuar mësimin nga përvojat e përbashkëta të fëmijëve?
- h) A zhvillon stafi mënyra për ta bazuar të nxënit nga objektet dhe artefaktet me rëndësi dhe interes për fëmijët?
- i) A përfshihet në aktivitetet e zhvillimit profesional lidhja e vlerave me veprime për të zhvilluar të nxënit dhe pjesëmarrjen?
- j) A ndihmojnë aktivitetet e zhvillimit profesional në shfrytëzimin e plotë të mundësive për të mësuar jashtë klasës?
- k) A ndihmon zhvillimi profesional në inicimin e mësimave nga përvojat e përbashkëta të fëmijëve?
- l) A e zhvillon stafi ekspertizën e tyre në krijimin e klasave mësimore bashkëpunuese ku aktivitetet përfshijnë punë individuale dhe grupe?
- m) A mësojnë së bashku mësimdhënësit dhe ndihmës mësimdhënësit me qëllim që të rritet bashkëpunimi i tyre?
- n) A i ndajnë së bashku mësimdhënësit dhe ndihmës mësimdhënësit mundësitë për mënyrën e uljes së pakënaqësive dhe përçarjes së fëmijëve?
- o) A ka mundësi për stafin dhe fëmijët që të mësojnë për tutorimin nga bashkëmoshatarët?
- p) A planifikon stafi se si të luftojë mbipërfaqësimin e grupeve të fëmijëve që shihet se përjetojnë pengesa në të nxënit dhe pjesëmarrje, për shembull, sipas gjinisë, etnisë ose klasës?
- q) A ka mundësi që stafi dhe fëmijët të mësojnë për ndërmjetësimin në konflikte dhe mosmarrëveshje nga bashkëmoshatarët?
- r) A e mbështetin stafi mësimdhënës dhe mbështetës rritjen e njohurive të tyre për përdorimin e teknologjisë për punë me grupe diverse, si tabelat e bardha, kamerat, televizori, DVD-të, projektorët, pajisjet për incizim të zërit dhe kompjuterët/interneti?
- s) A mëson stafi si t'i ndihmojnë fëmijët për zhvillimin e rrjeteve sociale që mund t'i mbështetin ata brenda dhe jashtë shkollës, duke përfshirë Rrathët e Miqve?
- t) A mban stafi orë leximi dhe seminare joformale ku mund të mësojnë së bashku dhe të ndajnë përvojat e tyre?
- u) _____

B2.3 Gjuha angleze si mbështetje shtesë gjuhësore është burim për tërë shkollën.

A1.3 Fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrit; B2.1 Të gjitha format e mbështetjes janë të koordinuara; C2.5 Fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri; C2.6 Mësimet mundësojnë kuptimin e ngjashmërive dhe dallimeve mes njerëzve.

- a) A e ndajnë të rriturit dhe fëmijët përgjegjësinë për t'i ndihmuar fëmijët që mësojnë gjuhën angleze si gjuhë tjetër për ta mësuar gjuhën e tyre të re?
- b) A informohet stafi për burimet e të nxënimit brenda komuniteteve të atyre që sapo kanë mbërritur në vend, si në institucionet fetare dhe kulturore?
- c) A ofron shkolla, apo a ka lidhje me, orë mësimore të gjuhës dhe literaturës angleze për prindërit/kujdestarët dhe të afërmit më të moshuar, në mjedise që janë atraktive si vende për të mësuar të rriturit, pavarësisht prejardhjes dhe gjinisë së tyre?
- d) A i vlerëson shkolla shkathtësitë shumëgjuhësore të atyre që e mësojnë gjuhën angleze si gjuhë tjetër?
- e) A kanë interes të rriturit dhe fëmijët për gjuhët që fliten nga të tjerët dhe a bëjnë përpjekje për të mësuar disa fjalë nga këto gjuhë?
- f) A janë të integruara gjuhët amtare të fëmijëve në aktivitetet dhe detyrat e klasës?
- g) A sigurojnë shkollat që fëmijët të kenë mundësi të reflektojnë për shkathtësitë e tyre gjuhësore në opsionet e tyre të provimit publik?
- h) A i vlerëson shkolla aspektet e tilla kulturore si ushqimi, muzika dhe këngët që fëmijët dhe familjet e tyre i sjellin me vete nga një vend tjetër?
- i) A i adreson mbështetja pengesat në mësim në të gjitha aspektet e mësimdhënies, kurrikulë dhe organizim të shkollës për ata që mësojnë gjuhën angleze si gjuhë tjetër?
- j) A përdoren modifikimet në gjuhën e klasës dhe aktivitete mësimore të cilat rrisin përfshirjen e fëmijëve që e mësojnë gjuhën angleze si gjuhë tjetër për të reduktuar më gjerësisht pengesat në të nxënimit dhe pjesëmarrje?
- k) A fokusohet mbështetja në identifikimin dhe tejkalimin e pengesave në të nxënimit dhe pjesëmarrje të fëmijëve në vend të diferencimit në mes 'vështirësive në mësimin e një gjuhe tjetër' dhe 'vështirësive në të nxënimit'?
- l) A ka përkthyes të gjuhës së shenjave dhe gjuhëve të tjera amtare për t'i mbështetur ata që kanë nevojë për ta?
- m) A njihet efekti i lëvizjes së vendit dhe kulturës si pengesë e mundshme në të nxënimit dhe pjesëmarrje?
- n) A njihet trauma e përvojës së të rinjve që kërkojnë azil si faktor që kontribuon në vështirësitë që ata mund të kenë në shkollë?
- o) A i ndihmon stafi fëmijët që të kuptojnë se interesimi për të komunikuar dhe dëgjuar të tjerët mund të ndihmojë në tejkalimin e pengesave në komunikim me fëmijët që flasin gjuhë të ndryshme dhe kanë kulturë të ndryshme?
- p) A ofrohet mësimdhënie dhe mbështetje, kur është e mundur, nga dikush që ka të njëjtën prejardhje me fëmijët?
- q) _____
- r) _____
- s) _____

B2.4 Shkolla mbështet vazhdimësinë në arsimimin e fëmijëve në kujdesin publik.

A2.1 Shkolla zhvillon vlera të përbashkëta gjithëpërfshirëse; A2.7 Shkolla i lufton të gjitha format e diskriminimit; B2.8 Pengesat për vijimin e shkollës janë zvogëluar.

- a) A janë të kujdesshëm stafi për ndërhyrjen pa ftesë në jetën e fëmijëve të cenueshëm?
- b) A janë stafi të informuar për rezultatet e ulëta të vendit të tyre në ofrimin e ndihmës për fëmijët në kujdesin publik për të shmangur të ardhmen e trazuar si të rritur?
- c) A përpiqet stafi të shmangë një trajektore negative të të nxëniet dhe punësimit për fëmijët dhe të rinjtë në kujdesin publik?
- d) A e shmang shkolla stereotipizimin e fëmijëve në kujdesin publik si gjithmonë sfidues?
- e) A i ndihmon stafi fëmijët e cenueshëm që të kontribuojnë më shumë në vendime për arsimin e tyre dhe jetën e tyre?
- f) A e shmang shkolla fajësimin e fëmijëve në kujdes publik dhe fëmijëve të tjerë të cenueshëm për sjellje diskriminuese ndaj tyre?
- g) A siguron shkolla të ketë persona kyç që shërbejnë si lidhje për fëmijët që kanë nevojë për vazhdimësi të kontakteve gjatë kohës së tyre në shkollë dhe pas largimit nga shkolla?
- h) A sigurojnë personat kyç të stafit për fëmijët në kujdesin publik se ata i tejkalojnë barrierat për marrëdhënie të mira kur punojnë me këta fëmijë me kolegët që kanë përgatitje profesionale të ndryshme?
- i) A dakordohen të gjithë ata që punojnë me fëmijët në kujdesin publik për përfitimet e arritjeve arsimore për fëmijët?
- j) A merr përgjegjësi stafi për të ndihmuar fëmijët e cenueshëm që ata të ndihen mirë me veten?
- k) A reflekton stafi për pasojat e refuzimit të fëmijëve të cenueshëm, duke përfshirë fëmijët që janë në kujdesin publik, ose nënshtrimin e tyre ndaj përjashtimit disiplinor?
- l) A i kushtohet vëmendje e veçantë kapërcimit të pengesave në përfshirjen në aktivitetet jashtëshkollore?
- m) A bëhen përpjekje të veçanta për të ndërtuar lidhje të forta me prindërit/kujdestarët?
- n) A e inkurajon mbështetja për fëmijët në kujdesin publik vazhdimësinë e mësimit dhe minimizimin e ndryshimeve në shkollë?
- o) A ka mbështetje për të ndihmuar ata që kanë humbur mësimin për ta zënë hapin pa e ndërprerë ndërtimin e miqësisë?
- p) A ofron shkolla hapësirë në fund të ditës shkollore ku fëmijët që kanë nevojë mund të kryejnë punë shkollore?
- q) A ofron shkolla hapësirë të qetë kur fëmijët që kanë nevojë mund të tërhiqen në kohën e lojës dhe para dhe pas shkollës?
- r) A janë të ndërgjegjshme shkollat e mesme dhe kolegjet për mbështetjen e kufizuar që të rinjtë në kujdesin publik mund të kenë pasi të kenë mbushur tetëmbëdhjetë vjeç nëse nuk ndihmojnë për të siguruar që kjo mbështetje të vazhdojë?
- s) _____
- t) _____
- u) _____

B2.5 Shkolla siguron që politikat për 'nevojat e veçanta arsimore' mbështesin gjithëpërfshirjen.

A2.4 Gjithëpërfshirja shihet si pjesëmarrje në rritje për të gjithë.

- a) Kur stafi flet për një 'fëmijë me nevoja të veçanta arsimore' a e përdorin atë për të nënkuptuar 'një fëmijë me nevoja të paplotësuara', duke nënkuptuar mungesën e mjedisit e jo mangësitë tek një fëmijë?
- b) A reflekton stafi për përvojat e tyre të të mësuarit për të kuptuar kur dhe pse fëmijët kanë vështirësi në të nxënit?
- c) A janë të kujdesshëm stafi që të shmangin cilësimin e disa nxënësve normalë dhe nënkuptimin se të tjerët me 'nevoja të veçanta arsimore' janë më pak se normalë?
- d) A e konsideron stafi zëvendësimin e nocionit të një fëmije 'që ka nevoja të veçanta arsimore' me një fëmijë 'që ka pengesa në të nxënit dhe pjesëmarrje'?
- e) A kuptohet se përdorimi i termave të tillë për aftësi të kufizuara si 'aftësi të kufizuara fizike', 'i verbër' dhe 'i shurdhër' janë në pajtim me shmangien e termit më të gjerë 'nevoja të veçanta arsimore'?
- f) A i reziston stafi tendencës në rritje të etiketimit të fëmijëve si 'autik', 'që kanë sindromën e Asperger-it', 'kanë çrregullime të mungesës së koncentrimit', dhe termave të tjerë të ngjashëm?
- g) A e vë në pyetje stafi shkallën e përdorimit të ilaçeve për ta kontrolluar sjelljen e fëmijëve?
- h) A shihet se pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje lindin në marrëdhënie, qasjet e mësimdhënies dhe aktivitetet mësimore, si dhe rrethanat shoqërore dhe materiale?
- i) A e shmang stafi përdorimin e 'pengesave' për të nënkuptuar mangësitë te fëmijët si në 'një fëmijë me pengesa'?
- j) A i përgjigjet stafi kërkesave zyrtare për të identifikuar fëmijët si fëmijë 'që kanë nevoja të veçanta arsimore' pa e përdorur termin në dialogun e tyre me fëmijët dhe njëri-tjetrin?
- k) A përdoren burimet për t'i mbështetur nxënësit e kategorizuar 'me nevoja të veçanta arsimore' për të rritur kapacitetin e shkollës për t'iu përgjigjur diversitetit?
- l) A quhet koordinatori i mbështetjes 'mbështetje për të nxënit', 'zhvillim i të nxënit' apo 'koordinator i gjithëpërfshirjes', e jo 'koordinator për nevoja të veçanta arsimore'?
- m) A përpiket koordinatori i mbështetjes të rritë kapacitetin e një shkolle për t'iu përgjigjur diversitetit në mënyra që i vlerësojnë fëmijët në mënyrë të barabartë ?
- n) A shihen fëmijët që kanë pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje si individë me interesa, njohuri dhe shkathtësi të ndryshme e jo si pjesë e një grupi homogjen?
- o) A përdoren përpjekjet për të hequr pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje të një fëmije për të promovuar idetë për përmirësimin e përvojave të të gjithë fëmijëve?
- p) A shihet mbështetja shtesë e të rriturve si e drejtë e fëmijëve kur të kenë nevojë për të e jo si diçka që kërkon kategorizim apo vlerësim formal?
- q) A janë bërë publike për fëmijët dhe prindërit/kujdestarët detajet e të drejtës për mbështetje?
- r) A është minimizuar tërheqja e fëmijëve për mbështetje jashtë mësimëve të rregullta?
- s) A shihet ideja se fëmijët në të njëjtën klasë mund të bëjnë gjëra të ndryshme në vende të ndryshme si pjesë e zakonshme e përvojës së çdo fëmije?
- t) A kanë të bëjnë planet individuale të arsimit me të nxënit në një komunitet me të tjerët?
- u) A përdoret përgatitja e planeve individuale të arsimit për disa fëmijë si mundësi për t'i përmirësuar organizimet e mësimdhënies dhe mësimnxënies për të gjithë fëmijët?
- v) A e adresojnë deklaratat e 'nevojave të veçanta arsimore' mënyrën e kapërcimit të pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje përmes organizimeve të mësimdhënies dhe mësimnxënies ?
- w) _____

B2.6 Politika e sjelljes është e lidhur me mësimin dhe zhvillimin e kurrikulës.

A1.4 Stafi dhe fëmijët e respektojnë njëri-tjetrin; A1.5 Stafi dhe prindërit/kujdestarët bashkëpunojnë; A1.9 Të rriturit dhe fëmijët i përgjigjen mënyrave të ndryshme të përjetimit të gjinisë. B2.7 Presionet për përjashtim disiplinor janë ulur. B2.9 Ngacmimi është minimizuar.

- a) A është e shkruar qartë politika e sjelljes dhe a është nxjerrë pas konsultimeve dhe marrëveshjes me fëmijët, prindërit, stafin dhe sindikatat e tyre?
- b) A zbatohet kodi i sjelljes për shkollën si për të rriturit ashtu edhe për fëmijët?
- c) A është e lidhur politika e sjelljes me ndërtimin e komuniteteve bashkëpunuese në shkollë dhe ndarjen e vlerave?
- d) A është angazhimi në mësim dhe përmirësimi i marrëdhënieve gjithmonë qëllimi i ndërhyrjeve për sjellje?
- e) A kërkon shkolla të rrisë angazhimin në mësim përmes përmirësimeve në aktivitetet mësimore?
- f) A përfshijnë shqetësimet për mënyrën e rritjes së angazhimit për disa fëmijë reflektim për mënyrat e përmirësimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies për të gjithë fëmijët?
- g) A fokusohet politika e sjelljes në parandalimin e pakënaqësive dhe vështirësive me sjelljen?
- h) A i identifikojnë të rriturit dhe fëmijët kur lindin vështirësi me sjelljen në mënyrë që politika t'i adresojë ato?
- i) A janë të lidhura politikat për të reduktuar vështirësitë me sjelljen me strategjitë për përmirësimin e përvojave të fëmijëve para dhe pas shkollës dhe në sheshet e lojërave?
- j) A i adreson politika e sjelljes pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje në politikat dhe kulturat e shkollave si dhe në praktika?
- k) A kuptohet se përgjegjësia për përmirësimin e marrëdhënieve në shkollë është e përbashkët për të gjithë fëmijët dhe të rriturit?
- l) A i inkurajon politika të rriturit për të ndarë vështirësitë e tyre dhe për ta mbështetur njëri-tjetrin për zhvillimin e strategjive që parandalojnë konfliktin me dhe mes fëmijëve?
- m) A e adreson politika e sjelljes mirëqenien e fëmijëve që janë të shqetësuar në heshtje?
- n) A përpiqet shkolla të rritë ndjenjën e vetëvlerësimit të atyre që kanë vetëbesim të ulët?
- o) A e dinë fëmijët e trazuar se ata mund të marrin mbështetje dhe vëmendje para se të shfaqin pakënaqësi?
- p) A mbështetet shkolla në punëtorët socialë dhe punëtorët e rinj për ta reduktuar konfliktin mes grupeve të fëmijëve me histori konflikti jashtë shkollës?
- q) A e përdor shkolla mësimdhënien zëvendësuese në mënyra që minimizojnë vështirësitë me sjelljen, për shembull duke u mbështetur rregullisht tek disa persona dhe duke zhvilluar mënyra rutinë për t'i mbështetur ata?
- r) A i eksploron shkolla lidhjet në mes pakënaqësisë të djemtë dhe qëndrimet ndaj mashkullisë brenda dhe jashtë shkollës?
- s) _____
- t) _____
- u) _____

B2.7 Presionet për përjashtim disiplinor janë ulur.

A1.2 Stafi bashkëpunon; A1.4 Stafi dhe fëmijët e respektojnë njëri tjetrin; A1.7 Shkolla është model i qytetarisë demokratike; B2.6 Politika e sjelljes është e lidhur me mësimin dhe zhvillimin e kurrikulës.; C2.8 Disiplina bazohet në respekt të ndërsjellë.

- a) A shihet përjashtimi disiplinor si një proces që përfshin një rënie graduale në marrëdhënie dhe eventin e ndarjes nga një klasë apo shkollë?
- b) A përpqet politika e sjelljes të minimizojë të gjitha format e përjashtimit disiplinor qoftë të përkohshëm apo të përhershëm, formal apo joformal?
- c) A kuptohet se përjashtimi disiplinor mund të ndërpritet me mbështetja dhe ndërhyrje në organizimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe në marrëdhënie?
- d) A ndihmojnë politikat e shkollës në minimizimin e përjashtimit disiplinor nga mësimet?
- e) A përdoren njohuritë e fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve për t'i ulur pakënaqësitë dhe përçarjen?
- f) A ka takime, që përfshijnë stafin, fëmijët, prindërit/kujdestarët dhe të tjerët, ku bëhen përpjekje për të trajtuar problemet me fleksibilitet para se ato të përshkallëzohen?
- g) A kuptohet se ka ndërlidhje në mes nënvlerësimit të fëmijëve dhe pakënaqësisë, përçarjes dhe përjashtimit disiplinor?
- h) A e shmang shkolla krijimin e pakënaqësisë në grupet e nënvlerësuara të mësimdhënies?
- i) A i adreson shkolla ndjenjat e nënvlerësimit kur ato lindin tek fëmijët, për shembull në grupet e pakicave ose në grupet sociale?
- j) A përpqet shkolla për të zvogëluar konfliktin midis grupeve etnike apo sociale?
- k) A lidhen gjithmonë reagimet ndaj shqetësimeve për sjelljen e fëmijëve me edukimin dhe rehabilitimin e jo me ndëshkimin?
- l) A trajtohen me falje fëmijët ose të tjerët që shihet se kanë ofenduar komunitetin e shkollës?
- m) A kuptohet mirë si pjesë e kulturës së shkollë fakti se njerëzit mund të kërkojnë falje dhe mund të ndryshojnë pa e 'humbur fytyrën'?
- n) A trajtohet zemërimi i vazhdueshëm i fëmijëve si arsye për t'i ndihmuar e jo për t'i ndëshkuar ata?
- o) A mban stafi përgjegjësi për t'u kujdesur në mënyrë të barabartë për të gjithë fëmijët edhe kur i përgjigjen vështirësive me sjelljen?
- p) A ka plane të qarta dhe pozitive për riparaqitjen në shkollë të fëmijëve të cilët nuk ndjekin mësimin për arsye disiplinore?
- q) A e merr stafi përgjegjësinë për atë që ndodh me fëmijët kur i nënshtrohen përjashtimit disiplinor dhe nuk janë në shkollë?
- r) A ka plane për menaxhimin dhe reduktimin e varësisë së fëmijëve dhe të rinjve nga nikotina dhe/ose droga të tjera?
- s) A ka raporte të rregullta për përjashtimin disiplinor të përpiluara për stafin, prindërit, administratorët dhe fëmijët?
- t) A e monitoron stafi reduktimin në përjashtimet e përkohshme, përhershme, formale dhe joformale?
- u) _____
- v) _____

B2.8 Pengesat për vijimin e shkollës janë zvogëluar.

A2.9 Shkolla inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten; B2.9 Ngacmimi është minimizuar.

- a) A eksplorohehen të gjitha pengesat brenda kulturave, politikave dhe praktikave të shkollës si dhe në qëndrimet dhe shtëpitë e fëmijëve dhe të rinjve?
- b) A e heton stafi se përse fëmijët vonohen rregullisht dhe a e ofrojnë mbështetjen e duhur?
- c) A e di shkolla se për sa fëmijë ajo është përvojë pozitive dhe më pak se pozitive?
- d) A inkurajohen fëmijët të shprehin në mënyrë konstruktive se si përvojat e tyre në shkollë mund të bëhen më pozitive?
- e) A zhvillon stafi qasje jo-konfrontuese për bashkëpunim me prindërit/kujdestarët për mungesat e paautorizuara?
- f) A e shmang shkolla mungesën e paautorizuar si arsye për përjashtimin disiplinor?
- g) A e shmang shkolla inkurajimin e mungesave si formë jozyrtare përjashtimi ose për të pasur rezultate të mira ekzaminimi apo inspektimi?
- h) A ju ofrohet fëmijëve që kanë munguar për një kohë të gjatë përshëndetje e ngrohtë dhe e sinqertë kur rikthehen në shkollë?
- i) A trajtohet mungesa e paautorizuar e fëmijëve në mënyrë të barabartë pa marrë parasysh gjininë apo prejardhjen?
- j) A kuptohet se ka lidhje në mes mungesës dhe cenueshmërisë, siç është mungesa e miqësive mbështetëse ose pasiguria për gjininë apo identitetin seksual?
- k) A kuptohet se ka lidhje mes ngacmimeve dhe mungesës në shkollë?
- l) A i përgjigjet shkolla shtatzënisë në mënyrë mbështetëse dhe jodiskriminuese ndaj vajzave?
- m) A e mbështet shkolla në mënyrë aktive rikthimin në shkollë dhe pjesëmarrjen e fëmijëve që kanë pasur një humbje, sëmundje kronike apo një mungesë tjetër afatgjatë?
- n) A ofrohen këshilla të qarta për leje më të gjatë për ta vizituar vendin 'amë' që është negociuar me komunitetet e shkollës?
- o) A inkurajohet stafi për të integruar në aktivitetet mësimore përvojat e fituara nga ata që kanë qenë larg për periudha të gjata kohore?
- p) A ka strategji të koordinuar për mungesën e fëmijëve në mes të shkollës dhe agjencive të tjera të përfshira me to?
- q) A ka sistem efikas për raportimin dhe regjistrimin e mungesave dhe gjetjen dhe kuptimin e arsyeve për to?
- r) A mbahen shënime të mungesave për lëndët individuale?
- s) A bëhen lidhje në mes mungesës në mësim dhe varësive ndaj pirjes së duhanit dhe/ose drogave të tjera?
- t) A shihen mungesat në lëndë të veçanta si arsye për të eksploruar marrëdhëniet me mësimdhënësit dhe atë që mësohet?
- u) A është në rënje mungesa e paautorizuar e fëmijëve?
- v) _____
- w) _____
- x) _____

B2.9 Ngacmimi është minimizuar.

A2.8 Shkolla nxit ndërveprimet dhe zgjidhjet jo të dhunshme të mosmarrëveshjeve;
C2.6 Mësimet zhvillojnë aftësinë për të kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve.

- a) A e negociojnë të rriturit dhe fëmijët një pikëpamje të përbashkët për atë që llogaritet si ngacmim?
- b) A ka një deklaratë rreth ngacmimit, që dihet dhe kuptohet nga të gjithë, e cila përcakton se cilat sjellje janë të pranueshme dhe të papranueshme, duke përfshirë edhe ngacmimet kibernetike?
- c) A shihet ngacmimi si pjesë e mundshme e të gjitha marrëdhënieve të pushtetit dhe si abuzim i pushtetit?
- d) A shihet ngacmimi në të gjitha format e ngacmimit seksual dhe diskriminimit ndaj të rriturve dhe fëmijëve?
- e) A janë stafi vigjilentë në ndalimin e 'lojërave' të abuzimit fizik si mbërthimi, gjuajtja ose shqelmimi i fëmijëve në organet e tyre gjentiale?
- f) A shihet ngacmimi si lëndim verbal dhe emocional dhe si sulm fizik?
- g) A kuptohet si ngacmim kërcënimi i tërheqjes nga miqësia?
- h) A shihet se ngacmimi ndodh kur dikush bëhet të ndihet keq për shkak të identitetit të tij?
- i) A shihen komentet dhe sjelljet raciste, seksiste, klasiste, diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar, homofobike dhe transfobike si aspekte të ngacmimit?
- j) A shihen si ngacmim komentet negative për karakteristikat personale si ngjyra e flokëve ose pesha ose mbajtja e syzeve?
- k) A e kundërshtojnë stafi dhe fëmijët përdorimin e termit 'homoseksual' për të nënkuptuar diçka të 'pavlerë'?
- l) A e shmang stafi supozimin për arsyet për ngacmim, për shembull se një fëmijë me aftësi të kufizuara është ngacmuar për shkak të një qëndrimi diskriminues ndaj aftësisë së kufizuar?
- m) A ndihen të rriturit dhe fëmijët të sigurt ta identifikojnë veten e tyre jo heteroseksual apo as mashkull as femër?
- n) A konsultohen një sërë organizatash për hartimin e udhëzimeve kundër ngacmimit, për shembull në lidhje me pjesëtarët e komunitetit romë, lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe trangjinorët, personat me aftësi të kufizuara, azilkërkuesit dhe refugjatët?
- o) A ndihen të aftë fëmijët të shprehin mënyra të ndryshme për të qenë djalë, vajzë, asnjëra apo të dyja pa u vënë në lojë apo ngacmuar?
- p) A bën shkolla dallimin në mes stileve menaxhuese mbështetëse dhe lejuese të ngacmimit?
- q) A shihet ngacmimi si shenjë se kryesi mund të jetë vetë i cënueshëm dhe mund të ketë nevojë për mbështetje?
- r) A e fsheh menaxhmenti i shkollës ose e shmang hetimin e shkollës së ngacmimit në mënyrë që të ruajë imazhin pozitiv të shkollës?
- s) A mund ta zgjedhin fëmijët e ngacmuar personin që do t'i ndihmojë ata nga një numër personash staf të gjinive të ndryshme?
- t) Përveç sindikatave, a ka persona të cilëve stafi mund t'ju drejtohet nëse ata ngacmohen?
- u) A janë fëmijët të trajnuar për t'i ndërmjetësuar incidentet e ngacmimit si pjesë e përfshirjes së tyre në parandalimin dhe minimizimin e ngacmimit?
- v) A ka shënime të qarta për incidentet e ngacmimit?
- w) A është ngacmimi në rënie?
- x) _____
- y) _____

Dimensioni C: Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse

C1: Përpilimi i një kurrikule për të gjithë

- 1 Fëmijët eksplorojnë ciklet e prodhimit dhe konsumin e ushqimit.
- 2 Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit.
- 3 Fëmijët i studiojnë veshjet dhe stolitë e trupit.
- 4 Fëmijët mësojnë rreth banimit dhe mjedisit të ndërtuar.
- 5 Fëmijët shqyrtojnë si dhe pse njerëzit lëvizin në lokalitetin e tyre dhe botë.
- 6 Fëmijët mësojnë për shëndetin dhe marrëdhëniet.
- 7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin.
- 8 Fëmijët studiojnë jetën në tokë.
- 9 Fëmijët hetojnë rreth burimeve të energjisë.
- 10 Fëmijët mësojnë rreth komunikimit dhe teknologjisë së komunikimit.
- 11 Fëmijët angazhohen dhe merren me krijime në literaturë, art dhe muzikë.
- 12 Fëmijët mësojnë për punën dhe e lidhin atë me zhvillimin e interesave të tyre.
- 13 Fëmijët mësojnë për etikën, pushtetin dhe qeverinë.

C2: Orkestrimi i të nxënit

- 1 Aktivitetet mësimore planifikohen duke marrë parasysh të gjithë fëmijët.
- 2 Aktivitetet mësimore inkurajojnë pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve.
- 3 Fëmijët inkurajohen të kenë vetëbesim dhe të zhvillojnë mendimin kritik.
- 4 Fëmijët janë të përfshirë në mënyrë aktive në të nxënit e tyre.
- 5 Fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri.
- 6 Mësimet zhvillojnë aftësinë për të kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve.
- 7 Vlerësimet inkurajojnë arritjet e të gjithë fëmijëve.
- 8 Disiplina bazohet në respekt të ndërsjellë.
- 9 Stafi planifikojnë, japin mësim dhe rishikojnë së bashku.
- 10 Stafi zhvillon burime të përbashkëta për ta mbështetur të nxënit.
- 11 Ndihmës mësimdhënësit mbështesin të nxënit dhe pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve.
- 12 Detyrat e shtëpisë caktohen që të kontribuojnë në të nxënit e të gjithë fëmijëve.
- 13 Aktivitetet jashtë mësimave të shkollës përfshijnë të gjithë fëmijët.
- 14 Burimet në lokalitetin e shkollës njihen dhe shfrytëzohen.

C1: Përpilimi i një kurrikule për të gjithë

Përpilimi i një kurrikule për të gjithë (seksioni C1) ofron një qasje për kurrikulat që i marrin seriozisht vlerat gjithëpërfshirëse. Inkurajon që të nxënit të jetë aktiv, kritik dhe reflektues. Sugjeron aktivitete mësimore të lidhura me përvojën, që promovojnë kuptimin e ndërvarësisë së mjediseve dhe njerëzve nëpër botë. Si seksionet e tjera, e strukturon të menduarit rreth pyetjeve. Ne duam që këto të përdoren për të nisur një numër hetimesh brenda dhe jashtë klasave pasi fëmijët dhe të rriturit t'i shikojnë treguesit që formojnë titujt tanë kryesor. Nënkuptohej natyrë aktive e të nxënit pavarësisht nëse përdorim fjalët, 'mësojmë për', 'hetojmë', 'shqyrtojmë', 'studiojmë' ose 'konsiderojmë' në secilën pyetje.

Detyra e strukturimit të një qasjeje ndaj njohurive është e madhe. Për shkak të natyrës së materialit, këtu ka më shumë pyetje për secilin tregues sesa në pjesët tjera të *Indeksit*. Në këtë seksion, i kemi ndarë pyetjet me tituj dhe nën-tituj. Shpresojmë se pyetjet tona do të nxisin pyetje të tjera për ta mbështetur kuriozitetin e fëmijëve dhe të rriturve. Shumë nga pyetjet që shtrojmë në këtë seksion ofrojnë shembuj të asaj që mund të përfshihet në përgjigje. Hezituam ta bëjmë këtë për shkak se besojmë se aktivitetet mësimore duhet të jenë të hapura. Por përmbajtja është këtu për të treguar se si këta tregues mund ta strukturojnë një kurrikulë që është e thellë dhe e gjerë, për fëmijët dhe të rriturit e të gjitha moshave; që ajo të ofrojë një alternativë të besueshme për kurrikulat tradicionale.

Seksion është punë në progres. Por të gjitha sugjerimet e kurrikulës mund të shihen në këtë mënyrë. Ato duhet të jenë thirrje për të rriturit dhe fëmijët që të përpilojnë kurrikulat e tyre së bashku duke i lidhur sugjerimet me rrethanat e tyre të veçanta. Disa sugjerime janë zhvilluar më hollësisht se të tjerat. Siç sugjerohet në Pjesën 2, shpresojmë që njerëzit do të dërgojnë idetë e tyre për zhvillimin e mëtejshëm të kurrikulave gjithëpërfshirëse në info@indexforinclusion.org.

C1.1 Fëmijët eksplorojnë ciklet e prodhimit dhe konsumin e ushqimit.

A2.9 Shkolla i inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten; C1.6 Fëmijët mësojnë për shëndetin dhe marrëdhëniet; C1.7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin; C1.8 Fëmijët studiojnë jetën në Tokë.

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A ka një kopsht ose ndarje në shkollë ku fëmijët mësojnë rreth kultivimit të bimëve për ushqim?
- A është e lidhur shkolla me një fermë lokale?
- A e shqyrtojnë fëmijët se nga vijnë ushqimet dhe pijet e tyre të preferuara?
- A i eksplorojnë fëmijët preferencat ushqimore dhe dietat në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?
- A i inkurajojnë familjet dhe komunitetet fëmijët të mësojnë për rritjen e ushqimit?
- A mësojnë fëmijët për ushqimin përmes shujtave të ofruara në shkollë dhe kafeterisë?
- A e studiojnë fëmijët mirëqenien e kafshëve nga politikat e shkollës për blerjen e qumështit, vezëve dhe mishit?
- A e blen shkolla ushqimin nga fermerët lokalë dhe tregjet e fermerëve?
- A kontribuojnë në mësimet njerëzit që blejnë, kultivojnë dhe përgatisin ushqimin në ferma, shtëpi dhe resorante?
- A i identifikojnë fëmijët ndikimet globale në atë që ata hanë, nga vjen dhe si është gatuar?
- A e bëjnë fëmijët një listë të vendeve nga vjen ushqimi që ofrohet
- në dyqanet ushqimore lokale dhe në supermarkete dhe a e llogarisin rrugën e ushqimit duke përfshirë të gjitha rrugët që ka kaluar ushqimi?
- A mësojnë fëmijët për dallimet lokale, kombëtare dhe globale në atë që njerëzit hanë?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si tregtarët në rrugë ofrojnë ushqime të gatuar në nivel lokal dhe ndërkombëtar?

Ciklet e ushqimit

- A mësojnë fëmijët se si një cikël i ushqimit përfshin përgatitjen e dheut, mbjelljen, rritjen, vjeljen, ruajtjen/konservimin, përpunimin, shpërndarjen/transportimin, marketingun, blerjen, ruajtjen, gatimin, ngrënien, trajtimin e mbeturinave, kompostimin dhe fertilizimin?
- A mësojnë fëmijët se si ciklet e ushqimit janë të lidhura me ciklin e azotit, karbonit dhe ujit?

Rrjetat ushqimore (Shih sistemet e mbështetjes së jetës, faqe 142)

- A krijojnë fëmijët rrjeta ushqimore që përfshijnë diellin, prodhuesit e bimëve, konsumuesit kafshë, kafshët që ushqehen me kërna dhe dekompozuesit fungjal dhe bakterial?

Rritja dhe shfrytëzimi i tokës

- A mësojnë fëmijët për llojet e dheut dhe si përbërja e tyre ndikon në atë që kultivohet mirë në të?
- A mësojnë fëmijët për rolin e bakteve në zhvillimin e tokave pjellore?
- A mësojnë fëmijët për shkaqet dhe pasojat e erozionit të tokës?
- A i shqyrtojnë fëmijët pasojat e shfrytëzimit të tokës për një kulturë të vetme apo në rotacion për disa kultura?
- A e shqyrtojnë fëmijët përse toka përdoret për të prodhuar çaj, kafe, sheqer, pije alkoolike, duhan dhe droga ilegale e jo për ushqim?
- A hetojnë fëmijët se kush e zotëron tokën ku rritet ushqimi?
- A mësojnë fëmijët për konvertimin e tokës pyjore në tokë bujqësore dhe efektin që ka kjo për gazrat serrë?
- A mësojnë fëmijët se sa bujqësia është e mekanizuar në vende të ndryshme?

Sezonet e ushqimit dhe moti

- A i eksplorojnë fëmijët marrëdhëniet midis kultivimit të ushqimit dhe sezonave?
- A mësojnë fëmijët për efektet e klimës në kultivimin e ushqimit?
- A e shqyrtojnë fëmijët si ngrohja globale dhe moti ekstrem ndikon në prodhimin e ushqimit dhe si do të ndikojë në të në të ardhmen?

Insektet e dëmshme dhe barërat e këqija

- A mësojnë fëmijët se si mund të kontrollohen insektet e dëmshme në mënyrë natyrale dhe artificiale?
- A mësojnë fëmijët se si mund të kontrollohen barërat e këqija në mënyrë natyrale dhe artificiale?

Kafshët për ushqim

- A mësojnë fëmijët se si kafshët e fermave rriten për ushqim?
- A studiojnë fëmijët për peshqit për ushqim nga detet, lumenjtë dhe fermat e peshqve?
- A e eksplorojnë fëmijët shterimin e stoqeve të peshqve, efektet e kuotave të peshkimit dhe mundësitë e rigjenerimit të rezervave?
- A mësojnë fëmijët për përdorimin e metodave industriale për rritjen e kafshëve për ushqim?
- A hetojnë fëmijët për prodhimin e qumështit nga lopët, delet dhe kafshët e tjera?
- A mësojnë fëmijët për prodhimin e vezëve?
- A mësojnë fëmijët për mbajtjen e bletëve për mjaltë?
- A mësojnë fëmijët për sëmundjet e kafshëve (si sëmundja e gjedhit dhe BSE-ja) dhe pasojat e përhapjes së sëmundjeve në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?
- A e mësojnë fëmijët përdorimin e pesticideve dhe antibiotikëve në kontrollimin e sëmundjeve të kafshët?
- A e eksplorojnë fëmijët përdorimin e hormoneve për rritjen e kafshëve?
- A e shqyrtojnë fëmijët se sa tokë nevojitet për të njëjtën vlerë ushqimore në kultivimin e perimeve dhe kafshëve për ushqim?
- A mësojnë fëmijët se si bagëtia prodhon sasi të mëdha të gazit serrë (metanit)?

Transportimi

- A mësojnë fëmijët se si ushqimi udhëton në nivel global dhe kombëtar nga prodhuesit tek konsumatorët?
- A mësojnë fëmijët se si kafshët transportohen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për prodhim të mishit dhe për t'u therur?

Përgatitja dhe ngrënia

- A mësojnë fëmijët të përgatisin dhe të gatujnë në shkollë?
- A i shohin fëmijët kënaqësitë që ofron gatimi dhe ngrënia?
- A mësojnë fëmijët se kush e përgatit dhe gatuan ushqimin dhe pse disa njerëz nuk e bëjnë?
- A mësojnë fëmijët në lidhje me shkallën në të cilën njerëzit lexojnë për gatimin, shikojnë programet e gatimit dhe gatujnë vetë?
- A e hetojnë fëmijët kohën kur njerëz të ndryshëm duhet të gatujnë?
- A mësojnë fëmijët për masën në të cilën përdoren ushqimet e gatshme si pasojë e kohës së shkurtër që njerëzit kanë për të gatuar?
- A e shqyrtojnë fëmijët sesi të ngrënit së bashku i forcojnë marrëdhëniet ndërmjet njerëzve?

Erëzat

- A mësojnë fëmijët për zhvillimet në përdorimin e aromatizuesve dhe erëzave?
- A mësojnë fëmijët për zhvillimin e përdorimit të kripës?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën se si kripa dhe erëzat u bënë mallra të çmuara në tregti?
- A i shqyrtojnë fëmijët përfitimet dhe disavantazhet e aditivëve në ushqim?
- A e eksplorojnë fëmijët mënyrën e përdorimit të erëzave në kultura dhe tradita të ndryshme të ushqimit?

Ruajtja/përpunimi

- A e eksplorojnë fëmijët ruajtjen e ushqimit me anë të ngrirjes, ambalazhimit, paketimit në shishe, tymosjes dhe kriposjes?

Hedhja e mbeturinave, kompostimi dhe fertilizimi

- A mësojnë fëmijët për sistemet e kanalizimit dhe trajtimit të mbeturinave?
- A mësojnë fëmijët për përdorimin e plehut organik për përmirësimin e tokës?
- A mësojnë fëmijët për qasjet në kompostim, duke përdorur kazanët për përzierjet e plehrave dhe krimbat?

Ushqyerja, shëndeti dhe sëmundjet

- A e eksplorojnë fëmijët se kush merr ushqim me vlera ushqyese të mjaftueshme dhe të pamjaftueshme?
- A e eksplorojnë fëmijët rëndësinë e ushqimeve kryesore për shumë njerëz në mbarë botën?
- A e krahasojnë fëmijët ushqimin që ju duhet njerëzve për të qenë të shëndetshëm dhe asaj që ata hanë?
- A e bëjnë fëmijët dallimin ndërmjet promovimit të shëndetit dhe ushqimit të shpejtë jo të shëndetshëm?
- A mësojnë fëmijët se si ushqimi dhe uji i kontaminuar mund të jenë burim i sëmundjeve?
- A mësojnë fëmijët se si sëmundjet nga ushqimet mund të minimizohen nëpërmjet ruajtjes, freskisë, pastërtisë dhe gatimit?
- A e eksplorojnë fëmijët konsumimin e pijeve alkoolike dhe si kontribuojnë ato në shëndetin e mirë dhe problemet shëndetësore?

Kostot e ushqimit

- A mësojnë fëmijët për kostot e ushqimit dhe si lidhet kjo me të ardhurat në familje të ndryshme?
- A mësojnë fëmijët se si kostot ndikojnë në zgjedhjen e ushqimit?
- A e konsiderojnë fëmijët zinxhirin e efekteve të kërkesave për ushqim të lirë në: mirëqenien e kafshëve; pagesën dhe kushtet e prodhuesve; degradimin e tokës, përdorimin e plehrave, herbicideve dhe pesticideve; humbjen e pyjeve, biodiversitetin, fertilitetin e dheut dhe tokës për ushqime lokale, shfrytëzimin e energjisë për ruajtje, transportin ajror, rrugor dhe hekurudhor, udhëtimin jashtë supermarketeve të qytetit dhe humbjen pasuese të bizneseve të vogla lokale?

Tregtimi i produkteve ushqimore dhe biznesi

- A mësojnë fëmijët se si njerëzit e sigurojnë jetesën nga prodhimi, tregtimi, përpunimi, shpërndarja, gatimi dhe shitja e ushqimeve?
- A mësojnë fëmijët se si fitimet nga kultivimi i ushqimeve rriten përmes përpunimit, ambalazhimit ose gatimit dhe ngrirjes, dhe kush përfiton prej tyre?
- A e eksplorojnë fëmijët masën në të cilën biznesi ushqimor kryhet nga prodhuesit e mëdhenj dhe të vegjël, dhe shitësit e mëdhenj dhe të vegjël me shumicë dhe pakicë?
- A mësojnë fëmijët se si marrëveshjet tregtare dhe pengesat tregtare mund ta vështirësojnë konkurrencën e fermerëve në vendet ekonomisht të varfra me importet e lira nga vendet e pasura dhe shitjen në këto vende?
- A eksplorojnë fëmijët për ngritjen dhe rënien e çmimit të ushqimeve dhe si kjo ndikon ndryshe tek njerëzit në vendin e tyre dhe në vende të tjera?
- A eksplorojnë fëmijët mënyrën se si ndryshojnë çmimet e ushqimit me koston e naftës dhe përdorimin e tokës për biomasë?
- A i shqyrtojnë fëmijët se si fermerët mund të fitojnë më pak ndërsa çmimet e ushqimit rriten?

Etika në ushqim dhe politika

- A e diskutojnë fëmijët dhe të rriturit përgjegjësinë e tyre për të ditur kushtet e prodhimit të ushqimit të tyre, mirëqenien e njerëzve që e prodhojnë atë dhe për të vepruar në rast se ato bien ndesh me vlerat e tyre?
- A mendojnë fëmijët për mirëqenien e kafshëve të rritura për ushqim?
- A e shqyrtojnë fëmijët pse ka uri në vendet ekonomisht të varfra krahas bollëkut të ushqimit në vendet e pasura?

- A i eksplorojnë fëmijët shqetësimet e qeverive në vendet e pasura për nivelet e obezitetit dhe çfarë bëjnë ata për ta ulur obezitetin?
- A e eksplorojnë fëmijët mundësinë që shumica e reklamave të ushqimit dhe pijeve në televizion është për ushqimet të cilat në masë të madhe janë jo të shëndetshme?
- A e eksplorojnë fëmijët ndikimin e korporatave në çmimin dhe cilësinë e ushqimit, prodhimin dhe shpërndarjen e tyre dhe hulumtimet për të zhvilluar burime dhe metoda të reja të kultivimit?
- A i shqyrtojnë fëmijët parimet e sovranitetit të ushqimit: se ushqimi është një e drejtë; prodhuesit duhet të respektohen; prodhimi duhet të jetë lokal; njerëzit duhet të kontrollojnë burimet e prodhimit të tij; shkathtësitë lokale duhet të zhvillohen; dhe prodhimi i ushqimit duhet ta ruaj natyrën?⁵⁵
- A i eksplorojnë fëmijët efektet në mjedis dhe efektet shëndetësore të konsumimit të mishit, peshkut, produkteve të qumështit, vegjetarianizmit?
- A i kuptojnë fëmijët parimet që qëndrojnë pas Tregtisë së drejtë dhe argumenteve për dhe kundër zgjerimit të saj?
- A i mësojnë fëmijët përparësitë dhe disavantazhet e prodhimit të ushqimeve në mënyrë organike ose me përdorimin e pesticideve dhe herbicideve artificiale?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si pesticidet, si DDT-ja, e ndaluar në vendet e ekonomikisht të pasura, lejohen për përdorim në vendet ekonomikisht të varfra?
- A e shqyrtojnë fëmijët pse pesticidet vrasin një numër të madh të njerëzve në zonat ekonomikisht të varfra në botë dhe pse shumë njerëz bëjnë vetëvrasje duke konsumuar pesticide qëllimisht?
- A mësojnë fëmijët për rreziqet e përdorimit të pesticideve dhe herbicideve për kultivuesit dhe për konsumatorët, për shembull për mënyrën se si DDT-ja koncentrohet në qumështin e gjirit?
- A mësojnë fëmijët se si nënat me qasje të pakët në ujë të pastër mund të inkurajohen nga korporatat që ta përdorin qumështin pluhur në vend të qumështit natyrshëm steril të gjirit?

Kulturat e modifikuara gjenetikisht

- A e inkurajon shkolla diskutimin e përfitimeve dhe problemeve të modifikimit gjenetik natyral dhe artificial?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si farat mund të modifikohen gjenetikisht për ta rritur rezistencën ndaj thatësisë, pesticideve dhe herbicideve dhe për t'i bërë ato jopjellore?
- A e shqyrtojnë fëmijët se përparësitë dhe disavantazhet e modifikimit gjenetik mund të ndryshojnë sipas natyrës dhe qëllimit të modifikimit dhe efekteve të tij tek njerëzit, bimët dhe kafshët e tjera?
- A i diskutojnë fëmijët përfitimet dhe pengesat e kulturave të modifikuara gjenetikisht për furnizuesit e farërave, fermerët dhe konsumatorët?
- A i eksplorojnë fëmijët efektet që ka rezistenca ndaj insekteve të dëmshme në kulturat e modifikuara gjenetikisht tek bimët përreth?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A e eksplorojnë fëmijët se si prodhimi dhe konsumimi i ushqimit ka ndryshuar me kalimin e kohës në lokalitetin e tyre, në vend dhe në botë?
- A i eksplorojnë fëmijët efektet që kanë ndryshimet e zgjedhjes në ushqime në shëndet dhe mjedis?
- A e hetojnë fëmijët mënyrën se si dietat kanë ndryshuar?
- A e shqyrtojnë fëmijët se çfarë ushqimi do të prodhohet dhe konsumohet në të ardhmen në vendin e tyre dhe në mbarë botën?
- A i shqyrtojnë fëmijët lëvizjet për bujqësinë urbane?

⁵⁵ The pillars of food sovereignty, in Millstone, E. and Lang, T. (2008) The Atlas of Food, who eats what, where and why [Shtylla e sovranitetit ushqimor në Millstone, E. and Lang, T. (2008), Atlasi i ushqimit, kush ha çfarë, ku dhe pse], Brighton, Earthscan p.101

C1.2 Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit.

B1.12 Shkolla e redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit; C1.5 Fëmijët e shqyrtojnë si dhe pse njerëzit lëvizin në lokalitetin e tyre dhe botë; C1.8 Fëmijët studiojnë jetën në tokë.

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A e ka shkolla një lumë lokal apo një rrëke që mund të hetohet dhe ruhet dhe përmes së cilës fëmijët mund t'i kuptojnë ekosistemet dhe ciklet e ujit?
- A e ka shkolla një lumë në një pjesë tjetër të botës dhe a e kupton rëndësinë e tij për jetën e njerëzve atje?
- A kontribuojnë në kurrikulë njerëzit që shesin ujë, bëjnë furnizimin me ujë për shtëpitë, fabrikat dhe fermat dhe kujdesen për ujërat lokale?
- A është e përfshirë shkolla në ruajtjen e lumenjve dhe ujërave lokale?

Përdorimi i burimeve të shterueshme

- A mësojnë fëmijët se si uji është thelbësor për jetën e bimëve, kafshëve dhe njerëzve?
- A e kuptojnë fëmijët rëndësinë e jetës së lumenjve, liqeneve dhe rezervuarëve?
- A e kuptojnë fëmijët se ujërat e ëmbla përbëjnë një pjesë të vogël të ujërave në tokë (2.5%) dhe vetëm një e treta e tyre është në dispozicion për t'u përdorur nga gjallesat?
- A mësojnë fëmijët se si rrjedhjet e akullit në det përbëhen kryesisht nga ujërat e ëmbla?
- A mësojnë fëmijët për përdorimin e ujit për pije nga njerëzit, përdorimin për higjienë, higjienë personale, larjen e ushqimit, enëve dhe rrobave, kopshtari, bujqësi dhe blegtori duke përfshirë kultivimin e peshkut, prodhimin industrial dhe prodhimin e energjisë?
- A e eksplorojnë fëmijët rolin e ujit në rekreacion?

Një burim nën presion

- A e eksplorojnë fëmijët kërkesën në rritje për ujë si pasojë e rritjes së popullsisë, rritjes së prodhimit të ushqimit dhe prodhimeve të tjera, stileve të shtrenjta të jetesës dhe konsumit?
- A e shqyrtojnë fëmijët masën në të cilën 'stilet industriale të jetesës mbështeten po aq nga uji sa edhe nga nafta'?⁵⁶
- A i eksplorojnë fëmijët presionet në furnizimin me ujë nga rritja e urbanizimit, ndryshimet në rrjedhat e lumenjve nga digat dhe ndryshimet klimatike?
- A e shqyrtojnë fëmijët shkallën në të cilën uji kontaminohet nga mbetjet e njerëzve dhe të kafshëve dhe proceset industriale?
- A mësojnë fëmijët për pasojat e thatësisë në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?
- A mësojnë fëmijët për efektet e mungesës së ujit në lëvizjen e kafshëve dhe njerëzve?
- A mësojnë fëmijët për marrëdhënien ndërmjet nevojave për ujë dhe konsumit të ujit?

Uji si habitat

- A hetojnë fëmijët se si janë zhvilluar format e para të jetës në ujë?
- A mësojnë fëmijët për krijesat dhe bimët që jetojnë në ujëra të kripur dhe të ëmbla?
- A mësojnë fëmijët për pasojat që ka për kafshët dhe bimët ujore devijimi dhe fragmentimi i lumenjve, tharja e liqeneve dhe humbja e ligatinave?

Ruajtja dhe shpërndarja

- A mësojnë fëmijët se si shpërndahet uji në ndërtesa, duke përfshirë shtëpitë e tyre?
- A mësojnë fëmijët masën në të cilën fermat varen nga uji i ruajtur?
- A mësojnë fëmijët se si uji ruhet në mënyrë natyrale dhe në tanke dhe rezervuarë të ndërtuar nga njerëzit?
- A mësojnë fëmijët për tabelën e ujit (akuifer) dhe përdorimin e puseve?
- A mësojnë fëmijët për sistemet e ujitjes?
- Ai i shqyrtojnë fëmijët përparësitë dhe disavantazhet e ndërtimit të impianteve të largimit të kripës për të siguruar ujëra të ëmbla?

⁵⁶ Black, M. and King, J. (2009) The Atlas of Water [Atlasi i ujërave], Brighton, Skanimi i tokës dhe kjo faqe është mbështetur nga leximi i këtij libri.

Vetitë e ujit

- A e hetojnë fëmijët lëvizjen e ujit në lumenj dhe në rryma?
- A mësojnë fëmijët për rëndësinë e ruajtjes së jetës nënujore të ekspansionit të ujit teksa ngrihet në akull?
- A e hetojnë fëmijët mënyrën se si uji mund të transformohet në gjendje të ngurtë, të lëngshme dhe të gaztë?
- A e hulumtojnë fëmijët rëndësinë e vetive të tensionit në sipërfaqe të ujit për formimin e pikave të shiut dhe valëve, funksionimin e qelizave, lëvizjen e ujit në pemë dhe bimë të tjera dhe qarkullimin e gjakut në kafshë?
- A e hulumtojnë fëmijët efektin stabilizues që ka në klimë ngadalësimi i ndryshimit të temperaturës së ujit në krahasim me tokën?
- A e hulumtojnë fëmijët përdorimin e ujit si tretës?
- A e hulumtojnë fëmijët përdorimin e ujit në prodhimin e hidrogjenit si lëndë djegëse?
- A e hulumtojnë fëmijët përdorimin e ujit si ftohës në motorë dhe në centrale energjetike?
- A i eksplorojnë fëmijët ndryshimet e ujit në avull dhe përdorimin e avullit?
- A mësojnë fëmijët për energjinë në lëvizjen e ujit, dhe si mund të kontrollohet kjo për gjenerimin e energjisë elektrike nga lumenjtë dhe deti?
- A mësojnë fëmijët për efektet e lëvizjes së pakontrolluar të ujit nga akullnajat, ortekët, përmbytjet dhe cunami?

Uji dhe klima

- A e studiojnë fëmijët ciklin e ujit duke përfshirë avullimin, kondensimin, reshjet?
- A mësojnë fëmijët për retë?
- A mësojnë fëmijët se si shiu bie në raport me kodrat dhe luginat?
- A i shqyrtojnë fëmijët ndryshimet në rënien e shiut dhe borës, thatësinë dhe përmbytjet?
- A mësojnë fëmijët për rrëshqitjen e dheut dhe ortekët?
- A e shqyrtojnë fëmijët për formimin e mjegullës, vesës dhe ngricave?
- A i hetojnë fëmijët modelet e rënies së borës në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?
- A i shqyrtojnë fëmijët pasojat e rritjes së nivelit të ujit të detit për shkak të ngrohjes globale?

Uji dhe shëndeti

- A mësojnë fëmijët për rëndësinë e ujit për higjienën?
- A mësojnë fëmijët në lidhje me zhvillimin e tualetit me shpëlarje, përparësitë dhe disavantazhet e tij dhe shtrirjen e përdorimit të tyre në mbarë botën?
- A mësojnë fëmijët rreth shkallës së ndotjes së ujit dhe pasojat që kjo ka për gjallesat?
- A e shqyrtojnë fëmijët si uji bëhet i sigurt për pije?
- A mësojnë fëmijët për rolin e ujit në përhapjen e sëmundjeve në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?

Etika, pronësia dhe konflikti

- A mësojnë fëmijët për shkallën në të cilën njerëzit kanë qasje në ujë të pijshëm të pastër?
- A mësojnë fëmijët për avantazhet dhe disavantazhet e pronësisë publike ose private të ujit në një vend?
- A mësojnë fëmijët se si mungesa e ujërave të ëmbla dhe kontrolli i ujit çon në konflikte në mbarë botën?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A i eksplorojnë fëmijët ndryshimin në formën e reshjeve të shiut me kalimin e kohës?
- A e hulumtojnë fëmijët ndryshimin në nivelin e detit?
- A i hetojnë fëmijët kërkesat në ndryshim për ujë?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si mund të shmangët mungesa e ujit në të ardhmen?

C1.3 Fëmijët i studiojnë veshjet dhe stolitë e trupit.

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A i fton shkolla dyqanet lokale të veshjeve, lavanderitë, dizajnerët, krijuesit dhe riparuesit, bizhuteritë, parukierët dhe artistët e tattoo-ve për ta shpjeguar punën e tyre?
- A mësojnë fëmijët për përhapjen e stileve të veshjeve nga një vend në tjetrin?
- A bëjnë kërkime fëmijët për diversitetin global të konventave të veshjeve?
- A mësojnë fëmijët për lidhjen në mes veshjeve, stinëve, temperaturës dhe motit në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?
- A e lidhin shkollat zgjedhjen e tyre të veshjeve në mot të ftohtë me nevojën për ngrohje në shtëpi dhe ndërtesa të tjera?
- A e eksplorojnë fëmijët përhapjen e stileve të veçanta 'perëndimore' të veshjeve si kostumet e biznesit, kravatat dhe xhinset?
- A e eksplorojnë fëmijët mënyrën se si ruhen stilet tradicionale të veshjes nga disa grupe dhe gjini?
- A mësojnë fëmijët se si po reduktohet diversiteti i stileve të veshjeve në botë?

Cikli i veshjeve

- A e studiojnë fëmijët një cikël të veshjeve nga prodhimi i lëndës së parë, marketingu dhe moda, prodhimi, blerja, përdorimi, riparimi, këmbimi, riciklimi, heqja nga përdorimi dhe hedhja?

Prodhimi

- A mësojnë fëmijët se si punohen këpucët dhe veshjet nga bimët, leshi dhe lëkura e kafshëve dhe mëndafshi?
- A mësojnë fëmijët për masat e këpucëve dhe veshjeve të punuara nga burime të ndryshme?
- A e zhvillojmë fëmijët njohjen e shumëllojshmërisë së mënyrave të prodhimit të veshjeve dhe këpucëve?

Moda dhe marketingu

- A mësojnë fëmijët për dizajnimin e kapelave, veshjeve, këpucëve dhe stolive?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën se si veshjet dhe stolitë reklamohen dhe shiten?
- A mësojnë fëmijët se si brendimi ndikon në dëshirën, vlerën dhe çmimin e rrobave, këpucëve, çantave?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën se si promovimi i modës dhe stilit është i lidhur me presionet për përdorimin e rrobave dhe këpucëve?

Zgjedhja e veshjeve

- A i hulumtojnë fëmijët presionet që i përcaktojnë veshjet dhe këpucët që ata veshin?
- A mësojnë fëmijët të bëjnë zgjedhje aktive në veshjet dhe stolitë që ata përdorin?
- A mësojnë fëmijët se pse njerëzit veshin veshje në mjedise publike dhe private?
- A e shqyrton shkolla mënyrën se si grupet dhe kulturat inkurajojnë dhe kërkojnë që burrat dhe gratë të mbulojnë ose shfaqin fytyrën dhe trupin?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si dhe pse krijohen konventa për veshje të veçanta për grupe të veçanta në kontekste të veçanta, si veshjet për shkollë, punë dhe mbrëmje?
- A i eksplorojnë fëmijët arsyet pse zgjedhjet e veshjeve mund të ndryshojnë sipas gjinisë në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si veshja mund të tregojë përkatësinë në një grup apo nënkulturë?
- A mësojnë fëmijët se si dhe pse njerëzit i ndryshojnë stilet e veshjeve me moshë?

Stolitë dhe dekorimi i trupit

- A e eksplorojnë fëmijët nxjerrjen e mineraleve për stolitë?
- A e eksplorojnë fëmijët prodhimin dhe përdorimin e stolive?
- A e eksplorojnë fëmijët zbulurimin e trupit, si pikturimi, tattoo-të, shpimi (piercing), vraja (scarring)?
- A mësojnë fëmijët për trendet në stilin e flokëve?
- A i shqyrtojnë fëmijët arsyet pse njerëzit i ngjyrosin, rrisin dhe i presin flokët?

Mirëmbajtja e rrobave

- A mësojnë fëmijët për qasjet e ndryshme për larjen dhe tharjen e rrobave?
- A mësojnë fëmijët për teknikat për riparimin e rrobave?

Riciklimi dhe hedhja e rrobave

- A mësojnë fëmijët se çfarë ndodh me rrobat kur nuk i duam më apo kur vjetrohen?

Etika e veshjes dhe stolisjes së trupit

- A mësojnë fëmijët për kostot e fshehura të veshjeve të lira në pagesat e ulëta, punën e fëmijëve dhe në kushtet e këqija të punës?
- A e shqyrtojnë fëmijët shkallën e ndotjes nga përdorimi i pesticideve në kultivimin e pambukut?
- A e gurmajnë fëmijët çmimin e paguar dhe fitimet e nxjerra nga prodhimi i lëndës së parë, punimi i rrobave dhe materialeve të tjera dhe prodhimi, shpërndarja dhe shitja me pakicë e rrobave, këpucëve dhe stolive?
- A e hetojnë fëmijët shkallën në të cilën dëshira për të kontrolluar minierat e gurëve të çmuar dhe metaleve ka çuar në luftëra?
- A mësojnë fëmijët për Tregtinë e drejtë në veshje?
- A bëjnë kërkime fëmijët për idenë e etikës në veshje dhe çfarë mund të nënkuptojë kjo për zgjedhjet e tyre të veshjeve dhe veshjet e rekomanduara nga një shkollë?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A mësojnë fëmijët se si modelet e veshjeve ndryshojnë nga një periudhë në tjetrën?
- A e hetojnë fëmijët shkallën në të cilën fushatat e kanë ndaluar tregtinë e gëzofit?
- A mësojnë fëmijët se si modelet e stolisjes së trupit ndryshojnë nga një periudhë në tjetrën?
- A e shqyrtojnë fëmijët disponueshmërinë e materialeve të veshjeve në të ardhmen?
- A i shqyrtojnë fëmijët kostot e veshjeve në të ardhmen?



Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlera gjithëpërfshirëse

C1.4 Fëmijët mësojnë rreth banimit dhe mjedisit të ndërtuar.

B1.12 Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit.

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A e shqyrtojnë fëmijët shumëllojshmërinë e ndërtesave në lokalitetin e tyre?
- A e mendojnë fëmijët cilat ndërtesa i pëlqejnë në lokalitetin e tyre dhe pse?
- A e eksplorojnë fëmijët se cilat ndërtesa lejohen të ndërtohen në zonën e tyre?
- A mësojnë fëmijët se në çfarë mase është planifikuar ndërtimi në qytetin apo lagjen e tyre?
- A kontribuojnë në kurrikulën e shkollës ndërtuesit, operatorët e makinerisë, elektrikistët, hidraulikët, marangozët, ngjyrosësit dhe dekoratorët, punëtorët që punojnë me kulmin, tjegullat, suvatesit, muratorët, arkitektët, punëtorët e shembjes dhe planifikuesit e qytetit?
- A mësojnë fëmijët për shumëllojshmërinë dhe cilësitë e materialeve të ndërtimit në kulturën e tyre dhe në vende të tjera, si tulla, baltë, metal, dru, plastikë, dengjet e kashës, pëlhurë etj?
- A mësojnë fëmijët për shumëllojshmërinë e shtëpive, si anijet, tendat, furgonët me rimorkio, ndërtesat me tulla dhe gur, shtëpitë nga materialet e gjetura, shtëpitë mbi struktura të ngritura etj?

Shtëpitë dhe ndërtesat rurale dhe urbane

- A mësojnë fëmijët për origjinën e qyteteve dhe si ndryshojnë ato me kalimin e kohës?
- A mësojnë fëmijët për shpërndarjen e njerëzve në mes qyteteve dhe zonave rurale dhe dallimet në përvojën e tyre të mjedisit të ndërtuar?
- A i mësojnë fëmijët qëllimet e ndryshme për ndërtimin e ndërtesave, si fabrikat, zyrat, burgjet, ndërtesat civile, kishat, hambarët, shtëpitë, restorantet dhe kafenetë?
- A i shqyrtojnë fëmijët ndryshimet në ndërtesa në zonat rurale që paraqiten për shembull nga ndryshimi i popullatës rurale dhe metodat e zhvillimit të bujqësisë?
- A mësojnë fëmijët për arsyet e vendndodhjes së shtëpive?
- A e hulumtojnë fëmijët se si bartet uji, rryma elektrike dhe gazi në shtëpi?
- A mësojnë fëmijët se si largohen mbeturinat nga shtëpia dhe ndërtesat e tjera?
- A mësojnë fëmijët se si dhe pse ndërtesat shemben?

Format e ndërtesave dhe materialeve të ndërtimit

- A mësojnë fëmijët për ndërtimin e shtëpive në ndërtesa me madhësi dhe numra të ndryshëm të kateve nga barakat te bloqet e larta?
- A i analizojnë fëmijët shtëpitë e ndërtuara për personat beqarë, të rriturit me dhe pa fëmijë dhe familjet e gjera?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën se si ndërtohen themelet për shtëpitë dhe si këto varen nga kushtet e tokës dhe parashikimet e stuhive dhe tërmeteve?
- A mësojnë fëmijët se si izolohen ndërtesat për të qenë të papërshkueshme nga uji?
- A mësojnë fëmijët se si u zhvillua qelqi për përdorim në dritare?
- A e shqyrtojnë fëmijët masën në të cilën materialet në ndërtesa i pasqyrojnë burimet lokale?

Dizajnimi dhe planifikimi i ndërtesës

- A mësojnë fëmijët për mënyrën e dizajnit të shtëpive dhe ndërtesave të tjera?
- A i eksplorojnë fëmijët mundësitë për dizajnimin e ndërtesave eficiente në energji?
- A e shqyrtojnë fëmijët si dekorohen shtëpitë?
- A e eksplorojnë fëmijët përse shtëpitë ndërtohen në fushat e përmbytura?

Zotërimi i shtëpive

- A mësojnë fëmijët për shtëpitë që janë në pronësi, të hipotekuara, të marra me qira dhe të zëna në mënyrë jo të ligjshme?
- A e hetojnë fëmijët koston e ndërtimit, blerjes dhe dhënies me qira të shtëpive?
- A mësojnë fëmijët për asetet që njerëzit kanë në shtëpitë e tyre dhe si dhe pse këto ndryshojnë?

Ndërtimi i makinave

- A i shqyrtojnë fëmijët makinat e mëdha që përdoren për ndërtim, gjermim, zhvendosje, ngritje, shpim dhe përzierje të çimentos dhe betonit?
- A mësojnë fëmijët për makinat e vogla, veglat manuale dhe me rrymë të përdorura në ndërtim?
- A mësojnë fëmijët për qasjet e kaluara dhe të tashme në lidhje me skelat?

Siguria në shtëpi

- A mësojnë fëmijët për sigurinë e shtëpive në rastet e stuhive, zjarrit, përmbytjeve dhe tërmeteve?
- A mësojnë fëmijët se si pajisjet elektrike, prizat dhe instalimet elektrike mund të përdoren sigurt në shtëpi?
- A mësojnë fëmijët përse uji mbahet i ndarë nga pajisjet dhe instalimet elektrike?
- A mësojnë fëmijët për parandalimin e rreziqeve të zjarrit nga pajisjet elektrike dhe ato të gazit dhe përdorimin e alarmeve të tymit?
- A mësojnë fëmijët për sigurimin e shtëpive dhe mbulimin e rrezikut?

Ngrohja dhe freskimi

- A mësojnë fëmijët se si ngrohen dhe freskohen ndërtesat?
- A mësojnë fëmijët se si ndërtesat mund të bëhen më efikase në energji për shembull përmes zgjedhjes së materialeve të ndërtimit, izolimit dhe reduktimit të rrymave të ajrit?

Bizneset e ndërtimit

- A mësojnë fëmijët se si njerëzit merren me profesione që kanë të bëjnë me ndërtimin, arkitekturën dhe planifikimin?
- A e eksplorojnë fëmijët se çfarë do të thotë të jesh i vetëpunësuar ose të punosh për organizata të vogla apo të mëdha ndërtimi?
- A mësojnë fëmijët se në çfarë mase ndërtimtarët specializohen ose përfitojnë shkathtësi të ndryshme?
- A mësojnë fëmijët për pronësinë e tokës, çmimet e tokës, çmimet e shtëpive dhe si mund të ndryshojnë këto?

Etika dhe politikat e ndërtimit

- A mësojnë fëmijët për arsyet e mungesës së strehimit dhe kë e prek ajo?
- A e shqyrtojnë fëmijët çfarë e bëjnë një lagje më shumë dhe më pak të pëlqyeshme?
- A i eksplorojnë fëmijët zgjedhjet dhe rrethanat ekonomike që ndikojnë në vendin ku jetojnë njerëzit?
- A e eksplorojnë fëmijët përse disa njerëz kanë më shumë hapësirë për të jetuar se të tjerët?
- A mësojnë fëmijët se si shtëpitë e njerëzve ndikohen nga luftërat dhe pasojat e tyre?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A mësojnë fëmijët se si kanë ndryshuar ndërtesat me kalimin e kohës?
- A e shqyrtojnë fëmijët si dhe pse qytetet janë zgjeruar?
- A e hetojnë fëmijët ndryshimin e popullsisë në zonat rurale?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si janë reduktuar tokat rurale?
- A i shqyrtojnë fëmijët qasjet e ardhshme për ndërtimin?

C1.5 Fëmijët shqyrtojnë si dhe pse njerëzit lëvizin në lokalitetin e tyre dhe botë.

C1.13 Fëmijët mësojnë për etikën, pushtetin dhe qeverinë

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A e konsiderojnë fëmijët mbajtjen e shënimeve për një javë ose një muaj të udhëtimeve që bëjnë nga shtëpia në vende të tjera brenda ose jashtë zonës ku ata jetojnë?
- A kontribuojnë në kurrikulë njerëzit që udhëheqin biznese lokale të transportit, ngasin taksi, autobusë, trena, punojnë me motorët, sheshin dhe servisojnë vetura dhe biçikleta dhe marrin vendime për transportin lokal?
- A kontribuojnë në kurrikulë njerëzit familjet e të cilëve kanë qëndruar në një zonë për një kohë të gjatë?
- A kontribuojnë në kurrikulë njerëzit që kanë ardhur nga vendet e tjera ose prindërit apo gjyshërit apo paraardhësit më të largët të të cilëve kanë ardhur nga vendet e tjera?
- A i shqyrtojnë fëmijët format e transportit të përdorura në pjesë të ndryshme të botës?

Lidhja me vendin

- A mësojnë fëmijët për rëndësinë që ka vendi i origjinës për shumë njerëz?
- A e shqyrtojnë fëmijët se çfarë e bën një vend të mirë për të jetuar dhe qëndruar?

Pse lëvizin njerëzit

- A i hetojnë fëmijët si lëvizin njerëzit për të përmbushur nevojat themelore për ushqim, ujë, lëndë djegëse për gatim, ngrohje dhe transport, strehim, siguri, arsim dhe punë?
- A e hetojnë fëmijët se si njerëzit zgjedhin të lëvizin për turizëm, eksplorim, sport dhe marrëdhënie?
- A mësojnë fëmijët se si industria e turizmit e promovon udhëtimin?
- A mësojnë fëmijët për stilet e udhëtimit në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?
- A mësojnë fëmijët se si njerëzit zhvendosen nga ndryshimi i përdorimit të tokës, siç janë projektet hidroelektrike?
- A mësojnë fëmijët se si njerëzit shpërngulen për shkak të konfliktit?
- A mësojnë fëmijët se si njerëzit shpërngulen për shkak të degradimit mjedisor?
- A e eksplorojnë fëmijët përse njerëzit bëhen refugjatë dhe azilkërkues?
- A i shqyrtojnë fëmijët arsyet për eksplorimin e hapësirës?

Tregtia

- A mësojnë fëmijët për rolin e tregtisë lokale dhe të largët në promovimin e udhëtimit?
- A mësojnë fëmijët për rolin e shkëmbimit në tregti?
- A mësojnë fëmijët se si lëvizin njerëzit për të marrë lëndën e parë?
- A mësojnë fëmijët si realizohen fitimet në tregti?
- A mësojnë fëmijët për avantazhet dhe disavantazhet e tregtisë së kufizuar dhe të pakufizuar për vendet ekonomikisht të pasura dhe të varfra?
- A mësojnë fëmijët për fuqinë e organizatave ndërkombëtare dhe marrëveshjeve për rregullimin e tregtisë?

Konflikti, pushtimi dhe okupimi

- A mësojnë fëmijët për arsyet pse njerëzit shkojnë në luftë?
- A mësojnë fëmijët se si vendet okupojnë vendet e të tjerëve për t'i kontrolluar burimet?
- A mësojnë fëmijët pse disa pjesë të botës kanë rëndësi strategjike?

Mënyrat e transportit dhe format e forcës shtytëse

- A e shqyrtojnë fëmijët si lëvizin njerëzit duke ecur, vrapuar, notuar, me biçikletë, në karrige me rrota, hipur në kafshë, në kamionë, makina, tramvaje, trena, anije, anije lundruese, anije me avull dhe naftë, balona me ajër të nxehtë dhe balona heliumi, helikopterë, mjete lundruese me jastëkë ajri, aeroplanë dhe raketa?
- A mësojnë fëmijët për krijimin e rrjeteve rrugore dhe hekurudhore?
- A mësojnë fëmijët për zhvillimin e rrotave dhe motorëve, forcën shtytëse të avionëve dhe raketave?

Transporti dhe mjedisi

- A e shqyrtojnë fëmijët masën në të cilën udhëtimi varet nga disponueshmëria e lëndëve djegëse fosile dhe lëndëve të tjera jo të ripërtëritshme?
- A mësojnë fëmijët për efektet në mjedis të lëvizjes së mallrave duke përdorur forma të ndryshme të transportit në distanca të ndryshme?
- A e shqyrtojnë fëmijët si mund të rritet përdorimi i transportit që nuk shkakton dëme në mjedis si ecja dhe çiklizmi?
- A e eksplorojnë fëmijët se si inkurajohet përdorimi i makinave nga reklamat, programet televizive dhe sportet motorike?
- A mësojnë fëmijët se si zgjedhja e transportit me vetura dhe transportit ajror bëhet pjesë e identiteteve të njerëzve?

Navigimi dhe hartat

- A mësojnë fëmijët për zhvillimin e hartave?
- A mësojnë fëmijët për zhvillimin e lundrimit në det duke përdorur yjet, orët dhe hartat dhe sistemet e pozicionimit global?

Kontrollimi i lëvizjes

- A e konsiderojnë fëmijët kush ka dhe kush e përdor pasaportën?
- A e konsiderojnë fëmijët si jepen dhe refuzohen vizat?
- A mësojnë fëmijët për kufizimin e lëvizjes nga pronësia e tokës, kufijtë natyrorë dhe kufijtë kombëtarë?

Lëvizja dhe etika

- A i eksplorojnë fëmijët kostot e fshehta të veturave dhe udhëtimit ajror në dëmin mjedisor?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën se si trajtohen njerëzit që kërkojnë azil kur vijnë në këtë vend?
- A i hetojnë fëmijët kriteret për dhënien e azilit dhe kush nëpër botë i plotëson këto kriteret?
- A e eksplorojnë fëmijët çfarë ndikime ka tërheqja e njerëzve të kualifikuar nga vendet ekonomikisht të varfra në vendet ekonomikisht të pasura në ekonomitë dhe shërbimet në vendet e tyre të origjinës?
- A mësojnë fëmijët për pikëpamjet e njerëzve lidhur me atë se sa duhet të jenë të lirë ata të udhëtojnë në vendet e të tjerëve dhe sa të lirë duhet të jenë të tjerët për të udhëtuar në vendin e tyre?
- A mësojnë fëmijët për përgjegjësinë e veçantë për personat e shpërngulur dhe të cenueshëm në vendet me të cilat MB-ja është, ose ka qenë, në luftë?
- A e diskutojnë fëmijët natyrën e një politike etike të imigrimit?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A e hulumtojnë fëmijët se si kanë ndryshuar mënyrat e transportit?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si është rritur përdorimi i veturave private?
- A e studiojnë fëmijët se si kanë ndryshuar modelet e migrimit?
- A mësojnë fëmijët se si ngritja dhe rënia e perandorive ndikon në lëvizje dhe migracion?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si dhe pse transporti mund të ndryshojë në të ardhmen?
- A i konsiderojnë fëmijët lëvizjet dhe kontrollet e mundshme në të ardhmen të lëvizjes së njerëzve nëpër botë?

C1.6 Fëmijët mësojnë për shëndetin dhe marrëdhëniet.

A2.9 Shkolla inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten; A2.10 Shkolla kontribuon në shëndetin e fëmijëve dhe të rriturve; C1.1 Fëmijët hulumtojnë ciklet e prodhimit dhe konsumit të ushqimit; C1.2 Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit.

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A mësojnë fëmijët nga përvojat e tyre dhe të njerëzve të tjerë për shëndetin dhe problemet shëndetësore?
- A kontribuojnë në kurrikulë njerëzit lokalë që promovojnë shëndetin fizik, mendor dhe mjedisor dhe/ose trajtojnë problemet shëndetësore?
- A mësojnë fëmijët për dallimet në modelet e sëmundjeve midis vendeve?
- A mësojnë fëmijët për marrëdhëniet midis varfërisë, sëmundjes dhe ushqimit dhe mungesës dhe cilësisë së ujit?

Kuptimi i shëndetit

- A e mendojnë fëmijët se çfarë nënkuptojnë me të qenit i shëndetshëm?
- A e eksplorojnë fëmijët se çfarë do të thotë të qenit i shëndetshëm për njerëz të ndryshëm?
- A e konsiderojnë fëmijët nëse një jetë e shëndetshme është ajo që zgjat sa më gjatë të jetë e mundur?

Shëndeti dhe trupi

- A mësojnë fëmijët për anatominë dhe fiziologjinë e trupave njerëzorë?
- A mësojnë fëmijët për rolin e gjeneve dhe ADN-së në zhvillim?
- A mësojnë fëmijët për varësinë e zhvillimit nga natyra e mjedisit?
- A e shqyrtojnë fëmijët si ndryshojnë trupat me moshë?

Shëndeti dhe sëmundjet

- A e eksplorojnë fëmijët shkallën në të cilën mund të reduktohen dhe parandalohen problemet shëndetësore nga ndryshimet në mjedis dhe ushqyerje, rritjen e masës së ushtrimeve, reduktimin e stresit dhe ndërhyrjet mjekësore dhe paramjekësore?
- A i konsiderojnë fëmijët zhvillimet dhe përparimet në trajtimin e problemeve shëndetësore?
- A mësojnë fëmijët se si përhapen sëmundjet nga njerëzit, kafshët e tjera duke përfshirë zogjtë dhe insektet, ajrin dhe ujin?
- A mësojnë fëmijët për rolin e baktereve, viruseve dhe prioneve në paraqitjen e sëmundjeve?
- A mësojnë fëmijët për rolin e bakterieve në ruajtjen e shëndetit?
- A mësojnë fëmijët për zhvillimin e antibiotikëve?
- A e eksplorojnë fëmijët shkallën me të cilën dhënia e tepërt e antibiotikëve ka kontribuar në rezistencën ndaj tyre?
- A e studiojnë fëmijët mbizotërimin e baktereve rezistente ndaj antibiotikëve në spitale?
- A mësojnë fëmijët për lloje të ndryshme të kancerit dhe si janë zhvilluar trajtimet?
- A e hetojnë fëmijët si dhe pse jetëgjatësia ndryshon ndërmjet individëve dhe grupeve?
- A mësojnë fëmijët se si industria farmaceutike promovon shëndetin dhe nocionet e sëmundjes?
- A mësojnë fëmijët për rëndësinë e përdorimit të ilaçeve në përmirësimin e jetës së disa njerëzve?
- A mësojnë fëmijët për rolin e trajtimit të sëmundjes në zgjatjen e jetës?
- A i eksplorojnë fëmijët arsyet e ndryshme për kirurgji kozmetike?
- A e eksplorojnë fëmijët vlerën e mënyrave të ndryshme të trajtimit të sëmundjes?

Shëndeti mendor

- A e shqyrtojnë fëmijët ndikimin e rrethanave të njerëzve në atë se sa mirë ndihen ata për veten?
- A mësojnë fëmijët se si disa njerëz kanë gjendje mendore që i ndalojnë ata të bëjnë atë që duan?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si gjendja mendore e disa njerëzve ndërhyt me atë që të tjerët dëshirojnë të bëjnë?
- A e eksplorojnë fëmijës shkallën në të cilën njerëzit konsiderohen se kanë sëmundje mendore?
- A i hetojnë fëmijët mënyrat e ndryshme me të cilat ndihmohen njerëzit për të kapërcyer sëmundjet mendore dhe për të rritur shëndetin e tyre mendor?
- A mësojnë fëmijët për masën e përshkrimit të ilaçeve për sëmundjen e ankthit, depresionit apo problemeve të tjera mendore?
- A i hulumtojnë fëmijët efektet e ilaçeve për zvogëlimin e problemeve të shëndetit mendor në trup dhe mendje?
- A i shqyrtojnë fëmijët marrëdhëniet ndërmjet përbushjes së aktivitetit dhe shëndetit mendor?

Marrëdhëniet

- A diskutojnë fëmijët për natyrën e miqësisë dhe si kjo mund të thellohet, ruhet dhe humbet?
- A i shqyrtojnë fëmijët format e ndryshme të marrëdhënieve me të njohurit, miqtë dhe familjen?
- A janë të përfshira në kurrikulë njohuritë e fëmijëve për llojllojshmërinë dhe kompleksitetin e marrëdhënieve?
- A përdoren në mësim situatat njerëzore që shfaqen në televizor dhe mediat e tjera?
- A mësojnë fëmijët për kuptimet e ndryshme të dashurisë?
- A reflektojnë fëmijët për mënyrën se si ndjenjat i shtojnë ata të veprojnë në mënyrë pozitive dhe negative ndaj të tjerëve dhe vetvetes?
- A mësojnë fëmijët për besimin në marrëdhënie?
- A mësojnë fëmijët për shumëllojshmërinë e mënyrave të të qenit një familje?
- A mësojnë fëmijët për mënyrat se si njerëzit mund të ndërtojnë familje nga grupet e miqve që kujdesen për njëri-tjetrin?

Kujdesi për fëmijët

- A mësojnë fëmijët për kënaqësitë e të ardhmes me dhe pa pasur fëmijë?
- A i hulumtojnë fëmijët modelet e kujdesit për fëmijët brenda komuniteteve të tyre dhe komuniteteve të tjera në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar?
- A mësojnë fëmijët për përgjegjësitë dhe vështirësitë e mundshme të kujdesit për fëmijët e vegjët dhe rritjen e tyre dhe gëzimet që mund të zgjasin gjatë gjithë jetës?

Marrëdhëniet seksuale dhe edukimi seksual

- A e shmangin stafi atribuimin e ndjenjave të veçanta seksuale atyre që mund të mos i kenë ato?
- A fokusohet edukimi seksual në marrëdhëniet dhe kënaqësinë, si dhe shtatzëninë dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme?
- A ju jepen fëmijëve informacione të plota për ndryshimet në paraqitje, risqet e marrjes dhe trajtimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme?
- A lidhet edukimi seksual me zgjedhjet që njerëzit mund të bëjnë për jetën dhe trupin e tyre?
- A i diskutojnë fëmijët mundësitë për miqësi të thellë ndërmjet partnerëve seksualë dhe si mund të ndihen njerëzit nëse mungon miqësia?
- A diskutojnë fëmijët për ndjenjat e xhelozisë dhe si kjo ndikon në marrëdhëniet seksuale dhe marrëdhëniet e tjera me miqtë dhe familjen?

- A i eksplorojnë fëmijët mënyrat e ndryshme se si vajzat/gratë dhe djemtë/burrat ndikohen kur kanë nisur një shtatzëni?
- A e konsiderojnë fëmijët përgjegjësini e përbashkët të djemve/burrave dhe vajzave/grave për veprime që kanë çuar në një shtatzëni?
- A e shmang stafi prezantimin e monogamisë afatgjatë si mënyrë që secili do ta preferonte për organizimin e jetës së veti?
- A ka të bëjë edukimi seksual dhe për marrëdhëniet me djemtë, vajzat, transgjitorët dhe ndërgjitorët, nëse ata e shohin veten si heteroseksualë, lesbike, homoseksualë apo biseksualë?
- A e shqyrtojnë të rinjtë mënyrën se si pornografia ndikon në marrëdhëniet e djemve dhe vajzave?
- A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët se si nivelet e larta të dhunës në familje, dhunimit dhe sulmit seksual mund të parandalohen?

Shëndeti dhe drogat

- A mësojnë fëmijët për shtrirjen e përdorimit të drogave legale dhe jolegale?
- A mësojnë fëmijët për pasojat sociale dhe shëndetësore të përdorimit të drogave legale dhe jolegale?
- A e eksplorojnë fëmijët përdorimin, varësinë, përshkrimin, drogat legale dhe jolegale dhe si kjo ndikon në mendjen, trupin dhe jetën e tyre?
- A mësojnë fëmijët për masën e ndryshe të konsumit të alkoolit nga njerëzit?
- A mësojnë fëmijët për presionet në përdorimin e drogave legale dhe jolegale nga reklamat, dyqanet dhe klubet dhe brenda kulturave të fëmijëve dhe të rriturve?

Shëndeti dhe ushqimi

- A e hulumtojnë fëmijët se çka i bën ushqimet të shëndetshme apo të dëmshme?
- A lidhen diskutimet e të ushqyerit të shëndetshëm me të kuptuarit e buxheteve familjare?

Shëndeti dhe etika

- A i eksplorojnë fëmijët argumentet për dhe kundër legalizimit të prodhimit, shpërndarjes dhe përdorimit të drogave ilegale?
- A diskutohen pikëpamje të ndryshme për kontributin në shëndet të vegjetarianizmit dhe ngrënies së peshkut dhe mishit?
- A e shqyrtojnë njerëzit masën në të cilën kirurgjia kozmetike, për arsye jo të lidhura drejtpërdrejt me shëndetin, përfshin kirurgët dhe infermierët në sjellje joetike?
- A i eksplorojnë fëmijët interesat e prodhuesve të ushqimit në promovimin e ushqimeve të shëndetshme dhe jo të shëndetshme?
- A i eksplorojnë fëmijët shkallët e ndryshme të disponueshmisë së ilaçeve dhe trajtimit mjekësor për shpëtimin e jetës dhe zgjatjen e jetës për njerëzit e pasur dhe të varfër në nivel kombëtar dhe global?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën se si buxhetet shëndetësore kombëtare përfshijnë vendime për atë se kush mund të trajtohet dhe me çfarë shpenzimesh?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A e hetojnë fëmijët se si kanë ndryshuar modelet e sëmundjeve?
- A mësojnë fëmijët se si ka ndryshuar jetëgjatësia dhe si mund të ndryshojë në të ardhmen?
- A i eksplorojnë fëmijët se si ndryshimet në jetëgjatësi ndikojnë në potencialin për marrëdhënie të gjata?
- A mësojnë fëmijët se si ka ndryshuar kujdesi dhe higjiena gjatë sjelljes në jetë të fëmijës dhe si ka ndikuar kjo në jetëgjatësinë e grave?
- A i shqyrtojnë fëmijët si mund të ndryshojnë modelet e sëmundjes me rritjen e rezistencës ndaj antibiotikëve dhe ndryshimit të klimës?

C1.7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin

A2.3 Shkolla inkurajon respektin për integritetin e planetit Tokë; 12 Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit; B1.13 Shkolla kontribuon në reduktimin e mbeturinave; C1.2 Fëmijët hulumtojnë rëndësinë e ujit; C1.5 Fëmijët shqyrtojnë si dhe pse njerëzit lëvizin në lokalitetin e tyre dhe nëpër botë; C1.8 Fëmijët studiojnë jetën në Tokë; C1.9 Fëmijët hetojnë rreth burimeve të energjisë.

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A e mendojnë fëmijët se si do t'ia tregonin adresën e tyre dikujt që jeton afër, në Afrikë apo Azi, në një planet tjetër, një sistem tjetër diellor ose galaktikë dhe si mund të ndryshojë kjo nga mënyra se si mësojnë të shkruajnë adresën e tyre?
- A bëjnë fëmijët foto të mjedisit të tyre lokal, peisazheve, qiellit, reve dhe ndryshimeve të motit dhe a i këmbëjnë me njerëzit në pjesët tjera të vendit, pjesët tjera të botës?
- A i fotografojnë, pikturojnë apo vizatojnë fëmijët detajet që ata i pëlqejnë dhe nuk i pëlqejnë në mjedisin e tyre lokal dhe a komentojnë për zgjedhjet e tyre?
- A e kuptojnë njëjtë të rriturit dhe fëmijët mënyrën se si mjediset në një pjesë të botës ndikojnë te njerëzit në pjesët tjera të botës nëpërmjet përdorimit të lëndëve djegëse fosile, humbjes së pyjeve, tërmeteve, aksidenteve bërthamore, shpërthimeve vullkanike?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si ka ndryshuar peizazhi i tyre lokal me kalimin e kohës?
- A kërkojnë shkollat nga astronomët amatorë ose profesionistë lokalë; fizikantë; kimistë; minatorë; përdorues të detektorëve metalikë; punues të orëve, gjeografë, hartografë; meteorologë; shkencëtarë; fotografë të peisazheve, dizajnerë dhe artistë, shkrimtarë; dhe miq që të japin mendimin e tyre për planetin dhe vlerësimin e peisazheve natyrore?
- A mbajnë fëmijët të dhëna për saktësinë e parashikimeve të motit?

Sistemi diellor, galaktika dhe universi

- A mësojnë fëmijët për yllin e tyre, diellin si një nga shumë yjet?
- A e konsiderojnë fëmijët diellin si burim i Tokës?
- A e konsiderojnë fëmijët diellin si burim i energjisë në Tokë?
- A e konsiderojnë fëmijët ciklin e jetës së yjeve?
- A hulumtojnë fëmijët për Tokën si një nga planetët që lëviz rreth diellit?
- A e studiojnë fëmijët orbitën e Tokës dhe si janë zhvilluar njohuritë për të?
- A mësojnë fëmijët për galaktikën e tyre, rrugën e qumështit dhe galaktikat e tjera?
- A e hulumtojnë fëmijët mënyrën se si duken yjet në kohë dhe vende të ndryshme?
- A e konsiderojnë fëmijët universin si tërësi e galaktikave dhe e gjithë materies?
- A e mësojnë fëmijët se si pjesa dërrmuese e universit përbëhet nga hidrogjeni dhe heliumi?
- A mësojnë fëmijët se si të gjithë yjet, planetet dhe jeta në Tokë, duke përfshirë trupat e tyre janë zhvilluar nga materia në univers?
- A studiojnë fëmijët se si krijohet drita dhe si udhëton nga dielli dhe yjet?
- A e studiojnë fëmijët se si matet distanca ndëryjore në vite drite?
- A e kuptojnë fëmijët se ne studiojmë të kaluarën e universit për shkak të kohës që i duhet dritës për të arritur Tokën?
- A e eksplorojnë fëmijët zhvillimin e astronomisë dhe përdorimin e teleskopëve për ta studiuar universin?

Graviteti

- A mësojnë fëmijët se si graviteti i mban ata dhe atmosferën në Tokë?
- A mësojnë fëmijët se si graviteti e ka skalitur universin?
- A mësojnë fëmijët se si graviteti e mban diellin dhe planetet dhe hënat në orbitat e tyre?

Magnetizmi i tokës

- A mësojnë fëmijët në lidhje me fushën magnetike të Tokës dhe polet magnetike që prodhon ajo?
- A mësojnë fëmijët si ka ndryshuar fusha magnetike e Tokës dhe si polet magnetike kanë lëvizur anasjelltas?
- A e eksplorojnë fëmijët rolin e fushës magnetike të Tokës në mbrojtjen e atmosferës duke devijuar grimcat e ngarkuara nga era diellore?

Koha, orët dhe kalendarët

- A mësojnë fëmijët për kohën dhe si matet ajo?
- A mësojnë fëmijët për vitin si koha që i duhet Tokës për t'u rrotulluar rreth diellit?
- A e kuptojnë fëmijët mënyrën se si rrotullimi i Tokës jep ditën dhe natën?
- A e hulumtojnë fëmijët se si pjerrtësia e tokës sjell stinët?
- A e shqyrtojnë fëmijët rrotullimin e hënës rreth Tokës si matje e muajve?
- A mësojnë fëmijët për gjatësinë dhe gjerësinë dhe mënyrën si caktohet ora nga gjerësia zero në Greenwich?
- A i shqyrtojnë fëmijët periudhat kohore gjeologjike në historinë e Tokës?
- A i hulumtojnë fëmijët mënyrat e ndryshme të krijimit të kalendarëve dhe si kanë ndryshuar ata?

Toka dhe hëna e saj

- A e shqyrtojnë fëmijët origjinën e hënës si pjesë e Tokës e ndarë nga ndikimi i një planeti tjetër?
- A e studiojnë fëmijët përbërjen e hënës dhe implikimet e zbulimit të ujit në të?
- A e hulumtojnë fëmijët madhësinë dhe distancën nga Toka në hënë dhe si kjo e lejon eklipsin total të diellit?
- A e shqyrtojnë fëmijët si hëna krijon rryma?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si rrymat do të ndikoheshin nëse hëna do të ishte më afër Tokës?
- A e hetojnë fëmijët se si rrotullimi dhe stabiliteti i Tokës do të ndikohet nga rritja e distancës së hënës nga Toka?

Oqeanet

- A mësojnë fëmijët për oqeanet dhe si ndikojnë ata dhe si ndikohen nga moti?
- A mësojnë fëmijët për transmetimin e energjisë në dallgë?
- A mësojnë fëmijët për efektet e dallgëve dhe rrymave në ndryshimin e peisazheve bregdetare?
- A e hulumtojnë fëmijët mënyrën si krijohet rëra dhe plazhet?
- A mësojnë fëmijët për shkaqet dhe efektet e dallgëve të mëdha ose cunamit?

Toka

- A e hulumtojnë fëmijët se si sipërfaqja e Tokës lëviz përgjatë vijave në pllakat tektonike?
- A i shqyrtojnë fëmijët kontinentet dhe lëvizjen e tyre të vazhdueshme?
- A e konsiderojnë fëmijët formimin e maleve, luginave, lumenjve dhe liqeneve dhe peisazheve të tjera?
- A mësojnë fëmijët për strukturën e shkëmbinjve në sipërfaqen e planetit dhe si dhe kur u formuan shkëmbinjte?
- A mësojnë fëmijët për përbërjen e dheut?

Brenda tokës

- A mësojnë fëmijët për strukturën e brendshme të tokës?
- A e studiojnë fëmijët se si shpaloset brendia e tokës në tërmete dhe vullkane, gejzere dhe spa-të?

Materialet e tokës

- A mësojnë fëmijët për përbërjen e tokës, elementët e saj natyralë dhe molekulat?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën se si elementët dhe molekulat ekzistojnë natyrshëm si gazra, lëngje por kryesisht lëndë të ngurta?
- A mësojnë fëmijët se si atomet dhe molekulat mund të riorganizohen për të formuar gazra, lëngje dhe lëndë të ngurta?
- A mësojnë fëmijët se si u formuan elementët e tokës gjatë ciklit të jetës së yjeve?
- A e studiojnë fëmijët strukturën e brendshme të atomeve?

Burimet nga toka

- A mësojnë fëmijët se si disa prej materialeve të tokës, si diamanteve dhe arit, ju është dhënë vlerë e veçantë financiare nga njerëzit?
- A mësojnë fëmijët se si burimet e tokës shfrytëzohen dhe janë shfrytëzuar për përfitime personale dhe përfitime njerëzore në shpime, miniera dhe në gurore?

Atmosfera dhe struktura e saj

- A mësojnë fëmijët për përbërjen e atmosferës, si është formuar ajo, rëndësinë e saj për ruajtjen e jetës dhe si dhe pse ndryshon?
- A e shqyrtojnë fëmijët si ruhet atmosfera?
- A e konsiderojnë fëmijët trashësinë e shtresës së atmosferës në lidhje me diametrin e tokës?
- A mësojnë fëmijët për cilësitë izoluese të atmosferës?
- A mësojnë fëmijët se si materia e atmosferës më afër tokës është më e përqendruar?
- A mësojnë fëmijët se si temperatura e atmosferës më afër tokës është më e nxehtë?
- A e shqyrtojnë fëmijët rëndësinë e shtresës së ozonit në thithjen e rrezatimit?
- A mësojnë fëmijët për efektet e ndryshme të tokës dhe detit në temperaturën e ajrit?
- A mësojnë fëmijët se si temperatura e atmosferës ndryshon shtypjen e saj?

Klima dhe moti (Shih C1.2 Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit: Uji dhe klima f131)

- A i konsiderojnë fëmijët ndryshimet e klimës nëpër botë dhe si kjo është pasojë e marrëdhënies së Tokës me diellin?
- A e konsiderojnë fëmijët se si ndryshon klima në raport me detin dhe malet?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si krijohen erërat?
- A studiojnë fëmijët se si lëvizin erërat nga shtypja atmosferike e lartë në shtypje atmosferike të ulët?
- A mësojnë fëmijët për formimin e stuhive, shtrëngatave, uraganeve, tajfuneve, tornadove, stuhive të rërës?
- A i shqyrtojnë fëmijët efektet e erërave normale si musonet dhe alizet në atë se si njerëzit e planifikojnë jetën dhe lëvizjet e tyre?
- A mësojnë fëmijët për rrymat e oqeanit dhe sistemet e motit: Rrymën e Golfit, El Niño dhe El Niña?
- A mësojnë fëmijët për rrymat e ajrit dhe si kjo ndikon në fluturimet për aeroplanët?

Kuptimi i ndryshimeve klimatike

- A e shqyrtojnë fëmijët natyrën e gazrave serë, burimet e tyre dhe kohëzgjatjen e tyre në atmosferë?
- A i kuptojnë fëmijët avujt e ujit si gaz serrë që kontribuon me një efekt shumëfishues kur temperaturat rriten?

- A i hulumtojnë fëmijët efektet e industrializimit në shfrytëzimin e lëndëve djegëse fosile dhe prodhimin e gazrave serrë?
- A mësojnë fëmijët se si funksionon efekti serrë dhe si përshpejtohet ngrohja globale?
- A e shqyrtojnë fëmijët kontributin e aktivitetit njerëzor në prodhimin e gazrave serrë dhe ndryshimin e klimës përmes përdorimit të lëndëve djegëse fosile, shkatërrimit të pyjeve dhe konsumit të rritur të mishit dhe mallrave të prodhuara?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si ngrohja globale shkakton: ndryshime në sjelljen e kafshëve dhe bimëve; humbjen e pyjeve; ndryshimin e rrjedhave të sëmundjes; motin ekstrem; shira më të shpejtë monson, rritje të nivelit të detit, përmytje dhe rrëshqitje; humbje të akullit në Arktik dhe Antarktik; shkrirje të akullnajave, humbje të reflektimit të rrezatimit të nxehtësisë nga bora, dhe kërcënimet për furnizimin me ujë dhe sigurinë e ushqimit?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si nivelet e rritura të dioksidit të karbonit në atmosferë acidifikojnë detet me pasoja për koralet dhe format e tjera jetësore në det?
- A mësojnë fëmijët në lidhje me humbjen e permafrostit - uji i ngrirë i tokës - që ndikon në një të katërtën e tokës së hemisferës veriore dhe se si kjo çon në rënien e pemëve dhe ndërtesave dhe lirim të metanit dhe dioksidit të karbonit nga lënda organike e vdekur?
- A e shohin fëmijët mohimin e ndryshimeve klimatike si ekstremizëm të rrezikshëm?

Luftimi i ndryshimeve klimatike

- A e hulumtojnë fëmijët se si ngrohja globale mund të ngadalësohet dhe reduktohet nga efica e energjisë, konsumi më i ulët, varësia e reduktuar nga lëndët djegëse fosile dhe rritja e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë?
- A mësojnë fëmijët për argumentet për dhe kundër energjisë bërthamore si mënyrë për të reduktuar varësinë nga lëndët djegëse fosile?
- A i shqyrtojnë fëmijët argumentet për dhe kundër përdorimit të tokës për biomasë?
- A i konsiderojnë fëmijët argumentet për dhe kundër kompanive dhe qeverive që kompensojnë emetimin e gazrave serrë duke mbjellë pemë ose blerë kredi për ndotje nga konsumatorët e ulët të energjisë?
- A mësojnë fëmijët në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare për të luftuar ndryshimet klimatike dhe çfarë thonë përkrahësit dhe kritikët për to?
- A e hetojnë fëmijët mënyrën se si njerëzit janë adaptuar me ndryshimet klimatike?
- A mësojnë fëmijët për përpjekjet për t'u adaptuar me jetën ku konsumohet më pak, rritet ushqim organik lokal dhe reduktohet përdorimi i lëndëve djegëse fosile në lëvizjet e tilla si 'Transitions'?

Planeti dhe etika (Shih A2.3 Shkolla inkurajon respektimin e integritetit të planetit Tokë, faqe 93.)

- A e eksplorojnë fëmijët se si ruajtja e burimeve është një domosdoshmëri për mirëqenien e njerëzve dhe të kafshëve?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si mbulimi më i pakët me akull në Arktik dhe Antarktik mund t'i inkurajojë disa që të shfrytëzojnë më tej burimet e Tokës?
- A mësojnë fëmijët se si veprimi njerëzor mund të zvogëlojë përkeqësimin mjedisor të planetit?
- A eksplorojnë fëmijët se si degradimi i mjedisit dhe ngrohja globale ndikojnë te disa njerëz më shumë se tek të tjerët, sipas varfërisë, gjinisë dhe pushtetit?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si varfëria dhe pasuria mund të çojnë në mungesën e ruajtjes së burimeve të shterueshme?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A mësojnë fëmijët se si klimat kanë ndryshuar në të kaluarën dhe si mund të ndryshojnë në të ardhmen?
- A mësojnë fëmijët se si u rregullua koha në mbarë botën?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën se si mjediset janë përkeqësuar dhe janë përmirësuar në nivel lokal dhe global?
- A i konsiderojnë fëmijët presionet e mundshme të ardhshme në mjedis nga rritja e popullsisë dhe konsumit nga ta?

C1.8 Fëmijët studiojnë jetën në tokë.

A2.3 Shkolla inkurajon respektimin e integritetit të planetit Tokë; 12 Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit; B1.13 Shkolla kontribuon në reduktimin e mbeturinave; C1.2 Fëmijët hulumtojnë rëndësinë e ujit; C1.5 Fëmijët shqyrtojnë si dhe pse njerëzit lëvizin në lokalitetin e tyre dhe nëpër botë; C1.7 Fëmijët studiojnë jetën në Tokë, sistemin diellor dhe universin; C1.9 Fëmijët hetojnë rreth burimeve të energjisë.

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A nxiten fëmijët të shënojnë, përmes shkrimit, vizatimit, videove, audiove dhe fotografive, shumëllojshmërinë e jetës së kafshëve dhe bimëve brenda ndërtesave, terrenit dhe rrethinës së shkollës?
- A angazhohen fëmijët në projekte për restaurimin e rrëqeve, lumenjve, bimëve dhe kafshëve të egra të rrezikuara?
- A është e lidhur shkolla me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare që mund të ofrojnë mundësi për të eksploruar diversitetin e bimëve dhe kafshëve?
- A e shfrytëzon shkolla mbështetjen e shoqërive lokale të kopshtarisë, bletarëve, fidanishteve, organizatave për mirëqenien e kafshëve, konservatorëve, aktivistëve të mjedisit?
- A i përgjigjen mësimet ndryshimeve në stinë, kultivimit të pemëve dhe bimëve të tjera dhe migrimit të zogjve dhe kafshëve të tjera?
- A i konsiderojnë fëmijët efektet e maceve të tyre në zogj dhe gjitarë të vegjël?
- A ka shkolla pellg për të studiuar gjallesat e pellgjeve dhe bimët ujore?
- A rriten në mjediset e shkollës bimë që janë tërheqëse për fluturat dhe insektet e tjera?
- A kontribuon shkolla në zhvillimin e popullatave të zogjve lokal, përmes ushqyerjes, foleve dhe fushatave për ruajtjen e habitateve?
- A e inkurajon shkolla sigurimin e habitateve për krijesa të rrezikuara nga përkeqësimi mjedisor, si bletët dhe bretkosat?
- A rriten në mjediset e shkollës bimë që i përshtaten kushteve klimatike lokale?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën se si kafshët dhe bimët i përshtaten kushteve në pjesë të ndryshme të botës?
- A kontribuojnë fëmijët duke sjellë specie në një klasë ose në shfaqjen e specieve lokale dhe/ose nga bota, duke treguar se ku gjenden ato dhe në çfarë numri?

Parimet ekologjike

- A konsiderohen parimet ekologjike si mënyrë për të lidhur drejtimin e një shkolle me parimet që e mbështesin jetën? ⁵⁷
- A shihen ndërvarësia dhe konkurrenca dhe dominimi si parimi kryesor i botës së gjallë dhe a përdoret si një metaforë udhëzuese për shkollën?
- A konsiderohet se gjallesat ekzistojnë në rrjete të ndërvarura reciprokisht?⁵⁸
- A konsiderohet se jeta mbështetet në sisteme të ndërlidhura, secila e varur nga marrëdhëniet e saj me një sistem më të gjerë dhe përfundimisht me planetin dhe universin?
- A konsiderohen se ndërveprimet brenda ekosistemeve kontrollohen nga ciklet e ujit dhe lëndët e tjera ushqyese?
- A konsiderohet se jeta varet nga rrjedhat e energjisë që fillojnë nga energjia e diellit?
- A konsiderohet se të gjitha mjediset janë në gjendje konstante të zhvillimit?
- A konsiderohet se ekosistemet e shëndetshme (komunitetet biologjike në mjedise fizike të ndryshme) janë vetërregulluese, në gjendje të ekuilibrit dinamik?
- A e kuptojnë fëmijët se balanci i eko-sistemeve mund të çrregullohet aq shumë sa të ndalojë vetërregullimin?

⁵⁷ Shembull, i iniciuar nga një student 15 vjeçar, është dhënë të Stone, M. (2009) *Smart by Nature : Schooling for sustainability* [Mësojmë përmes natyrës: shkollimi për qëndrueshmëri], pp174-183, Healdsburg, Watershed Media.

⁵⁸ Gjashtë nocionet në italics këtu janë nga Fritjof Capra (2005), *Speaking nature's language* in Stone M. and Barlow Z. eds. *Ecological Literacy: Educating our children for a sustainable world.* [Edukimi i fëmijëve tanë për një botë të qëndrueshme.] San Francisco, Sierra Club Books.

Qëndrimet ndaj gjallesave të tjera

- A i eksplorojnë fëmijët ndjenjat e tyre për botën natyrore të bimëve, kafshëve dhe mikrobeve?
- A i eksplorojnë fëmijët qëndrimet e veta dhe të njerëzve të tjerë për ruajtjen e kafshëve dhe bimëve?
- A e kuptojnë të rriturit dhe fëmijët mënyrën se si ndajnë ekosistemet me gjallesat e tjera?
- A mësojnë fëmijët se janë bërë nga të njëjtat elemente si gjallesat e tjera?
- A e shqyrtojnë fëmijët nëse ata kanë nevojë për speciet e tjera më shumë sesa speciet e tjera kanë nevojë për ta?
- A e shqyrtojnë fëmijët bukurinë dhe vlerën e kafshëve dhe bimëve që mund të mos i pëlqejnë, si merimangat, kërmijtë, grerëzat, gjarpërinjtë, hithrat dhe gjembat?

Kuptimi i diversitetit

- A studiojnë fëmijët për shumëllojshmërinë e gjallesave duke përfshirë kafshët, bimët, kërpudhat, bakteret dhe organizmat e tjerë njëqelizorë?
- A e eksplorojnë fëmijët idenë se shumica dërrmuese e organizmave të gjallë janë mikroorganizma njëqelizorë?
- A mësojnë fëmijët se shumica dërrmuese e kafshëve janë insekte?
- A shihet se diversiteti përfshin ekosistemet, larminë e llojeve dhe variacionet gjenetike brenda një specieje?
- A mësojnë fëmijët për shumëllojshmërinë e ekosistemeve në tokë, në ujë dhe në mes tyre?
- A e kuptojnë fëmijët rëndësinë e kimikateve, shkëmbinjve, dheut, strehimit, ushqimit, oksigjenit dhe ujit brenda ekosistemeve?
- A mësojnë fëmijët se si bimët, kafshët, mikroorganizmat dhe mjedisi i tyre bashkëveprojnë për të formuar ekosisteme vetëmbajtëse?
- A janë të vetëdijshëm fëmijët se si ata varen për mirëqenien e tyre nga shëndeti i specieve të tjera, si bletët për pjalmim dhe bakteret për tretje, fiksimin e azotit dhe kompostimin?
- A i hulumtojnë fëmijët mënyrat se si diversiteti i specieve ndryshon me klimën, lartësinë, grabitqarët dhe suksesin me të cilin specie të veçanta e kolonizojnë një ekosistem?
- A e hulumtojnë fëmijët shkallën në të cilën zbulohen dhe humben speciet e reja, edhe para se të zbulohen?

Kuptimi i evolucionit

- A e hulumtojnë fëmijët se si përmes fosileve shihet biodiversiteti në periudha të ndryshme gjeologjike?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si kontribuojnë fosilet për ta kuptuar evolucionin?
- A mësojnë fëmijët për natyrën e specieve dhe si kanë evoluar ato?
- A mësojnë fëmijët për arsyet pse speciet mbijetojnë, përhapen ose zhduken?

Klasifikimi i gjallesave dhe ekosistemeve

- A i eksplorojnë fëmijët mënyrat e ndryshme në të cilat mund të grupohen gjallesat, si nga dukja, ato që mund të bëhen bashkë për dhënë pasardhës, dobia për ushqim ose ilaçe dhe madhësia?
- A i hulumtojnë fëmijët mënyrat e ndarjes së gjallesave në mënyrë hierarkike nga domenet në specie?
- A mësojnë fëmijët se si ekosistemet e ndryshme mund të grupohen në biome në lidhje me klimën, gjerësinë, lartësinë dhe ujin e ëmbël dhe oqeanet?

Kuptimi i sistemeve të mbështetjes së jetës

- A i hulumtojnë fëmijët zinxhirët e ushqimit dhe rrjetet ushqimore?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si rrjetat ushqimore përfshijnë diellin, prodhuesit e bimëve, konsumuesit kafshë, kafshët që ushqehen me kërra dhe dekompozuesit fungal dhe bakterial?
- A mësojnë fëmijët për ciklin e azotit dhe si kontributi i tij në balancin ekologjik mund të ndërpritet nga përdorimi i tepruar i plehrave kimike?

- A mësojnë fëmijët për ciklin e karbonit dhe si kontributi i tij në balancin ekologjik mund të ndërpritet nga humbja e pyjeve dhe përdorimi i lëndëve djegëse me bazë karboni?
- A mësojnë fëmijët për ciklin e ujit dhe si mund të pengohet disponueshmëria e ujit për gjallesat nga ndotja dhe vënia e digave dhe devijimi i lumenjve?

Struktura e gjallesave

- A mësojnë fëmijët për strukturën e brendshme të bimëve dhe kafshëve?
- A mësojnë fëmijët për larminë e qelizave të ndryshme në bimë dhe kafshë?
- A mësojnë fëmijët se si të gjitha qelizat në kafshë formohen nga qelizat e përbashkëta në embrion?
- A mësojnë fëmijët për gjenet dhe kromozomet?
- A mësojnë fëmijët për gjenomet unike të secilës specie?
- A hulumtojnë fëmijët për paraardhësit e zbuluar në gjenoma të bimëve dhe kafshëve të ndryshme?
- A mësojnë fëmijët se si gjenet mund të modifikohen në mënyrë natyrale dhe artificiale?
- A mësojnë fëmijët se si gjallesat janë të ndërtuara nga molekulat?
- A mësojnë fëmijët se si molekulat nga të cilat ndërtohen gjallesat bazohen në një numër të vogël të numrit total të elementeve kimike (59% hidrogjen, 24% oksigjen, 11% karbon, 4% azot, 2% të tjerë)?
- A mësojnë fëmijët se si ndërveprimet e molekulave të gjallesave hulumtohen në biokimi?
- A e hulumtojnë fëmijët përbërjen e skeleteve, guacave dhe koraleve?

Kërcënimet ndaj biodiversitetit

- A mësojnë fëmijët për normën e përshpejtuar së humbjes së specieve të kafshëve dhe bimëve, në nivel global?
- A i shqyrtojnë fëmijët shkaqet e zhdukjeve në masë të specieve në të kaluarën dhe kërcënimin nga njerëzit në 'zhdukjen e tanishme të holocenit'?

Rritja e popullsisë njerëzore dhe konsumi

- A i konsiderojnë fëmijët efektet e rritjes së popullsisë njerëzore (nga 2.5 miliardë në vitin 1950 në 7 miliardë vlerësuar për vitin 2012) në habitatet e bimëve dhe kafshëve?
- A e shqyrtojnë fëmijët se sa ngadalë popullsia njerëzore i përgjigjet reduktimeve në normat e fertilitetit njerëzor?
- A i hulumtojnë fëmijët mënyrat se si rritja e popullsisë reduktohet me reduktimet në varfëri?
- A e hulumtojnë fëmijët se si efektet e rritjes së popullsisë njerëzore varen nga sasia e burimeve të shtershme që konsumohen si rezultat?

Gjuetia

- A hulumtojnë fëmijët për kërcënimin që iu kanoset specieve nga gjuetia dhe peshkimi legal dhe ilegal?
- A hulumtojnë fëmijët për tregtinë ndërkombëtare në specie të rrezikuara?

Humbja e habitatit

- A e dokumentojnë fëmijët shkallën e zvogëlimit të pyjeve në vendet e tyre dhe implikimin për ruajtjen e specieve të kafshëve dhe bimëve?
- A i konsiderojnë fëmijët e implikimeve që paraqiten nëse kemi gjysmën e diversitetit të specieve brenda pyjeve tropikale?
- A e shqyrtojnë fëmijët humbjen e habitatit nga rritja e urbanizimit dhe rrjeteve rrugore?
- A e shqyrtojnë fëmijët fragmentimin e habitatit nga rrugët dhe bujqësia?
- A i shqyrtojnë fëmijët humbjet e habitateve nga tharja e ligatinave?

Ndotja dhe sëmundjet

- A mësojnë fëmijët rreth presioneve të veçanta në habitatet e ujërave të ëmbla nga ndotja?
- A i shqyrtojnë fëmijët ndikimet në biodiversitet për shkak të përdorimit të herbicideve dhe insekticideve?
- A hetojnë fëmijët për rritjen e mbetjeve industriale dhe ujërave të zeza të patrajuara në lumenj dhe në det?
- A e shqyrtojnë fëmijët kërcënimin e biodiversitetit nga sëmundjet e bimëve dhe kafshëve?

Paraqitja dhe humbja e specieve

- A i konsiderojnë fëmijët ndikimet e mundshme negative në bimët lokale që ka paraqitja e bimëve nga ekosistemet e tjera më të afta për të konkurruar për lëndët ushqyese, ujin dhe dritën?
- A i konsiderojnë fëmijët efektet e paraqitjes së kafshëve më të afta për të konkurruar për ushqim dhe ujë nga një tjetër ekosistem?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën e se si humbja e një bime ose kafshe nga ekosistemi ndikon në mbijetesën e bimëve dhe kafshëve të tjera?

Metodat e bujqësisë dhe peshkimit

- A e konsiderojnë fëmijët kërcënimin ndaj specieve nga mbishfrytëzimi i tokës dhe deteve?
- A hulumtojnë fëmijët zvogëlimin e madh të llojeve të kulturave bujqësore që përdoren si pasojë e metodave të bujqësisë industriale në vendin e tyre dhe vendet e tjera në krahasim me shumëllojshmërinë e kulturave në vendet që përdorin metoda më pak të mekanizuara?
- A mësojnë fëmijët se si metodat dhe intensiteti i peshkimit ndikon në speciet detare?
- A mësojnë fëmijët se si zvogëlimi i diversitetit gjenetik (përmes kultivimit selektiv) mund t'i bëjë bimët më të ndjeshme ndaj sëmundjeve?
- A i konsiderojnë fëmijët kërcënimet e diversitetit gjenetik nga kulturat e modifikuara gjenetiksht?

Ndryshimi klimatik (C1.7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin, faqe 144.)

- A hulumtojnë fëmijët për ndikimet që kanë në biodiversitet ndryshimet të shkaktuara nga njeriu?

Përmirësimi i biodiversitetit


- A hulumtojnë fëmijët për përpjekjet e ruajtjes së kafshëve dhe bimëve në vendin e tyre dhe në mbarë botën?
- A harton shkolla plan për rritjen e biodiversitetit përreth saj?
- A mësojnë të rriturit dhe fëmijët për mënyrat e inkurajimit të jetës së egër në fshatra, krahas kultivimit të tokës për rritjen e ushqimit?
- A hulumtojnë fëmijët për mënyrën se si stoqet e peshqve dhe kafshëve mund mund të rikthehen me anë të kufizimeve në peshkim dhe gjueti?
- A e shqyrtojnë fëmijët masën në të cilën kopshtet zoologjike mund të kontribuojnë në ruajtjen e specieve?
- A hulumtojnë fëmijët për shkallën në të cilën rikthehet humbja e habitateve për kafshët dhe bimët?
- A e shqyrtojnë fëmijët se mund të ndryshohen metodat bujqësore për ta kthyer reduktimin e biodiversitetit?
- A mësojnë fëmijët për riparaqitjen e specieve vendase në habitatet që ato zinin më parë?
- A mësojnë fëmijët se si mund të rikuperohet toka e degraduar, si pllaja e Loess-it në Kinë?

Biodiversiteti dhe etika

- A e shqyrtojnë fëmijët se si varfëria mund të çojë në neglizhimin e mjedisit?
- A inkurajohen fëmijët të vlerësojnë bukurinë në diversitetin e gjallesave që jetojnë në habitatet e tyre natyrore?
- A i shqyrtojnë fëmijët argumentet për dhe kundër ruajtjes së diversitetit të bimëve dhe kafshëve?
- A janë të vetëdijshëm fëmijët për vetitë shëruese të bimëve dhe numrin e vogël të bimëve që janë studiuar për këto veti?
- A hulumtojnë fëmijët për mënyrën se si larmia në speciet e bimëve mund të ofrojë lloje të reja ushqimi kur të korrat bëhen të ndjeshme ndaj insekteve apo sëmundjeve?
- A i konsiderojnë të rriturit dhe fëmijët efektet që kanë në ruajtjen e biodiversitetit Konventa Ndërkombëtare për Diversitetin Biologjik dhe Strategjitë Kombëtare të Biodiversitetit dhe Planet e veprimit (NBSAP) që rrjedhin nga ajo?
- A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët masën në të cilën nuk u arritën objektivat ndërkombëtare për ta ulur humbjen e specieve deri në vitin 2010?
- A e shqyrtojnë të rriturit dhe fëmijët mënyrën se si janë të rregulluara korporatat ndërkombëtare dhe si mund të rregullohen për ta korrigjuar ndotjen, mbishfrytëzimin dhe reduktimin e habitateve?
- A e shqyrton shkolla vlerën e lidhjes së saj me dekadën e Kombeve të Bashkuara për biodiversitetin 2011-2020?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A e shqyrtojnë fëmijët si ka ndryshuar peisazhi në zonën e tyre, për shembull përmes pranisë së shkurreve dhe pemëve, kultivimit, ndërtimit të rrugëve, ndërtesave dhe efektin të kafshët dhe bimët?
- A i hulumtojnë fëmijët mënyrat e ndryshme në të cilat gjallesat janë grupuar historikisht në vendin e tyre dhe nga njerëzit e ndryshëm nëpër botë?
- A e shqyrtojnë fëmijët mënyrën se si kanë ndryshuar kafshët në vendin e tyre dhe në vende të tjera?
- A e konsiderojnë fëmijët të ardhmen nëse vazhdojnë normat e tanishme të humbjes së specieve?
- A e shqyrtojnë fëmijët të ardhmen nëse humbja e specieve ngadalësohet dhe ndalohe dhe si mund të arrihet kjo?



Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlera gjithëpërfshirëse

C1.9 Fëmijët hetojnë rreth burimeve të energjisë.

B1.12 Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit; C1.7 Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin; C1.8 Fëmijët studiojnë jetën në tokë.

Lidhja në nivel lokal dhe global

(Shih B1.12 faqe 113 për aktivitetet që lidhin përdorimin e lëndëve djegëse me shkollën dhe zonën lokale)

- A hulumtojnë fëmijët për mënyrat e ndryshme të prodhimit të rrymës elektrike në lokalitetin e tyre?
- A e gjurmojnë fëmijët furnizimin me energji elektrike nga prodhimi deri në shkollat dhe shtëpitë e tyre?
- A e gjurmojnë fëmijët furnizimin me gaz, benzinë dhe naftë nga nxjerrja te përdorimi në shtëpi dhe në shkollë?
- A kontribuojnë në kurrikulë furnitorët e lëndëve djegëse dhe përdoruesit e paneleve diellore, turbinave me erë dhe pompave termike të ngrohjes?
- A mësojnë fëmijët se si përdoren lëndët djegëse në pjesë të ndryshme të botës?
- A mësojnë fëmijët se sa shpenzohet lëndë djegëse nga grupe të ndryshme të njerëzve në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?

Kuptimi i energjisë

- A e diskuton stafi 'energjinë' në një mënyrë që i ndihmon fëmijët të kuptojnë botën e tyre në ndryshim duke e shmangur konfliktin me termin që përdoret në fizikë?
- A kuptohet energjia si kapacitet për ta shtyrë diçka të lëvizë; një kapacitet për të bërë punë?
- A kuptohen njerëzit dhe kafshët si burime energjie që mund të vënë në punë makineri dhe të bartin ngarkesa?
- A e shqyrtojnë fëmijët nga vjen energjia në trupin e tyre?
- A mësojnë fëmijët se si burimet e energjisë nevojiten për gatim, ngrohje, ftohje, ndriçim, pajisje shtëpiake dhe makineri industriale dhe transport?
- A e konsiderojnë fëmijët shkallën në të cilën dielli është burim i energjisë në tokë?
- A mësojnë fëmijët se si energjia nga dielli kontribuon në krijimin e lëndëve djegëse me bazë karboni dhe burimeve të tjera të energjisë si erërat dhe valët?
- A e kuptojnë fëmijët si bimët e shndërrojnë energjinë nga dielli në ushqim dhe lëndë djegëse?
- A e konsiderojnë fëmijët origjinën e energjisë që vjen nga bërthama e tokës, nga rrymat dhe fisionet bërthamore?
- A e konsiderojnë fëmijët se si energjia diellore filloi pas formimit të Universit që përfshinte kolapsin gravitacional të materies dhe fisionin bërthamor?
- A reflektojnë fëmijët nëse shuma totale e energjisë dhe e materies në një univers në të cilin ruhet energjia është zero nëse universi ka filluar nga zero materie dhe energji?
- A hulumtojnë fëmijët se si energjia nga brendësia e tokës ka rezultuar në kontinente, vargmale, vullkane shpërthyesë dhe tërmete?
- A e kuptojnë fëmijët se energjia ka forma të ndryshme (magnetike, kinetike, ngrohje/termike, e dritës/rrezatuese, e zërit, kimike, elektrike, gravitacionale, elastike, nukleare)?

Burimet e energjisë së ripërtërishme dhe jo të ripërtërishme

- A mësojnë fëmijët për energjinë e ripërtërishme nga dielli, era, lumenjtë, bimët apo biomasa, valët, pompat e nxehtësisë dhe burimet gjeotermale?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si hidrogjeni mund të prodhohet si lëndë djegëse e ripërtërishme që mund të arrihet duke përdorur burime të tjera të energjisë, të ripërtërishme dhe jo të ripërtërishme?
- A mësojnë fëmijët se si përdoret druri si burim i ripërtërishëm dhe jo i ripërtërishëm i lëndës djegëse në pjesë të ndryshme të botës?

- A e hulumtojnë fëmijët se si era është përdorur si burim i drejtpërdrejtë i energjisë në mullinj të erës?
- A mësojnë fëmijët se si qymyri, nafta, gazi dhe uranumi janë burime jo të ripërtëritshme?
- A hetojnë fëmijët si burimet jo të ripërtëritshme të energjisë nxjerren nga toka dhe detet?
- A mësojnë fëmijët se si nafta rafinohet për përdorim në motorë me benzinë, naftë dhe motorët e avionit?

Prodhimi i energjisë elektrike

- A mësojnë fëmijët se si prodhohet energjia elektrike nga konvertimi i burimeve të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme të energjisë?
- A mësojnë fëmijët se si mund të prodhohet energjia elektrike duke përdorur burime të ripërtëritshme nga lumenjtë, valët dhe rrymat, turbinat me erë, burimet gjeotermale, pompat e nxehtësisë duke përdorur dallimet e temperaturës dhe energjinë diellore?
- A mësojnë fëmijët se si mund të prodhohet energjia elektrike nga burime jo të ripërtëritshme të energjisë në centrale me qymyr, gaz dhe bërthamore?
- A mësojnë fëmijët për përdorimin e avullit në gjenerimin e energjisë elektrike?
- A mësojnë fëmijët për turbo-alternatorët dhe rolin e magnetizimit brenda tyre?
- A mësojnë fëmijët se sa i përgjigjet gjenerimi i rrymës elektrike reduktimit të shfrytëzimit të energjisë elektrike në shtëpi dhe shkolla?

Furnizimi me energji dhe ruajtja

- A mësojnë fëmijët se si transportohen lëndët djegëse?
- A mësojnë fëmijët se si ruhen lëndët djegëse?
- A mësojnë fëmijët se si gazet mund të ruhen si lëngje?
- A mësojnë fëmijët se si shpërndahet energjia elektrike në shtëpi dhe ndërtesa në rrjetin kombëtar?
- A mësojnë fëmijët se si prodhimi lokal i energjisë elektrike mund të kontribuojë në rrjetin kombëtar?
- A mësojnë fëmijët se si energjia elektrike mund të ruhen në bateri?

Biznesi me lëndë djegëse

- A mësojnë fëmijët se kush fiton para nga nxjerrja dhe shpërndarja e lëndëve djegëse, gjenerimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike?
- A i shqyrtojnë fëmijët kostot përkatëse të prodhimit të energjisë elektrike duke përdorur burime të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme?
- A hulumtojnë fëmijët se si kushtet financiare mund të ndryshojnë duke e favorizuar prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme ose jo të ripërtëritshme?
- A e konsiderojnë fëmijët masën në të cilën është në interes të prodhuesve të energjisë që të inkurajojnë konsumin në vend të ruajtjes?

Zvogëlimi i përdorimit të lëndëve djegëse me bazë karboni

- A e shqyrtojnë fëmijët sa është energjia elektrike e gjeneruar nga lëndët djegëse jo të ripërtëritshme me bazë në fosile (90%), implikimet për emetimet e gazrave serrë dhe si kjo mund të zvogëlohet?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si mund të zvogëlohet kërkesa për energji elektrike duke e përdorur atë në mënyrë më efikase?
- A e konsiderojnë fëmijët se si përdorimi i lëndëve djegëse me bazë karboni mund të zvogëlohet duke e ulur konsumin e mallrave që varen prej tyre?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si mund të sfidojnë presionet për të konsumuar nga qeveritë, reklamat, dyqanet dhe korporatat?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si dëshira për konsumim bëhet pjesë e identitetit tonë, kështu që konsumimi na bën të ndihemi mirë?
- A e hulumtojnë fëmijët masën në të cilën ne duhet ta ndryshojmë veten nëse duam të konsumojmë më pak?

Etika dhe lëndët djegëse

- A mësojnë fëmijët për rreziqet që ka nxjerrja e naftës, gazit, qymyrit dhe uraniumit të zbërthueshëm nga toka dhe detet për njeriun dhe mjedisin?
- A e hetojnë fëmijët shkallën në të cilën qytetarët e një shteti prodhues së lëndëve djegëse përfitojnë nga nxjerrja e naftës ose lëndëve të tjera djegëse nga toka e tyre?
- A mësojnë fëmijët për ndryshimin e disponueshmërisë së drurit si lëndë djegëse dhe për pasojat mjedisore të përdorimit të tij?
- A i shqyrtojnë fëmijët argumentet për dhe kundër pronësisë kombëtare të nxjerrjes së lëndëve djegëse dhe prodhimit të energjisë elektrike?
- A mësojnë fëmijët për rreziqet që paraqet për mjedisin nxjerrja e burimeve më pak të qasshme të naftës nën det ose nën shtresat e akullit?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si vendet hyjnë në luftë për ta siguruar furnizimin e tyre me naftë dhe gaz?
- A mësojnë fëmijët për pasojat e prodhimit në masë të madhe të biomasës (nga bimët) për shkatërrimin e habitateve të kafshëve dhe bimëve dhe disponueshmërinë më të vogël të tokës për kultivimin e ushqimit?
- A i mësojnë fëmijët për ndikimet e prodhimit të biomasës në çmimin e ushqimit?
- A i krahasojnë fëmijët kostot e njerëzve dhe rreziqet e formave të ndryshme të prodhimit të energjisë?
- A i shqyrtojnë fëmijët pasojat e mënyrës së organizimit të shoqërive nëse njerëzit duhet të sigurojnë sigurinë e mbetjeve nukleare për qindra vjet?
- A mësojnë fëmijët për ndërlidhjen në mes lëndëve nukleare dhe industrive të armëve?
- A mësojnë fëmijët se si ndryshojnë furnizuesit e energjisë në angazhimin e tyre për përdorimin e burimeve të ripërtëritshme dhe si kjo mund të ndikojë në zgjedhjet e bëra nga familjet dhe shkollat?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A mësojnë fëmijët për pikun e naftës dhe si njerëzit do të përshtaten me rënien e disponueshmërisë së naftës?
- A hulumtojnë fëmijët se si disponueshmëria e naftës ka ndikuar në zhvillimin e motorëve me benzinë, naftë dhe motorëve të avionit?
- A mësojnë fëmijët se si njerëzit kanë ndezur dhe e kanë ngrohur shtëpinë e tyre dhe si kanë gatuar në të kaluarën?
- A eksplorojnë fëmijët për ndryshimin në përdorimin e drurit, torfës, qymyrit, gazit dhe naftës?
- A mësojnë fëmijët se si dhe pse po ndryshon konsumi i lëndëve djegëse në pjesë të ndryshme të botës?
- A e mendojnë fëmijët se si njerëzit do t'i ngrohin shtëpitë e tyre në të ardhmen, si do të udhëtojnë dhe si do t'i bëjnë gjërat?



Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

C1.10 Fëmijët mësojnë rreth komunikimit dhe teknologjisë së komunikimit.

A1.8 Shkolla e inkurajon kuptimin e ndërlidhjeve në mes njerëzve nëpër botë; C1.11 Fëmijët angazhohen dhe merren me krijime në literaturë, art dhe muzikë.

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A kontribuojnë në kurrikulë gazetarët dhe pronarët e gazetave, dizajnerët e uebfaqeve, prodhuesit e harduerëve dhe softuerëve, shkrimtarët dhe bizneset e telefonisë?
- A hulumtojnë fëmijët se kush nëpër botë flet gjuhët që fliten nga fëmijët në shkollë?
- A komunikojnë fëmijët me të tjerët në nivel lokal dhe në largësi përmes letrave, përmes komunikimit online duke përfshirë emailin dhe përmes telefonit?
- A mësojnë fëmijët për shkallën në të cilën njerëzit komunikojnë në mënyra të ngjashme dhe të ndryshme në mbarë botën, për shembull përmes të folurit dhe shkrimit dhe përdorimit të teknologjisë?
- A është e lidhur shkolla me shkollat e tjera në nivel lokal dhe kombëtar dhe në ndonjë vend tjetër?

Mjetet e komunikimit

- A hulumtojnë fëmijët për komunikimin përmes të folurit, shkrimit, gazetave dhe librave, radios, televizionit, internetit, teknologjisë asistuese, celularëve, telefonave fiks, emaileve dhe rrjeteve sociale?
- A e hetojnë fëmijët rolin që kanë mediet për të ndikuar në qëndrime, besime dhe njohuri?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si ata dhe të tjerët ndikohen nga reklamat?
- A mësojnë fëmijët për zhvillimin e internetit dhe si përdoret?
- A mësojnë fëmijët se deri në ç'masë kompjuterët përdoren në praktikë për të fituar njohuri, për rrjete sociale dhe për të luajtur lojëra?

Shkrim-leximi

- A mësojnë fëmijët të lexojnë në një mënyrë që e zgjon interesimin e tyre dhe ju jep kënaqësi?
- A mësojnë fëmijët të shkruajnë duke u angazhuar në komunikim të vërtetë si shënimi i ngjarjeve, argëtimi ose duke iu treguar të tjerëve në largësi për jetën e tyre?
- A zhvillohet saktësia në shkrim e fëmijëve nga dëshira për të komunikuar?

Gjuhët dhe dialektet

- A mësojnë fëmijët për gjuhët e folura dhe gjuhët e shenjave në botë, përhapjen e tyre gjeografike dhe ndërlidhjen?
- A hulumtojnë fëmijët për arsyet e mësimin të gjuhëve shtesë si për punë, kënaqësi në komunikim me të tjerët nga një vend tjetër dhe për ta ndihmuar turizmin dhe eksplorimin?
- A inkurajohen të gjithë fëmijët dhe të rriturit në shkollë që të mësojnë gjuhë të tjera të folura ose të shenjave?
- A ndihmohen fëmijët që të bëhen folës të rrjedhshëm, lexues dhe shkrimtarë ose përdorues të rrjedhshëm të shenjave të gjuhës së tyre të parë?
- A mësojnë fëmijët se si po reduktohet diversiteti gjuhësor në botë?
- A e hulumtojnë fëmijët se si dhe pse gjuha angleze është bërë gjuha dominante në botë?
- A hulumtojnë fëmijët për efektet që ka gjuha angleze si gjuhë dominante në botë në arsimimin e fëmijëve në vende të tjera?
- A hulumtojnë fëmijët për efektin e internetit në mënyrën se si njerëzit komunikojnë në mbarë botën?

Tejkalimi i pengesave në komunikim

- A e kuptojnë fëmijët se si komunikim mund të mos jetë i qartë përmes përdorimit të kodeve dhe nëpërmjet përdorimit të zhargonit të kuptuar brenda grupeve të veçanta?
- A e konsiderojnë fëmijët se si dialogu varet nga barazimi i pushtetit në mes folësve dhe dëgjuesve?
- A mësohen fëmijëve të dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë dhe reflektojnë me kujdes si ndihmë për komunikim?
- A u mësohet fëmijëve të zhvillojnë saktësi në komunikimin e folur dhe të shkruar?
- A hulumtojnë fëmijët se çfarë e pengon dhe e ndihmon komunikimin në komunitete dhe kultura, brenda dhe mes vendeve?
- A hulumtojnë fëmijët për atë që mund ta pengojë dhe ndihmojë komunikimin midis gjeneratave?
- A mësojnë fëmijët për rolet e ndryshme që luajnë gjestet dhe shprehja e fytyrës në komunikim?

Bizneset e komunikimit dhe teknologjisë së komunikimit

- A eksplorojnë fëmijët për bizneset dhe industritë e telefonisë, televizionet, gazetatat, radiot, reklamimit, harduerit, softuerit, uebfaqeve dhe lojërave kompjuterike?
- A e eksplorojnë fëmijët mënyrën se si softueri e ka ndryshuar ndërveprimin në mes bizneseve, si bankat dhe klientët e tyre?
- A hulumtojnë fëmijët për mënyrën se si softueri i biznesit ka ndryshuar universitetet dhe shkollat?
- A hulumtojnë fëmijët se si njerëzit fitojnë para nga shitjet në internet?
- A e konsiderojnë fëmijët se si ata që krijojnë motorë kërkimi dhe rrjete sociale fitojnë para?
- A e eksplorojnë fëmijët punën e mësimdhënësve, përkthyesve me shkrim dhe me gojë?

Komunikimi, teknologjia e komunikimit dhe etika

- A mësojnë fëmijët për dallimet ndërmjet shtëpive sa i përket qasjes në teknologjinë e komunikimit?
- A mësojnë fëmijët se si burimi i mineraleve për celularë mund të shkaktojë konflikte në vendet e varfra?
- A hulumtojnë fëmijët për përfitimet dhe rreziqet e internetit?
- A e shqyrtojnë fëmijët si dialektet, theksi dhe zgjedhja e fjalorit vlerësohet dhe nënvlerësohet në Angli dhe mund të asociohet me perceptimin për klasën sociale?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A mësojnë fëmijët për të kaluarën nga historitë të treguara gojarisht dhe me shkrim?
- A mësojnë fëmijët se si e kaluara komunikohet përmes të dhënave gjeologjike dhe fosileve, nga ndërtesat dhe objekte të tjera, simbole dhe dokumente?
- A mësojnë fëmijët se si format e komunikimit kanë ndryshuar dhe po ndryshojnë, për shembull me gjuhët që zhduken, rritjen e statusit dhe përhapjen e gjuhës angleze dhe përdorimin e telefonit dhe kompjuterit?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si gjuhët e tjera mund të bëhen më dominuese se gjuha angleze kur ndryshon fuqia ekonomike e vendeve?
- A e hetojnë fëmijët zhvillimin e mjeteve të komunikimit duke përfshirë zjarrin dhe tymin, telegrafin, telefonin, celularët dhe telefonin multimedial?
- A mësojnë fëmijët për zhvillimin e radios dhe televizionit si mjet komunikimi i largët?
- A mësojnë fëmijët se si ndryshimet në mediat e komunikimit kanë ndryshuar mënyrën se si njerëzit e kalojnë kohën e tyre?

C1.11 Fëmijët angazhohen në punë krijuese në literaturë, arte dhe muzikë

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A i inkurajon shkolla artistët lokalë, fotografët, kompozitorët, muzikantët, valltarët, poetët dhe shkrimtarët për të ekspozuar dhe performuar në shkollë dhe për të treguar shkathtësitë e tyre?
- A organizon shkolla festival ku fëmijët dhe të rriturit nga shkolla dhe komunitetet përreth mund të performojnë?
- A inkurajohen fëmijët dhe familjet e tyre të vizitojnë studiot e arteve dhe zejeve lokale?
- A i konsiderojnë fëmijët dallimet nga njëri-tjetrit në atë që ata dëshirojnë të shikojnë, lexojnë dhe dëgjojnë?
- A e hulumtojnë fëmijët si prodhohen librat e tyre të preferuar, programet televizive, filmat?
- A i konsiderojnë fëmijët dallimet në art, muzikë, drama dhe poezi që prodhohen në pjesë të ndryshme të botës?
- A e konsiderojnë fëmijët se si arti, muzika, drama dhe poezia prodhohen në vende të ndryshme të botës?
- A e kuptojnë fëmijët se të gjitha vendet kanë shkrimtarë, artistë, valltarë, muzikantë dhe se qasja vetëm në format tradicionale në vendet në zhvillim mund të çojë në krijimin e stereotipeve?
- A mësojnë fëmijët se të gjitha format e artit përfshijnë një bashkim ndikimesh?

Zhvillimi i interesave

- A shihet secili si shkrimtar kreativ, rrëfimtari, poet, filmbërës, fotograf, këngëtar, valltar, muzikant, aktor, piktor, skulptor, mjeshtër keramike, jorganpunues?
- A inkurajohen nxënësit të zhvillojnë interesat e tyre në arte kreative që nxisin aktivitete jashtë shkollës?
- A ka mundësi të ndryshme për të dëgjuar këngë, muzikë, tregime, poezi dhe për të parë fotografi, filma, drama, vallëzim dhe arte pamore?
- A inkurajohen fëmijët të zbulojnë dhe ndjekin artin, vallëzimin, dramën, muzikën që ata më së shumti e pëlqejnë?

Muzika

- A inkurajohen fëmijët të angazhohen në forma të ndryshme të muzikës?
- A u jepet fëmijëve mundësi të mësojnë dhe luajnë lloje të ndryshme të instrumenteve të blera ose të bëra në shtëpi, si instrumentet me tela, frymor dhe perkusion?
- A mësojnë fëmijët për kompozimin dhe si të përcjellin ndjenjë dhe kuptim?
- A ka mundësi për t'ju bashkuar koreve të ndryshme?
- A e zhvillon shkolla repertorin e saj të këngëve që i dinë të gjithë?
- A lidhet repertori i këngëve me ato që njihen dhe pëlqehen nga fëmijët?
- A ka mundësi për të kënduar këngë të stileve të ndryshme?
- A është repertori i këngëve i lidhur me ato që fëmijët i sjellin nga shkollat e mëparshme?
- A mëson shkolla nga stilet e këndimit në vendet e tjera, për shembull në përdorimin e harmonisë?
- A merren hapa për të kapërcyer ndjenjat e fëmijëve nëse ata mendojnë se këndimi nuk është 'cool' ose kur janë shumë të turpshëm për të kënduar para të tjerëve?
- A studiohet në mësim kontributi që këndimi dhe njohja e teksteve mund të japë për shkrim-lexim?
- A mësojnë fëmijët të shkruajnë tekste?
- A mësojnë fëmijët të shkruajnë dhe interpretojnë këngët e tyre dhe këngët e njëri-tjetrit, për shembull për ngjarjet personale, kombëtare, lokale apo shkollë?

Vallëzimi

- A i mësojnë fëmijët llojet e ndryshme të vallëzimit?
- A inkurajohen fëmijët të gjejnë stilin e tyre të preferuar të vallëzimit?
- A inkurajohen valltarët dhe shkollat e vallëzimit të ndajnë shkathtësitë e tyre në shkollë?

Tregimi i historive

- A inkurajohen fëmijët të zhvillojnë aftësi për të treguar histori?
- A i përdorin fëmijët njohuritë e tyre për të treguar histori në shtëpi dhe komunitetet e tyre?
- A kontribuon zhvillimi i shkathtësisë së fëmijës në tregimin e historive në shkrimin e historive?

Letërsia

- A e ndajnë të rriturit vlerësimin e tyre të ndryshëm për poezinë, prozën dhe dramën?
- A mësojnë fëmijët të vlerësojnë një sërë stilesh të shkrimit dhe të zhvillojnë stilin e tyre?

Poezia

- A inkurajohen fëmijët të shprehin veten në poezi në një stil me të cilin ndihen rehat?
- A ju prezantohen fëmijëve disa stile të shkrimit të poezisë?
- A inkurajohen fëmijët të shkruajnë, ndajnë dhe performojnë poezinë e tyre si një mënyrë për t'iu përgjigjur ndjenjave dhe ngjarjeve?

Drama

- A janë të integruara në kurrikulë një gamë e shkathtësive për dramë, për shembull në shfaqjen e kukullave dhe lojën me role?
- A mësojnë fëmijët të trillojnë, shkruajnë dhe interpretojnë dramën e tyre?
- A përdoret drama për t'i inkurajuar fëmijët të zhvillojnë zëra plot besim, të fuqishëm?
- A e di secili se magjia e teatrit mund të realizohet edhe në mjediset më të thjeshta?
- A mësojnë fëmijët potencialin dramatik të ndriçimit, muzikës dhe mediave të tjera në shfaqjet e dramave?

Filmi dhe televizioni

- A janë të ekspozuar fëmijët ndaj filmave në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera?
- A i krahasojnë fëmijët librat dhe filmat e realizuar nga librat?
- A i përdorin fëmijët filmat dhe programet televizive si një trampolinë për tregimet e tyre?
- A mësojnë fëmijët të bëjnë filmat e tyre, të shkruajnë skenar, të bëjnë filmimin, redaktimin dhe të shtojnë muzikën?

Fotografia

- A mësojnë fëmijët të bëjnë fotografi?
- A diskutojnë fëmijët për atë që u pëlqen dhe nuk u pëlqen për fotografitë?
- A i përdorin fëmijët fotografitë për të ilustruar tregime, për shembull për lokalitetin e tyre dhe për të prodhuar fotostorie?

Biznesi i artit

- A hulumtojnë fëmijët se kush e fiton jetesën nga arti dhe performimi i tij?
- A mësojnë fëmijët se kush bën para nga vënia në skenë dhe blerja dhe shitja e artit?

Arti dhe etika

- A e shqyrtojnë fëmijët se si disa forma të artit nuk janë të qasshme për shkak të kostos së tyre?
- A e marrin parasysh fëmijët censurën, për shembull, nëse duhet të ketë kufizime për paraqitjen e dhunës në film?
- A e shqyrtojnë fëmijët mundësinë që portretizimi i marrëdhënieve shfrytëzuese përfshin marrëdhënie shfrytëzuese?
- A e shqyrtojnë fëmijët vlerën e dallimit ndërmjet arteve dhe zejeve?
- A e shqyrtojnë fëmijët masën në të cilën karakteri dhe veprimet e një autori dhe artisti ndikojnë në vlerën e artit të tyre?
- A e shqyrtojnë fëmijët marrëdhënien midis vlerës së artit dhe kostos së tij?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A e shqyrtojnë fëmijët se si është zhvilluar përdorimi i librave dhe shkrim-leximi?
- A e shqyrtojnë fëmijët mënyrën e zhvillimit të shtypjes?
- A e shqyrtojnë fëmijët natyrën në ndryshim të muzikës popullore?
- A e shqyrtojnë fëmijët si ka ndryshuar muzika klasike?
- A e shqyrtojnë fëmijët efektin e internetit dhe pajisjeve elektronike në mënyrën se si njerëzit merren me letërsi dhe muzikë dhe si do të ndryshojë kjo në të ardhmen?
- A hetojnë fëmijët për zhvillimin e shumëllojshmërisë së formave të artit?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si format e artit janë zhvilluar ndryshe në vende të ndryshme?



C1.12 Fëmijët mësojnë për punën dhe e lidhin atë me zhvillimin e interesave të tyre

B1.9 Fëmijët janë të përgatitur mirë për të kaluar në mjediset tjera.

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A mësojnë fëmijët për punën që bëjnë njerëzit në lokalitetin e tyre, vendin dhe nëpër botë, në lidhje me ushqimin, veshjet, ndërtimin, transportin, energjinë, financat, drogat legale dhe ilegale, shëndetin, arsimin dhe kujdesin për fëmijët, mjedisin natyror, udhëtimin, argëtimin, artet, qeverinë?
- A hulumtojnë fëmijët se si punët në një pjesë të botës varen nga ato në një tjetër?
- A hulumtojnë fëmijët se si punët mund të zhvendosen nga vend në tjetrin?
- A kontribuojnë njerëzit, të gjinive të ndryshme, me profesione të ndryshme, në aktivitetet mësimore në shkollë?
- A mësojnë fëmijët të mbajnë shënime për aktivitete të ndryshme në të cilat ata angazhohen brenda një jave ose muaji?

Natyra e punës dhe e veprimtarisë

- A mësojnë fëmijët për aftësitë e nevojshme në profesione të ndryshme dhe si fitohen ato?
- A mësojnë fëmijët se shumë njerëz bëjnë punë të ndryshme gjatë jetës së tyre?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si mund të lëvizin nga një punë apo profesion që nuk u pëlqen?
- A hulumtojnë fëmijët për dallimet ndërmjet punës në sektorin publik dhe atë privat?
- A mësojnë fëmijët që puna e rëndësishme në shtëpi dhe për përkujdesjen për të tjerët, shpesh nuk paguhet?
- A mësojnë fëmijët për larminë e punëve vullnetare në të cilat angazhohen njerëzit?
- A mësojnë fëmijët se si puna bëhet burim i identitetit për shumë njerëz?
- A hulumtojnë fëmijët kuptimin e daljes në pension për personat që punojnë shumë duke u përkujdesur për të tjerët por që nuk paguhen për këtë?
- A e kuptojnë fëmijët kuptimin e pensionimit për ata që kanë një sërë aktivitete për ta kaluar kohën e lirë pas përfundimit të punës së paguar me kohë të plotë?

Kuptimi i papunësisë

- A mësojnë fëmijët të bëjnë dallimin midis papunësisë, pasivitetit dhe punësimit pa pagesë?
- A e kuptojnë fëmijët përse disa janë të papunë dhe si ndryshon kjo me ndryshimet në fuqinë e ekonomisë kombëtare?

Zhvillimi i interesave dhe aktiviteteve

- A mësojnë njerëzit se si puna e disa njerëzve bazohet në interesat e tyre të veçantë ndërsa të tjerët ndjekin interesat e tyre jashtë punës së tyre të paguar?
- A ndihmohen fëmijët të zhvillojnë një sërë aktivitete që lidhen me interesat e tyre që i zhvillojnë jashtë shkollës dhe që mund t'i vazhdojnë kur ta kryejnë arsimin formal?

Puna, pagat dhe financat

- A mësojnë fëmijët për buxhetimin e të hyrave dhe shpenzimeve?
- A mësojnë fëmijët se si dhe përse paratë zbriten nga paga për tatime dhe kontribute pensionale?

- A i shqyrtojnë fëmijët përparësitë dhe disavantazhet e kartelës së debitit dhe kreditit?
- A mësojnë fëmijët se si mund të ketë fitime dhe humbje përmes blerjes dhe shitjes së mallrave dhe të mirave?
- A hulumtojnë fëmijët për marrëdhëniet midis punës që kërkohet për një produkt dhe çmimit të tij?
- A i eksplorojnë fëmijët idetë e produktivitetit?
- A mësojnë fëmijët për punën e bankave dhe si bëjnë ato para nga investimet më shumë ose më pak të rrezikshme?
- A mësojnë fëmijët për kompanitë publike, obligacionet, aksionet, aksionarët dhe dividendët?
- A hulumtojnë fëmijët për industrinë e lojërave të fatit duke përfshirë llotarinë kombëtare dhe kush fiton dhe humbet para prej tyre?

Puna, etika dhe politika

- A i hulumtojnë fëmijët perspektivat e ndryshme në punë, paga dhe fitim?
- A mësojnë fëmijët se si shkëmbimet e punës ose shërbimeve, si dhe puna e paguar, ndodhin jashtë një ekonomie zyrtare?
- A mësojnë fëmijët për pagat që lidhen me punë të ndryshme?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si vlera e punës lidhet me pagat që merren për të?
- A e hulumtojnë fëmijët kuptimin e një page për jetesë, çfarë do të thotë të jetosh në varfëri, pasuri ose të kesh standard 'të mirë' të jetesës?
- A e shqyrtojnë fëmijët qëllimin dhe nivelin e dëshiruar të pagës minimale?
- A e shqyrtojnë fëmijët mundësinë që ekziston niveli pas të cilit paga pushon të jetë e hyrë e ligjshme dhe bëhet vjedhje?
- A mësojnë fëmijët për barazinë, pabarazinë, ngacmimin dhe diskriminimin në punë?
- A i shqyrtojnë fëmijët dallimet në pagë midis burrave dhe grave dhe midis grupeve dhe nëse dhe si duhet të reduktohet kjo?
- A mësojnë fëmijët për të drejtat në vendin e punës?
- A mësojnë fëmijët për shfrytëzimin dhe si parandalohet ai?
- A mësojnë fëmijët se si mund të sfidohen pabarazitë në vendin e punës?
- A e shqyrtojnë fëmijët pse disa i mendojnë paratë për punën që bëjnë si rrogë e disa si pagë?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A e shqyrtojnë fëmijët se si kanë ndryshuar profesionet gjatë pesëdhjetë viteve të fundit dhe gjatë periudhave më të gjata, në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?
- A mësojnë fëmijët për mënyrën se si kanë ndryshuar pabarazitë në të ardhura?
- A mësojnë fëmijët për fushatat e kaluara për të përmirësuar kushtet e punës duke përfshirë pagesën për pushimet, pagesën për pushim mjekësor, pushimin e lehonisë dhe atësisë dhe pagesën e barabartë për gratë dhe çfarë kanë arritur këto fushata?
- A i hulumtojnë fëmijët profesionet brenda familjeve të tyre dhe a i intervistojnë anëtarët e familjes së tyre për punën e tyre të kaluar?
- A mësojnë fëmijët se si ka ndryshuar jeta e punës në raport me jetëgjatësinë dhe moshën e fillimit të punës dhe pensionimit?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si modelet e punës mund të ndryshojë në të ardhmen?

C1.13 Fëmijët mësojnë për etikën, pushtetin dhe qeverinë.

A1.7 Shkolla është model i qytetarisë demokratike; A2.1 Shkolla zhvillon vlera të përbashkëta gjithëpërfshirëse; A2.2 Shkolla inkurajon respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut; C1.12 Fëmijët mësojnë për punën dhe e lidhin atë me zhvillimin e interesave të tyre.

Lidhja në nivel lokal dhe global

- A kontribuojnë filozofët, politikanët, bankierët, zyrtarët e sindikatave, humanistët, liderët fetarë lokalë në kurrikulë?
- A hulumtojnë fëmijët për mënyrat se si format e qeverisjes në pjesë tjera të botës janë të ngjashme dhe të ndryshme nga forma e qeverisjes në vendin e tyre?
- A hulumtojnë fëmijët për ngjashmëritë dhe dallimet midis mënyrës se si funksionojnë sistemet ligjore në vendin e tyre dhe në vende të tjera?
- A e hulumtojnë fëmijët kuptimin e korrupsionit dhe shkallën në të cilën ndikon ai në qeveri dhe institucionet e tjera në vendin e tyre dhe në vendet e tjera?
- A e shqyrtojnë fëmijët formën e qeverisjes që e përshkruan më së miri shkollën e tyre, familjet dhe institucionet e tjera që ata i njohin?

Kush ka pushtet?

- A e shqyrtojnë fëmijët se kush ka pushtet për të bërë që gjërat të ndodhin e të cilat kanë ndikim në jetën e tyre në familje, shkolla dhe lagje, në nivel lokal, kombëtar dhe global?
- A i hulumtojnë fëmijët mënyrat se si mund të shpërndahe pushteti dhe ndikimi ndërmjet qeverive kombëtare dhe lokale, sistemeve ligjore, ushtrisë, korporatave, aksionarëve, bizneseve, institucioneve financiare, medie, sindikatave, klasave, komuniteteve, familjeve dhe qytetarëve?
- A mësojnë fëmijët për shkallën në të cilën korporatat mund të kenë ndikim më të madh në jetën e qytetarëve sesa disa qeveri?
- A e shqyrtojnë fëmijët fuqinë relative të vendeve të ndryshme?

Kombet dhe kufijtë

- A e shqyrtojnë fëmijët si krijonin kombet dhe si vendosen kufijtë?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si hiqen kufijtë?
- A mësojnë fëmijët se si vendet kanë qenë të kolonizuara dhe kolonizohen dhe pushtohen?
- A mësojnë fëmijët se si njerëzit janë trajtuar (dhe vazhdojnë të trajtohen) si mallra dhe janë blerë dhe shitur si skllëvër?
- A i shqyrtojnë fëmijët lëvizjet për shpëtim dhe pavarësi?
- A e hulumtojnë fëmijët natyrën e aleancave midis qeverive dhe si dhe pse vendet e tjera shihen si aleatë apo armiq?
- A e hulumtojnë fëmijët kuptimin e sovranitetit ose të pavarësisë së shtetit, dhe si ndikohet ajo tani dhe në të kaluarën nga ligji ndërkombëtar dhe evropian, parlamenti evropian, lëvizja e parave, borxhi, pronësia e gazetave, ushqimi, lëndët djegëse dhe siguria e energjisë dhe pronësia e tokës?

Demokracia dhe format e tjera të qeverisjes

- A e shqyrtojnë fëmijët se si njerëzit qeverisen në monarki, teokraci, diktatura dhe demokraci?
- A e hulumtojnë fëmijët se çfarë pune bëjnë qeveritë lokale dhe ato kombëtare?
- A i hulumtojnë fëmijët kuptimet e demokracisë?
- A kuptohet demokracia si gjithmonë në zhvillim?
- A mësojnë fëmijët për sistemet e ndryshme të votimit?

- A mësojnë fëmijët se çfarë pune bëjnë këshilltarët lokalë, anëtarët e parlamentit dhe anëtarët e Parlamentit Evropian?
- A mësojnë fëmijët se pse njerëzit votojnë dhe nuk votojnë në zgjedhjet lokale, kombëtare dhe në zgjedhjet evropiane?
- A mësojnë fëmijët se si mund të ushtrohen dhe të pengohen të drejtat demokratike?
- A mësojnë fëmijët për marrëdhëniet në mes Kishës së Anglisë, religjioneve të tjera dhe shtetit?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si priorizimi i një feje mund të nënkuptojë se besimet e tjera fetare dhe jo-fetare janë me vlerë më të vogël?
- A mësojnë fëmijët për partitë politike dhe kush i bashkohet atyre?
- A mësojnë fëmijët për pronësinë e medie dhe interesat e pronarëve në drejtimin e politikës në mënyra të veçanta?
- A i hulumtojnë fëmijët meritat e pronësisë private dhe publike të shumë shërbimeve si burgjet, prodhimi i veshjeve, transporti, shërbimet bankare, arsimit, furnizimi me ujë, telefonat, gazi dhe energjia elektrike?
- A mësojnë fëmijët për rëndësinë e kohezionit kombëtar dhe veprimin kolektiv të zhvillimit dhe humbjes së hapësirës publike?
- A i hulumtojnë fëmijët marrëdhëniet midis pasurisë, varfërisë dhe pjesëmarrjes në shoqëri?

Sistemet ligjore

- A mësojnë fëmijët se si jetët e tyre ndikohen nga ligjet kombëtare?
- A mësojnë fëmijët për punën e gjykatave?
- A mësojnë fëmijët për masën në të cilën dënohet shkelja e ligjit?
- A mësojnë fëmijët për format e ndryshme të dënimeve të vendosura nga gjykatat, qëllimet dhe efektet e tyre?
- A mësojnë fëmijët se sa aplikohet ligji në mënyrë të drejtë?
- A mësojnë fëmijët se si ata ndikohen nga ligjet ndërkombëtare?
- A mësojnë fëmijët për fuqinë e gjykatave ndërkombëtare dhe kë e sjellin dhe nuk e sjellin para drejtësisë?

Financat publike dhe private

- A e zbulojnë fëmijët se si qeveritë marrin të hyra?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si qeveritë vendosin se sa para duhet të shtypen?
- A mësojnë fëmijët për të ardhurat hyrat dhe shpërndarjen e pasurisë në nivel kombëtar dhe global?
- A mësojnë fëmijët se për çfarë i shpenzojnë paratë qeveritë dhe si vendoset kjo?
- A e hulumtojnë fëmijët se nga kush huazojnë mjete qeveritë kur janë në borxhe?
- A mësojnë fëmijët për Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe si financohet ai?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si ndikohen financat e qeverisë nga gjendja financiare ndërkombëtare?
- A i shqyrtojnë fëmijët transaksionet me vendet e tjera (bilanci i pagesave) dhe implikimet nëse importohet më shumë sesa që eksportohet apo fitohet në vendet e tjera?
- A e mësojnë fëmijët se si vendosen normat e interesit bankar?
- A e hetojnë fëmijët se si njerëzit dhe shtetet marrin klasifikimin kreditor?
- A mësojnë fëmijët për shkaqet dhe pasojat e inflacionit, nivelin e tij të dëshirueshëm dhe si matet dhe kontrollohet?
- A i hulumtojnë fëmijët mënyrat e ndryshme të matjes së inflacionit dhe deflacionit dhe si vendoset për një nivel ideal të inflacionit?
- A mësojnë fëmijët se si vlerësohen valutat kundrejt valutave të tjera?
- A i shqyrtojnë fëmijët kreditë dhe grantet që qeveria e tyre u jep në ndihmë vendeve të tjera?
- A e shqyrtojnë fëmijët ekzistencën e deficitit publik në vendet me pasuri private masive?

Etika personale dhe politike

- A e shqyrtojnë fëmijët nëse vlerat e njëjta ose të ndryshme duhet t'i udhëheqin veprimet në jetën personale dhe të punës, duke përfshirë politikën?
- A e shqyrtojnë fëmijët se çfarë bëjnë dhe çfarë nuk bëjnë vendet nëse kanë një politikë të jashtme etike?
- A i hulumtojnë fëmijët vlerat në të cilat ata dëshirojnë t'i bazojnë veprimet e tyre dhe ato të të tjerëve?
- A e zhvillojnë fëmijët aftësitë e tyre për t'i lidhur vlerat me veprimet?
- A e zhvillojnë fëmijët aftësinë për të gjykuar kur vlerat japin impulse kontradiktore për veprim?
- A mësojnë fëmijët të angazhohen në argumente morale?
- A i hulumtojnë fëmijët vlerat e ndryshme që frymëzojnë veprimet e njerëzve të ndryshëm?
- A e shqyrtojnë fëmijët natyrën e dënimit dhe cilat dënime mendojnë se janë të përshtatshme brenda shkollave, familjeve dhe burgjeve?
- A e hetojnë fëmijët se si dëshirat, zgjedhjet dhe etika e tyre ndikohet nga qeveria, religjioni, familja, miqtë, mediet dhe reklamat?

Lidhja e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes

- A mësojnë fëmijët për historitë e demokracisë në Mbretërinë e Bashkuar dhe në nivel ndërkombëtar?
- A mësojnë fëmijët për përpjekjet e njerëzve për të arritur të drejtat e tyre demokratike?
- A mësojnë fëmijët për atë që është arritur nëpërmjet veprimeve kolektive?
- A mësojnë fëmijët për rolet e partive politike, sindikatave dhe veprimeve kolektive në zhvillimin e demokracisë?
- A e hulumtojnë fëmijët natyrën e monarkisë në MB, si ka ndodhur kjo dhe nëse ajo paraqet një fazë në rrugën drejt një demokracie më të pjekur?
- A e hulumtojnë fëmijët se çfarë do ta bënte vendin, komunitetet, shkollat dhe familjet e tyre më demokratike?
- A e shqyrtojnë fëmijët se si pushteti mund të shpërndalet në vendin e tyre në të ardhmen?
- A hulumtojnë fëmijët për ndikimet që do të ketë në jetën në MB largimi nga Bashkimi Evropian (BE)?



C2.1 Aktivitetet mësimore planifikohen duke marrë parasysh të gjithë fëmijët.

C2.2 Aktivitetet mësimore inkurajojnë pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve.

- a) A planifikohen aktivitetet për të mbështetur mësimin e jo për të ofruar një kurrikulë?
- b) A i pasqyrojnë materialet e kurrikulës prejardhjet, përvojat dhe interesat e të gjithë nxënësve?
- c) A e pasqyrojnë aktivitetet mësimore shumëllojshmërinë e interesave të fëmijëve?
- d) A ka aktivitete të ndryshme që përshijnë prezantimin me gojë dhe diskutimet, të dëgjuarit, leximin, shkrimin, vizatimin, zgjidhjen e problemeve, dramën, shfrytëzimin e bibliotekës, materialet audio/vizuale, detyra praktike, teknologji informatike dhe kompjuterike (ICT)?
- e) A ofrojnë aktivitetet mësimore mundësi për aktivitete në çift dhe grupe si dhe punë individuale dhe që përfshin tërë klasën?
- f) A i përfshijnë aktivitetet përvojat jashtë klasës, në terren dhe përreth shkollës dhe në vizitat e mëtejshme?
- g) A e zgjerojnë aktivitetet mësimore të nxënit e fëmijëve?
- h) A e zhvillojnë aktivitetet aftësitë e fëmijëve për të menduar, folur, shkruar dhe mësuar?
- i) A e inkurajojnë aktivitetet pikëpamjen e të nxënit si të vazhdueshme e jo të përfunduar me disa detyra të caktuara?
- j) A janë fleksibile organizimet e aktiviteteve mësimore ashtu që të jetë e mundur për shembull që fëmijët të kenë një kurs intensiv të gjuhëve të huaja ose kurs letërsie?
- k) A ka interpretë për fëmijët e shurdhër ose të tjerët për të cilët gjuha angleze është gjuhë tjetër?
- l) A i identifikon dhe minimizon planifikimi pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje për fëmijët e caktuar?
- m) A i inkurajon stafi aktivitetet të cilat apelojnë për mënyra të ndryshme në të cilat fëmijët e shohin gjininë e tyre?
- n) A i shfrytëzon stafi mundësitë e ofruara nga temat, të cilave u kushtohet vëmendje mediale, të cilat mund të motivojnë grupe të caktuara të fëmijëve, si futbollit i meshkujve apo femrave dhe ragbi, dhe ofrojnë alternativa të konsideruara në mënyrë të barabartë për ata që nuk janë të interesuar në një temë të veçantë?
- o) A mund të marrin pjesë fëmijët në mësim si shkenca dhe edukata fizik me rroba të përshtatshme për besimet e tyre fetare?
- p) A është përshtatur kurrikula për fëmijët që nuk marrin pjesë, për shembull, në art ose muzikë, për shkak të besimeve të tyre fetare?
- q) A përshtaten mësimet, nëse është e nevojshme, për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike ose dëmtime në shqisa për të zhvilluar shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në edukimin fizik, kuptimin e dritës dhe tingullit ose punën praktike?
- r) A e pranon stafi se disa fëmijë me aftësi të kufizuara kanë nevojë për kohë shtesë për të përdorur pajisjet në punë praktike?
- s) A i jepet vëmendje e veçantë përfshirjes në mësim të fëmijëve që janë të lëvizshëm, të paangazhuar dhe të pakënaqur?
- t) _____
- u) _____
- v) _____

C2.2 Aktivitetet mësimore inkurajojnë pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve.

C2.1 Aktivitetet mësimore planifikohen duke marrë parasysh të gjithë fëmijët.

- a) A përfshijnë aktivitetet mësimore përvojat e përbashkëta që mund të zhvillohen nga fëmijët në mënyra të ndryshme?
- b) A i shmangin mësimdhënësit specifikimet e pritjeve për mësimin si objektiva mësimore?
- c) A e marrin mësimet gjithmonë formën e hetimeve të udhëhequra me pyetje të hapura?
- d) A i kufizojnë mësimdhënësit pyetjet për të cilat ata presin një përgjigje të vetme të drejtë?
- e) A bazohen mësimet në përvojën, njohuritë dhe aftësitë që fëmijët kanë fituar jashtë shkollës?
- f) A i përfshijnë mësimet fëmijët emocionalisht?
- g) A përcjellin mësimet një ndjenjë ngazëllimi dhe kënaqësie në mësim?
- h) A e demostrojnë mësimdhënësit dashurinë e tyre për të mësuar?
- i) A është gjuha e folur dhe e shkruar e përdorur në mësimet e qasshme për të gjithë fëmijët?
- j) A përdoret fjalori teknik vetëm aty ku është e nevojshme dhe shpjegohet dhe praktikohet gjatë mësimetve?
- k) A inkurajohen fëmijët të tregojnë kur nuk e kuptojnë diçka?
- l) A mund ta shënojnë fëmijët punën e tyre në mënyra të ndryshme, duke përdorur vizatime, fotografi, videoregjistrime dhe regjistrim të zërit si dhe shkrim?
- m) A e inkurajojnë mësimet dialogut ndërmjet stafit dhe fëmijëve dhe ndërmjet fëmijëve?
- n) A mësojnë fëmijët se si të pyesin njëri-tjetrin për ta mbështetur të nxënërit e njëri-tjetrit?
- o) A inkurajohen fëmijët të flasin për proceset e të menduarit dhe të nxënërit?
- p) A nisin fëmijët punë tjetër të pavarur pasi kanë përfunduar një detyrë të sugjeruar nga një mësimdhënësi?
- q) A i përmirësojnë të rriturit dhe fëmijët shkathtësitë e tyre në internet për ta ndihmuar mësimin në shkollë dhe në shtëpi?
- r) A janë fletët e punës të shkruara qartë në mënyrë që ta zgjerojnë mësimin e fëmijëve?
- s) A kanë mundësi fëmijët që mësojnë gjuhën angleze si një gjuhë tjetër që gjatë mësimetve të flasin, shkruajnë ose të flasin me shenja gjuhën e tyre amtare dhe të përdorin aftësitë e tyre të përkthimit?
- t) A i bën stafi rregullimet e nevojshme për pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara?
- u) A e di stafi përpjekjen e nevojshme fizike për detyrat e shtëpisë nga disa fëmijë me aftësi të kufizuara ose sëmundje kronike, dhe lodhjen që mund të rezultojë nga kjo?
- v) A i di stafi përpjekjet mendore të përfshira në leximin e buzëve dhe përdorimin e ndihmave për të parë?
- w) A shfrytëzohen përparimet teknologjike, si programet e njohjes së të folurit, për t'i mbështetur fëmijët që kanë vështirësi të mëdha në shkrim?
- x) _____
- y) _____
- z) _____

C2.3 Fëmijët inkurajohen të kenë vetëbesim dhe të zhvillojnë mendim kritik.

C2.4 Fëmijët janë të përfshirë në mënyrë aktive në të nxënit e tyre.

- a) A e mbështetin stafi njëri-tjetrin për të pasur vetëbesim dhe mendim kritik?
- b) A është kuptuar që dialogu funksionon më së miri kur njerëzit lënë mënjanë dallimet e pushtetit dhe statusin e perceptuar?
- c) A e tregon stafi se respekton dhe vlerëson pikëpamjet alternative?
- d) A inkurajohen fëmijët dhe të rriturit që të shprehin pikëpamjet e tyre me vetëbesim dhe në mënyrë jo agresive?
- e) A inkurajohen debatet në mënyrë që njerëzit të dëgjojnë pikëpamje të ndryshme nga ato të tyre dhe të praktikojnë të shprehurit?
- f) A nxiten fëmijët të zhvillojnë dhe shprehin pikëpamje dhe ndjenja për ngjarje të rëndësishme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, siç është rasti kur vendi i tyre është në luftë ose ka ndodhur një katastrofë në vendin e tyre apo në një vend tjetër?
- g) A nxiten fëmijët të bëjnë pyetje sfiduese?
- h) A i njohin ata që janë në anët e kundërta të argumenteve rëndësishme e pikëpamjeve të tjera për sqarimin e mendimeve dhe arritjen e zgjidhjeve të përbashkëta të problemeve?
- i) A mësojnë fëmijët të zbulojnë kontradikta në argumentet e tyre dhe të personave të tjerë?
- j) A mësojnë fëmijët dhe të rriturit të peshojnë forcën e argumenteve duke përfshirë edhe ato të tyre?
- k) A mësojnë fëmijët kur e vërteta e një pohimi ose argumenti kërkon dëshmi mbështetëse?
- l) A mësojnë fëmijët se si të përdorin shembuj për të mbështetur një argument?
- m) A mësojnë fëmijët se si shembujt e zgjedhur me kujdes mund të tregojnë kufijtë e përgjithësimeve?
- n) A mësojnë fëmijët të shtrojnë pyetjet 'në çfarë mase..?' dhe 'në cilat rrethana...?' kur njerëzit pohojnë se diçka është e vërtetë për botën (për shembull për dallimet midis gjinive)?
- o) A mësojnë fëmijët se si ta vlerësojnë audiencën të cilës iu bënë thirrje një shkrim?
- p) A mësojnë fëmijët se si njerëzit e pranojnë si të mirëqenë se disa argumente janë të sakta, edhe kur nuk janë, sepse duket se mbajnë bartin e autoritetit?
- q) A i identifikojnë fëmijët dhe të rriturit besimet dhe vlerat që theksojnë dallimet e pikëpamjeve?
- r) A ndihmohen fëmijët dhe të rriturit që të rrisin rrjedhshmërinë e tyre në argumentim?
- s) A mësojnë fëmijët për presionet që ata të mendojnë dhe veprojnë në mënyra të veçanta?
- t) A i eksplorojnë fëmijët arsyet për mendimet që shprehin?
- u) A mbështeten të gjithë ata që marrin pjesë në dialog për ta ruajtur vetëbesimin e tyre?
- v) A e shmangin njerëzit triumfalizmin kur ata mendojnë se kanë fituar një argument?
- w) A ndihmojnë fëmijët dhe të rriturit mentorë për të kontribuar pikëpamjet e tyre?
- x) A i kushtohet vëmendje e veçantë ndihmesës së atyre që janë më të turpshëm për të folur, për të dhënë kontribut?
- y) _____
- z) _____
- aa) _____

C2.4 Fëmijët janë të përfshirë në mënyrë aktive në të nxënit e tyre.

A1.11 Stafi e lidh atë që ndodh në shkollë me jetën e fëmijëve në shtëpi;

C2.3 Fëmijët inkurajohen të kenë vetëbesim dhe të zhvillojnë mendimin kritik.

- a) A është e qartë se të rriturit në shkollë janë nxënës aktivë me një sërë interesash?
- b) A inkurajohen fëmijët të besojnë se mund ta rrisin kapacitetin e tyre për të mësuar në mënyrë të pavarur?
- c) A dihet se ndërsa disa fëmijë rrisin aftësinë e tyre për të mësuar dhe për të bashkëpunuar në mënyrë të pavarur, kjo e liron stafin t'i ndihmojë të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë?
- d) A inkurajohen fëmijët të identifikojnë atë që duan të mësojnë dhe të marrin përgjegjësinë për ta mësuar?
- e) A inkurajohen fëmijët të zhvillojnë interesim në mësim që i ndjekin jashtë shkollës?
- f) A i inkurajojnë stafi rastet kur fëmijët mund të bëjnë zgjedhje për atë që mësojnë?
- g) A ndihmohen fëmijët të shkruajnë titujt dhe temat e tyre për ta strukturuar një pjesë të punës?
- h) A inkurajohen fëmijët të bëjnë pyetje sfiduese për të cilat askush nuk ka përgjigje të menjëhershme?
- i) A ndahen planet e kurrikulës me fëmijët ashtu që ata të mund të zgjedhin të studiojnë në një ritëm më të shpejtë ose më në detaje?
- j) A i ndihmon mbështetja e dhënë fëmijëve për të avancuar në mësim duke u mbështetur në njohuritë dhe shkathtësitë që tashmë i posedojnë?
- k) A mësojnë fëmijët se si të bëjnë kërkime dhe të shkruajnë një temë?
- l) A janë në gjendje fëmijët ta përdorin bibliotekën dhe burimet e teknologjisë informative në mënyrë të pavarur?
- m) A mësohen fëmijët se si të marrin shënime nga leksionet, librat dhe interneti?
- n) A ndihmohen fëmijët të hetojnë një temë duke shtruar pyetje të qarta të cilave do të përpiqen t'i përgjigjen?
- o) A mësojnë fëmijët të ndihmojnë njëri-tjetrin me hulumtime duke dëgjuar me kujdes se çfarë tjetri po mundohet të bëjë dhe pastaj duke bërë pyetje për ta sqaruar çfarë po mendon ai person?
- p) A mësojnë fëmijët të shkruajnë përmbledhje të shkurtra të një punimi në mënyrë që ta kuptojnë strukturën e saj?
- q) A shmangen aktivitetet mekanike të kopjimit?
- r) A mësojnë fëmijët se si ta paraqesin punën e tyre në formë të prezantimit me gojë, me shkrim dhe në forma të tjera, individualisht dhe në grupe?
- s) A ndihmohen fëmijët të planifikojnë dhe menaxhojnë rishikimin e testet dhe provimeve?
- t) A konsultohen fëmijët për mbështetjen në mësim për të cilën ata kanë nevojë?
- u) A ofrojnë fëmijët komente konstruktive se si të përmirësohen aktivitetet mësimore?
- v) A e bëjnë dallimin përshtypjet që i japin fëmijët për aktivitetet mësimore?
- w) A janë të përfshirë fëmijët në gjetjen e mënyrave për të kapërcyer pengesat e tyre dhe të njëri-tjetrit në mësim?
- x) _____
- y) _____
- z) _____

Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

C2.5 Fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri.

A1.3 Fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin.

- a) A e ndihmojnë fëmijë njëri-tjetrin në mënyrë të rregullt?
- b) A inkurajohen të gjithë të dëgjojnë me kujdes të tjerët pa i ndërprerë?
- c) A mësojnë fëmijët se si të kërkojnë sqarime nga njëri-tjetri për të kuptuar më mirë atë që thuhet dhe për ta ndihmuar folësin të zhvillojë idetë e tij?
- d) A e shmangin fëmijët përqeshjen e kontributit të tjetrit përveç nëse janë duke bërë shaka?
- e) A shfaqin fëmijët mosdakordimin me idetë e një tjetri pa i kritikuar ata?
- f) A e dinë fëmijët kur e ndërrojnë një temë diskutimi në vend që të kontribuojnë tek ajo paraprakja?
- g) A përmbajnë mësimet rregullisht mundësi për punë në grup?
- h) A mësojnë fëmijët se si t'i udhëheqin diskutimet në mënyrë që të gjithë të kontribuojnë?
- i) A e përdorin fëmijët sinjalin e njëjtë për të kontribuar në punën në grup si në diskutimin në klasë?
- j) A bazohen aktivitetet mësimore në dallimet në njohuritë dhe përvojën e fëmijëve, siç janë vendet, gjeografia lokale dhe historitë familjare?
- k) A i lejojnë aktivitetet grupore fëmijët që të ndajnë detyrat dhe të grumbullojnë atë që kanë mësuar?
- l) A hartojnë nxënësit raporte të përbashkëta nga kontributet e ndryshme të një grupi?
- m) A planifikohen aktivitetet në mënyrë që fëmijët e moshave dhe me arritje të ndryshme mund ta mbështesin të nxënësit e njëri-tjetrit?
- n) A mësojnë fëmijët si t'ju tregojnë dhe t'i mësojnë të tjerët për diçka që dinë apo kanë bërë?
- o) A kuptohet mësimdhënia të përfshijë shkathtësi të nivelit të lartë që i ndihmojnë të nxënësit të fëmijës apo të vetë mësimdhënësit?
- p) A kuptohet se secili mund të japë kontribut në mësimdhënie dhe mësimnxënie pavarësisht nga arritja ose aftësia e kufizuar e tyre?
- q) A japin fëmijët ide dhe zgjidhje për problemet pa i gjykuar kontributet e njëri-tjetrit?
- r) A e shijojnë fëmijët të nxënësit përmes aktiviteteve në grup?
- s) A e ndajnë fëmijët përgjegjësinë me mësimdhënësit për të ndihmuar në kapërcimin e pengesave në të nxënësit të përjetuara nga disa fëmijë?
- t) A i përmendin fëmijët kontributet e të tjerëve në raportet e punës së tyre?
- u) A komentojnë fëmijët në mënyrë kritike dhe konstruktive në të nxënësit e njëri-tjetrit?
- v) A i ndajnë fëmijët shkathtësitë e tyre, për shembull, në një gjuhë, lojë zhongleri, shah, origami, kriket, në pauza dhe në kohën e drekës dhe në klubet pas shkollës?
- w) A përdoret shumëllojshmëria e gjuhëve të folura nga fëmijët për të zhvilluar gjuhën e secilit?
- x) A e ndajnë fëmijët përvojën e tyre në tejkalimin e problemeve në të nxënësit dhe marrëdhënie?
- y) A përfshijnë projektet e dizajnit dhe zgjidhjes së problemeve nga fëmijët zgjidhje imagjinative për pengesat që ata dhe të tjerët përjetojnë, si qasja në ndërtesa apo kurrikula?
- z) _____
- aa) _____
- ab) _____

C2.6 Mësimet zhvillojnë aftësinë për të kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve.

A1.8 Shkolla e inkurajon kuptimin e ndërlidhjeve në mes njerëzve në mbarë botën.

- a) A e zhvillojnë aktivitetet mësimore kuptimin e dallimeve të prejardhjes, kulturës, etnisë, gjinisë, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, besimit, religjionit dhe politikës?
- b) A ka mundësi që fëmijët të punojnë me të tjerët që kanë prejardhje, etni, aftësi të kufizuara dhe gjini të ndryshme?
- c) A e pasqyrojnë materialet e përdorura në mësimet diversitetin njerëzor?
- d) A e debatojnë fëmijët përdorimin e stereotipeve në materialet e kurrikulës dhe në diskutime?
- e) A i njohin fëmijët ngjashmëritë me veten të atyre që ata i shohin si shumë të ndryshëm?
- f) A i njohin fëmijët dallimet nga vetja të atyre që ata i shohin si shumë të ngjashëm?
- g) A i njohin fëmijët dallimet ndërmjet njerëzve që i shohin si të ngjashëm me njëri-tjetrin?
- h) A inkurajohen fëmijët të shikojnë paralele në vendin e tyre me veprime në vende të tjera që ata i konsiderojnë si të pacivilizuara, diskriminuese apo antidemokratike?
- i) A janë të lidhura rregullisht aktivitetet me ngjarjet dhe jetën e fëmijëve në vendet e tjera?
- j) A mësojnë fëmijët për origjinën e dallimeve në përhapjen gjeografike të feve dhe sistemeve politike?
- k) A e përcjell shkolla kuptimin e dallimeve në varfëri, shëndet, jetëgjatësi, mirëqenie dhe siguri për njerëzit në pjesë të ndryshme të vendit dhe botës?
- l) A hulumtojnë fëmijët për trashëgiminë e trajtimit negativ dhe diskriminimit të vazhdueshëm ndaj njerëzve historikisht, për shembull nëpërmjet skllavërisë ose kolonizimit të popujve indigjenë?
- m) A mësojnë fëmijët se sa lehtë njerëzit i mohojnë dhe i refuzojnë aspektet e vetvetes, si të moshuarit që harrojnë si ka qenë të jesh i ri?
- n) A identifikohen fëmijët me të moshuarit duke e kuptuar se edhe ata do të plaken?
- o) A identifikohen fëmijët që nuk kanë aftësi të kufizuara me ata që kanë duke i njohur mundësitë e tyre që kjo të ndodhë?
- p) A hulumtojnë fëmijët se si padrejtësitë e kaluara mund të kontribuojnë në pabarazitë e tanishme?
- q) A njihet identifikimi i thellë me vendin për ata persona familjet e të cilëve kanë jetuar në një zonë për breza me radhë?
- r) A e kuptojnë të rriturit dhe fëmijët se si besimi në një kulturë të vetme kombëtare diskriminon njerëzit dhe kufizon të kuptuarit në mes njerëzve?
- s) A i ndalojnë mësimet përgjithësimet për gjinitë si ajo që djemtë janë më të fortë dhe vrapojnë më shpejtë se vajzat?
- t) A kanë mundësi fëmijët që të komunikojnë me fëmijët në pjesët ekonomikisht më të pasura dhe më të varfra të botës?
- u) _____
- v) _____
- w) _____

C2.7 Vlerësimet inkurajojnë arritjet e të gjithë fëmijëve

C1.4 Fëmijët janë të përfshirë në mënyrë aktive në të nxënit e tyre;

C2.12 Detyrat e shtëpisë caktohen që të kontribuojnë në të nxënit e të gjithë fëmijëve.

- a) A përfshin gjithmonë vlerësimi i mësimit të fëmijëve reflektimin për mësimdhënien?
- b) A bazohen të rriturit në përvojat e tyre për ta përmirësuar mënyrën se si i vlerësojnë fëmijët?
- c) A ndihmohen fëmijët të reflektojnë për kontributin e tyre të shkruar, me gojë dhe kontributet e tjera në mësim, në mënyrë që ata të dinë si të bëjnë përmirësimet e tyre?
- d) A janë të përfshirë fëmijët në mbështetjen dhe komentimin e mësimit të të tjerëve?
- e) A përfshin vlerësimi i fëmijëve identifikimin e pengesave që pengojnë të nxënit?
- f) A identifikojnë vlerësimet se si marrëdhëniet me të rriturit mund ta pengojnë dhe mbështesin të nxënit?
- g) A e vlerëson stafi se si marrëdhëniet e fëmijës me të rriturit dhe fëmijët e tjerë mund ta mbështesin ose pengojnë të nxënit e tyre?
- h) A janë komentet për punën e fëmijëve inkurajuese dhe respektuese?
- i) A përfshin vlerësimi i fëmijëve përpjekje për të kuptuar të nxënit nga këndvështrimi i tyre?
- j) A përpiqen mësimdhënësit dhe ndihmësit mësimdhënësit të kuptojnë të nxënit e fëmijëve përmes vëzhgimit dhe përshkrimit të kujdesshëm?
- k) A e ndihmojnë të rriturit njëri-tjetrin për të kuptuar implikimet e vëzhgimeve të tyre për të nxënit e fëmijëve?
- l) A çojnë vlerësimet e fëmijëve në ndryshime në aktivitetet mësimore?
- m) A përdoret vlerësimi i fëmijëve për t'i ndihmuar ata që të reflektojnë për të nxënit e tyre?
- n) A përdoret vlerësimi për t'i rritur aftësitë e fëmijëve për ta vlerësuar vetveten?
- o) A e shmang stafi lejinin e përfshirjes në vlerësime të gjykimit të aftësisë ose potencialit që ul pritjet ose kufizon mundësitë e fëmijëve?
- p) A bëhen rregullime në provime publike, në aspektin kohor, të pajisjeve ndihmëse të komunikimit ose interpreteve, për t'i bërë ato më të drejta për fëmijët me aftësi të kufizuara?
- q) A janë të përfshirë prindërit/kujdestarët në komentimin e të nxënit të fëmijëve?
- r) A ka mënyra të ndryshme për vlerësimin e të nxënit që merren me dallimet në karakterin, interesat dhe shkathtësitë e fëmijëve?
- s) A e vlerësojnë rregullisht stafi dhe fëmijët punën e bërë në bashkëpunim me të tjerët?
- t) A i kuptojnë fëmijët arsyet për vlerësimin e iniciuar nga mësimdhënësit dhe ato kombëtare?
- u) A janë fëmijët të informuar hapur për qëllimin e vlerësimeve kombëtare për ta matur performancën e shkollës?
- v) A janë të informuar fëmijët për pasojat e hyrjes në provim në një nivel të caktuar dhe si kjo perceptohet nga njerëzit, duke përfshirë punëdhënësit?
- w) A monitorohen arritjet e grupeve të ndryshme (djem/vajza/fëmijë të grupeve etnike jo shumicë/fëmijë me aftësi të kufizuara) në mënyrë që pengesat në të nxënit të mund të zbulohen, hetohen dhe trajtohen?
- x) A përpilohen rezultatet e arritjeve në bashkëpunim me fëmijët në mënyrë që ato të reflektojnë të gjitha shkathtësitë, njohuritë dhe përvojën e tyre?
- t) _____
- u) _____

Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

C2.8 Disiplina bazohet në respekt të ndërsjellë.

A1.4 Stafi dhe fëmijët respektojnë njëri-tjetrin;
B2.7 Presionet për përjashtim disiplinor janë ulur.

- a) A është mënyra se si fëmijët dhe të rriturit sillen me njëri-tjetrin në mësim pasqyrim i një kulture pozitive të respektit në shkollë?
- b) A e inkurajon qasja ndaj disiplinës vetëdisiplinimin?
- c) A i ndihmojnë fëmijët mësimdhënësit për të krijuar një atmosferë që mbështet të nxënësit?
- d) A e mbështetin stafi njëri-tjetrin për të shprehur vetëbesim pa qenë i zemëruar?
- e) A ndajnë stafi përgjegjësitë për tejkalimin e vështirësive me disiplinë që përjeton një koleg individual?
- f) A i bashkojnë stafi njohuritë dhe shkathtësitë e tyre për kapërcimin e pakënaqësisë dhe përçarjes?
- g) A konsiderohet se disiplina varet nga marrëdhëniet e mira me fëmijët?
- h) A e shmangin të rriturit dhe fëmijët sensin se janë në anët e kundërta të konfliktit?
- i) A e shmang stafi përcjelljen e këndvështrimit se fëmijët duhet ta ndjekin verbërisht autoritetin?
- j) A është mënyra se si fëmijët pritet të sillen në mësim konsistente me kuadrin e vlerave të zhvilluar me mbështetjen e stafit, prindërve/kujdestarëve dhe fëmijëve dhe të rinjve?
- k) A e shohin fëmijët se mësimi jashtë dhe brenda orëve mësimore përfshin mënyra të njëjta të sjelljes?
- l) A ndihen stafi dhe fëmijët rehat ta pranojnë mungesën e njohurive ose se kanë bërë gabim?
- m) A i japin fëmijët idetë e tyre për përmirësim kur fëmijët janë të pavëmendshëm në mësim?
- n) A e bëjnë dallimin fëmijët midis bisedave të qeta dhe bisedave të penguar?
- o) A e ndryshojnë fëmijët tonin e zërit kur kjo u kërkohet, në mënyrë që t'i lejojnë të gjithë të mësojnë?
- p) A e dinë fëmijët se secili fëmijë duhet të ketë pjesën e tyre të të qenit në qendër të vëmendjes?
- q) A ndihmojnë fëmijët të qetësojnë të tjerët në vend se t'i nxisin kur ata janë të trazuar ose pengojnë mësimet?
- r) Nëse është më shumë se një i rritur duke punuar me fëmijët, a i ndajnë ata përgjegjësitë për një proces të rregullt të mësimave?
- s) A ka procedura të qarta, që kuptohen nga fëmijët dhe mësimdhënësit për t'ju përgjigjur sjelljeve sfiduese?
- t) A ndihen fëmijët se trajtohen në mënyrë të drejtë pavarësisht gjinisë, klasës ose etnisë?
- u) A dihet nga stafi dhe fëmijët se është e padrejtë që një gjini të marrë më shumë vëmendje nga një mësimdhënës ose në shumë kohë në klasë apo në diskutime në grup sesa një tjetër?
- v) _____
- w) _____
- x) _____

C2.9 Stafi planifikojnë, japin mësim dhe rishikojnë së bashku.

A1.2 Stafi bashkëpunon; C2.10 Stafi zhvillon burime të përbashkëta për ta mbështetur të nxënit.

- a) A i planifikojnë mesimdhënësit dhe ndihmës mesimdhënësit mesimet dhe detyrat e shtëpisë?
- b) A planifikohen aktivitetet mesimore për t'i shfrytëzuar plotësisht të gjithë të rriturit e pranishëm në klasë?
- c) A përdoren në planifikim njohuritë që ndihmës mesimdhënësit mund të kenë për mënyrën e reagimit të fëmijës në mesime me mesimdhënësit të ndryshëm?
- d) A i planifikojnë mesimdhënësit aktivitetet në mënyrë që të përdorin njohuritë dhe shkathtësitë e njëri-tjetrit?
- e) A e përdorin mesimdhënësit bashkëpunimin si një mundësi për të mësuar nga njëri-tjetri?
- f) A i ndihmon stafi njëri-tjetrit për përdorimin e teknologjisë, si kompjuterë dhe tabela të bardha interaktive?
- g) A reflekton stafi për praktikën mesimore me shkollat e tjera për ta rishikuar dhe përshtatur praktikën e tyre?
- h) A përdorë stafi idetë nga kolegët në arsimin e mesimdhënësit dhe diku tjetër në arsimin e lartë?
- i) A i rishikojnë mesimdhënësit dhe ndihmës mesimdhënësit praktikën e tyre në lidhje me një kuadër të përbashkët të vlerave?
- j) A ndiqet vëzhgimi i ndërsjellë nga një reflektim i përbashkët i përdorur për të përmirësuar mesimdhënien dhe mesimnxënien?
- k) A i regjistrojnë mesimdhënësit mesimet e njëri-tjetrit dhe a i rishikojnë mesimet së bashku?
- l) A i mirëpresin mesimdhënësit komentet nga kolegët për shembull për qasjen në gjuhën që ata përdorin dhe cilësinë e pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitete?
- m) A e modifikojnë mesimdhënësit mesimdhënien e tyre në përgjigje të reagimeve nga kolegët e tyre?
- n) A e ndihmon stafi njëri-tjetrit për ta parë mesimin nga perspektiva e fëmijëve?
- o) A janë në gjendje stafi të marrin pjesë në mesime me një fëmijë ose një grup fëmijësh të mësuar nga disa mësues në një ditë për të kuptuar më mirë përvojën e tyre të arsimit?
- p) A ndan stafi që punon në të njëjtën klasë përgjegjësinë për të siguruar se të gjithë fëmijët të marrin pjesë?
- q) A angazhohet stafi në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, brenda dhe jashtë shkollës, kur progresi i një fëmije apo grupi është shkak për shqetësim?
- r) A ndihet stafi me vetëbesim për t'i sfiduar mendimet e njëri-tjetrit për mënyrën se si paraqiten probleme?
- s) A e inkurajojnë stafi njëri-tjetrit për të provuar qasje dhe aktivitete të reja?
- t) A i shqyrton stafi ndjenjat e tyre për të nxënit e një fëmije dhe si këto mund të pengojnë ose ndihmojnë për të hequr pengesat për atë fëmijë?

u) _____

v) _____

w) _____

C2.10 Stafi zhvillon burime të përbashkëta për ta mbështetur të nxënit.

C2.14 Burimet në lokalitetin e shkollës njihen dhe shfrytëzohen.

- a) A ka ndonjë zonë në sallën e stafit kur stafi i vendos informacionet për librat dhe uebfaqet e preferuara si burime?
- b) A zhvillon komuniteti i shkollës uebfaqe që lidh interesat e stafit, fëmijëve dhe prindërve?
- c) A e lidh uebfaqja e shkollës shkollën me shkollat e tjera në nivel lokal/kombëtar dhe në vende të tjera?
- d) A punojnë stafi dhe studentët në krijimin e një gazete për ngjarjet dhe çështjet e rëndësishme për ta, e cila është e integruar në aktivitetet mësimore?
- e) A zhvillohen klasat si mjedise stimuluese të të nxënit që pasqyrojnë njohuritë dhe interesat e të rriturve dhe fëmijëve?
- f) A i ndan stafi bimët e klasës, insektet, krimbat etj?
- g) A janë të disponueshme mjetet ose materialet e lojës që stimulojnë imagjinatën për fëmijët e vegjël edhe për fëmijët më të mëdhenj dhe të rinjtë?
- h) A bashkëpunon stafi për krijimin e një kopshti të shkollës, kopshti me dru frutor dhe ndarje?
- i) A e ndajnë të rriturit dhe fëmijët një zonë, sallë apo kënd të dedikuar për rrëfimin e tregimeve?
- j) A bashkëpunojnë të rriturit dhe fëmijët rreth koleksionit të muzeut të artefakteve të shkollës dhe historive që lidhen me to?
- k) A e organizon stafi një bibliotekë në mënyrë që ajo të mbështesë të nxënit për të gjithë?
- l) A është biblioteka e organizuar për të mbështetur të nxënit e pavarur të fëmijëve?
- m) A ka koleksion lehtë të qasshëm të DVD-ve?
- n) A janë të përfshirë stafi në planifikimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies?
- o) A ka sistem për regjistrimin, organizimin dhe ndarjen e programeve televizive?
- p) A kanë fëmijët qasjen në libra digjitalë dhe lexues elektronikë të librave?
- q) A ka libra që apelojnë për diversitetin e nxënësve?
- r) A janë librat në dispozicion në gjuhët që fliten dhe mësohen nga fëmijët?
- s) A janë materialet e përshtatura sipas kurrikulës në dispozicion për fëmijët me aftësi të kufizuara, për shembull në shkronja të mëdha, të regjistruara në audio ose në alfabetin e Breilit?
- t) A kanë klasat e shkollës fillore qasje në një teatër kukullash dhe një gamë të kukullave të mëdha dhe të vogla?
- u) _____
- v) _____
- w) _____

C2.11 Ndhmës mësimdhënësit mbështesin të nxënit dhe pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve.

A1.2 Stafi bashkëpunon; B1.4 Ekspertiza e stafit njihet dhe përdoret.

- a) A janë ndihmësit e mësimdhënies të lidhur me mësimin ose fushën e kurrikulës e jo me fëmijët e veçantë?
- b) A shqetësohen ndihmës mësimdhënësit për ta rritur pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve?
- c) A tregojnë ndihmës mësimdhënësit se edhe ata janë nxënës me një sërë interesash?
- d) A i ndihmojnë ndihmës mësimdhënësi fëmijët që të bëhen të pavarur nga mbështetja e tyre e drejtpërdrejt?
- e) A e inkurajojnë ndihmës mësimdhënësit mbështetjen e bashkëmoshatarëve që kanë vështirësi në mësim?
- f) A i ndajnë ndihmës mësimdhënësi njohuritë e tyre për pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje të përjetuara nga fëmijët dhe të rinjtë në shkollë?
- g) A kontribuojnë ndihmës mësimdhënësit me njohuri të tyre të veçanta për lokalitetin dhe komunitetet e shkollës?
- h) A janë të përfshirë ndihmës mësimdhënësit në planifikimin dhe rishikimin e aktiviteteve mësimore?
- i) A e shmangin ndihmës mësimdhënësit ndërhyrjen në marrëdhëniet e fëmijëve e bashkëmoshatarët e tyre dhe stafin tjetër?
- j) A është e organizuar hapësira në klasa në mënyrë që mësimdhënësit dhe ndihmës mësimdhënësit të mund të punojnë me grupe si dhe me individë?
- k) A bëhen përpjekje për të punësuar ndihmës mësimdhënësit meshkuj dhe femra?
- l) A kërkohen pikëpamjet e ndihmës mësimdhënësve për natyrën e detyrave që ata priten të kryejnë?
- m) A e negociojnë ndihmës mësimdhënësit përshkrimin e punës që pasqyron gamën e detyrave që ata i ndërmarrin?
- n) A janë të gjithë mësimdhënësit të njoftuar me gamën e aktiviteteve që ndihmës mësimdhënësit priten të ndërmarrin?
- o) A paguhen ndihmës mësimdhënësit për tërë kohën që i kushtojnë punës në një shkollë, duke përfshirë pjesëmarrjen në takime, përgatitjen e materialeve të mësimdhënies dhe për zhvillimin e stafit?
- p) A dihet se disa fëmijë me aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë për ndihmës personal e jo për ndihmës mësimdhënës?
- q) A janë të mirëseardhur ndihmës mësimdhënësit me aftësi të kufizuara për punësim nga shkolla?
- r) A i ndajnë ndihmësit personalë të njëjtat shqetësime si mësimdhënësit dhe ndihmës mësimdhënësit në mbështetjen e një fëmije për të marrë pjesë me fëmijët e tjerë brenda dhe jashtë orëve të mësimi?
- s) A konsultohen fëmijët me aftësi të kufizuara për mbështetjen që mund t'ju duhet dhe karakteristikat e personit që mund ta ofrojë atë?
- t) A dihet se ndihmësit personalë dhe ndihmës mësimdhënësit mund të duhet të marrin rol avokues për disa fëmijë dhe të rinj?
- u) _____
- v) _____
- w) _____

C2.12 Detyrat e shtëpisë caktohen që të kontribuojnë në të nxënëit e të gjithë fëmijëve.

C2.1 Aktivitetet mësimore planifikohen duke marrë parasysh të gjithë fëmijët.;
C2.7 Vlerësimet inkurajojnë arritjet e të gjithë fëmijëve.

- a) A e shqyrton stafi se në cilat rrethana detyrat e shtëpisë japin kontribut ose e pengojnë të nxënëit?
- b) A e shqyrton stafi nëse ka një moshë nën të cilën detyrat e shtëpisë janë zakonisht të papërshtatshme?
- c) A i kuptojnë stafi çfarë gjërash fëmijët mësojnë në shtëpi kur nuk janë duke i bërë detyrat e shtëpisë?
- d) A sugjerohen detyrat e shtëpisë për të kontribuar në të nxënëit e jo për arsye të tjera si krijimi i rutinës?
- e) A punon stafi me prindërit dhe fëmijët për të shqyrtuar qasjen e shkollës për detyrat e shtëpisë?
- f) A kanë mësuesit një ide të saktë për kohës që nevojitet për të kryer detyrat e shtëpisë?
- g) Kur caktohen detyrat e shtëpisë a ndihmojnë ato në zhvillimin e shkathtësive dhe njohurive të të gjithë fëmijëve?
- h) A e shqyrton stafi se si t'i inkurajojnë fëmijët të angazhohen në interesat e tyre dhe jo të bëjnë detyrat e shtëpisë?
- i) A e mbështet stafi njëri-tjetrin se si të caktohen detyra të shtëpisë që sjellin dobi?
- j) A janë të integruara detyrat e shtëpisë në planifikimin e kurrikulës për periudhën/vitin?
- k) A e kontrollojnë mësimmshënësist nëse të gjithë fëmijët e kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë për detyrë shtëpie?
- l) A kanë fëmijët zgjedhje për detyrat e shtëpisë në mënyrë që ata t'i lidhin ato me zhvillimin e njohurive dhe interesave të tyre?
- m) A modifikohen detyrat e shtëpisë nëse pas diskutimit del se ato nuk kanë kuptim ose nuk janë të përshtatshme për disa fëmijë?
- n) A mund ta shtrijnë fëmijët të nxënëit e tyre duke i caktuar vetë pyetjet e tyre të detyrave të shtëpisë?
- o) A i inkurajojnë detyrat e shtëpisë fëmijët të marrin përgjegjësinë për të nxënëit e tyre?
- p) A e di stafi se kush i kryen detyrat e shtëpisë me dhe pa ndihmën e motrës/vëllait, prindërve ose kujdestarëve?
- q) A e di stafi se kush ka libra dhe qasje në kompjuterë në shtëpi për ndihmë me detyrat e shtëpisë?
- r) A ofron stafi ndihmë alternative për fëmijët që nuk kanë ndihmë në shtëpi?
- s) A ka mundësi për t'i bërë detyrat e shtëpisë dhe për të marrë ndihmë në lidhje me to në mjediset e shkollës jashtë orëve të shkollës?
- t) A i përdorin fëmijët detyrat e shtëpisë për ta plotësuar një fushë interesi gjatë një periudhe kohore?
- u) A i inkurajojnë detyrat e shtëpisë fëmijët që të bashkëpunojnë?
- v) A ka mundësi për t'i shënuar detyrat e shtëpisë në mënyra të ndryshme?
- w) _____
- x) _____
- y) _____

C2.13 Aktivitetet jashtë mësimëve të shkollës përfshijnë të gjithë fëmijët

C2.14 Burimet në lokalitetin e shkollës njihen dhe shfrytëzohen.

- a) A ekziston një gamë e gjerë e aktiviteteve para shkollës, në kohën e drekës dhe pas shkollës?
- b) A i pasqyrojnë interesat e të gjithë fëmijëve lojërat në pauza dhe kohën e lojës?
- c) A mësojnë fëmijët një repertor të lojërave në këndin e lojërave në mënyrë që askush të mos ndihet i përjashtuar?
- d) A konsultohen fëmijët për aktivitetet që janë në dispozicion në pauza dhe para dhe pas shkollës?
- e) A ka mundësi për të rriturit dhe fëmijët që të mësojnë së bashku, për shembull gjuhë të tjera, informatikë, shkrim-lexim?
- f) A është në dispozicion transporti që fëmijët që jetojnë larg shkollës mund të marrin pjesë në ngjarje që organizohen para dhe pas shkollës?
- g) A inkurajohen të gjithë fëmijët të marrin pjesë në aktivitete jashtëkurrikulare të artit, dramës, vallëzimit dhe stërvitjes fizike?
- h) A ka përpjekje që aktivitetet në të cilat një gjini e caktuar mbizotëron të bëhen tërheqëse për të gjithë fëmijët?
- i) A mund të marrin pjesë djemtë dhe vajzat në grupe të përbëra vetëm nga djemtë ose vajzat nëse ka aktivitete në të cilat mbizotëron një gjini, si klubi i kompjuterëve, klubi i shahut ose kori?
- j) A ka mundësi për grupe të përbëra vetëm nga djemtë ose vajzat aty ku aktivitetet e përziera janë të ndaluara për arsye kulturore apo fetare?
- k) A dekurajohen grupet e veçanta të fëmijëve dhe të rinjve nga monopolizimi i hapësirës në këndin e lojërave, për shembull për futboll?
- l) A përshijnë ditët e sportit aktivitetet në të cilat të gjithë mund të marrin pjesë, pavarësisht nivelit të aftësive apo aftësisë së kufizuar?
- m) A reflektojnë fëmijët që janë të zgjedhur për të përfaqësuar klasat e tyre ose shkollën në sport, dramë dhe aktivitete të tjera diversitetin e fëmijëve në shkollë?
- n) A apelojnë vizitat jashtë shtetit për diversitet të fëmijëve brenda shkollës?
- o) A janë udhëtimet shkollore, duke përfshirë vizitat jashtë shtetit, në dispozicion të të gjithë fëmijëve pavarësisht nga arritjet, aftësia e kufizuar ose të ardhurat e prindërve?
- p) A ju jepet të gjithë fëmijëve mundësia për të marrë pjesë në aktivitete jashtë shkollës?
- q) A ju jepet të gjithë fëmijëve mundësia për të marrë pjesë në aktivitete në të mirë të komuniteteve lokale?
- r) _____
- s) _____
- t) _____

C2.14 Burimet në lokalitetin e shkollës njihen dhe shfrytëzohen.

C1.1 – C1.13 dhe C2.1 – C2.13

- A kontribuojnë pjesëtarët e komuniteteve lokale në mësimdhënien në shkollë?
- A e mbështesin prindërit/kujdestarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit të nxënies në shkollë?
- A ndihmojnë organizatat e komunitetit në mbështetje të të nxënies jashtë orëve të mësimi dhe shkollës?
- A i mentorojnë njerëzit që punojnë në lagje fëmijët që përjetojnë vështirësi?
- A dihet se disa të rritur si ata me aftësi të kufizuara, familjet e pjesëtarëve të komunitetit romë ose ata që flasin gjuhën e joshumicës, mund të luajnë një rol të veçantë në mbështetjen e fëmijëve që mund të ndihen të cenueshëm?
- A vihen ndonjëherë në dispozicion për një grup më të fëmijëve burimet në disa shtëpi, si njohuritë dhe shkathtësitë e veçanta, kompjuterët dhe materialet referuese, toka për kultivim, etj?
- A ka shënime të përditësuara rregullisht, të qasshme për stafin, të burimeve në lokalitet për të mbështetur mësimdhënien dhe të mësimnxënien?

Burimet mund të përfshijnë:

ndarje	klubet e hobit	politikanët dhe partitë politike
shërbimi i ambulancës	shtëpitë për të moshuarit/qendrat ditore	shërbimet dhe qendrat e riciklimit
galeritë e artit	organizatat e lesbikeve	qendrat fetare
bizneset	homoseksualeve biseksualëve dhe transgjinjorëve	qendrat e Royal Mail
bamirësitë dhe organizatat e fushatave	bibliotekat	dyqanet dhe bizneset e tjera
organizatat për kujdesin e fëmijëve të porsalindur	autoritetet lokale/departamentet e fëmijëve	grupet e këndimit
kinematë	ngjarjet lokale dhe ekspozitat	punëtorët socialë
zyra për këshillimin e qytetarëve	ngjarjet kombëtare si: muaji i historisë së njerëzve me ngjyrë,	klubet sportive dhe qendrat sportive
fermat e qytetit dhe rurale dhe fermerët	muaji i historisë së LGBT-ve, muaji i historisë së personave me aftësi të kufizuara	argëtuesit në rrugë
grupet komunitare	Trusti Kombëtar organizatave të personave me aftësi të kufizuara	qendrat e studimit pishinat
këshilltarët	shkollat e tjera, arsimit më të lartë	kompanitë telefonike/celulare
zyrtarët e këshillit	prindërit/kujdestarët dhe anëtarët e komunitetit	teatri/grupet teatrale
autoritetet e fshatit	paria, qyteti dhe këshillat e qarkut	stacionet e trenit, stacionet e autobusit, aeroportet, portet
gjykatat	parqet dhe kopshtet	sindikatat
qendrat e vallëzimit/grupet e vallëzimit	shërbimi policor, shërbimi i zjarrfikjes, spitalet	universitetet
grupet mjedisore		autoritetet për ujë, lumenj dhe kanale
liderët dhe organizatat e pakicave etnike		qendrat për joga dhe meditim
të gjithë në komunitet		grupet e të rinjve
kopshtet dhe parqet		etj, etj, etj.
qendrat e kopshteve		
vizitorët shëndetësorë		
trashëgimia dhe të parët		
autoritetet për ndërtim		

Indeksi për gjithëpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithëpërfshirëse

5 Kuadri i planifikimit dhe pyetësorët



Kuadri i planifikimit dhe pyetësorët

Pjesa 5 e *Indeksit* përmban një kuadër të planifikimit dhe katër pyetësorë. Kuadri i planifikimit është përfshirë këtu që të mund të fotokopjohet lehtësisht dhe të përdoret për të reflektuar në një plan zhvillimi në të cilin ndryshimet e bëra në çdo dimension dhe seksion të *Indeksit* bëhen përforcuese në mënyrë reciproke (Aktiviteti 13 në faqen 65). Pyetësorët mund të përdoren për t'i nxitur të rriturit dhe fëmijët që të punojnë në atë që duhet të zhvillohet në vijim brenda shkollës së tyre. Ato mund të ndihmojnë për të përfshirë një grup të gjerë njerëzish për të rishikuar se çfarë po ndodh dhe si të përmirësohet gjendja. Por ato përdoren më mirë si pjesë e dialogut të vazhdueshëm që thëllon pjesëmarrjen e stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës, administratorëve, prindërve/kujdestarëve, fëmijëve dhe të rinjve dhe të tjerëve që janë të përfshirë në shkollë.

Pyetësori 1 mund të përdoret më së shpeshti me stafin mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës dhe administratorët. Prindërit dhe fëmijët që janë të interesuar për mënyrën e strukturimit të *Indeksit* dhe se si treguesit lidhen me pyetjet mund ta përdorin atë gjatë punës me materialet e *Indeksit*.

Pyetësori 2 është për prindërit/kujdestarët. Pyetësorët 3 dhe 4 janë për fëmijët dhe të rinjtë. Gjuha në pyetësorit 3 mund të duket e thjeshtë për fëmijët më të mëdhenj. Mund të shpjegohet se është shkruar për t'ju përgjigjur të gjitha moshave – ose formulimi mund të ndryshohet për t'ju përshtatur në mënyrë specifike atyre. Pyetësori 4 është përshtatur për t'u përdorur me fëmijët më të vegjël.

Kuadri i planifikimit	179
Pyetësori 1: Treguesit	180
Pyetësori 2: Shkolla e fëmijës tim	182
Pyetësori 3: Shkolla ime (për fëmijët dhe të rinjtë)	184
Pyetësori 4: Shkolla ime (për fëmijët më të vegjël)	186

KUADRI I PLANIFIKIMIT

Ju lutem shkruani prioritetet tuaja për zhvillim në këtë fletë, të shprehura në cilëndo mënyrë që duket më e arsyeshme për ju. Ju duhet të konsideroni se si ndryshimi brenda një seksioni mund të duhet të mbështetet nga ndryshimet diku tjetër. Mund t'i mbështetni sugjerimet tuaja në një tregues, pyetje ose grup pyetjesh ose ide të tjera rreth pengesave në të nxënit dhe pjesëmarrje dhe cilat burime duhet të mobilizohen për t'i kapërcyer ato. Nëse kjo fletë përdoret si pjesë e një punëtorie mund të tregoni marrëdhënien tuaj me shkollën duke e shënuar njërin nga kutitë në vijim që vlen për ju:

- mësimdhënës
 ndihmës mësimdhënës
 anëtar tjetër i stafit (ju lutem specifikoni) _____
 administrator
 prind/kujdestar
 fëmijë ose i ri
 tjera (ju lutem specifikoni) _____

KUADRI I PLANIFIKIMIT	
Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse	
Ndërtimi i komunitetit	Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse
Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse	
Zhvillimi i shkollës për të gjithë	Koordinimi i mbështetjes
Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse	
Përpilimi i një kurrikule për të gjithë	Orkestrimi i të nxënit

PYETËSORI 1: TREGUESIT

Ju lutemi shënoni kutitë për grupet e mëposhtme që e përshkruajnë përfshirjen tuaj në shkollë:

- mësimdhënës
 ndihmësmësimdhënës
 anëtar tjetër i stafit
 prind/kujdestar
 fëmijë ose i ri
 administrator
 tjera (ju lutemi specifikoni) _____

Ju lutemi shënoni kutinë që më së mirë pasqyron mendimin tuaj

Përgjigjem
 Përgjigjem dhe
 nuk përgjigjem
 Nuk përgjigjem
 Kam reaguar për më shumë
 informacion

Dimenzioni A – Krijimi i KULTURËS gjithëpërfshirëse					
A1: Ndërtimi i komunitetit	1	Të gjithë janë të mirëpritur.			
	2	Stafi bashkëpunon.			
	3	Fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin.			
	4	Stafi dhe fëmijët respektojnë njëri-tjetrin.			
	5	Stafi dhe prindërit/kujdestarët bashkëpunojnë.			
	6	Stafi dhe administratorët punojnë mirë së bashku.			
	7	Shkolla është model i qytetarisë demokratike.			
	8	Shkolla e inkurajon kuptimin e ndërlidhjeve në mes njerëzve nëpër botë.			
	9	Të rriturit dhe fëmijët i përgjigjen mënyrave të ndryshme të përjetimit të gjinisë.			
	10	Shkolla dhe komunitetet lokale zhvillojnë njëra tjetrën.			
	11	Stafi e ndërlidh atë që ndodh në shkollë me jetën e fëmijëve në shtëpi.			
A2: Krijimi i vlerave	1	Shkolla zhvillon vlera të përbashkëta gjithëpërfshirëse.			
	2	Shkolla nxit respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut..			
	3	Shkolla inkurajon respektin për integritetin e planetit Tokë.			
	4	Gjithëpërfshirja shihet si pjesëmarrje në rritje për të gjithë.			
	5	Pritjet janë të larta për të gjithë fëmijët.			
	6	Fëmijët vlerësohen në mënyrë të barabartë.			
	7	Shkolla lufton të gjitha format e diskriminimit.			
	8	Shkolla nxit ndërveprimet dhe zgjidhjet jo të dhunshme të mosmarrëveshjeve.			
	9	Shkolla inkurajon fëmijët dhe të rriturit të ndihen mirë me veten.			
	10	Shkolla kontribuon në shëndetin e fëmijëve dhe të rriturve.			
Dimenzioni B – Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse					
B1: Zhvillimi i shkollës për të gjithë	1	Shkolla ka një proces zhvillimi me pjesëmarrje.			
	2	Shkolla ka qasje gjithëpërfshirëse në udhëheqje.			
	3	Emërimet dhe promovimet janë të drejta.			
	4	Ekspertiza e stafit njihet dhe përdoret.			
	5	Stafi i ri ndihmohet për t'u vendosur në shkollë.			
	6	Shkolla përpiqet të pranojë të gjithë fëmijët nga lokaliteti i saj.			
	7	Të gjithë fëmijët e rinj ndihmohen të vendosen në shkollë.			
	8	Grupet e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të organizuara drejt për të mbështetur nxënien e të gjithë fëmijëve.			
	9	Fëmijët janë të përgatitur mirë për të kaluar në mjedise të tjera.			
	10	Shkolla i bën ndërtesat e saj fizikisht të qasshme për të gjithë.			
	11	Ndërtesat dhe terreni janë zhvilluar për të mbështetur pjesëmarrjen e të gjithëve.			
	12	Shkolla redukton emetimin e saj të dioksidit të karbonit dhe përdorimin e ujit.			
	13	Shkolla kontribuon në reduktimin e mbeturinave.			

B2: Organizimi i mbështetjes së	1	Të gjitha format e mbështetjes janë të koordinuara.				
	2	Aktivitetet e zhvillimit profesional e ndihmojnë stafin t'i përgjigjet diversitetit.				
	3	Gjuha angleze si mbështetje shpesh gjuhësore është burim për tërë shkollën.				
	4	Shkolla mbështet vazhdimësinë në arsimimin e fëmijëve në kujdesin publik.				
	5	Shkolla siguron që politikat për 'nevojat e veçanta arsimore' mbështesin gjithëpërfshirjen.				
	6	Politika e sjelljes është e lidhur me mësimin dhe zhvillimin e kurrikulës.				
	7	Presionet për përjashtim disiplinor janë ulur.				
	8	Pengesat për vijimin e shkollës janë zvogëluar.				
	9	Ngacmimi është minimizuar.				
Dimenzioni C – Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse						
C1: Përpilimi i një kurrikule për të gjithë	1	Fëmijët eksplorojnë ciklet e prodhimit dhe konsumin e ushqimit.				
	2	Fëmijët hetojnë për rëndësinë e ujit.				
	3	Fëmijët i studiojnë veshjet dhe stolitë e trupit.				
	4	Fëmijët mësojnë rreth banimit dhe mjedisit të ndërtuar.				
	5	Fëmijët shqyrtojnë si dhe pse njerëzit lëvizin në lokalitetin e tyre dhe botë.				
	6	Fëmijët mësojnë për shëndetin dhe marrëdhëniet.				
	7	Fëmijët hetojnë për Tokën, sistemin diellor dhe universin.				
	8	Fëmijët studiojnë jetën në tokë.				
	9	Fëmijët hetojnë rreth burimeve të energjisë.				
	10	Fëmijët mësojnë rreth komunikimit dhe teknologjisë së komunikimit.				
	11	Fëmijët angazhohen dhe merren me krijime në literaturë, art dhe muzikë.				
	12	Fëmijët mësojnë për punën dhe e lidhin atë me zhvillimin e interesave të tyre.				
	13	Fëmijët mësojnë për etikën, pushtetin dhe qeverinë.				
C2: Orkestrimi i të nxënit	1	Aktivitetet mësimore planifikohet duke marrë parasysh të gjithë fëmijët.				
	2	Aktivitetet mësimore inkurajojnë pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve.				
	3	Fëmijët inkurajohen të kenë vetëbesim dhe të zhvillojnë mendimin kritik.				
	4	Fëmijët janë të përfshirë në mënyrë aktive në të nxënit e tyre.				
	5	Fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri.				
	6	Mësimet zhvillojnë aftësinë për të kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve.				
	7	Vlerësimet inkurajojnë arritjet e të gjithë fëmijëve.				
	8	Disiplina bazohet në respekt të ndërsjellë.				
	9	Stafi planifikojnë, japin mësim dhe rishikojnë së bashku.				
	10	Stafi zhvillon burime të përbashkëta për ta mbështetur të nxënit.				
	11	Ndihmës mësimdhënësit mbështesin të nxënit dhe pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve.				
	12	Detyrat e shtëpisë caktohen që të kontribuojnë në të nxënit e të gjithë fëmijëve.				
	13	Aktivitete jashtë mësimave formale ofrohen për të gjithë fëmijët.				
	14	Burimet në lokalitetin e shkollës njihen dhe shfrytëzohen.				

Tri gjerat që më pëlqejnë më së shumti për shkollën:

- 1 _____
- 2 _____
- 3 _____

Tri gjërat që do të doja më së shumti t'i ndryshoja:

- 1 _____
- 2 _____
- 3 _____

PYETËSORI 2: SHKOLLA E FËMIJËS TIM

Ju lutemi shënoni kutinë që më së mirë pasqyron mendimin tuaj

Pajtohem dhe
Pajtohem nuk pajtohem Nuk pajtohem

1	Zakonisht fëmija im mezi pret të vijë në shkollë.			
2	Fëmija im ka miq të mirë në shkollë.			
3	Ndihem pjesë e komunitetit të shkollës.			
4	Shkolla më mban të informuar për atë që ndodh.			
5	Më është kërkuar që të jap kontribut në mësim.			
6	Mendoj se kjo është shkolla më e mirë në këtë zonë.			
7	Shkolla dhe sheshi i lojërave janë tërheqëse.			
8	Tualetet janë të pastra dhe të sigurta.			
9	Fëmijët shkojnë mirë me njëri-tjetrin.			
10	Stafi shkojnë mirë me njëri-tjetrin.			
11	Të rriturit dhe fëmijët shkojnë mirë me njëri-tjetrin.			
12	Mësimdhënësit dhe prindërit shkojnë mirë me njëri-tjetrin.			
13	Të gjitha familjet janë njëjtë të rëndësishme për mësimdhënësit në shkollë.			
14	Kam miq midis prindërve të tjerë.			
15	Më pëlqejnë mësimdhënësit.			
16	Mësimdhënësit janë të interesuar në atë që unë u tregoj për fëmijën tim.			
17	Është mirë të kesh fëmijë me prejardhje të ndryshme në shkollë.			
18	Vetëm duke qenë në shkollë fëmija im mëson se si të kalojë mirë me njerëzit e tjerë.			
19	Vetëm duke qenë në këtë shkollë fëmija im mëson se çfarë do të thotë demokracia.			
20	Fëmija im mëson rëndësinë e kujdesit për mjedisin.			
21	Fëmija im ha shëndetshëm pas shkollës.			
22	Kam qenë i/e përfshirë për ta bërë shkollën një vend më të mirë.			
23	Çdo fëmijë që jeton afër kësaj shkolle është i mirëpritur të vijë këtu.			
24	Kur fëmija im filloi në këtë shkollë ka pasur përpjekje për të më bërë të ndihem i/e përfshirë.			
25	Çdo fëmijë trajtohet me respekt.			
26	Fëmijët me aftësi të kufizuara pranohen dhe respektohen në shkollë.			
27	Djemtë dhe vajzat shkojnë mirë me njëri-tjetrin.			
28	Të qenit homoseksual ose lesbike ose transeksual shihet si pjesë e zakonshme e jetës.			
29	Respektoheni pavarësisht ngjyrës së lëkurës.			
30	Jeni pjesë e barabartë e shkollës pavarësisht cili është religjioni juaj apo nëse nuk keni religjion.			
31	Njerëzit nuk i shohin me përçmim fëmijët për shkak të asaj që veshin.			
32	Respektoheni për përpjekjet tuaja jo për rezultatet që merrni në teste.			

33	Fëmijët nuk e thërrasin njëri-tjetrin me emra fyes.			
34	Ngacmimi nuk është problem.			
35	Nëse dikush do ta ngacmonte fëmijën tim unë e di se do të merrja ndihmë nga shkolla.			
36	Nëse fëmijët mungojnë në shkollë një ditë mësimdhënësi dëshiron të dijë se ku kanë qenë.			
37	Mësimdhënësit nuk kanë të preferuar në mesin e fëmijëve.			
38	Mendoj se mësimdhënësit janë të drejtë kur e lavdërojnë një student.			
39	Mendoj se mësimdhënësit janë të drejtë kur e dënojnë një student.			
40	Kur fëmijët ndërpresin mësimet, fëmijët e tjerë ndihmojnë për t'i qetësuar ata.			
41	Fëmija im mëson se si t'i zgjidhë mosmarrëveshjet duke dëgjuar, folur dhe duke arritur kompromis.			
42	Fëmijët rrallë dërgohen në shtëpi për arsye disiplinore.			
43	Mësimet e përdorin mirë përvojat e fëmijës sim jashtë shkollës.			
44	Shkolla ka një sistem të mirë për mbështetjen e fëmijëve kur ata kanë probleme.			
45	Fëmija im mëson shumë në këtë shkollë.			
46	Fëmijëve shpesh u besohet të mësojnë vetë.			
47	Shkolla është e mirë për kursimin e energjisë.			
48	Fëmija im mëson të kujdeset për mjedisin në shkollë dhe zonën përreth tij.			
49	Fëmijët e ndihmojnë njëri-tjetrin kur ngecin me punën e tyre.			
50	Fëmija im e di se si të kërkojë ndihmë me punën e tij kur i nevojitet.			
51	Shkolla është një vend ku njerëzit me të vërtetë i dëgjojnë idetë e njëri-tjetrit.			
52	Fëmija im gjithmonë e kupton se çfarë duhet të bëjë më pas në një mësim.			
53	Fëmija im zakonisht e kupton se çfarë duhet të bëjë kur i jepen detyra të shtëpisë.			
54	Detyrat e shtëpisë e ndihmojnë fëmijën tim të mësojë.			
55	Nganjëherë, në kohë të drekës fëmija im shkon në klube ose praktikon një sport.			
56	Nganjëherë, pas shkollës fëmija im shkon në klube ose praktikon një sport.			

Këto janë tri gjerat që më pëlqejnë më së shumti në këtë shkollë:

- 1 _____
- 2 _____
- 3 _____

Këto janë tri gjerat që do të më pëlqente më së shumti t'i ndryshoja në këtë shkollë:

- 1 _____
- 2 _____
- 3 _____

QUESTIONNAIRE 3: SHKOLLA IME

Ju lutem vini re se në këtë pyetësor kur përdorim fjalën fëmijë nënkuptojmë edhe fëmijët më të rritur dhe të rinjtë.

Ju lutemi shënoni kutinë që më së mirë pasqyron mendimin tuaj

Pajtohem dhe
Pajtohem nuk pajtohem Nuk pajtohem

1	Mezi pres të vijë në shkollë.			
2	Ndihem pjesë e komunitetit të madh të shkollës.			
3	Shkolla dhe sheshi i lojërave duken tërheqëse.			
4	Tualetet janë të pastra dhe të sigurta.			
5	Fëmijët shkojnë mirë me njëri-tjetrin.			
6	Të rriturit shkojnë mirë me njëri-tjetrin.			
7	Të rriturit dhe fëmijët shkojnë mirë me njëri-tjetrin.			
8	Kam disa miq të mirë.			
9	Më pëlqejnë mësimdhënësit e mi.			
10	Shkolla më ndihmon të ndjehem mirë për veten time.			
11	Shkolla më ndihmon të ndjehem mirë për të ardhmen.			
12	Inkurajohemi të ngremë zërin për atë që besojmë se është e drejtë.			
13	Është mirë të kesh fëmijë me prejardhje të ndryshme në shkollë.			
14	Vetëm duke qenë në shkollë mëson se si të kalosh mirë me njerëzit.			
15	Kam mësuar se çfarë do të thotë demokracia duke qenë në shkollë.			
16	Kam mësuar se si veprimet e mia ndikojnë te të tjerët në shkollë.			
17	Kam mësuar se si veprimet e mia ndikojnë te të tjerët nëpër botë.			
18	Kam mësuar se si vlerat e mia ndikojnë në mënyrën si veprojmë.			
19	Ha shëndetshëm në shkollë.			
20	Familja ime ndihet e përfshirë në atë që ndodh në shkollë.			
21	Kur mësimdhënësit thonë se do të bëjnë diçka ata e bëjnë.			
22	Njerëzit e pranojnë kur gabojnë.			
23	Në shkollë është një vend i rehatshëm ku unë shkoj gjatë kohës së drekës.			
24	Kam qenë i/e përfshirë për ta bërë shkollën një vend më të mirë.			
25	Çdo fëmijë që jeton afër kësaj shkolle është i mirëpritur të vijë këtu.			
26	Kur kam ardhur për herë të parë në shkollë më kanë ndihmuar të vendosem.			
27	Respektohemsh pavarësisht ngjyrës së lëkurës.			
28	Ndihesh pjesë e barabartë e shkollës pavarësisht cili është religjioni juaj apo nëse nuk keni religjion.			
29	Fëmijët nuk i shohin me përçmim të tjerët për shkak të asaj që veshin.			
30	Djemtë dhe vajzat shkojnë mirë me njëri-tjetrin.			
31	Të qenit homoseksual ose lesbike shihet si pjesë e zakonshme e jetës.			
32	Fëmijët me aftësi të kufizuara respektohen dhe prahen.			
33	Fëmijët nuk e thërrasin njëri-tjetrin me emra fytes.			
34	Nëse dikush do të më ngacmonte mua ose dikë tjetër, do t'i tregoja një mësimdhënësi.			
35	Mësimdhënësit nuk kanë të preferuar në mesin e fëmijëve.			

36	Nëse mungoj në shkollë një ditë mësimdhënësi dëshiron të dijë se ku kam qenë.			
37	Mendoj se mësimdhënësit janë të drejtë kur e lavdërojnë një fëmijë.			
38	Mendoj se mësimdhënësit janë të drejtë kur e dënojnë një fëmijë.			
39	Mësimdhënësit dinë si t'i ndalojnë fëmijët që ndërpresin mësimet.			
40	Kur fëmijët ndërpresin mësimet, fëmijët e tjerë i qetësojnë ata.			
41	Ne mësojmë si t'i zgjidhim mosmarrëveshjet duke dëgjuar, folur dhe bërë kompromis.			
42	Në mësimet fëmijët shpesh e ndihmojnë njëri-tjetrin në çifte dhe grupe të vogla.			
43	Në mësimet fëmijët ndajnë atë që dinë me fëmijët e tjerë.			
44	Nëse kam problem në një mësim, mësimdhënësi ose ndihmësi mësimdhënësi më ndihmojnë.			
45	Më pëlqen shumica e mësimëve të mia.			
46	Mësoj për atë që po ndodh në botë.			
47	Kam mësuar për rëndësinë e të drejtave të njeriut.			
48	Mësoj se si mund të zvogëlohet vuajtja në botë.			
49	Mësoj shumë në këtë shkollë.			
50	Fëmijëve shpesh u besohet të mësojnë vetë.			
51	Mësojmë se si ta kursejmë energjinë në shkollë.			
52	Mësojmë të kujdesemi për mjedisin në shkollë dhe zonën përreth tij.			
53	Mësojmë ta respektojmë planetin Tokë.			
54	Kur ndihmës mësimdhënësit janë në klasë ata i ndihmojnë secilit që ka nevojë.			
55	Mësimdhënësit janë të interesuar të dëgjojnë idetë e mia.			
56	Fëmijët janë të interesuar të dëgjojnë idetë e njëri-tjetrit.			
57	Në mësimet gjithmonë e di me çfarë të vazhdoj më pas.			
58	E njoh veten kur kam bërë punë të mirë.			
59	Mësimdhënësit nuk e bëjnë të madhe nëse bëj gabime në punën time për sa kohë që përpiqem të bëj më të mirën.			
60	Puna ime shfaqet në muret në shkollë.			
61	Kur më jepen detyra të shtëpisë zakonisht e kuptoj atë që duhet të bëj.			
62	Mendoj se detyrat e shtëpisë më ndihmojnë me atë që dua të mësoj.			
63	Në kohën e drekës ose pas shkollës ndonjëherë shkoj në klube ose praktikoj sport.			

Këto janë tri gjerat që më pëlqejnë më së shumti në shkollën time?

1

2

3

Këto janë tri gjerat që do të më pëlqente më së shumti t'i ndryshoja në këtë shkollë?

1

2

3

PYETËSORI 4: SHKOLLA IME

A pajtoheni apo nuk pajtoheni? Ju lutem vendosni një vijë në fytyrë që tregon atë që mendoni.

1	Jam i/e lumtur në shkollë.			
2	Më pëlqen si duket shkolla.			
3	Kam miq të mirë në shkollë.			
4	Fëmijët sillen mirë me njëri-tjetrin në shkollë.			
5	Të rriturit sillen mirë me fëmijët në shkollë.			
6	Më pëlqejnë mësimit në shkollë.			
7	Në shkollë ha ushqim që është i mirë për mua.			
8	Më pëlqen t'i tregoj familjes çfarë kam bërë në shkollë.			
9	Kur kam ardhur për herë të parë në shkollë më kanë ndihmuar të ndjehem i lumtur.			
10	Djemtë dhe vajzat shkojnë mirë me njëri-tjetrin.			
11	Fëmijët nuk lëndohen ose nuk thirrem me emra fyes në shkollë.			
12	Ndjehem i sigurt në sheshin e lojërave dhe në tualete.			
13	Mësimit i ndalojnë fëmijët të bëjnë zhurmë në mësim.			
14	Fëmijët shpesh e ndihmojnë njëri-tjetrin në mësim.			
15	Nëse kam ndonjë problem mund të kërkoj ndihmë nga një i rritur.			
16	Mësoj shumë gjëra interesante në shkollë.			
17	Mësoj për njerëzit në pjesë të tjera të botës.			
18	Në shkollë mësojmë si ta kursejmë energjinë.			
19	Mësojmë të kujdesemi për mjedisin.			
20	Mësimit janë të interesuar të dëgjojnë idetë e mia.			
21	Gjithmonë e di se çfarë të bëj në mësim.			
22	Mësimit nuk e kanë problem nëse bëj gabime për sa kohë që përpiqem të bëj më të mirën.			
23	Puna ime nganjëherë vendoset në murin e shkollës.			
24	Ndonjëherë shkoj në klube para apo pas shkollës.			

Cilat janë tri gjërat që të pëlqejnë më së shumti për shkollën tënde?

1 _____

2 _____

3 _____

Cilat janë tri gjërat që do të pëlqente më së shumti t'i ndryshoje në shkollën tënde?

1 _____

2 _____

3 _____

Burimet

6 Burimet



Burimet

- Abdi, A. and Shultz, L. (2008) *Educating for human rights and global citizenship* [Edukimi për të drejtat e njeriut dhe qytetarinë globale], Albany: State University of New York Press.
- Actionaid (2008) *Power down: save energy, be the solution* [Fike: kurse energjinë, bëhu zgjidhja], Chard: Action Aid.
- Alexander, R. (2010) (ed.) *Children, their world, their education: final report and recommendations of the Cambridge Primary Review* [Fëmijët, bota e tyre, edukimi i tyre: raporti final dhe rekomandimet e Cambridge Primary Review], London: Routledge.
- Andreotti, V. and de Souza, L. M. (2008) *Learning to read the world through other eyes* [Mësojmë ta lexojmë botën përmes syve të tyre], Derby: Global Education.
- Au, W. and Tempel, M. (2012) *Rethinking high-stakes testing and accountability in public schools* [Rimendimi i testimeve të rëndësishme dhe llogaridhënia në shkollat publike], Milwaukee, Rethinking Schools.
- Baginsky, W. (2004) *Peer mediation in the UK, a guide for schools* [Ndërmjetësimi nga bashkëmohatarët në MB, udhëzues për shkollat], London: NSPCC. Balshaw, M. (1999) *Help in the classroom* (2nd edition) [Ndihma në klasë (edicioni i 2-të)], London: Fulton.
- Barnes, J. (2011) *Cross-curricular learning 3-14* (2nd edition) [Mësimi ndërkurrikular 3-14 (edicioni i 2-të)], London: Sage.
- Barnes, J. and Ntung, A. (2015) *Education in a diverse UK* [Edukimi në një MB diverse], London, Migrant Help Communications.
- Bigelow, B. and Swinehart, T. eds. (2014) *A people's curriculum for the earth* [Kuurikulë e njerëzve për Tokën], Milwaukee, Rethinking Schools.
- Bigelow, B. and Swinehart, T. eds. (2014) *A people's curriculum for the earth* [Kurrikulë e njerëzve për Tokën], Milwaukee, Rethinking Schools.
- Black, M. and King, J. (2009) *The atlas of water: mapping the world's most critical resource* [Atlasi i ujërave: paraqitja e burimeve më kritike të botës], Brighton: Earthscan.
- Blair, M. and Bourne, J. with Coffin, C., Creese, A. and Kenner, C. (1999) *Making the difference: teaching and learning strategies in successful multi-ethnic schools* [Bëjmë diferencën: strategjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkolla multietnike të suksesshme], London: HMSO.
- Boaler, J. (2010) *The Elephant in the Classroom: helping children learn and love maths* [Elefanti në klasë; asistimi i fëmijëve për ta mësuar dhe dashur matematikën], London: Souvenir Press.
- Bohm, D. (1996) *On Dialogue* [Për dialogun], London: Routledge.
- Brighton and Hove City Council (2005) *Biodiversity Action Plan* [Plani i veprimit i biodiversitetit], Brighton: BHCC.
- Buckingham, S. and Turner, M. (eds.) (2008) *Understanding environmental issues* [Kuptojmë çështjet mjedisore], London: Sage.
- Centre for Equity in Education (2007) *Equity in Education: new directions, second annual report on the state of equity in the English education system* [Barazia në arsim: drejtimet e reja, raporti i dytë vjetor për gjendjen e barazisë në sistemin e arsimit], Manchester: The University of Manchester.
- Centre for Studies on Inclusive Education (2010) *Developing a single equality policy for your school: a CSIE guide* [Zhvillimi i një politike të vetme të barazisë për shkollën tuaj: udhëzues i CSIE -së], Bristol: CSIE.
- Clark, A. and Moss, P. (2001) *Listening to young children* [Dëgjimi i fëmijëve të vegjël], London: National Children's Bureau.
- Clutterbuck, P. (2008) *Values: a programme of study for primary schools* [Vlerat: program studimi për shkollat fillore], Carmarthen: Crown House Publishing Ltd.
- Collaborative Learning Project: www.collaborativelearning.org
- Craig, D. (2009) *The weather book: why it happens and where it comes from* [Libri i motit: pse ndodh dhe nga vjen], London: Michael O'Mara Books.
- Cummins, J. and Sayers, D. (1995) *Brave new schools; challenging global illiteracy through global learning networks* [Shkolla të reja të guximshme: sfidimi i analfabetizimit global përmes rrjeteve globale të të nxënimit], New York, St. Martin's Press.
- Dahlberg, G., Moss, P. and Pence, A. (2007) *Beyond quality in early childhood education and care* [Përtej cilësisë në arsimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme], London: Routledge.
- Denman-Sparks, L. and the A.B.C. Task Force (1989) *Anti-Bias Curriculum, tools for empowering young children* [Kurrikula kundër paragjyqimeve, mjetet për fuqizimin e fëmijëve të vegjël], Washington: National Association for the Education of Young Children.
- Department for Children, Families, Lifelong Learning and Skills, (2008) *Careers and the world of work: a framework for 11-19 year olds in Wales* [Karriera dhe bota e punës: kornizë për 11-19 vjeçarët në Uells], Cardiff: Welsh Assembly.

- Department for Children, Schools and Families (2008) *Top tips for developing the global dimension in schools* [Këshillat kryesore për zhvillimin e dimensionit global në shkolla], London: DCSF.
- Department for Children, Schools and Families (2008) *Top tips for sustainable purchasing in schools* [Këshillat kryesore për zhvillimin e dimensionit global në shkolla], London: DCSF.
- Department for Children, Schools and Families (2008) *Planning a sustainable school: driving school improvement through sustainable development* [Planifikimi i një shkolle të qëndrueshme: udhëheqja e përmirësimit të shkollës përmes zhvillimit të qëndrueshëm], London: DCSF.
- Department for Children, Schools and Families (2009) *S3: Sustainable school self-evaluation* [Vetëvlerësimi i shkollave të qëndrueshme], London: DCSF.
- Department for Education and Employment (1999) 'Inclusion: providing effective learning opportunities for all pupils [Gjithpërfshirja: ofrimi i mundësive efektive të të nxënimit]', in *The national curriculum handbook for primary teachers in England*, London: DfEE.
- Department for Education and Employment (2000) *Working with teaching assistants: a good practice guide* [Puna me ndihmësit e mësimdhënies: udhëzues i mirë i praktikës], London: DfEE.
- Department for Education and Employment (2000) *Guidance on the education of children and young people in care* [Udhëzime për arsimin e fëmijëve dhe të rinjve në kujdes], London: DfEE.
- Department for Education and Skills (2002) *Accessible schools: planning to increase access to schools for disabled pupils* [Shkollat e qasshme: planifikimi për të rritur qasjen në shkolla për nxënësit me aftësi të kufizuara][Guidance] London: DfES.
- Department for Education and Skills (2006) *Implementing the Disability Discrimination Act in schools and early years settings* [Zbatimi i Ligjit kundër diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar në shkolla dhe shkollat në vitet e hershme], London: DfES.
- Department for Education and Skills (2006) *Learning outside the classroom manifesto* [Manifest i të nxënimit jashtë klasës], London: DfES.
- Department for Education and Skills (2007) *Këshilla kryesore për ta reduktuar përdorimin e energjisë dhe ujit në shkollë*, London: DfES.
- Dow, K. and Downing, T. (2006) *The atlas of climate change, mapping the world's greatest challenge* [Atlasi i ndryshimeve klimatike, paraqitja e sfidës më të madhe të botës], Brighton: Earthscan.
- Dressner, S. (2008) *The principles of sustainability* [Parimet e qëndrueshmërisë], London: Earthscan.
- Drummond, M. J. (2003) *Assessing children's learning* [Vlerësimi i të nxënimit të fëmijëve], London: David Fulton.
- Durbin, G., Morris, S. and Wilkinson, S. (1990) *A teacher's guide to learning from objects* [Udhëzuesi i mësimdhënësve për të mësuar nga objektet], London: English Heritage.
- Egan, K. (1988) *Teaching as Storytelling, an alternative approach to teaching and the curriculum* [Mësimdhënia si tregim, qasje alternative ndaj mësimdhënies dhe kurrikulës], London: Routledge.
- Farrer, F. (2000) *A quiet revolution, encouraging positive values in our children*[Revolucion i qetë, inkurajimi i vlerave pozitive tek fëmijët tanë], London: Ebury Press.
- Fielding, M. and Moss, P. (2011) *Radical education for the common school* [Edukimi radikal për shkollën e përbashkët], London: Routledge.
- Fisher, R. (2003) *Teaching thinking* [Mësimi për të menduar], London: Continuum.
- Flowers, N. (2000) *Human rights education handbook: effective practices for learning, action and change* [Doracaku i edukimit për të drejtat e njeriut: praktika efektive për të nxënimit, veprimin dhe ndryshimin], Minneapolis: Human Rights Resource Centre, University of Minnesota.
- Forest Schools: www.forestschoools.com
- George, S. (2010) *Whose crisis, whose future? Towards a greener, fairer, richer world* [Kriza e kujt, e ardhmja e kujt? Drejt një bote më të gjelbër, më të drejtë, më të pasur], Cambridge: Polity.
- Hart, S. (1996) *Beyond special needs: enhancing children's learning through innovative thinking* [Përtej nevojave të veçanta: rritja e të nxënimit të fëmijëve përmes të menduarit inovativ], London: Paul Chapman Publishing.
- Hart, S. (2000) *Thinking through teaching: a framework for enhancing participation and learning* [Mendimi përmes mësimdhënies: kuadër për rritjen e pjesëmarrjes dhe të nxënimit], London: David Fulton.
- Hart, S., Dixon, A., Drummond, M.J. and McIntyre, D. (2006) *Learning without limits [Të nxënimit pa kufij]*, Buckingham: Open University Press. <http://learningwithoutlimits.educ.cam.ac.uk>
- Hatcher, R. (2006) 'Social class and schooling: differentiation or democracy?' in Cole, M. (ed.) *Education, equality and human rights: issues of gender, race, sexual orientation, disability and social class* (2nd edition) [Klasa sociale dhe shkollimi: çështjet e gjinisë, racës, orientimit seksual, aftësitë e kufizuara dhe klasa sociale], London: Routledge.

- Hawkes, N. (2003) *How to inspire and develop positive values in your classroom* [Si të frymëzoni dhe zhvilloni vlera pozitive në klasën tuaj], Cambridge: LDA.
- Higgins, P. (2010) *Eradicating ecocide* [Çrrenjosja e shkatërrimit të mjedisit natyror], London: Shephard-Walwyn.
- Holmes, T., Blackmore E., Hawkins, R. and Wakeford, T. (2011) *The common cause handbook: values and frames* [Doracaku i arsyeve të përbashkëta: vlerat dhe kuadrot], Machynlleth, Public Interest Research Centre.
- Klein, N. (2014) *This changes everything, capitalism versus the climate* [Kjo ndryshon gjithçka, kapitalizmin kundrejt klimës], New York, Simon Schuster.
- Knight, S. (2011) *Forest School for All* [Shkolla në pyll për të gjithë], London, Sage.
- Kohn, A. (2006) *The homework myth: why our kids get too much of a bad thing* [Miti i detyrave të shtëpisë: pse fëmijët tanë marrin shumë nga gjërat e këqija], Cambridge, MA: Da Capo Press.
- Language and Curriculum Access Service (LCAS) (1999) *Enabling progress in multilingual classrooms* [Mundësimi i përparimit në klasat ku fliten shumë gjuhë], London: London Borough of Enfield.
- Leggett, J. (2005) [Gjysmë e shkuar: nafta, ajri i nxehtë dhe kriza globale e energjisë], London: Portobello Books.
- Lesbian, Gay, Bisexual and Transgender History Month [Muaji i historisë në lezbikeve, homoseksualëve dhe Transgjinjorëve] (2009) Toolkit for schools, London: LGBT. www.lgbthistorymonth.org.uk
- Mackay, M. (2008) Sustainable energy without the hot air: www.withouthotair.com
- McNamara, S. and Moreton, G. (1997) *Understanding Differentiation: A Teacher's Guide* [Kuptimi i diferencimit: Udhëzues për mësime të ndryshme], London: David Fulton.
- Marlowe, B. A. and Page, M. L. (1998) *Creating and sustaining the constructivist classroom* [Krijimi dhe mbajtja e klasës konstruktiviste], London: Corwin Press/Sage.
- Martin, F. and Owens, P. (2008) *Caring for our world: a practical guide to education for sustainable development* [Kujdesi për botën tonë: udhëzues praktik për edukimin për zhvillim të qëndrueshëm], Sheffield: Geographical association.
- Millstone, E. and Lang, T. (2008) *The atlas of food: who eats what, where and why?* [Atlasi i ushqimit: kush ha çfarë, ku dhe pse?] Brighton: Earthscan.
- Noddings, N. (2005) *The challenge to care in schools, an alternative approach to education* [Sfida për kujdesin në shkollë, qasje alternative në arsim], New York: Teachers College Press.
- Noddings, N. (2005) *Critical lessons: what our schools should teach* [Leksione kritike: çfarë mësimi duhet të ofrojnë shkollat tona], New York: Cambridge University Press.
- Norfolk County Council (2009) February is Lesbian, Gay, Bisexual and Transgender History Month, Ideas for primary schools [Muaji shkurt është muaji i historisë së lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinjorëve, ide për shkollat fillore], Norwich: NCC.
- Norfolk County Council (2009) February is Lesbian, Gay, Bisexual and Transgender History Month, Ideas for primary schools [Muaji shkurt është muaji i historisë së lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinjorëve, ide për shkollat e mesme], Norwich: NCC.
- Northern Ireland Curriculum (2009) *Clothes conscious, learning for life and work* [Kujdesi për veshjen, mësimi për jetën dhe punën], Belfast: CCEA.
- Noyes, A. (2007) *Rethinking school mathematics* [Rimendimi për matematikën në shkollë], London: Paul Chapman Publishing.
- Office for Standards in Education (2008) Learning outside the classroom [Të nxënit jashtë klasës], London: Ofsted.
- Office for Standards in Education (2009) Education for sustainable development [Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm], London: Ofsted.
- Ollerton, M. and Watson, A. (2004) *Inclusive mathematics 11-18* [Matematikë gjithëpërfshirëse 11-18], London: Continuum.
- O'Neill, O. (2002) *A question of trust* [Çështje besimi], BBC Reith Lectures, Cambridge, Cambridge University Press.
- Open spaces for dialogue and enquiry, critical literacy in global citizenship education* [Hapësira për dialog dhe hulumtime, mendimi kritik për fjalën në edukimin e qytetarisë globale], Nottingham: Centre for the study of social and global justice.
- Orr, D. (2004) *Earth in mind: on education, environment and the human prospect* [Me Tokën në mendje: në arsim, mjedis dhe perspektivën njerëzore], Washington: Island Press.
- Owen, J. (1991) *The ecology of a garden, the first fifteen years* [Ekologjia e kopshtit, pesëmbëdhjetë vitet e para], Cambridge: Cambridge University Press.
- Pearl, A. (1997) 'Democratic education as an alternative to deficit thinking', in Valencia, R. (ed.) *The evolution of deficit thinking: educational thought and practice* [Evolucioni i fajësimit të mangësive: mendime dhe praktika arsimore], London: Falmer Press.

- Potts, P. (ed.) (2002) *Inclusion in the city* [Gjithëpërfshirja në qytet], London: Routledge.
- Qualifications and Curriculum Authority (2007) *The global dimension in action: a curriculum planning guide for schools* [Dimensioni global në veprim, udhëzues për planifikimin e kurrikulës për shkollat], London: QCA.
- Rich, D., Casanova, D., Dixon, A., Drummond, M.J., Durrant, A. and Myer, C. (2004) *First hand experience, what matters to children* [Përvojë e drejtpërdrejt, çfarë ka rëndësi për fëmijët], Clopton: Rich Learning Opportunities.
- Rich, D., Drummond, M.J. and Myer, C. (2008) *Learning: what matters to children* [Të nxënit: çfarë ka rëndësi për fëmijët], Clopton: Rich Learning Opportunities.
- Rustemier, S. and Booth, T. (2005) *Learning about the Index in use, a study of the use of the Index in schools and LEAs in England* [Mësimi për Indeksit në përdorim, studim i përdorimit të Indeksit në shkolla dhe LEA në Angli], Bristol: CSIE.
- Save the Children (2000) *The school council: a children's guide* [Këshilli i shkollës: udhëzues për fëmijë], London: Save the Children. School councils UK: www.schoolcouncils.org
- Schools out classroom: www.schools-out.org.uk/classroom
- Scoffham, S. (2010) (ed.) *Primary Geography Handbook* [Doracaku i gjeografisë në shkollat fillore], Sheffield: Geographical Association.
- Scoffham, S., Bridge, C. and Jewson, T. (2006) *Keystart World Atlas* [Atlasi i botës], London: Harper Collins.
- Scottish Health Promoting Schools Unit (2004) *Being well, doing well* [Kur je mirë, punon mirë], Dundee: Learning and Teaching Scotland.
- Steel, C. (2008) *Hungry city: how food shapes our lives* [Qyteti uritur: si ushqimi formëson jetën tonë], London: Vintage Books.
- Stibbe, A. (2009) *The handbook of sustainability literacy: skills for a changing world* [Doracaku i njohurive dhe shkathtësive për të ndërtuar qëndrueshmëri në ardhmen: shkathtësi për një botë në ndryshim], Dartington: Green Books.
- Stone, M. (2009) *Smart by Nature: schooling for sustainability* [Mësojmë përmes natyrës: shkollimi për qëndrueshmëri], Healdsburg: Watershed Media.
- Stone, M. and Barlow, Z. (2005) *Ecological Literacy: educating our children for a sustainable world* [Njohuritë ekologjike: edukimi i fëmijëve tanë për një botë të qëndrueshme], San Francisco: Sierra Club Books.
- Sustain: the alliance for better food and farming (2010) *Every school a food growing school* [Çdo shkollë një shkollë për kultivimin e ushqimit], London: Sustain.
- Sustainability and environmental education: www.se-ed.co.uk
- Sustainable Development Commission (2009) *Prosperity without Growth? The transition to a sustainable economy* [Prosperiteti pa rritje? Kalimi në një ekonomi të qëndrueshme], London: Sustainable Development Commission.
- Swann, M. and Peacock, A. (2012) *Creating learning without limits* [Krijimi i të nxënit pa kufij], Buckingham: Open University Press.
- Swann, M., Peacock, A., Hart, H. and Drummond, M. (2012) *Creating learning without limits* [Krijimi i të nxënit pa kufij], Maidenhead, Open University Press.
- UNICEF UK (2008) *Rights respecting schools in England* [Shkollat që respektojnë të drejtat në Angli], London: Unicef.
- UNICEF/UNESCO (2007) *A human rights based approach to education for all* [Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut në arsimin për të gjithë], New York, Paris: UNICEF/UNESCO.
- Wallace, B. (2001) *Teaching thinking skills in the early years/across primary years* [Mësimi i shkathtësive të menduarit në vitet e hershme/përgjatë viteve të para], London: David Fulton.
- Warwick, I. and Douglas, N. (2001) *Safe for all: a best practice guide to prevent homophobic bullying in secondary schools* [Siguri për të gjithë: një udhëzues i praktikave më të mira për të parandaluar ngacmimin homofobik në shkollat e mesme], London: Citizenship 21.
- Watson, A. (2006) *Raising achievement in secondary mathematics* [Rritja e arritjeve në matematikë në shkollat e mesme], Maidenhead: Open University Press.
- Winter, R. (1989) *Learning from experience: principles and practice in action research* [Mësojmë nga përvoja: parimet dhe praktika në kërkimet për veprimin], London: Falmer.
- World of Inclusion: www.worldofinclusion.com
- Wrigley, T. (2006) *Another school is possible* [Një tjetër shkollë tjetër është e mundur], London: Bookmarks Publications.
- Young, M. (2002) *Global Citizenship, the handbook for primary teaching*, [Qytetaria globale, doracaku për mësimdhënësit në shkollat fillore] Cambridge: Oxfam.

Dokumentet e ratifikuara ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut

Për shkak të shkallës së ndarjes së sistemeve ligjore në Angli, Skoci, Irlandën e Veriut dhe Uells, miratimi në ligj i këtyre instrumenteve ndryshon në secilin vend të MB-së.

Dokumentet përfshijnë:

- Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut 1948 (të votuar në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së nga Mbretëria e Bashkuar në vitin 1948)
- Konventën ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor 1965 (e ratifikuar nga Mbretëria e Bashkuar në vitin 1969)
- Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike 1966 (e ratifikuar nga Mbretëria e Bashkuar në vitin 1976)
- Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore 1966 (e ratifikuar nga Mbretëria e Bashkuar në vitin 1976)
- Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave 1979 (e ratifikuar nga Mbretëria e Bashkuar në vitin 1986)
- Konventa për të drejtat e fëmijëve 1989 (e ratifikuar nga Mbretëria e Bashkuar me rezerva 1991, plotësisht në vitin 2008)
- Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2006 (e ratifikuar nga Mbretëria e Bashkuar me rezerva për përfshirjen në arsimin e rregullt)
- Konventa evropiane për të drejtat e njeriut 1950 (e përfshirë në Ligjin e Anglisë 1998).

Deklarata universale e të drejtave të njeriut 1948

Kjo është deklarata bazë për të gjitha dokumentet e tjera të të drejtave të njeriut. Doli si pasojë e Luftës së Parë Botërore 1939-1945 dhe çoi në themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale. U përpilua nga komiteti i kryesuar nga Eleanor Roosevelt, gruaja e presidentit amerikan. U miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 1948. Një mënyrë për ta shpallur një diçka si një të drejtë është të thuash se ajo është universale por jo të gjithë pajtohen se të gjitha nenet e Deklaratës përfaqësojnë të drejta. Edhe pse e drejta për jetë mund të shihet të përfshijë nevojën për mbrojtjen e mjedisit, ende ka pak referencë ndaj mjedisit në këtë Deklaratë.

Ekstrakte:

Neni 1:

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të të drejtave. Ata janë të pajisur me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit në një frymë vëllazërore.

Neni 2:

Secilit i përket të gjitha të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë pa kurrfarë dallimesh në pikëpamje të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, mendimit politik ose çdo mendimi tjetër, të prejardhjes kombëtare a shoqërore, të pasurisë, të lindjes apo të ndonjë gjendje tjetër juridike. Përveç kësaj, nuk do të bëhen kurrfarë dallimesh në bazë të statusit politik, juridik apo ndërkombëtar të vendit ose territorit të cilit i përket ndonjë individ, qoftë kur ky vend ose territor është i pavarur, apo kur ndodhet nën kujdestari ose është jove të qeverisë apo nën çfarëdo kufizimi tjetër të sovranitetit.

Neni 3:

Secili ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri vetjake.

Neni 17:

1. Secili ka të drejtë të ketë pasuri, vetë dhe në bashkësi me të tjerët.
2. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.

Neni 26:

Secili ka të drejtën e arsimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktin në fazat e arsimit fillor dhe themelor. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të jetë i përgjithshëm, ndërsa arsimi i lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në mënyrë të barabartë në bazë të aftësisë.

Arsimi duhet të synoj zhvillimin e plotë të personalitetit të njeriut dhe forcimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai duhet të nxitë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjitha kombeve, grupeve raciale ose fetare, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

Prindërit kanë të drejtën parësore për zgjedhjen e llojit të arsimit për fëmijët e tyre.

Konventa për të drejtat e fëmijës

Mbretëria e Bashkuar e ratifikoi Konventën në dhjetor të vitit 1991, por tha se nuk do t'i përmbahet kërkesave që kishin të bënin me trajtimin e fëmijëve të azilkërkuesve dhe moshën e përgjegjësisë penale. Përveç kësaj, MB-ja ishte kritikuar nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve në vitin 1995 për rritjen e varfërisë dhe pabarazisë së fëmijëve dhe mungesën e mundësive për fëmijët dhe të rinjtë për t'i shprehur pikëpamjet e tyre. Raporti i vitit 2002 i Komitetit theksonte shqetësimet për mirëqenien e fëmijëve në kujdestari dhe ndikimin negativ të varfërisë në të drejtat e fëmijëve. Përmendej vazhdimi i ndëshkimit trupor në shkollat private në Irlandën e Veriut, i cili u shfuqizua më në fund në vitin 2003. Raporti i vitit 2002 e përshkroi pikëpamjen e MB-së se prindërit duhet të lejoheshin të përdorin 'ndëshkimin e arsyeshëm' të fëmijëve si 'shkelje serioze të dinjitetit të fëmijës'. Kjo nuk u pranua nga Qeveria e MB-së. Ndonëse qeveria hoqi 'rezervimet' e saj në vitin 2008, në vitin 2017 mbeti ligjërish e lejueshme që prindërit të disiplinonin fëmijët e tyre duke i goditur dhe mosha e përgjegjësisë penale ishte më e ulët se në vende të tjera në Evropë (10 në Angli, Uells dhe Irlandë të Veriut, 12 në Skoci e rritur nga 8 në vitin 2011).

Ekstrakt:**Neni 29: Shtetet Palë u pajtuan që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:**

- a) të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;
- b) të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara;
- c) të rrisë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti;
- d) ta përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerimit, barazisë midis sekseve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone;
- e) t'i zhvillojë fëmijës respektin për mjedisin natyror.

Ekstrakte nga Deklarata Universale e të Drejtave të Nënës Tokë⁵⁹

Kjo deklaratë u miratua nga Konferenca botërore e popujve mbi ndryshimet klimatike dhe të drejtat e Nënës Tokë më 22 prill 2010 në Bolivi dhe iu dorëzua Kombeve të Bashkuara për shqyrtim.

Neni 2: Të drejtat e natyrshme të nënës Tokë

- (1) Nëna Tokë dhe të gjitha qeniet prej të cilave përbëhet ajo kanë këto të drejta të natyrshme:
 - (a) e drejta për jetë dhe për të ekzistuar;
 - (b) e drejta për t'u respektuar;
 - (c) e drejta për rigjenerimin e bio-kapacitetit të saj dhe për të vazhduar ciklet dhe proceset jetësore pa ndërhyrjet e shkaktuara nga njeriu;
 - (d) e drejta për të ruajtur identitetin dhe integritetin si qenie e veçantë, vetë-rregulluese dhe e ndërlidhur;
 - (e) e drejta për ujë si burim jete;
 - (f) e drejta për ajër të pastër;
 - (g) e drejta për shëndet tërësor;
 - (h) e drejta për të qenë e pakontaminuar, pa ndotje dhe mbetje toksike ose radioaktive;
 - (i) e drejta për të mos ia modifikuar strukturën gjenetike në një mënyrë që kërcënon integritetin e saj ose funksionimin jetësor dhe të shëndetshëm;
 - (j) e drejta për restaurim të plotë dhe të shpejtë [pas] shkeljes së të drejtave të njohura me këtë Deklaratë të shkaktuara nga aktivitetet e njeriut;
- (2) Çdo qenie ka të drejtën për një vend dhe për të luajtur rolin e saj në Nënën Tokë për funksionimin e saj në harmoni.
- (3) Çdo qenie ka të drejtën e mirëqenies dhe të jetojë pa tortura ose trajtim mizor nga qeniet njerëzore.

Neni 3: Detyrimet e qenieve njerëzore ndaj Nënës Tokë

- (1) Çdo qenie njerëzore është përgjegjëse për respektimin dhe për të jetuar në harmoni me Nënën Tokë.
- (2) Qeniet njerëzore, të gjitha Shtetet, dhe të gjitha institucionet publike dhe private duhet të:
 - (a) veprojnë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e njohura në këtë Deklaratë;
 - (b) njohin dhe promovojnë zbatimin e plotë dhe fuqizimin e të drejtave dhe detyrimeve të njohura në këtë Deklaratë;
 - (c) promovojnë dhe të marrin pjesë në mësimin, analizimin, interpretimin dhe komunikimin për mënyrën e të jetuarit në harmoni me Nënën Tokë në përputhje me këtë Deklaratë;
 - (d) sigurojnë që ndjekja e mirëqenies njerëzore t'i kontribuojë mirëqenies së Nënës Tokë, tani dhe në të ardhmen;
 - (e) krijojnë dhe zbatojnë norma dhe ligje efektive për mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave të Nënës Tokë;
 - (f) respektojnë, mbrojnë, ruajnë dhe kur është e nevojshme ta rivënë integritetin e cikleve ekologjike vitale, proceseve dhe balancave të Nënës Tokë;
 - (g) garantojnë që dëmet e shkaktuara nga shkeljet e të drejtave të natyrshme nga ana e njeriut të njohura në këtë Deklaratë të rregullohen dhe që përgjegjësit të mbahen përgjegjës për rivendosjen e integritetit dhe shëndetit të Nënës Tokë;
 - (h) të fuqizojnë qeniet njerëzore dhe institucionet për t'i mbrojtur të drejtat e Nënës Tokë dhe të të gjitha qenieve;
 - (i) vendosin masa parandaluese dhe kufizuese për të parandaluar aktivitetet e njeriut që rezultojnë me zhdukjen e specieve, shkatërrimin e ekosistemeve ose çrregullimin e cikleve ekologjike;
 - (j) garantojnë paqen dhe eliminimin e armëve bërthamore, kimike dhe biologjike;
 - (k) promovojnë dhe mbështesin praktikën e respektimit të Nënës Tokë dhe të gjitha qenieve, në përputhje me kulturat, traditat dhe zakonet e tyre;
 - (l) promovojnë sisteme ekonomike që janë në harmoni me Nënën Tokë dhe në përputhje me të drejtat e njohura në këtë Deklaratë.

59 <http://therightsofnature.org/universal-declaration/>

Indeksi për gjithpërfshirje: udhëzues për zhvillimin e shkollës të udhëhequr nga vlerat gjithpërfshirëse

Si duhet të jetojmë së bashku? Çfarë duhet të dimë për të jetuar mirë së bashku? *Indeksi* për gjithpërfshirje, i përkthyer tani në më shumë se dyzet e pesë gjuhë, ofron një trajtim ndryshe të këtyre pyetjeve filozofike të kamotshme. Përgjigja e tij ndaj pyetjes së parë është kuadri i vlerave gjithpërfshirëse. Implikimet për veprim të vlerave gjithpërfshirëse, të përforcuara me parime gjithpërfshirëse për mësimdhënie dhe mësimnxënie, janë të paraqitura në shtatëdhjetë tregues, duke i dhënë secilit prej tyre kuptim përmes pyetjeve sfiduese. Ato adresojnë detajet e aktiviteteve shkollore në klasa, sallat e stafit, sheshet e lojërave, komunitetin dhe mjedisin rrethues, dhe në marrëdhëniet ndërmjet dhe në mesin e fëmijëve dhe të rriturve. *Indeksi* bashkon ndërhyrjet që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë mjedisore, qytetarinë globale, promovimin e shëndetit, demokracinë, të drejtat dhe jo dhunën. Njerëzit mund të gjurmojnë shqetësimet e tyre më urgjente dhe më të rëndësishme në detajet e *Indeksit* dhe të gjejnë mënyra për t'i adresuar ato.

Përgjigja për pyetjen e dytë është një propozim i detajuar për një kurrikulë për shekullin 21, që pasqyron përvojën e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre, lidh aktivitetet në klasë me shqetësimet lokale dhe globale, duke përfshirë aktivitetin ekonomik. Secila fushë e lidh të kaluarën me të tashmen dhe të ardhmen.

Indeksi inkurajon rishikimin dhe zhvillimin bashkëpunues të kulturave, politikave dhe praktikave të shkollave. Përmes krijimit të kulturave gjithpërfshirëse përmirësimet në shkollë, duke përfshirë të gjitha arritjet e të gjithë fëmijëve, mund të jenë të qëndrueshme.

Stafi në shkollat fillore dhe të mesme të përfshira në pilotimin e edicionit të tretë kanë dhënë këto komente:

“ **Më pëlqeu shumë seksioni për vlerat. Është pikërisht ashtu si do të doja të mendoj për shkollën time kur të bëhem drejtoreshë e shkollës.** ”

“ ***Indeksi* i shton qartësi dhe fokus Ofsted-it.** ”

“ **I lehtë për t'u kyçur ose për ta lexuar nga fillimi në fund; është vetëvlerësimi juaj i bërë për juve por në një mënyrë shumë më të mirë.** ”

“ **Sistem mbështetës pa simbole, pa shënim të kutive për të ndihmuar me një sërë aktiviteteve zhvillimore, duke përfshirë riorganizimin e shkollës.** ”


“ **Më pëlqeu se mund të reflektojme dhe zhvillojmë një kurrikulë nëpërmjet tij. Më pëlqyen përditësimet sidomos dimensionin global.** ”

“ **Dokument që të bën të mendosh, jashtëzakonisht i dobishëm dhe sfidues.** ”

I qasshëm në:

Index for Inclusion Network
www.indexforinclusion.org
Contact info@inclusion.org

Blerja nga ne ndihmon për ta përhapur punën në zhvillimin e arsimit të udhëhequr



nga vlera gjithëpërfshirëse.